MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

KESHILLI I SHTETIT

LIGJE DEKRET LIGJE E RREGULLORE

TË VJETIT

1925

BKSH

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 2 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
TIRANË 1938

S 16
A
42

342.52 (496.5)(094.4)"1925"

R

BKSH

LIGJE
DEKRET LIGJE
RREGULLORE

BKSH

BKSH

MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

LIGJE DEKRET LIGJE e RREGULLORE

TË VJETIT

1925

BKSH

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 2 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
TIRANË 1938

BKSH

SHTYPUR NË SHTYPSHKRONJËN „TIRANA" NË TIRANË

STATUTI THEMELTAR
I
REPUBLIKËS SHQIPTARE

(i botuem në Fletoren Zyrtare, d. 7 Mars 1925, Nr. 8)

Kombi Shqiptar, i lirë dhe indipendent, kryenaltë për kohën e tij të kalueme dhe plot besim për kohën e ardhëdhëshme, në Kuvendin Kushtetuës vendon këtë Statut.

KAPTINË I.
FORMIM' I SHTETIT

Pjesa A.
DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Art. 1.—Shqipnija asht Republikë Parlamentare e Kryesueme prej nji Kryetari. Sovraniteti buron prej popullit.

Art. 2.—Republika Shqiptare, asht indipendente, e pa-ndame, tanësija toksore e sajë e padhunueshme edhe toka e sajë e pajetërtueshme.

Art. 3.—Flamuri Kombëtar, asht i kuq me shqipe të zezë dy krenshe në mes.

Art. 4.—Shqipja asht gjuha zyrtare.

Art. 5.—Republika Shqiptare s' ka fé zyrtare.

Të gjitha fét e besimet janë të nderueme dhe liria e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyne asht e sigurueme.

Feja nuk mund të formojë pengime juridike me as-nji mënyrë.

Fét e besimet kurrsesi nuk mund të përdoren për qëllime politike.

Art. 6.—Tirana asht Kryeqyteti i Shqipnis.

Art. 7.—Pushteti legjislativ ushtrohet prej Senatit e Dhomës së Deputetve si mbas këtij Statuti.

BKSH

Art. 8. – Pushteti përmbaruës i përket vetëm Kryetarit të Republikës, i cili e ushtron me anën e Ministravet.

Art. 9. – Pushteti gjyqsuer ushtrohet prej gjykatavet dhe vendimet e tyne epen n' emën të Republikës Shqiptare.

Pjesa B.

I.
PUSHTETI LEGJISLATIV

DHOMA E DEPUTETVET

Art. 10. – Përfaqësija Kombëtare përmblidhet në dy trupa: prej Dhomës së Deputetve, e përbame prej deputetësh të zgjedhun nga populli, dhe prej Senatit, i përbamë prej Senatorve, të zgjedhun si mbas ligjës së posaçme.

Art. 11. – Deputetët zgjidhen për 4 (katër) vjet dhe për ç'do 15.000 frymë nji.

Art. 12. – As kush nuk mund të pranohet për deputet pa qenë shtetas Shqiptar, pa pasë mbushun moshën 30 vjetshe, pa gëzuem të drejtat civile e politike dhe pa pasun të gjitha cilësit e tjera të lypuna prej ligjës.

Art. 13. – Cilësija e deputetit asht e pa-pajtueshme me ç'do nëpunësi të Shtetit me rrogë ose me nëpunësi komunale, ose me shërbimin aktiv fetar.

Art. 14. – Deputeti nuk përfaqëson vetëm qarkun qi e ka zgjedhun, por kombin përgjithësisht.

Art. 15. – Deputetit nuk munt t' i epet as nji porosi urdhënore prej zgjedhësvet të vet.

Art. 16. – Deputetët kanë të drejtë me marrë nji shpërblim prej 5.000 fr. ari në vjet. Këjo shumë mund të ndryshohet herë pas here me ligjë.

Art. 17. – Mënyra e ushtrimit të zyravet të Dhomës së deputetvet, caktohet në rregulloren e mbrendëshme të saj.

Art. 18. – Parija e Dhomës së deputetve zgjidhet prej saj, dhe në gjî të saj, në nisje të ç'do sesioni, për gjith vijimin e tij deri në fillim të tjetrit. Zgjedhja e paris dhe emnimi i nëpunësve të Dhomës së Deputetve, bahen mbas rregullores së mbrendëshme të saj.

Art. 19. – Dhoma e deputetve shqyrton fuqít e cilësít ligjore

BKSH

të misvet të vet, dhe gjykon e vendon mbi tâ mbas parashkresavet të rregullores së mbrendëshme të saj.

Art. 20. – Ç'do Mis i Dhomës së deputetve, asht i detyruem me bamun dy bé; njanën përpara se të shqyrtohen fuqít e cilësít e tija, dhe tjetrën përpara se të nisë detyrën e tij si Deputet.

Beja e parë asht këjo: „Betohem n' emën të Perëndis e mbi nderin t' em se kam për të kryem detyrën e shqyrtimit me ndërgjegje e asnjianësi të plotë."

Beja e dytë do të bahet me këto fjalë:

„Betohem n' emën të Perëndis e mbi nderin t' em se kam për të ruejtun besnikrisht mëvehtësin e tanësin toksore të Shqipnis, se kam për t' i ndêjun besnik Atdheut e Republikës dhe për t' u dalun zot Statutit e ligjevet të Shtetit, e se kam për të kryem detyrën t' eme me ndërgjegje të plotë për të mirën e përgjithëshme pa u penguem as pak prej interesash të veçanta a krahine."

Art. 21. – Deputeti i zgjedhun rishtas qi, pa shkake të justifikuëshme të vërtetueme siç duhet, nuk paraqitet deri në dy muej përpara Dhomës së deputetve për të bamë bén e detyrshme, quhet i ramë nga deputetsija.

Gjykimi mbi pranueshmin a mos të shkakevet justifikative, i përket Dhomës së deputetve.

Art. 22. – Deputeti qi për dy muej rrjesht mungon prej mbledhjevet pa auktorizimin e Dhomës së deputetve, quhet vetiu i rrëxuem nga deputetsija.

Art. 23. – Kur, për ç'do arsye qi të jetë, mbetet zbrazët vëndi i nji deputeti, mbrenda dy muejsh prej ditës së zbrasjes, por jo ma parë se nji muej, duhet zgjedhun nji tjetër në vend të tij.

Art. 24. – Dhoma e deputetve mblidhet vetiu dy herë në vjetë në dy sesjone të rregullshme të tremuejshëm.

I pari sesjon fillon më 15 Shtatuer e mbaron më 15 Dhetuer dhe i dyti fillon më 1 Mars dhe mbaron më 31 Maj të ç'do viti.

Art. 25. – Deputetvet nuk mund t' u kërkohen përgjegjësi për mendimet e shfaquna e për votat e dhanuna në Dhomën e deputetve.

Art. 26. – Në kohë të sesjonit, deputetët nuk mund të gjinden të burgosun për borxh.

Gjith ashtu, në kohë të sesjonit, nuk mund të ndiqen as t' arestohen për çashtje penale, pa lejen e vendimin e Dhomës,

veç se n' u kapshin në faj e sipër për krim. Në këtë rast auktoritetet giyqsore janë të detyruem me lajmue Dhomën e deputetve, mbrënda 24 orësh me anë të Ministris së Drejtësis.

Për delikte e krime politike deputetët gjykohen dhe dënohen kurdoherë, domethanë mbrënda e jasht sesjonit, prej Gjyqit të naltë me auktorizimin e Dhomës si mbas ligjës së posaçme.

Art. 27. — Dhoma e deputetve, ka të drejtë me dekretue lirimin e nji misi të vet për gjithë kohën e sesjonit, në qoftë se ka qenë zanë në periudhë të pushimevet, me përjashtimin e atyne qi janë zânë për krime.

Art. 28. — Në sesjon të jashtzakonshëm bisedohen vetëm ato sende që e kanë shkaktuem, të cilat do të caktohen në programën e pregatitun prej Qeveris.

Kryetari i Republikës ka të drejtë me e mbyllun këtë sesjon kur do qi t'a shohë me arsye, por gjithmonë ma parë se të nisë sesjoni i zakonthëm.

Art. 29. — Në të hapun të sesjonit të parë të zakonshëm, Kryetari i Republikës me nji ligjiratë ase lajmesë, parashtron gjëndjen e përgjithshme të vëndit e masat e gjykueme të nevojshme për me u marrë atë mot prej Pushtetit përmbaruës, dhe Dhoma i ban nji përgjegje sa ma të shpejtë.

Art. 30. — Dhoma e deputetve nuk mund të bisedojë e të vendojë pa qênë pranë nji ma shum se gjysma e të gjithë misvet të saj qi kanë kaluem ndëpër formatitetet e artikujvet 19 e 20.

Nuk njehen në numër të përgjithshëm ata qi mungojnë me leje.

Art. 31. — Të gjitha vendimet votohen me shumicë absolute të deputetvet qi gjinden pranë.

Zgjedhjet qi i përkasin personave, në qoftë se nuk votohen për herën e parë me shumicë absolute, herën e dytë votohen me shumicën relative të deputetve të mbledhun.

Art. 32. — Votimi i ligjvet bahet nji herë parimisht e dy herë artikull për artikull në tri ditë të ndryshme.

Votimet për kodet e paraqitun prej Qeveris e të pregatituna prej nji komisije të posaçme të krijueme me ligjë, bahen toksisht (en bloc) në tri mbledhje në ditë të ndryshme, për veç ligjevet, qi Dhoma me vendim i quen të ngutshme, të cilat votohen mbas rregullores së mbrendëshme.

Art. 33 — Mbledhjet e Dhomës së deputetve, bahen botnisht. Për veç gjindjes s' armëvet kushdo tjetër mundet me marrë pjesë

në to në konformitet me rregulloren. Bisedimet e Dhomës botohen në vëllime të posaçme.

Art. 34. – Dhoma e deputetve, mund të bisedojë edhe në mbledhje të fshehtë në qoftë se kërkohet prej ministërvet ase prej pesë deputetvet e në qoftë se pranohet prej shumicës, mbassi të kenë lanë Dhomën të gjithë ata qi s' janë deputetë.

Art. 35. – Dhoma e deputetve asht e pa dhunuëshme. Asnji zyrtar a fuqi armësh, për veç trupit policuer me shenjë të veçantë, nuk mund të vehet mbrenda Dhomës ase te porta e ndërtesës ku mblidhen deputetët pa vendim e kërkim të Dhomës.

Art. 36. – Ç'do akt me fuqi ligjore do të shpallet në gazetën zyrtare, e cila u dërgohet të gjitha Bashkive të Shqipnis.

Shpallja do të bahet të shumtën dy javë mbas votimit dhe akti hyn në fuqi e zbatim nji muej mbas shpalljes, për veç atyne ligjevet qi caktojnë nji afat të ndryshëm për të hyemit e tyne në fuqi.

Aktet me fuqi ligjore do t' inserohen në mbështjelljen zyrtare të ligjevet e të dekretevet.

Art. 37. – Parija e Dhomës asht e detyrueme mbrënda në sesjon me i këthyem Pushtetit përmbaruës ç'do projekt të paraqitun prej tij e të refuzuem prej Dhomës me gjithë arsyet e mos pëlqimit.

Art. 38. – Asnji projekt-ligjë që s' pëlqehet prej Dhomës së deputetve, nuk mund të paraqitet për bisedim nji herë të dytë po n' atë sesjon.

Art. 39. – Për gjith vjetë, Pushteti përmbarues do t' i paraqesë Dhomës së deputetve për shqyrtim e pëlqim Bugjetin e përgjithëshëm t' ardhunavet e të prishunavet të Shtetit, bashkë me parashtresën e mënyravet e të mjetevet mbas të cilavet do t' u bajë ballë atyne shpenzimevet.

Të gjitha t' ardhunat e shpenzimet e Shtetit, do të futen në Bugjet.

Bugjeti do të paraqitet gjithmonë në hapjen e sesjonit vjeshtuer, i cili s' mund të mbyllet pa u-votue Bugjeti.

Mënyra e hartimit të Bugjetit, bahet me ligjë. Bugjeti votohet kaptinë për kaptinë, dy herë në dy ditë të ndryshme.

Pushteti përmbarues, në mbarim të vitit financjar dhe mbrënda në sesjonin e dytë të vitit financjar tjetër, do t' i paraqesë Dhomës së deputetve për shqyrtim e pëlqim Bugjetin konsomptif të motit të kaluem, i cili votohet nji herë përgjithësisht.

Art. 40.—Kur, për ç'do arsye qi të jetë nuk arrijnë me marrë formën ligjore definitive Bugjeti i ri deri në fillim të vjetit financjar për të cilin asht pregatitun, Pushteti përmbarues ven në zbatim atë ma të përparshmin për aqë kohë sa do të vonojë pëlqimi e votimi i të riut.

Në rasë qi Dhoma asht çelun, at'herë këjo i hap nji kredit të përmuejshëm se cilës degë t'administratës, por ky kredit nuk mund të kapërcejë nji të dymbëdhjetën pjesë të shpenzimevet të zakonshme qi i përkasin mbas Bugjetit të vjetër.

Art. 41.—Pushteti përmbaruës nën përgjegjësin e tij civile, detyrohet të shënojë në bugjetin e përvitshëm të Shtetit ç'do ligjë qi ngarkon shtetasit me paga e taksa.

Ligjet qi nuk shenjohen në Bugjet, quhen si të ngrituna e të pa fuqi ligjore.

Art. 42.—Kur nji kredit i dhanun në bugjet nuk mjafton për atë shërbim, Pushteti Përmbaruës me nji dekret ligjë mbrënda në motin financjar, kërkon prej Dhomës shtimin e atij krediti deri sa t'arrijë, dhe, kur shfaqen shpenzime për nevoja të paparapame në Bugjet, Pushteti Përmbaruës përsëri mund të kërkojë prej Dhomës nji shtesë krediti, gjithnji në themel të nji projekt-ligjës së posaçme.

Ligjet për kredite suplementare ashtu dhe të jashtzakonshme, votohen si ligjet e zakonshme.

Në rasa lufte, kryengritjeje e kalamiteti publik kur Dhoma e deputetve gjindet në pushim, Qeverija mundet me dekret-ligjë të krijojë nji kredit të jashtzakonshëm nën përgjegjësin' e saj.

Kjo dekret-ligjë i duhet paraqitun Dhomës në sesjonin e afërm.

Art. 43.—Dhoma e deputetve ka të drejtë të thërrasë përpara saj cilindo nga Ministrat për me pyetun mbi ç'do çashtje qi i përket degës së tij,

Mënyra e thirrjes dhe e shfaqjes së Ministravet, caktohet në rregulloren e mbrendëshme.

Art. 44.—Dhoma e deputetve kontrollon Qeverin.

Për mbrojtjen e interesave të përgjithëshme, Dhoma detyrohet, në ç'do rasë të veçantë, të formojë prej gjinit të vet Komisi hetimesh për të studjuem çashtjet e faktet qi lidhen me to. Komisit hetuëse kanë të drejtë me kërkuem shpjegime me gojë e me shkrim, si prej auktoritetevet botore ashtu edhe prej privatve. Mund të këqyrin edhe të gjitha aktet zyrtare qi t'u duken të nevojshme.

Art. 45.—Dhoma e deputetve akuzon Ministrat e i dërgon përpara Gjyqit të Naltë të Shtetit në bazë të ligjës së veçantë.

Art. 46.—Dhoma e deputetve nuk mund të pranojë deputetsi as të ndigjojë të tjerë për veç ministërvet ase zavendësvet të këtyne me përjashtimin e rasës së parapame në Art. 29.

Art 47.—Në mbarim të periudhës ase në rasë të shpërndarjes së Dhomës së deputetve, Pushteti përmbaruës detyrohet mbrenda në dy javë prej ditës së shpërndarjes së saj të dekretojë zgjedhjet e reja parlamentare, të cilat duhen bamë jo ma vonë se dy muej e gjymës dhe jo ma parë se nji muej prej datës së dekretit.

Në qoftë se, për shkake të pa prituna, periudha e Dhomës së deputetve merr fund, ma tepër se nji muej përpara kohës së caktueme në Statut, Dhoma e ré mblidhet vetiu pesëmbëdhet ditë pas zgjedhjeve. Në qoftë se në kohën mbas mbarimit të periudhës parlamentare dhe pa u bamë zgjedhjet e reja, Pushteti përmbaruës gjindet i shtrënguem me shpallë luftë ase me dhanë dorëhekjen Kryetari i Republikës, me dekret të këtij të fundit ase të zavëndësit të këtij, thëritet Dhoma e vjetër për aprovimin e dekret-ligjës për luftë ase për pranimin e dorhekjes së Kryetarit të Republikës dhe për zgjedhjen e Kryetarit të rí si mbas këtij Statuti.

Art. 48.—Trupi Ministruer e Ministrat votë-besimin e marrin vetëm prej Dhomës së deputetve.

B. II.
SENATI

Art. 49.—Senati përbâhet prej 18 vetësh të zgjedhun, dy të tretat prej popullit si mbas ligjës së posaçme dhe nji e treta prej Kryetarit të Republikës.

Kryetari i Senatit zgjidhet nga Kryetari i Republikës midis 18 Senatorvet.

Kur për ç'do arsye qi të jetë mbetet zbrazët vendi i ndonji Senatori nga dy të tretat përpara se të zbatohet ligja e posaçme mbi zgjedhjen e Senatorvet, mblidhen së bashku Senati e Dhoma e deputetvet dhe me shumicë votash zgjedhin Senatorin a Senatorët qi mungojnë.

Senatorët zgjidhen për gjashtë vjet.

Sa për këtë herë dy të tretat e Senatorvet zgjidhen prej Kuvendit Kushtetues.

Art. 50. – Senatorët detyrohen të betohen në Dhomën e tyne në mënyrën e caktueme n' art. 20 për deputetët.

Art. 51. – Në rast të mbledhjes së përbashkët të Senatit e të Dhomës së deputetvet, kryesín e mbledhjes e mban Kryetari i Senatit dhe veprohet mbas rregullores së Dhomës së deputetvet.

Art. 52. – As kush nuk mund të zgjidhet për senator pa pasë mbushun moshën 40 vjetshe, dhe pa pasun, për veç cilësive të caktueme në art. 12 për deputetët, njanën nga cilësit e poshtshenjueme:

A) Diplomë të ndonji shkollës së naltë.

B) Ish Ministër apo ish Deputet.

C) Zyrtar i naltë civil a ushtrijak, qi me prova të kjarta të ketë treguem atdhetarizëm, zotsi të plotë e bindësí në ligjet.

D) Tregtar a industrial i madh qi të ketë treguem zotsí të plotë e të jetë i njoftun në fushën ekonomike.

Art. 53. – Ç'do projekt-ligjë e pranueme prej Dhomës së deputetvet para se t' i parashtrohet Kryetarit të Republikës për aprovim, do të shkojë në Senat për shqyrtim e votim.

Art. 54. – Ç'do projekt-ligjë e pranuëme prej Dhomës së deputetve, vehet në bisedim prej Senatit mbrënda nji mueji prej ditës së paraqitjes të projektit, kur sesjoni asht i çelun; për kundrazi quhet i pranuem dhe i parashtrohet Kryetarit të Republikës.

Kur për ç'do arsye qi të jetë, nji pjesë apo të gjithë Senatorët, nuk marrin pjesë në mbledhje të përbashkët mbrenda nji mueji prej ditës së caktueme atëherë Dhoma e deputetvet mblidhet bashkë me Senatorët qi mund të ndodhen, dhe në mos u-ndodhët as nji, mblidhet vetëm Dhoma e deputetvet dhe procedojnë së bashku apo vetëm Dhoma në veprën qi ka shkaktue mbledhjen e përbashkët.

Art. 55. – Ç'do projekt ligjë e refuzueme nji herë prej Senatit nuk mund të paraqitet përsëri po n' atë sesjon.

Art. 56. – Në qoftë se Dhoma e deputetvet, has në kundrështime me Senatin mbi ndonji vendim apo ligjë, dhe Dhoma insiston në mendimin e vet, Kryetari i Republikës ka të drejtë, me pëlqimin e Senatit, të shpërndajë Dhomën e deputetve.

Në qoftë se edhe Dhoma e ré insiston në mendimin e Dhomës së parë, at-herë vendimi i Dhomës së ré asht i prémë.

Art. 57. — Në rasë trathëtije të naltë, atentate kundra sigurimit të Shtetit dhe akuzime Ministrash prej Dhomës së deputetvet, me dekretin e Kryetarit të Republikës, ngrifet Gjyqi i Naltë. Në këtë rasë, Gjyqi i Naltë përbahet prej pesë senatorvet e prej dy kryetarvet të Gjyqit të Diktimit. Detyrat e Prokurorit i ban nji Komisi Parlamentare prej katër deputetvet bashkë me Kryeprokurorin e Diktimit. Në këtë rasë, këta pesë Senatora, dalin nga trupi politik dhe bahen trup gjykuës.

Art. 58. — Senatorët gëzojnë të gjitha të drejtat e caktueme për deputetët të shenjueme në këtë Statut.

Art. 59. — Senati mblidhet po n' ato sesjone qi mblidhet Dhoma e deputetvet.

As njana Dhomë nuk mund të hapet pa qenë e mbledhun dhe tjetra.

Art. 60. — Senatorët kanë të drejtë me marrë shpërblim prej 6.000 dhe Kryetari i tyne prej 10.800 fr. ari në vjetë.

Këjo shumë mund të ndryshohet herë pas here me ligjë.

Art. 61. — Parija e Senatit, për veç kryetarit, zgjidhet në mënyrën e caktueme n' art. 18 të Statutit për parín e Dhomës së deputetvet.

Art. 62. — Senati me rregulloren e mbrendëshme të tij cakton mënyrën mbas së cilës ai do të kryejë detyrat e veta, në konformitet me këtë Statut.

Art. 63. — Senatori i zgjedhun rishtas si prej popullit ashtu dhe prej Kryetarit të Republikës, qi pa shkake të justifikueshme siç duhet, nuk paraqitet deri në dy muej përpara Senatit për të bamë benë e ndryshme, quhet i ramë nga Senatorija.

Gjykimi mbi pranueshmenin a mos të shkaqevet justifikative, i përket Senatit.

Art. 64. — Senatori qi për dy muej rrjesht mungon prej mbledhjevet pa autorizimin e Senatit, quhet vetiu i rrëxuem nga Senatorija.

Art. 65. — Cilsija e Senatorit asht e pa pajtueshme me ç'do nëpunësi të Shtetit me rrogë, ase me nëpunësi komunale, ase me shërbimin aktiv fetar.

Art. 66. — Mbledhjet e Senatit bahen në mënyrën e caktueme për deputetët në këtë Statut.

Art. 67. — Senati shqyrton fuqit e cilsit ligjore të misvet të

vet, dhe gjykon e vendon mbi ta mbas parashkresavet të rregullores së mbrendëshme të tij.

Art. 68.—Senati deri sa të bajë rregulloren e vet, vepron mbas rregullores së mbrendëshme të Dhomës së deputetvet.

Pjesa C.

PUSHTETI PËRMBARUËS

KRYESIJA E REPUBLIKËS

Art. 69.—Kryetari i Republikës zgjidhet prej mbledhjes së përbashkët të Senatit e të Dhomës së deputetvet për shtat vjet, me shumicë absolute votash, dhe në qoftë se për dy herë rresht nuk zgjidhet me shumicë absolute, herën e tretë zgjidhet me shumicë relative votash. Sa për këtë herë, zgjidhet prej Kuvendit Kushtetuës.

Art. 70.—As kush nuk mund të zgjidhet Kryetar i Republikës pa qenë Shqiptar me racë e me gjuhë, pa qenë shtetas Shqiptar, pa gëzuem të drejtat civile e politike dhe pa pasun të gjitha cilësit e tjera të lypuna për deputet.

Art. 71.—Periudha shtat vjetshe fillon qysh prej ditës së zgjedhjes. Nji muej para mbarimit të kësaj periudhe, bahet zgjedhja e ré.

Art. 72.—Kryetari i Republikës pa hymun në detyrë, betohet përpara Senatit e Dhomës së deputetvet mbas kësaj formule: „Betohem n' emën të Perëndis e mbi nderin t' em se kam për të qenë ruejtës besnik i mëvetësis e i tansis toksore të Shqipnis, i Republikës, si edhe i Statutit e i ligjvet të Shtetit."

Sa për këtë herë betohet përpara Kuvëndit Kushtetuës.

Art. 73.—Kryetari i Republikës ka të drejtë me marrë nji shpërblim prej 10.000 fr. ari në muej.

Këjo shumë mund të ndryshohet herë pas here me ligjë.

Shpenzimet e shtëpis zyrtare të Kryetarit të Republikës, rregullohen me ligjë të veçantë.

Art. 74.—Kryetari i Republikës asht i pa përgjegjshëm, veçse për trathëti të naltë dhe për aktet e tij qi nuk kanë kundërfirmën e Ministrit ase të Ministravet kompetent.

Art. 75.—Kryetari i Republikës, asht kreu mâ i naltë i Shtetit, ka Komandën e Përgjithshme të fuqive t' armatosuna, emnon e ç'emnon Ministrat e zgjedhun prej tij, nëpunësit e naltë të

BKSh

Shtetit dhe gjith oficerët e fuqive t' armatisuna, asht drejtuesi i politikës së Shtetit edhe ka të drejtë me bamë traktate e marrëveshtje gjith-farësh me Shtetet e huej me pëlqimin e dy Dhomave, dhe me pranue e akreditue trupa diplomatike.

Kryetari i Republikës nuk ka të drejtë me shpallë luftë e me bamë paqe pa pëlqimin e Senatit e të Dhomës së deputetve, veç se në rasë mprojtjeje.

Art. 76. – Kryetari i Republikës urdhënon shpalljen e zbatimin e projekt-ligjeve të votueme prej dy Dhomave. Ka edhe të drejtën e veto-s.

Art. 77. – Në qoftë se trupat Ministruer me ndryshime nuk marrin për dy herë rrjesht votëbesimin e Dhomës së deputetvet, Kryetari i Republikës ka të drejtë të shpërndajë Dhomën; por në qoftë se edhe Dhoma e ré nuk i jep vot-besimin, at-herë rrëxohet trupi Ministruer.

Deri sa të marri fund konflikti, qindrojnë në fuqi Ministrat e fundit qi nuk muerrën votëbesimin e Dhomës së deputetvet të shpërndame.

Art. 78. – Kryetari i Republikës ka të drejtën e faljes (grace).

Propozimi i ligjës për amnisti i përket vetëm pushtetit përmbaruës.

Art. 79. – Kryetari i Republikës mund të thërrasë dy Dhomat në mbledhje të jashtzakonshme.

Art. 80. – Propozimi i ligjevet i përket pushtetit përmbaruës dhe Senatit e Dhomës së deputetvet, por, propozimi i ligjeve qi sjellin me vete shtesa ase barrë financjare, i përket vetëm pushtetit përmbaruës.

Art. 81. – As nji akt i Kryetarit të Republikës nuk ka vleftë pa kundërfirmën e Ministrit ase Ministravet kompetentë.

Art. 82. – Në kohë kryengritjeje, luftë të mbrendëshme ase të jashtme, mobilizimi të përgjithshëm, ase kalamiteti publik, Kryesija e Republikës nën përgjegjësin e trupit Ministruer shpallë shtetin e rrethimit, dhe ven në zbatim ligjën relative në gjithë tokën e Shtetit ase në ndonji copë të sajë; në qoftë se Dhomat janë të mbledhuna, duhet marrë auktorizimi, dhe në qoftë se Dhomat nuk ndodhen të mbledhuna, Pushteti përmbaruës e ven në zbatim, por dekreti i shpalljes së shtetrrethimit i duhet paraqitun Dhomavet në fillim të sesjonit t' afërmë.

Dekreti i shpalljes së shtetrrethimit i paraqitet Dhomës së deputetvet mbas mbledhjes së saj për aprovim ase refuzim, e

cila mbrenda 30 (tridhjet) ditve prej datës së paraqitjes të këtij dekreti, ep vendimin e refuzimit, ase t' aprovimit të tij.

Nji ligjë e posaçme ka me rregullue pezullimin e nenevet të Statutit relativ me lirin personale, të drejtën e mbledhjevet, të drejtën e shoqnimit, padhunueshmin e banimit, lirin e fjalës e të shtypit dhe fshehtësin e letravet.

Këjo ligjë mund të vehet në zbatim e tanë, ase pjesësisht. Në rasë qi s' ka Dhomë deputetësh, thërritet Dhoma e përparshme vetëm për qëllimet e sipër-tregueme, dhe këta deputetë, sa për këtë detyrë, gëzojnë gjithë imunitetet e deputetit.

Art. 83. – Kryetari i Republikës kryeson Ministrat e emnuem prej tij; por këta duhet të paraqiten përpara Dhomës së deputetve jo ma vonë se 5 ditë mbas ditës s' emnimit tue shpallun programën e tyne për të marrë votëbesimin, për ndryshe, quhen sikur kanë marrë votë mos besimi.

Art. 84. – Në rasë vdekje, sëmundjeje të pa-shërueshme qi ndalon veprimin, dorëheqje të Kryetarit të Republikës, në qoftë se trupat legjislative ndodhen të mbledhuna at ças zgjedhin Kryetarin e rí të Republikës, dhe në mos qofshin të mbledhuna, Kryetari i Senatit vetiu zavendëson kryesin e Republikës dhe m' at ças mblidhen vetiu dy Dhomat legjislative për të zgjedhun Kryetarin e rí të Republikës.

Për veç rasave të sipërpërmënduna, në mungesë të Kryetarit të Republikës, zavendëson Kryetari i Senatit, dhe në mungesë të këtij të fundit, Kryetari i Dhomës së deputetvet.

MINISTRAT

Art. 85. – Ministër mund t' emnohet kushdo qi ka cilësit e lypuna prej ligjës për t' u zgjedhun deputet.

Nuk mund t' emnohen ministër gjinít prej gjaku të Kryetarit të Republikës dhe të Kryetarit të Senatit deri në gradë të dytë; gjith-ashtu dy gjiní prej gjaku deri në gradë të tretë gjith n' atë trup Ministruer.

Të huejt prej race, qi natyralizohen shtetas shqiptar, nuk mund t' emnohen Ministër.

Art. 86. – Ministrat hyjnë lirisht në Senat e në Dhomën e deputetvet dhe ndigjohen kurdoherë qi kërkojnë fjalën, por votojnë nër Dhomat e tyne, vetëm ata qi janë Senatora dhe Deputetë.

Art. 87.—Ministrat, pa hymë në detyrë betohen përpara Kryetarit të Republikës.

Art. 88.—Kur trupat legjislative ndodhen në pushim, Qeverija ka të drejtë me bamë dekret-ligjë; por këto do t' i parashtrohen pushtetit legjislatif në fillim të sesjonit t' afërmë për shqyrtim e pranim.

Në qoftë se nuk paraqiten ose nuk pranohen, quhen vetiu të rrëxueme.

Art. 89.—Ministrat janë të përgjegjshëm politikisht përpara Dhomës së deputetvet, solidarisht për politikën e përgjithëshme të tyne dhe ç'do Ministër veçanërisht për veprat e veta.

Art. 90.—Askurr urdhëni i Kryetarit të Republikës nuk mund të lirojë ministrat prej përgjegjësis së tyne.

Art. 91.—Ministrat gëzojnë imunitetin parlamentar.

Art. 92.—Në ç'do shfaqje të Ministravet, Ministri i Drejtësis mbanë vendin kryesor.

KËSHILLI KONTROLLUËS I FINANCAVET

Art. 93.—Financat e Shtetit kontrollohen prej Këshillit Kontrollues të Financavet.

Art. 94.—Organizimi i këtij Këshilli, mënyra e ushtrimit të zyravet të tij dhe cilësit e misvet qi e përbâjnë, caktohen në ligjën e posaçme.

Art. 95.—Të drejtat e këtij Këshilli janë kontrolli parashikuës (preventiv) e ndeshkuës (represiv) i llogarive të gjithë administratës së Shtetit si edhe qi caktohen në ligjën e posaçme.

Art. 96.—Kryetari dhe anëtarët e këtij Këshilli emnohen prej Kryetarit të Republikës dhe nënpunsit e tjerë, si mbas ligjës.

Art. 97.—Patundëshmija e Këshillit Kontrolluës të financavet, sigurohet në mënyrën e caktuëme në këtë Statut për misët e Gjyqit të Diktimit, me ndryshimin qi asht vetëm për pesë vjet çë prej ditës s' emnimit të së cilit prej tyne.

Pjesa D.

PUSHTETI GJYQSUËR

Art. 98.—Gjykatat janë independente. Në të dhanunit e gjykimevet të veta, nuk dipendojnë prej as nji tjetër auktoriteti veç se prej atij të ligjës.

As nji pushtet i shtetit, as legjislativ as përmbaruës, nuk mund të trazohet në punët gjyqsore.

Art. 99. – As njeri nuk mund të thëritet as të gjykohet prej nji tjetër gjykate veçse prej asaj, të cilës i përket ligjorisht. Me as nji mënyrë nuk mund të formohen gjykata të jashtzakonshme për gjykime mbi rasa të veçanta.

Art. 100. – Bisedimet përpara gjykatavet, bahen botnisht veçse n' ato rasa kur gjyqtarët e shohin me udhë qi të mbajnë dyrët të mbylluna n' interesë të qetsis botore e të moralit.

Gjyqtarët vendojnë e votojnë fshehtas, por gjykimet e dhanuna shqiptohen me zâ të naltë e botnisht.

Ç'do gjykim duhet të përmbajë arsyet nji nga nji dhe artikujt e ligjës ku mbështetet.

Art. 101. – Ç'do njeri i pandehun me krim, duhet të ketë nji mprojtës çë prej ditës qi vehet nen akuzim. Në qoftë se ai nuk kujdeset për të marrë mprojtës, atëherë gjykata i a emnon vetiut.

Art. 102. – Të gjithë gjyqtarët e prokurorët emnohen me dekret të Kryetarit të Republikës mbas propozimit të Ministris së Drejtësis në bazë të zgjedhjes së bamun prej nji komisije të posaçme. Këjo komisi do të ketë për Kryetar Ministrin e Drejtësis e për misa Sekretarin e përgjithshëm të Ministris së Drejtësis, kryetarët dhe kryeprokurorin e Diktimit.

Cilësit e gjyqtarvet e të prokurorvet, do të caktohen me ligjë.

Art. 103. – Gjyqtarvet e prokurorvet u sigurohet patundshmija prej zyrës së tyne.

Nji gjyqtar, për as nji arsye nuk mund të pushohet nga puna kundër dëshirës së tij veçse në bazë të nji gjykimi të dhanun prej nji gjykate kompetente apo të nji gjykimi të Gjykatës së Diktimit për faje disiplinore.

Nji gjyqtar nuk mund të thëritet në gjyq për akte qi i përkasin zyrës së tij pa vendimin e gjykatës së Diktimit. Vendimi i auktoritetit kompetent për të futunit nën akuzim të nji gjyqtari, sjellë me vete pezullimin e tij nga puna në rasat e parapame prej ligjës. Nji gjyqtar nuk mund të shpërngulet veçse në qoftë se dëfton mâ parë me shkrim se e pëlqen vendin e ri.

Nji gjyqtar nuk mund të vehet në pensjon kundër pëlqimit të tij veçse kur të ketë mbushun vjetet e shërbimit, apo të ketë kaptuem moshën e caktueme prej ligjës, ase kur sëmundjet fizike a mendore e bâjnë të pa zotin për shërbim. Në këtë rasën

e mbrame të vumit e tij në pensjon, do të bahet në bazë të nji vendimi të dhanun nga gjykata e Diktimit.

Mënyra për të futunit nën akuzim e për gjykimin për faje disiplinore të misvet të gjykatës së Diktimit, do të rregullohet me nji ligjë të posaçme.

Art. 104. – Gjyqtarët n' as nji mënyrë nuk mund të vehen në dispozitshmi.

Art. 105. – Nji gjyqtar nuk mund të pranojë as nji tjetër nëpunsi n' administratën botore, as me rrogë as pa rrogë.

Art. 106. – Gjyqtarët janë rreptësisht të ndaluem të merren me politikë. Për ndryshe pushohen nga puna.

Art. 107. – Vetëm gjyqtarët qi kanë cilësit e parapame prej ligjës qi do të bahet gëzojnë të drejtat e caktueme në këtë kaptinë mbas tre vjetësh shërbimi.

KAPTINË II.

DISPOZITA TË NDRYSHME

Art. 108. – Shteti Shqiptar as njeh as ndanë tituj fisnikije.

Art. 109. – Ndërpretimi autentik i ligjevet, i përket pushtetit legjislativ.

Art. 110. – Asnji organizim Shteti nuk mund të bahet as të të ndryshohet veçse me ligjë.

Asnji nëpunsi nuk mund të krijohet veçse me ligjë.

Qarshkrimet administrative, gjyqsore, ushtrijake dhe të ç'do dege tjetër, si dhe ndrimet e qendravet të tyne, rregullohen vetëm me ligjë.

Art. 111. – Shërbimi ushtrijak, asht i detyrshëm për të gjithë shtetasit shqiptar si mbas ligjës, për veç përjashtimevet të caktueme prej saj.

Art. 112. – Asnji e drejtë, ç'fare do qi të jetë dhe kujdo qi t' i përkasë, nuk mund të krijohet as të shuhet veçse me ligjë.

Art. 113. – Të gjithë bashkajapin në përpjesë të pasunis së vet për nevojat financjare të Shtetit. Asnji pagë ose taksë nuk mund të vehet as të mblidhet veç se me ligjë; vetëm kur impozohet ose shtohet taksë doganore e cila mund të mblidhet prej ditës së paraqitjes para Dhomës së deputetvet të projektit relativ, i cili duhet të votohet mbrenda në sesjonin në të cilin u paraqit.

Art. 114. – Asnji privilegjë nuk mund t' i bahet kuj përsa u përket pagave e taksavet.

Ç'do shkarkim a lehtësim do të rrjedhë prej nji ligje.

Art. 115. – Asnji shpenzim nuk mund të bahet pa nji ligjë autorizuese.

Art. 116. – Asnji rrogë, shpërblim a pensjon mbi kurriz të thesarit botuer nuk mund t' i lidhet a t' i epet kuj, veçse mbas ligjës.

Art. 117. – Asnji send prej pasunis së patundshme të Shtetit nuk mund të jetërtohet ase të pajtohet për nji kohë ma të gjatë se njëzet vjet, veçse me nji ligjë.

Art. 118. – Asnji hua nuk mund të kontraktohet për dobi të Shtetit, pa nji ligjë autorizuese.

Art. 119. – Borxhet e Shtetit janë të garantueme.

Ç'do borxh e Shtetit kundrejt kreditorvet të vet, asht e padhunueshme.

Art. 120. – Shteti njeh persona morale të krijueme mbas ligjës.

Art. 121. – Asnji fuqië e armatisun e huej nuk mund të shkelë në tokën Shqiptare, veçse me ligjë të posaçme.

Art. 122. – Nëpunës disponiblë janë të ndaluem për të gjiiha degat e administratës veçse n' ushtri dhe në Ministri të Punve të Jashtme.

Art. 123. – Gjendja juridike e nëpunësvet të Shtetit, rregullohet vetëm me ligjë.

KAPTINË III.

TË DREJTAT E QYTETASVET

Art. 124. – Të gjithë pa ndryshim shtetsije, janë të barasuem përpara ligjës dhe gëzojnë baras të drejtat civile ; por mbi tokat ryrale në Shqipni me ç'do titull kanë të drejtë pronësije vetëm shtetasit dhe personat morale Shqiptare. Të huejt kanë vetëm të drejtën e shitjes të tokavet ryrale dhe të drejtën e pronësis vetëm mbi ato toka ryrale të nevojshme për ngrefjen e fabrikavet dhe rregullimin e komunikacjonit.

Art. 125. – Të gjithë shtetasit gëzojnë baras të drejtat politike dhe pranohen në të gjitha nëpunsit civile e ushtrijake, përveç përjashtimevet të caktueme prej ligjës.

BRSH

Art. 126. – Lirija personale asht e garantueme. Askush nuk mund të ndiqet, t' arrestohet, të burgoset, të dërgohet në gjyq ose në ç'do mënyrë të pengohet nga lirija veçse në rasat e parapame prej ligjës dhe në formën e caktueme prej saj.

Art. 127. – Banimi asht i padhunueshëm.

Asnji e hyme pahirë nuk mund të bahet veç kur dhe si urdhënon ligja.

Art. 128. – Lirija e fjalës dhe e shtypit asht e garantueme. Censura preventive asht e ndalueme.

Konfiskimi i shtypshkrimevet rregullohet me ligjë.

Vetëm shtetas shqiptarë mund të nxjerrin gazeta si mbas ligjës së posaçme.

Art. 129. – E drejta e pronësis, pa përjashtim, asht e padhunuëshme, veçse kur interesi botuer ligjorisht i vërtetuem e kërkon dhe kundrejt nji damshpërblimi t' arsyeshëm si mbas ligjës, të paguem në dorë (peshin).

Art. 130. – Toka asht pronë e thjeshtë (mylq), por dispozitat ligjore deri tash në fuqi mbi tokat, janë në veprim deri sa të ndrrohen me ligjë të posaçme.

Pasunija minerare asht e ndame në dy klasë: Miniere e Gurore; të parat janë pronë e Shtetit dhe të dytat pronë e zotnuesvet të sipërfaqes së tokës.

Shfrytzimi i tyne bahet si mbas ligjës përkatëse.

Art. 131. – E drejta e shoqnimit dhe e drejta e mbledhjes paqësisht dhe pa armë, janë të garantueme, në konformitet me ligjet.

Shoqënit kurr nuk mund të përndahen për kundravajtje në ligjët, veçse me vendim gjyqi.

Vetëm në mbledhjet botore mund të ndodhet policija.

Vetëm mbledhjet përjashta në vend të hapun mund të ndalohen, në qoftë se prej mbledhjes lind rreziku i prishjes së qetsis botore.

Art. 132. – Fshehtësija postare asht e padhunueshme dhe rregullohet me ligjë.

Art. 133. – Vetëm shtetas shqiptar pranohen si zyrtarë e nëpunës të Shtetit, për veç përjashtimevet të caktueme me ligjë të posaçme.

Art. 134. – Ligjet penale s' mund të kenë fuqi prapa-veprue-se në sfavor të të pandehunit.

Art. 135. – Ç'do mundim trupi (torture) asbt krejt e ndalueme.

H70 57
BIBLIOTEKA KOMBETAR
TIRANE

Art. 136. – As nji shtetas shqiptar nuk mund të ekspulsohet, t' internohet ase të shkufizohet veç se me ligjë.

Art. 137. – Konfiskimi asht i ndaluem dhe s' mund të bahet veçse mbas ligjës me vendim gjykate.

Art. 138. – Sicili ose shumë së bashku kanë të drejtë, tue ruejtun ligjet e Shtetit, t' u drejtohen me shkresë ose me gojë auktoritetevet kompetente, të cilët detyrohen të veprojnë shpejt dhe t' i përgjigjen me shkresë atij qi u-drejtohet.

Art. 139. – Mbasi lirija e njeriut asht e shenjtë, në Shqipni as blehet as shitet njeri; ç'do njeri i blemë ase skllav, por sa të shkelë në tokën Shqiptare asht i lirë.

KAPTINË IV.

DISPOZITA TË MBRAME

Art. 140. – Ç'do ligjë ase dekret-ligjë në kundërshtim me shkronjën dhe me shpirtin e këtij Statuti, asht antikushtetore dhe e pa fuqishme.

Art. 141. – Dy trupat legjislativ mbi proponimin e Kryetarit të Republikës, ase të Misëvet qi i përbajnë, kanë të drejtë se cili trup ndër mbledhje të tyne të veçanta të marrin vendime me dy të tretat për ndrrimin e urdhënimevet të Statutit, tue deklaruem nevojën e ndrrimit.

Dy trupat legjislativ mbassi të kenë marrë se cili veçanërisht këtë vendim, mblidhen së bashku dhe procedojnë në ndrime.

Vendimet mbi ndrrime t' urdhënimevet Statutore, merren me dy të treta votash të gjithë Misvet qi përbajnë mbledhjen e përbashkët.

Gjith në këtë mënyrë bahet edhe interpretimi autentik i Statutit.

Forma Republikane e Shtetit nuk mund të ndrrohet me as nji mënyrë.

Art. 142. – Ky Statut hyn në fuqi prej ditës së shpalljes.

Vërtetohet njisija me origjinalin :

Kryetari i Kuvendit Kushtetuës
ESHREF FRASHËRI

Nr. 1.

DEKRET-LIGJË, 17 Fruer 1925.

Mbi formimin e nji Gjykatës Ushtarake në Shkodër

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 18 Fruer 1925, Nr. 5)

Neni I. – Mbasi shifet nevoja e domosdoshme, formohet nji Gjykatë Ushtarake në Shkodër, e cila përbahet prej tre Oficerve e dy antarve Civil, edhe prej nji Prokurori Civil.

Neni II. – Gjykata detyrohet me hetue e gjykue të gjitha çeshtjet e shënueme në nenet qi pasojnë:

Neni III. – Do të hetojë e të gjykojë të gjitha krimet e deliktet me të cilat asht shkaktue prishja e qetësis së mbrendshme, të pandehunit këso dore me ç'do gradë e me ç'do cilësi qi të jenë, gjykohen para Gjyqit Ushtarak si dhe ata Oficera qi kanë luftuar kundra fuqis legale n' Operacionin e fundit ashtu dhe ato çeshtje t' atyne qi kanë guxue kundra nënpunsavet Qeveritarë me qëllim vrasje.

Neni IV. – Gjykata Ushtarake mundet me kërkue banimin e atyne njerzëve qi shef me nevojë si natën ashtu dhe ditën, mundet t' internojë të gjithë ata njerzt e dyshimtë si dhe ata qi nuk kanë banim n' atë qark, ka të drejtë me ndalue gazetat të cilat shkaktojnë prishjen e qetësis.

Neni V. – Në rasë të interesit Shtetnuer heton dhe gjykon dhe krimet e deliktet ordinare.

Neni VI. – Gjykata Ushtarake ka kompetencë të plotë të hetojë e të gjykojë edhe çeshtjet politike të paraveprueme.

Neni VII. – Gjykata Ushtarake ka kompetencë me gjykue dhe mbi gjithë shoqënit e mbëshefta.

Neni VIII. – Gjith gjykimet e Gjykatës Ushtarake do të jenë të preme tue aplikue ligjat në veprim dhe Kodin Ushtarak.

Neni IX. – Kjo Ligje hyn në veprim që prej datës së dekretimit.

Neni X. – Me zbatimin e kësaj ligjë ngarkohet M. e P. të Mbrendshme dhe ajo e Drejtësis.

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MYFID LIBOHOVA

Min. P. Botore e Bulqësis
Zav. M. P. Mbrendshme
K. KOTTA

Ministri i Drejtësis
e Zav. Min. i Arsimit
P. POGA

Pëlqej këtë dekret-ligjë dhe dekretoj zbatimin e saj.

Tiranë, me 17-II-1925.

Kryetar' i Republikës
A. ZOGU

Nr. 2.

LIGJË, 18 Fruer 1925.

Kontrata e Konçesjonit të Voj-gurit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 21 Fruer 1925, Nr. 6)

Tue qenë se Qeveria Shqiptare dëshiron që „Anglo Persian Oil Company Lymited" të marrë mbi vedi në krejt Shqipnin operata explorimi për të lokalizue voj guri dhe landa qi do të përmenden mâ poshtë, e se Kompanija pranon me e ngarkue degën e vet t' explorimit (D'Arcy Exploration Company Lymited) nën kondita qi caktohen këtu poshtë:

Në mes të Z. Ministrit të Punvet Botore e Bulqësie, n'emën e për hesap të Shtetit Shqiptar (qi shënohet ktu e pastaj si „Qeverie") me nji anë; e Z. Edward Haweis Shearme i ngarkuem me fuqi nga D'Arcy Exploration Company Lymited, Dega e Anglo Persian Oil Company, e ngrehun si pas ligjës të Mbretnis së Bashkueme të Britanjës së Madhe e t' Irlandës qi flet mbi shoqnin e qi banojnë në Londër, E. C. 2 rruga Great Winchester, Nr, 23 (Britanik House), qi do të tregohet ma pastaj me emnin „Company" (term qi shënon Kompanin në fjalë ashtu si edhe ata qi marrin të drejtat e saja (ses ayants droits) çdo herë qi teksti i ktij konçesjoni e kërkon ose e pranon), m'anë tjetër; asht lidhë e çaktue ç' ka vijon :

1. Qeverija i njef Kompaniës të drejtën për të zgjedhë mbi krejt tokët e Shtetit Shqiptar, pa kurrfarë restrikcjonit të sypërfaqeve, qi përgjithësisht nuk kalojnë maximum prej 200.000 hektarësh me qëllim për të ba studime gjeologjike e për të kërkue petrol, bitum, gaz të natyrshëm, argjile bituminoze e shiste qi kanë aftësi me dhanë petrolin nëpër distilacjon.

Kjo zgjedhje e sypërfaqes prej 200 000 hektarësh duhet t' i komunikohet Qeveriës të nesërmen e botimit të ratifikimit të konçesjonit në fletoren zyrtare; kta 200.000 hektarë nuk do të munden as me nji mënyrë të përbajnë ma tepër se 4 zona të veçanta.

2. (a) Mbasi të shënjohet sypërfaqja ose sypërfaqet që bajnë 200.000 hektarë për studime gjeologjike, Kompanija merr mbi vedi me proçedue në këto veprime me konditat qi pasojnë :

(b) Qeverija merr mbi vedi me i ba Kompanis të gjitha lehtësinat, tuej parandalue ç'do lloj ndalim pune (obstrukcion) e pengime në dam të përparimit të veprimeve.

(c) Se as nji të drejtë shfrytzimi e germimi nuk duhet t' i konferohet as-nji të treti mbi as-nji pikë të këtyne 200.000 hektarve, deri më sa Kompania të ketë zgjedhun 50.000 hektarë qi kjo Kompanië do t' i shfrytsojë si asht thanë n'Art. 5.

(d) Se Kompania ka për të pasë të drejtën të bajë gërmime deri më nji thellësi prej 20 kambësh (afër 7 metrash), e nepër këto germime, Kompania merr mbi vedi të mos bajë dame pa pëlqimin e proprietarve (ose pronarve) të tokve në fjalë me nji distancë (largësië) prej 50 metrash nga ç'do ndërtesë se banueshme e do të bajë shka mundet për me ju largue ç'do damit qi kishte me mujtë me rjedhë në korrat, vneshtat ose pemët të frytëshme.

(f) Se kërkimet nuk do të bahen me nji largësië ma pak se 64 metër prej pusevet me ujë të përdorueshëm.

(g) Se ujnat minerale nuk duhen të damtohen pa lejen e Qeveriës.

(h) Se kërkimet nuk kanë për t'u ba në qytete e katunde ashtu edhe nepër vende botore si treg, kopsht e shesha qi i përkasin nji ose shumë katundeve ose qyteteve të vogjël, vorresa, rruga, udhë-hekurit ose rruga botore.

(i) Në mbarim të ç'do trimestrit Kompanija detyrohet t' i japë Qeveris raporta mbi të gjithë hollësinat mbi ç'do lloj studimesh, tue bashkalidhun në ta kopjet hartash e planesh të pregatituna e të dorëzueme Kompanis nga ana e Agjentave të saj, ashtu edhe për mostrat e landve të gjetuna.

3. Kompanija ka me pasë të drejtë me çue (emporter) e me eksportue si mostër (echantillon) sasiën t' arsyeshme landësh prej të gjitha llojnave qi janë tregue ma nalt e qi janë gjetë prej asaj (Kompaniës) nepër-mjet të gërmimeve (fouille). Kompanija ka me pasë edhe obligatin por sa duhet (convenable) me mbushë ç'do gropë qi asht ba edhe me rafshue syperfaqen e sa t' jetë e mundun me e prue në gjendjen të përparëshme.

4. (a) Ç'do të tret, në vazhdim të punimeve qi Shoqnija ka të drejtë me ba, që t' i jetë damtue proni prej Shoqniës, do t' i jetë shpërblye me nji herë nga Shoqnija me nji shpërblim të nji vleftës së vërtetë (equitable).

(b) Gjith ashtu Qeverija do të shpërblehet për ç'do lloj obligate qi t' i ngarkohet kundrejt ç'do personi të tretë nga shkaku i punimeve të sipërmarruna prej Kompaniës.

(c) Shuma e shpërblimit, qi do të paguhet ndër kondita të

sipërpërmenduna në rasë mos marrëveshtje në mes të dy anve, do të caktohet prej arbitrash qi do t' emnohen nga pronari i tokës e nga Kompanija. Numri i arbitravet do të caktohet me nji akord të përbashkët prej të dy palvet. Në rasë të nji mosmarrëveshtjes në mes t' arbitravet, kta do të zgjedhin nji sypërarbitër.

Vendimi i sypërarbitrit do të jetë definitiv. Në qoftë se arbitrat nnk biën në godi për personin e sypërarbitrit, puna do t' i referohet Gjykatorvet kompetentë Shqiptarë.

(d) Për sa i përket pagimit të shpërblimit të vendosun, duhet marrë para syësh vleftën ordinare të tokës pa-mvarsish (independament) prej ç'do konsiderate t' implikueme nga ky konvencjon.

(e) Pagimi i shpërblimit do të bahet mbrenda nji mueji qysh prej datës së vendimit t' arbitrave ose të sypërarbitrit.

(f) Në rasë ku, në kohë t' operatave të përmenduna në ket konvencjon, tokat do të damtohen me nji shkallë të papërdorueshme për kultivasjon, ose kur do të jenë të nxanuna për nji periudhë qi e kalon motin, pronari i nji të tillë tokë ka me pasë të drejtë me kërkue ekspropriminin si mbas ligjës në fuqi.

5. (a) Që prej ditës së notifikimit të premë për zgjedhjen të 200.000 hektarve për t' u eksplorohet ashtu si âsht thanë në nenin 1, do t' i epet Kompaniës nji periudhë deri më 30 Prill 1925, në të cillën ajo ka me pasë të drejtë me i caktue sypërfaqet për kërkime në hollësina e për sondage, si pas konditave qi pasojnë :

(b) Se sypërfaqet të caktueme kështu nuk duhet të kalojnë nji shumë të 50.000 hektarve, të cilët nuk do të zgjedhen veç se mbi 200.000 hektarë qi i janë koncedue Kompaniës për t' u eksplorue si pas termavet të nenit I. Kompanija i njef ç'do sypërmarrjes të tretë të drejtën e shkuarjes mbi 50.000 hektarët e zgjedhun prej sajë me qynga (borija) (avec conduits) ose me tjatër mjet transporti.

Fakulteti i zgjedhjes në fjale do t' jetë absolut e do t' jetë i liruem prej ç' do lloje reservash, posë dy restrikcjoneve qi pasojnë.

1. Kompanija nuk ka as-nji të drejtë me kërkue nji konçesjon për shfrytzimin e landvet të shënueme në ket konçesjon me nji zonë të caktueme si pason :

Në Veri : Nji vijë të drejtë qi niset prej ekstremitetit të

Perëndimit të katundit Risilies e qi shkon n'ekstremitet Linduer të katundit Lubenja.

Në Lindje: Nji vijë të drejtë qi bashkon pikën e sypërshenjueme në lindje të Lubenjës me nji pikë n' ekstremitet Prendimuer të katundit Penkova, prej s' andejmi nji vijë të drejtë qi shkon n' ekstremitet Prendimuer të Peshkopis.

N' Jugë: Nji vijë të drejtë prej ekstremitetit Prendimuer të Peshkopiës n' Urën e Serishtës, prej s' andejmi nji vie të drejtë qi shkon në qendër të katundit Kishbardha.

Në Prendim: Nji vijë të drejtë prej qendrës të Kishbardhës në nji pikë origjinit në Prendim e Trisiliës (të vështrohet plani i bashkanjitun).

Në katundin kuptojmë grupin principal të shpijavv dhe jo të dheravet komune.

2. Kompanija hjekë dorë prej ç'do pretendimi kërkimesh e shfrytzimesh të serës në zonë të konçestonit qi quhet „ i Selenicës" plani i së cilës gjindet bashkanjitun. Por Kompanija do të ketë të drejtë kalimi në kto tokë ashtu si edhe të drejtë kapërcime për shka i përket kërkimeve gjeologjike për të vuemit e të përmbajtunit e burijave si edhe të transportimit të petrolit e t' aq materjalit sa duhen për shfrytzimin etj. Pra kështu Kompanija ka të drejtë me bâ gërmime mbi zonën e Kompaniës së Selenicës me qëllim qi të kërkojë petrolin në kjoftë se zonj i Selenicës ka për të kenë mbrenda 50.000 Hektarve të caktueme si pas § b) i këtij nenit.

(c) E drejta e të zgjedhunit e sypërfaqes në fjalë qi i nepet kompaniës ka me pasë prijoritet absolutë mbi ç' do cillën partië të tretë.

(d) Se nuk munden m'u shenjue mâ shum se 4 zona të veçanta.

(e) Se për me i çue kah marimi i tyne kërkimet të hollueme (detailles) nji perjudhë prej 3 vjetësh, do t' i nepet mâ së shumit, kjo periudhë do të shënohet pastaj si periudhë kërkimeve të hollueme (detailles e gërmimesh) (forage).

(f) Se Kompanija duhet t' ja parashtrojë Qevcriës nji raportë në çë do gjasht muej mbi përparime qi bâhen nëpër kërkime e gërmime me nga nji kopje të gjith planeve e hartave të nevojëshme, ose Kompanija duhet prap me i dhanë të gjitha informatat suplementare qi Q-verija beson se janë të nevojëshme.

(g) Se Kompanija merr mbi vedi në kohë të perjudhës së gërmimit, me gërmue së pakti nji pus për çë do 7.000 Hektarë

të sypërfaqes rizervueme prej sajë për m' u shfrytzue, d. m. th. 7 pusa prej 50.000 Hektarësh.

Prej ktyne 7 pusave 3 (tre) do të gërmohen deri në nji thellësië prej 1000 (njimij) metrash posë me nji rasë ku petroli do të gjindet në nji thellësië mâ të vogël.

(h) Se nji Komisjon teknik do të formohet, i përbaëm prej 6 antarësh, tre nga këta do t' jenë t' emnuemë nga Qeverija e tre nga Kompanija. Ky Komisjon do t' i vërtetojë konditat e tokvet e do t' a vrejtojë (surciller) të kryemit e detyrave nga ana e Kompaniës, në rasë qi do të parashtroheshin veshtirsiëna të cillat do t' i pengoshin serjozisht, të kryemit të programit minimum, Komisjoni ka me muitë me vendue nji rrzim t' arësyeshëm prej këtij programi, Komisjoni ka për të pasë edhe fuqië për të ba nji zbritje nëpër të gjitha obligatat qi i përkasin gërmimevet, si për punë të gërmimevet si edhe për punë të shfrytzimit, në rasë ku cirkonstencat kryesore kan për t' a ba të dishrueshme nji masë këso doret.

(i) Se në çë do ças mbas datës së shenimit të kuptuem të sypërfaqes të sypritregueme, para mbarimit, ose në mbarim të periudhës së gërmimit, Kompanija ka me muejtë me shkrim me informue Qeveriën, a e konsideron a po jo qi ka petrol n' at sasië sa ka me muejtë m' u shfrytzue tregtarisht, në kët rasë Kompanija do të ketë të drejtë me zgjedhë, e lirë prej ç' do barre posë atyne që janë parapa në kët konvencjon, sypërfaqet krejtsisht ose vetëm nga një pjesë prej çdo sypërfaqe për t' a shvillue kët e për të ba në të kërkime të pastajshme (ulterieur) për me nxjerrë petrol ose çë do landë nga ato të tregueme nalt.

6. Kompanija do t' a ketë të drejtën exclusive të shfrytzimit e të kërkimeve mbi çka marrin sypërfaqet (etandue 50.000 Hektarësh qi ajo do t' i ketë zgjedhë si mbas nenit 5, për petrol ose për krejt apo nji pjesë landvet sypërtregueme deri me 31 Dhetuer 1985.

Kto të drejta ju shtrohen (soumis) konditavet qi pasojnë :

(a) Se ka për t' u formue nji Kompanië Ingleze nën titullin „Anglo Albanien Oil Company Lymited" qi ka për t' u shenjue këtu e poshtë si Kompanija e Veprimit.

(b) Se kapitali i autorizuem i Kompanis nuk do të jetë mâ pak se 500.000 n' akcjon nga nji lirë sterlini e do të mundet me u shtue në kjoftë se Kompanija e gjykon të nevojëshme.

Pesë (5) muej para emisjonit të çë do kapitalit n' akcjon

Kompanija do të detyrohet me informue Qeverien mbi qëllimin qi ka për t' a bâ komisjonin respektiv e në tre muejt e para të kësajë kohe prej 5 muejsh, nënshtetasit Shqiptarë do të munden të nënshkruejn $40^0/_0$ të këtij kapitalit n' akcione me çmim t' emisjonit e në rasë ku kto akcjone ose nji pjesë e tyne nuk do të jetë e shkrueme (souscrire) prej nënshtetasve Shqiptarë. Qeverija në dy muejt qi jesin do të ketë të drejtë me shkrue (souscrire) të gjitha ose nji pjesë prej akcjonesh në fjalë, tue pasë parasyësh gjith-nji qi shuma e akcjoneve të shkrueme nuk do të mundet me e kalue kufinin e $40^0/_0$.

(c) Se nji kopje e bilancavet të përmotëshme të Kompaniës Veprimeve do t' i komunikohet Qeveriës.

(d) Se Qeverija do të ketë të drejtë me emnue nji antar në këshillë t' Administratës të Kompaniës së Veprimeve.

(e) Se Kompanija do të detyrohet me ja lshue Kompaniës së Veprimeve krejt Konçesjonet qi do t' i jenë dhanun asajë me të gjitha të drejtat e privilegjet të përkatëshm me qëllim qi veprimit e explorimit ose zhvillimin e shfrytzimin e tokvet qi përbajnë objektin e këtij konvencjonit, t' jenë sypermarrë e të vazhdueme prej Kompaniës së Veprimeve.

(f) Se Kompanija e Veprimevet do të detyrohet me pague nji redevancë prej 13.50 për qind (tremdhetë e gjysë) mbi prodhimin e petrolit brutto qi do t' jetë kênë sjellë prej pusavet në reservoar (reservoire) të themelueme për ket qëllim mê parë (en expece) ose në landë (en nature). Pëlqimi i njênës prej këtyne të dyjave i lehet Qeveriës. Kompanija e Veprimit do të ketë të drejtë të rrzojë nga shuma e petrolit të prodhuem me mëndyrë të diftueme në paragrafin e përparëshëm, çë do sasië qi ajo ka për të prishë për të gjitha punët qi janë në lidhje me shfrytzimin ; në mëndyrë qi redevenca do të llogaritet mbi bazë të sasiës qi mbetet mbas rrzimit qi flitet këtu.

Në mbarim të ç' do trimesit Kompanija âsht e shtërngueme me ja parashtrue Ministrisë së Punvet Botore e Bujqësiës nji raport qi i përket sasiës së petrolit të prodhuem si edhe mëndyrën qi ajo se si ka me disponue ket sasië. Redevenca do të llogaritet në bazë të sasiënavet qi figurojnë në këto raporta.

(g) Se Kompanija e Veprimit do të detyrohet me pague nji t' ardhun të përmotshëm nga 1.50 fr.ari për hektar, për ato sypërfaqe qi do të t' jenë lëshue në konformitet të nenit 5 (a) (b), Kompanija do t' i paguej Qeveriës redevencën për dy vjetet e përpara në muej qi pason ratifikimi i konvencjonit.

(h) Se pas formimit Kompanija e Veprimit lidhë me vue në zbatim programin e foragit si pason:

Mbrenda vjetit të parë 1500 m.

Mbrenda vjetit të dytë edhe 3000 m. e mâ tepër.

Mbrenda vjetit të tretë edhe 4000 m. e mâ tepër.

Mbrenda vjetit të katërtë edhe 4000 m. e mâ tepër.

Mbrenda vjetit të pestë edhe 4000 m. e mâ tepër.

Teprica në kjoftë se do të ketë prej ktyne numrave metrash në ç' do vjetë do të llogaritet për të plotësue numrin e metravet të vjetit qi pason.

Me gjith këtë në kjoftë se mbrenda 5 vjetve sypërshenueme, pusat e gërmuem arrijnë nji prodhim tremuejshme prej 25.000 tonelate, Kompanija do të kishte të drejtë me i kadalue (relantir) punët e gërmimit, por do të shtërngohet t' i fillojë për së rij gjith-nji mbrenda 5 vjetve të para qi pas programit në krye deri sa për sërij t' arrij deri 25.000 tonelate. Komisjoni teknik do t' jetë kompetent me vendue nji zbritje t' arsyeshme të këtij programi, në kjoftë se kjo duket e dishrueshme në konsiderim të veprimeve të përgjithëshme të Kompaniës e të natyrës si edhe të konditës së tokve petrolifere.

Mbas 5 vjetve të para Kompanija e veprimit ngarkohet të bâjë të gjitha mundimet e arsyeshme për me zhvillue gradën mâ të naltë qi âsht e mundun për shfrytzimin e dejvet (gisement) petroliferi në sypërfaqet e koncedueme e do të rregullojë programin e gërmimit në konformitet me atë qi u tha ma nalt mbas këshillimit të Komisjonit teknik (D. m. th. me i ba të gjitha mundimet e arësyeshme për shfrytzimet e dejve petrolifere në nji shkallë ma të naltë qi mund t' jetë).

Se Kompanija e Veprimit do të ketë të drejtë me i lanë të gjitha pjesët e tokavet qi do t' i jenë dhanë asajë ky ndryshim i tokvet do të tërheqë librimin e Kompaniës prej të gjitha obligatave qi resultojnë prej këtij konvencjoni për ç' ka u përket tokve të lshueme.

(i) Se 200.000 Fr. ari (8000) L. St. do të depozitohen në kohën e nënshkrimit të këtij konvencjonit në nji Bankë të Londrës në shënjim të Qeveriës si një dorzanië (garantie) për eksekutimin e mirë të neneve të këtij konvencjoni.

Shuma e sipër përmendun e garantiës do t' jetë e penguem e për gjith perjudhën e kërkimeve edhe të foragit e të gërmimeve dhe do të lehet pasunië (propriete) e Qeveriës në qoft se

Kompanija nuk do të kishte mbushun detyrat që merr me kët konçesjon kundrejt Qeveriës.

Por me të marrmen fund perjudha e kërkimeve ose në kjoftë se Komisjoni teknik do t'i ketë konstatue nji përfundim negativ në ç'ka i përket kërkimeve apo në kjoftë se Parlamenti nuk do t'a ketë vërtetue konvencjonin, Qeverija Shqiptare lidhet me lajmue Bankën e sipërthënme qi mund të kthehet shuma në fjalë në dispozicjon të Kompaniës.

(k) Se në mbarim të periudhës së konçesjonit prej 60 vjetve krejt materjali qi gjindet në Shqypnië instalacjonet, ndërtesat, depojat, pusat, rrehtıme (Quai) rrugat e urat qi i përkasin Kompaniës së Veprimeve do t'i nepen në dorë gratis Qeveriës Shqyptare.

(l) Se kuër Kompanija e Veprimit do të ketë nevojë për rruga qi mund të kalojnë karrocat e për tramvay të nevojshme për shfrytzimin, Qeverija do t' japë kalim të lirë pa farë barret mbi rrugat.

(m) Qeverija do t'i japë Kompaniës të drejtën e ndërtimit e të përmbajtunit më kambë për nevojat e saj, të ullukave (buriaconduit). Vija e telefonikëve telegrafa pa tel, telegrafa robway ajrit rrugat e hekurit e tramvay për aq sa do t' jenë eksklusivisht të përdorueme për shërbimin e industriës petrolifere rruga e rehtima e ura, qi, tuej u nisë nga tokët që përshiën konçesjonin e vet do t'arrijnë në çë do pikë bregut qi Kompanija ka për t' a gjetë të pëlqyeshme.

Ajo ka për të pasë edhe të drejtën e ndërtimit të banimeve për puntorët e vet, të rezervuarvet, t' amplasamentave, të depojve, të zyravet, të uzinave e të rafineriëve, për kët ajo do të ketë të drejtë qi t'i lshohen tokë ki i përkasin njerzve privatë më mëndyrën t' ekspropriatës në konformitet me ligjet në fuqië.

Të çmuemit e tokve për t' u expropriue, do të bahet pa mvarësisht prej çë do konsiderimit t' implikuem prej konçesjonit qi flitet në kët konvencjon.

Për sa i përket tokvet botore jo të xanme, kto do t' lshohen gratis nga Qeverija.

(n) Kompanija dhe Kompanija e Veprimit do të ketë të drejtë me importue në Shqypnië, të lirueme prej çë do takset doganore, krejt materjalin e veglat qi asajë do t' i duhen.

(o) Se Kompanija do të ketë të drejtë me nxjerrë jashtë petrolin brutto, asfaltin, serën e prodhimet sëkondare pa pague as-nji takës eksportimi.

(p) Se kompanija edhe Kompanija e Veprimit do t' jenë të përjashtueme prej çë do takse speciale reale ose personale.

(q) Se nënpunësat dhe punëtorët qi merren në shërbim prej Kompanis Veprimit do t' jenë nga nënshtetsija Shqiptare, posë teknicieneve ekspertave dhe specjalistave.

(r) Se në rasë që një rafinerie do të mundet m' u instalue në Shqypnië prej Kompanjës Veprimit, Kompanija ngarkohet t'i përgjegjet kërkesave për vaj-guri e për prodhime sekundare qi janë faret të domos-doshme për nevojat e Qeveriës, me vleftën e pazarit, tuej e bamun një redukcion prej 10% me gjith këtë kërkesat e Qeveriës nuk do të munden të kapërcejnë të 20% të prodhimit neto mbasi t' jetë zbritë sasia e vojit të gurit të konsumuem për punrat e Kompaniës.

Përpara se t' eksportohet voji i gurit, çë do kërkesë e Qeverisë Shqyptare qi kapërcen 20% ashtu edhe gjith kërkesat për tregtin ose për qëllime tjera në Shqipnië, do të pranohen me çmimin e pazarit.

Kuër prodhimi i tremujshëm i vojit të gurit brutto do t'jetë 19.000 tonelatë e lartë, dhe në Shqypnië edhe nuk do të ketë rafinerie qi u përmend sypri, Kompanija detyrohet t' i napë (fournir) Qeveriës Shqyptare për tre muej 625 tonelatë voj-guri shndritës (lampant) dhe 75 tonelatë benzinë me vleftë 10% ma pak se çmimet e pazarit.

7. (a) Në rasë ku punrat të Kompaniës ose të Kompaniës së veprimit do t' jenë të preme, ose të (interrompus) nalueme ose të penguеme, nga ngjarja prej forcave majore të ngjame prej ç' do cillit shkak, perjudhat e kohve të para-shikuem si maximum në kët koncejon, do të pushojnë prej vazhdimit për gjith kohën e ngjarjeve të forcës majore.

(b) Personali dhe materjali i Kompaniës dhe i Kompaniës të Veprimit në çë do kohë do të gëzojnë mprojtjen e Qeveriës Shqyptare.

(c) Në kjoftë se Qeverija Shqyptare vendos mos pranímin e shkakut të cilve Kompanija ose Kompanija e Operacionit e deklaronte si prej forcës majore, kjo mos-marrveshtje do të vehet nën arbitrage si mbas rregullave të nenit 10.

8. Anët kontraktuëse detyrohen njera prej tjetrës të lehtësojnë zbatimin e konditave të parapame nga ky konçesjon.

9. Po të provohet se Kompanija nuk asht e konformueme me obligatat e ngarkueme me kët konvencjon Qeverija ka të drejtë t' a anulojë kët konvencjon.

10. Në rasë të çë do mos-marrveshtje midis Qeveriës e Kopaniës Veprimit qi i përket interpretimit e të drejtave dhe obligatave të dy anve kontraktuesa të rrjedhun (derivant) nga dispozitat e këtij konvencjonit, çashtja do të riferohet tri arbitranga të cilët njeri do t' emnohet nga Qeverija nji tjetër nga Kompanija dhe i tretí do të zgjedhet nga të dy arbitrat në marrëveshtie të përbashkët.

Në kjoft se arbitrat nuk merren dot vesh për personin e arbitrit tretë, ky do të zgjedhet në mëndyrën si pason:

Një komitet do të formohet prej 5 antarësh, 2 prej të cilëve do të zgjidhen prej Qeveriës, 2 prej Kompaniës dhe i pesti do t' emnohet me shumicën arbitrave, të parë.

Ky komitet do t' emnojë me shumicë votash arbitrin e tretë.

Në rasë kuër, për çë do farë arsyejet, zgjedhja e arbitrit të tretë nuk do të mund të bahet prej Komitetit e emnimi i tij do t' i referohet Gjyqit Diktimit Shqyptar.

11. Për sa i përket veprimeve Kompaniës të bamuna në Shqypnië, çë do konflikt i lindur prej tynve do t'i parashtrohet gjyqeve të vendit për veç se n' asht parapa ndryshe në ket konvecjon.

12. Çë do informatë e parashikueme në kët konvencjon, që Qeverija Shqiptare do të kërkojë nga Kompanija e Operationit, kjo informatë do t' i nepet kësajë me letër ose me kablogram, drejtuar Ministriës punvet Botore e Bulqësiës.

Çë do informatë e dhanme me letër, do të quhet e marrë 3 dit mbas arritjes së postës në destinacionin e rregullshëm, dhe po t' jetë dërguar me kablongram, 48 orë mbas dhanjes në zyrë e ekspedicjonit.

13. Ndalimi i të lshuarit (interdiction de ceder). Asht e ditun që Kompanja do t' i lshojë të drejtat dhe obligatat e sajë Kompaniës Veprimi por kjo e fundit, as me nji pretekst nuk do të mundet të lshojë tjerve (á des tiers) të gjith ose nji pjesë e ksaj kontrate, pa pëlqimin e Qeveriës se ndryshe Qeverija ka të drejtë me e prishë për nji herë kët kontratë.

14. Ky konvencjon u ba në dy (2) origjinale, shqyp, frengisht dhe anglisht. Por në rasë të nji mos-marrëveshtje (divergence) për interpretimin e tij, teksti frengisht do t' jetë ma i vlefshëm.

15. Sendet t' arteve dhe antikave të zbulueme në kohën e kërkimit dhe të punravę do t' i parashtrohen rregullave qi rregullonj kto landë.

16. Ky konvencjon nuk do t' jetë i fuqishm para se të ratifikohet nga Parlamenti Shqyptar dhe të shpallet në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Drejtësiës e Zav. Ministri i Arësimit
P. POGA

Ministri i P. Botore e Zav. Ministri i P. Mbrendshme
K. KOTTA

Ministri i Financavet e Zav. Ministri i P. Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Pëlqej Kontratën e lidhun në mest të Qeveris Shqiptare e të Shoqnis Anglo-Persian Oil, mbi konçesionin e voj-gurit në Shqipni, pranue edhe prej Kuvendit Kushtetues si mbas shkresës Kryesis së tij Nr. 63 datë 17-II-925 dhe dekretojë zbatimin e saj.

Tiranë, me 18-II-925.

Kryetar' i Republikës
A. ZOGU

Nr. 3.

LIGJË, 1 Mars 1925.

Mbi shperblimin e përjetshmë të Z. Xhafer Ypit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 2 Mars 1925)

1. I lidhet nji shpërblim i përjetshëm prej Fr. ari 500 (pesë qind) në muej Z. Xhafer Ypit, ish Anëtar i Këshillit të Naltë.

II. Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

III. Ministrija e Financavet detyrohet me zbatimin e kësaj ligje.

Tiranë, me 24-II-925.

Ministri i Financavet
MUFID LIBOHOVA

Pëlqej ligjën e naltë përmendun pranue edhe prej Kuvendit Kushtetues si mas shkresës së Kryesis së tij Nr. 62 I me 25-II-925 dhe urdhërojë zbatimin e sajë.

Tiranë, me 1-III-925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 4.

LIGJË, 7 Mars 1925.

Mbi internimin e propagandistëve

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Mars 1925 Nr. 9)

Art. 1. Për propagandat e rezikshme kundra indipendencës, tanësis e njësis së Republikës Shqiptare, ashtu edhe kundra regjimit qi bahen faqeza ose fshehtazi e nuk mund të provohen nga ana e gjyqit, mund të internohet autori i propogandës në fjalë me vendim të nji komisije i përbamë prej Prefektit, Komandantit të Gjendarmeris, Prokurorit të vendit dhe kur s'ka gjyqtarit e komiserit të Policiës.

Art. 2. Vendimi i internimit në ç' do vend të Shqipnis, caktohet ç' me dy muej deri nji vjet.

Qeverija asht e detyrueme me ushqye t' internuemit dhe t'u japë banimin.

Art. 3. Vendimi i internimit duhet t' i dërgohet me gjith aktet Ministris së P. të Mbrendëshme mbrenda dhet (10) ditve për me i a paraqit Këshillit Ministruer për shqyrtim e pranim.

Art. 4. Deri sa të pëlqehet vendimi i internimit prej Këshillit Ministruer, autori i propogandës mund të mbahet nën vrejtje të Gjindarmeriës.

Art. 5. Vendimi i internimit asht i premë me pëlqimin e Këshillit Ministruer.

Art. 6. Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes.

Art. 7. Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e këtij ligji.

Ministri i Drejtësiës
P. POGA

Zav. Ministri i P, të Mbrendshme
Ministri i P. Botore e Bujqësiës
K. KOTTA

Pëlqej ligjën e sipërme mbi internimin e propogandistëve të rezikshëm pranue prej Kuvendit Kushtetues si mbas shkresës së Kryesis së tij Nr. 91-I datë 2-III 925 dhe dekretoj zbatimin e saj.

Tiranë, me 7-III-925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 5.

LIGJË, 7 Mars 1925.

Mbi Pensionin e Familjes Hoxha Kadriut

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Mars 1925 Nr. 9)

1. Për deri sa të rregullohet e të vihet në zbatim ligja e pensioneve civil, familjes të ndiesë pastë Hoxha Kadriut, e përbame prej grues nji vajze, e nji djali, i lidhet nji pension i përmuejshëm prej 100 (nji qind) Fr. ari.
2. Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes.
3. Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Ministri i Financave
MUFID LIBOHOVA

Pëlqej ligjën e sipërme mbi lidhjen e nji pensioni të përmuajshëm familjes të ndyerit Hoxha Kadri prej 100 Fr. ari pranue prej Kuvendit Kushtetues si mbas shkresës së Kryesiës së tij. Nr. 86-I, me datë 2-III-925, dhe dekretoj zbatimin e saj.

7-III-1925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 6.

DEKRET-LIGJË, 7 Mars 1925.

Ndryshim mbi Ligjën Doganor të III. Nr. 39 e 36

(e botneme në Fletoren Zyrtare, 13 Mars 1925 Nr. 9)

1. Tagri Doganuer i grunit asht fr. ari 1 (nji) për kuintal.
2. Tagri Doganuer i miellit grunit asht fr. ar 10 (dhetë) për kuintal.
3. Ky dekret ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes e ka fuqi paravepruese për grunin e miellin e grunit qi asht importue qysh prej datës 25-XII-924.
4. Ky ndryshim mbi ligjën Doganore Art. 30 e 36 ka fuqi deri me 31 Gusht 1925.
5. Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Drejtësiës
P. POGA

Ministri i Financavet
e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës
e Zav. Min. i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 7.

DEKRET-LIGJË, 7 Mars 1925.

Mbi syprimimin e Ministris s' Arësimit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Mars 1925, Nr. 9)

Neni 1) Ministrija e Arësimit syprimohet dhe transferohet në Drejtori të Përgjithshme, e cila do të jetë e mvarun në Ministri të Drejtësis.

Neni 2) Drejtori i Arsimit do të jetë nënshtetas shqiptar i karjerës qi ka krye rregullisht mësime universitare të filosofis ose të fillollogjis dhe do të jetë nën urdhënat e Ministrit kompetent.

Neni 3) Veprimet teknike t' Arsimit drejtohen prej Drejtorit me anën e veglave subalterne të posaçme.

Neni 4) Drejtori i Arësimit nuk mundet të veprojë ç' do vepër pa dijeni të Ministrit kompetent nga i cili mvaret ajo Drejtori.

Neni 5) Dispozitat e ligjeve që i kundërshtojnë kësaj ligjë janë t' anulueme.

Neni 6) Ministrija e Drejtësis nga e cila mvaret Drejtorija e Përgjithsme e Arësimit ngarkohet me zbatimin e këtij dekret-ligji.

7-III-1925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Drejtësiës
P. POGA

Ministri i Financavet
e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës
e Zav. Min. i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 8.

Ligjë për zgjedhjen e dhomës së Deputetvet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Mars 1925, Nr. 10)

Kaptin' e I.

Mbi mënyrën e zgjedhjeve e numrin e misave të Dhomës së Deputetvet

Art. 1. — Zgjedhja për misët e Dhomës së Deputetvet bahet me votim universal te tërthurshëm (suffrage universel indirecte)

Art. 2. – Për ç' do 15,000 frymë shtetas shqiptar zgjidhet nji Deputet.

Art. 3. – Zgjedhja e Deputetvet bahet për Prefektura.

Secila Prefekturë asht nji qark elektoral (circonscription élektorale), dhe secila Nënprefekturë, nji degë zgjedhjesh të Prefekturës tek e cila varet.

Art. 4. – Kur nji Prefekturë në caktimin e misvet të Dhomës së Deputetvet si mbas Art. 2 të kësaj ligje, i mbetet nji fraksion 7,500 e sipër, atëhere edhe për kët fraksion zgjidhet nji mis për kët Dhomë, dhe kur i mbetet nji fraksion ma poshtë se 7.500 frymësh, atëhere ky fraksion nuk merret para sysh dhe quhet si i pa qenë.

Art. 5. – Caktimi i numrit të misvet të Dhomës së Deputetvet për ç' do Prefekturë në bazë t' Art. 2 e 4 të kësaj ligje, dhe në themël të dokumentavet të Zyrës së Shtetit Civil të tanë Prefekturës, bahet me vendim të Këshillit të Bashkis së qendrës së Prefekturës.

Ky vendim u kumtohet Bashkivet të gjith Nënprefekturavet tue treguem në kët vendim numrin e përgjithshëm të banorvet për secilën Nënprefekturë të ndamun mbas fevet.

Në rasa konfliktesh mbi caktimin e numrit të misvet, çeshtja zgjidhet nga ana e Gjyqevet Fillore të qarqeve, mbrenda 10 ditve. Vendimet e gjyqevet në kët rasë janë të preme.

Art. 6. – Në caktimin e numrit të Deputetvet ruhet për pjesëtimi ndërmjet të fevet të ndryshme, por vetëm në favor të pakicave.

Deputeti qi i përket fraksionit të parapamun n' Art. 4 do të jetë prej asaj feje që formon shumicën në fraksion.

Kaptin' e II.
Mbi zgjedhësit

Art. 7. — Zgjedhës i parë quhet ay votues qi zgjedhësit e dytë, të cilët kanë të drejtë të votojnë për zgjedhjen e Dhomës së Deputetve, sa asht caktue numri qi mund të nxjerrë qarku i Prefekturës nga i cili asht zgjedhun zgjedhës i dytë.

Art. 8. Zgjedhës i parë asht ç' do shqiptar mashkull qi gjindet i regjistruem në listat e zgjedhësvet dhe qi ka mbushun mo-

shën e tij 18 vjetësh. Përjashtohen nga e drejta e përdorimit të votimit këta:

a) Ata qi me vendim gjyqi janë vue nënë kujdestari për shkak mendor;

b) Ata qi kanë bamë falimento dhe unk kanë marrë kthimin e të drejtavet qytetnore (rêhabilitation);

c) Ata qi janë t' arestuem ose të denuem për krim si edhe ata qi gjinden të burgosun për shkak eksekutimi të dënimit të tyre për delikt të dënueshëm me 6 muaj burgim e sipër;

c) Shurdh-memecët qi nuk dinë të merren vesh me shkrim;

d) Ata qi rrojnë me të lypun;

dh) Gjith ushtrija, Gjindarmerija bashkë me gjith Oficerët e Nënoficerët e tyne, ashtu edhe agjentat e Policis të ç' do grade qi të jenë.

Art. 9. – Për me u-zgjedh zgjedhës i dytë duhet me pasë gjithë cilësitë e lypuna për zgjedhësin e parë dhe me mos qenë në ndonji nga kategorit e përjashtueme t' Art. 8 të kësaj Ligje.

Nuk mundeu me u zgjeth zgjethësa të dytë në qarkun e asaj Prejekture ku ndodhen t' emnuem Prefektat, Nënprefektat, Prokurorat, Gjyqtarët, Drejtorët e Financave, Komiserat dhe Nënkomiserat e Policis dhe Krahinarët.

Kaptin' e III.

Mbi Misat e Dhomës së Deputetvet

Art. 10. – Për me u-zgjedhun Deputet duhet me pasë gjithë cilsit e lypuna për deputet të caktueme n' Art. 12 të Statutit dhe me dijt me shkrue e me këndue lirisht gjuhën shqipe.

Nuk munden me u-zgjeth Deputet ata qi hyjnë në ndonji nga kategorit e përjashtueme t' Art. 8 të kësaj ligje përveç oficeravet të cilët mundet me u zgjeth.

Art. 11. – Nëpunësit qi shenjohen n' Art. 9 të kësaj ligje, ashtu edhe oficerët nuk munden me u-zgjeth misa të Dhomës së Deputetve në qarkun e asaj Prefekture qi ndodhen t' emnuem, për pa dhanë dorë-heqjen nga nëpunësija të paktën 30 ditë përpara ditës së votimit për zgjedhjen e misvet të Dhomës së Depdtetvet.

Oficerët, Inspektorat e përgjithshëm, Sekretarët e përgjithshëm dhe Shefat e Seksionevet të Ministrive nuk munden me u-zgjeth si Deputetën n' as njanin nga qarqet e Prefekturave

për pa dhanë dorë-heqjen nga nëpunësija të paktën 30 ditë para ditës së caktueme për zgjedhjen e Deputetvet.

Në këtë rasë oficerët, tue pasë dalë nga shërbimi i Ushtris apo i Gjindarmeris, humbasin të drejtat e vjetërsis në gradime për aqë kohë qj të jenë të larguem nga Ushtrija apo Gjindarmerija.

Gjithashtu, nuk kanë të drejtë të kërkojnë ri-këthimin e tyne në shërbime të përparshme, në qoftë se nuk zgjidhen deputetën, ose mbasi të mbarojnë misjonin e tyne si deputet, veçse në pastë nevojë Qeverija, e cila mund t' i riemnojë në shërbime t' ushtris ose të Gjindarmeris.

Në rasa dorë-heqjesh te tilla, nji kopje e dorë-heqjes duhet t' i paraqitet dhe Kryetarit të Gjyqit të Shkallës së parë t' atij qarku ku ndodhësh i emnuem nëpunësi ose oficjeri dorë hekës. Kryetari i gjyqit në fjalë me të shpejtë vërteton dhanjen e dorë-heqjes dhe i a paraqet Prefekturës t' atij qarku ku vihet kandidatura e nëpunësit dorë-heqës.

Dorë-heqja bashkohet me dosieren e aktevet t' asaj zgjedhjeje dhe quhet e pranueme që ditën e dhanjes.

Afati i 30 ditvet të këtij Art. fillon nga data e dorëzimit të kopjes së dorë-heqjes ne kryetari i gjyqit të nalt përmendun.

Nuk ndalohen me u-zgjeth misa të Dhomës së Deputetvet nepunësit e përmendun në kët art, në qoftë se gjinden të pushuem nga nëpunësija 30 ditë, përpara ditës së caktueme për zgjedhjen e misavet të Dhomës së Deputetvet.

Data e fillimit të këtij afati, fillon nga e nesërmja e çregjistrimit të tij nga lista e nëpunsavet të Ministris qi varet.

Art. 12. — Cilsit e pa-pajtueshme të misvet të Dhomës së Deputetvet me nëpunësina të tjera, janë ato qi caktohen për deputetnit n' Art. 13 të Statutit në veprim.

Kaptin' e IV.

Mbi zonat elektorale

Art. 13. — Mbrenda 15 ditve prej shpalljes së dekretit të Kryetarit Republikës qi thërret popuilin në zgjedhje, ç' do Këshillë Bashkije qi gjindet në qendër të ç' do Nënprefekture, e ndan qarkun e Nënprefekturës në zona eloktorale tue marrë para sysh, në caktimin e rrethit të ç' do zone, afërsin midis lagjevet ase katundevet qi do të formojnë zonën.

Ç' do zonë nuk mund të ketë ma pakë se 500 as ma shumë se 1500 banorë shtetas shqiptarë. Caktimi i numrit të banorvet të zonavet bahet në bazë të listavet të Shtetit Civil.

Art. 14. — Bashkë me zonën caktohet edhs qendra e saj si edhe numri i zgjedhësvet të dytë qi i përket çdo zone, tue marrë për bazë në krye 250 banorë shtetas shqiptarë zgjidhet nji zgjedhës i dytë.

Art. 15. — Mbrenda 3 ditsh prej mbarimit të veprimeve, Këshilli i Bashkis detyrohet me shpallun caktimin e ç' do zone e të qendrës së saj në dy kopje qi do të varen, njana në qendrën e Nënprefektnrës e tjetra në qendrën e zonës respektive.

Kaptin' e V.

Mbi hartimin e listave elektorale

Art. 16. — Mbrenda 5 ditve prej shpalljes së dekretit të Kryetarit të Republikës për zgjedhjet e misvet të Dhomës së Deputetvet, në qendrën e ç' do Nënprefekture me nisiativën e Prefektit a të Nënprefektit formohet nji Komisi e përbamun prej nji delegati të gjykatës së vendit, nji delegati të Bashkis e prej nëpunësit të Shtetit Civil, Komisis, kështu të formueme Prefekturat, Nënprefekturat e Bashkit janë te detyrueme t' u apin personalin shkrues të nevojshëm.

Art. 17. Kjo Komisi, mbrenda 15 ditve prej formimit të saj, âsht e detyrueme të nxjerrë nga regjistrat e Shtetit Civil emnat e të gjith atyne qi kanë të drejtë vote si mbas Art. 8. Në nji shtyllë bri emnavet t' atyne qi së kanë cilsi për zgjedhës të dytë si mbas Art. 9. do të shenohet fraza: „vetëm zgjedhës i parë" bashkë me shkakun justifikuës.

Art. 18. Për ç' do zonë elektorale bâhet, në tri kopje, nga nji listë e veçantë në të cilën do të përmblidhen emnat e zgjedhësvet të parë e të dytë vetëm t' asaj zone me shenimet e Art. të sypërm. Nga këto tri kopje, njana do të mbetet në zyrën e Komisis, nji tjetër do të varet përjashta Bashkis dhe e treta në qendrën e zonës respektive.

Art. 19. Bashkit e qendravet të Nënprefekturavet' e qendravet të zonavet elektorale janë të detyruem t' i varin botnisht këto lista nji ditë mbassi t' u jenë kumtuem nga Komisija kompetente.

Art. 20. Komisia âsht e detyrueme të bajë edhe nga nji lis-

të për ç' do zonë elektorale qi të përmbajë emnat e atyne shtetasve shqiptarë qi kanë mbushun moshën 18 vjetësh po qi janë përjashtuem nga e drejta e votës tue mos pasun cilcit e tjera t' Art 8. Në nji shtyllë bri emnat të të përjashtuemvet do të shenohen shkaqet e përjashtimevet të themelueme mbi vërtetimet e zyravet kompetente ase mbi prova të sigurta qi rezyltojnë nga hetimet e Komisis vetë, sa për shkaqet e parapame në paragrafet ç, e d, të Art. 8. Kjo listë do të ruhet në zyrën e Komisis në dispozitë të të gjith atyne qi kërkojnë shpjegime.

Art. 21. – Ata shtetas Shqiptarë qi kanë të drejtë vote po qi në kohën e zgjedhjeve nuk ndodhen mbrenda qarkut të Nënprefekturës së tyne ku kanë banimin, mund të regjistrohen në listat eloktorale të vendit ku ndodhen e të votojnë atje mbassi të bajnë kët formalitet :

T' i paraqesin Komisis kompetente të listavet elektorale të shumtën 10 ditë përpara zgjedhjes së zgjedhësvet të dytë, një kërkesë të shkrueme pa pullë me të cilën të deklarojnë:

1. Dëshirën e vet me u regjistruem në listat elektorale të zonës ku ndodhen.

2. Dorë-heqjen nga e drejta e votimit në vend të banimit të vet.

Kjo kërkesë bahet edhe me telegraf, por do të përcillet me nji dëshmi t' autoritetit kompetent të vendit të banimit të tij, nga e cila të rezultojë se kërkuesi âsht i regjistruem në Shtetin Civil t' atjeshëm dhe ka të drejtë votë absolute a të kufizueme.

Art' 22. – Ata qi besojnë se kanë të dreitë të jenë zgjedhës të parë a edhe të dytë e qi nuk figurojnë fare e figurojnë kufizisht në listat elektorale mbrenda 10 ditve nga data e shpalljes së këtyne, mund të kërkojnë rregjistrimin e tyne me nji kërkesë të shkrueme pa pullë, të drejtueme Komisis kompetente të listavet. Shqyrtimi i këtyne dëftesave duhet të bahet mbrenda 20 ditve prej shpalljes së listavet elektorale nga ana e Komisis së përmendun, të plotsueme me dy mise të tjerë të deleguem ad hoc. nga Këshilli i Bashkis së vendit.

Gjith ket të drejtë kanë edhe ata, qi për ç' do shkak nuk figurojnë fare në regjistrat e Shtetit Civil.

Art. 23. – Kjo Komisi shqyrton kërkesat ksodore edhe vendon, në mënyrë të preme, pranimin a refuzimin e tyne. Në rasë pranimi, urdhnon regjistrimin e kërkuesit, mbrenda në 24 orë në listë relative.

Kaptin' e VI

Mbi shfaqjen e kandidaturës t' atyne qi zgjidhen misa të Dhomës së Deputetvet

Art. 24. — Secili qi dishiron me u zgjedhë deputet duhet të gëzojë cilsit e shenjueme n' Art 10 të kësaj ligje dhe të shfaqë kandidaturën e tij në qarkun elektoral ku lyp të zgjidhet të paktën 15 ditë përpara ditës së caktueme për zgjedhjen e misevet të Dhomës së Deputetvet. Kandidatura e ç' do cilit për misë të Dhomës së Dëputetvet, vihet edhe me anën e 15 zgjedhësvet të parë, 15 ditë përpara zgjedhjeve të caktueme për zgjedhjen e deputetvet.

Ç' do kandidat Deputet ose ata që paraqesin kandidaturën e ndokuj që të merret parasyesh kandidatura duhet të kenë paguar në një nga zyrat Financiare të Shtetit ose Konsulata, 100 fr. ari; me kërkesën për kandidaturën duhet paraqitur dhe dëftesa; po mjafton që t' i drejtohet një telegraf Bashkis' o Prefekturës prej nënpunësit të financës ose konsullit ku u paguan të hollat; taksën e telegramit do t' u paguaj kandidati ose ata që kërkojnë kandidaturën e një tjetri.

Art. 25. — Kandidatura paraqitet me nji deklaratë me letër të porositun ase me telegramë, të drejtueme Bashkis së qendrës ose Prefekturës, të paktën 15 ditë përpara zgjedhjes të misevet të Dhomës së Deputetvet.

Art. 26. — Kandidatura e shqiptarve qi ndodhen jashtë Shqipnis i paraqitet Bashkis së vendit me anën e Legatavet e Konsullatavet shqiptare të vendit ku ndodhen, me letër të poporositun a me telegramë me shpenzimet e veta.

Art. 27. — Kur dekllarata paraqitet me dorë, zyrat e Bashkivet janë të detyrueme me i dhanë paraqitësit nji dëftesë. Kur paraqiten me letër të porositun a me telegrame vendin e dëftesës e zen nënëshkrimi i zyrës së Bashkis qi tregon marrjen e letrës a të telegramës.

Për efektet ligjore, afatet nisin prej datës së dëftesavet a të nënëshkrimevet të sypërpërmendura.

Art. 28. — Bashkija e përmendun, të nesërmen e mbarimit t' afatit për shfaqjen e kandidaturës d. m. th. 14 ditë përpara zgjedhjevet, harton listat e emnavet të kandidatvet dhe e shpall me botimin ma të gjanë në qendrën e Prefekturës si edhe me

anën e Bashkivet të tjera në qendrat e Nënprefekturavet të Prefekturës respektive.

Art. 29 — Nji kandidat ka të drejtë të verë kandidaturën e tij në tri vise të Shqipnis dhe në qoftë se zgjidhet në të trija viset atëhere ky zgjedh pranon përfaqësin' e njanës nga të trija qi u-zgjoth.

Art. 30. — Zgjedhja e zgjedhësvet të dytë ndëpër zonat elektorale fillon për nji herë në gjith Shtetin qysh nga data e dekretit të Kryetarit Republikës qi cakton për zgjedhjen e zgjedhësvet të dytë dhe mbaron të shumtën mbrenda 25 ditve.

Art. 31 — Të paktën 5 ditë përpara fillimit të zgjedhjevet për zgjedhësa të dytë, në ç' do qendër Prefekture ose Nënprefekture, mblidhet Këshilli i Bashkis dhe të shumtën mbrënda dy ditve formon Komisit për marrjen e votave dhe inspektimin e votimit ndë për zonat elektorale.

Art. 32. — Në ç' do qark Prefekture formohen aq komisi sa të shifen të mjaftueshme për marrjen e votave, inspektimin dhe mbarimin e votimit, në për gjith zonat elektorale t'atij qarku.

Këto veprime duhet të marrin fund të shumtën n' afatin e caktuem n' Art. 30 të kësaj ligjë.

Art. 33. — Komisit për marrjen e votave dhe për inspektimin e votimit, formohen prej nji nga gjyqtarët t' atij qarku dhe prej dy vetvet të tjerë të zgjedhnn prej Këshillit të Bashkis së vendit.

Art. 34. — Kur prej Këshillit kompetent për caktimin e formimin e këtyne Komisive parashikohet se në qarkun e asaj Nënprefekture nuk mjafton personali gjyqsuer i parapamë n'Art. 33 dhe për kompletimin e këtij shërbimi tregon qi duhet me do e mos edhe nji sasi tjetër e caktueme gjyqtarësh; Nënprefekti i vendit me të shpejt i kërkon Prokuroris së qendrës së Prefekturës kët sasi gjyqtarësh për qarkun e vet. Prokurorija âsht e detyrueme të dërgojë me të shpejt gjyqtarët e nevojshëm nga qarku i Prefekturës prej atyne qi kanë mbetun pa shërbim ndër të tilla Komisi dhe në qoftë se nuk gjinden të tillë, prej atyne avoketënve qi kanë lêjë për ushtrimin e avokaturës e qi Ministrija e Drejtësis ka të drejtë t' i shënojë si zavendsa gjyqtarësh në rasa nevojash të tilla.

Art. 35. — Avoketënve qi u-ngarkohet detyra ndër Komisi u epet rroga e Gjyqtarit Paqtues, për ditët e punimit të tyne ndër Komisit e përmënduna. Gjith ashtu u-epen dhe djetet e

shpenzimet e udhëtimit qi ligjorisht u përkasin Gjyqtarvet Paqtuesa. Pagimi i tyne bahet nga Budgeti i Ministris së P. të Brendëshme.

Art. 36. – Komisit e parapame në Art. 33 të kësaj ligjë, kryesohen prej nënpunsave të drejtësis të deleguem pranë këtyne Komisive.

Bashkit e qendravet të Prefekturave, të Nënprefekturave, të paktën dy ditë përpara se të fillojnë votimet për zgjedhësa të dytë, u dorëzojnë kryetarvet të Komisivet të përmenduna të gjitha mjetet e nevojshme për zgjedhje nëpër zonat përkatse.

Art. 37. – Kur në nji ose disa Nënprefektura të nji qarkut elektoral s' ka Bashkina, mjetet e duhuna për zgjedhje ndër zonat elektorale të qarkut të saj ose t' atyne Nënprefekturave, u-epen Komisivet relative nga Bashkija e qendrës së Prefekturës t' atij qarku elektoral, edhe kur s' ka Bashki as në qendrën e Prefekturës së përmendun, atëherë këto mjete i dorëzohen Komisive nga Nënprefektura e atij qarku elektoral.

Art. 38. – Nji ditë përpara se të merret vota nji zonë elektorale, Kryetari i Komisis për marrjen e votave dhe inspektimin e votimit lajmon me anën e nëpunsave të Bashkis ose me bekçit edhe gjindarmët Pleqësit e Lagjeve ose të katundevet të nji zonës elektorale qi këta të lajmojnë votuesit qi u përkasin se, të nesërmen qysh nga ora 9 e deri më 5 të ditës gjith votuesit e lagjevet ose të katundevet të tyne të ndodhen gati në qendrën e zonës elektorale për të votue zgjedhësat e dytë. Për vërtetimin e bamjes të këtij lajmimi, merret prej Pleqësivet nënëshkrimi ose vula e tyne mbi nji dëftesë të posaçme.

Art. 39. – Ditën e fillimit të zgjedhjeve, Komisit për marrjen e votave dhe kontrolimin e votimevet ora më 9 të mëngjesit ndodhen gati nëpër qendrat e zonavet elektorale relative.

Art. 40. – Votimi për zgjedhjen e zgjedhsavet të dytë bahet i fshehtë tue hedhun ç' do votues votën e vet në nji arkë të mbyllun e të vulosun me dyllë të kuq, me vulat e tri personavet të Komisis nga nji vrimë (birucë) sipër saj aq' e vogël sa të mundet me u fut bileta e votës.

Art. 41. – Votimi bahet me bileta të nji tipi uniformë dhe prej karte të bardhë me gjatsi e gjansi 10 centimetrash. Këto bileta kanë përsipër vulat e misvet të Komisis për marrjen dhe inspektimin e votimit.

Art. 42. Kryetari i Komisis së përmendun i ep çdo votuesi bi-

letën e votimit në të cilën votuesi shkruen kaq emna për zgjedhës të dytë sa mundet me nxjerrë ajo zonë elektorale në qarkun e së cilës voton.

Këto emna votuesi i shkruen me dëshirën e tij, ja atje ku ndodhet Komisija dhe me anën e cilit do qi dëshiron, ja i shkruan përjashta. Ç' do votuesi mundet me i'u dhanë bilet votimi tjetër në qoftë se e para i u prish në shkrim e sipër, dhe i a kthen Komisis.

Art. 43. Në qoftë se nji votë përmban emna shumë nga numri i zgjedhësve qi asht caktuem për atë zonë eloktorale, atëhere si të zgjedhun me até votë konsiderohen ata të cilvet u përmendën emnat ma përpara se të tjervet.

Art. 44. Votuesi me votën e tij të shkrueme paraqitet përpara Komisis e massi tregon se ka nji votën e vet edhe kqyret prej Komisis identiteti i tij dhe se në duert e veta përmban vetëm një votë, e kët votë pa i a këndue kurkush se ç' ka shkrue e heth më dorën e vet nga vrima e arkës mbrenda në tê.

Art. 45. Në gjith kohën e votimit ndodhet gati të paktën nji nga Pleqsija e katundevet të zonës elektorale. Mund të ndodhen gati edhe kandidatët për misa të Dhomës së Deputetve ose përfaqsuesat e tyne.

Art. 46. N' orën 5 pikërisht merrë fund votimi dhe çilet arka përpara atyne qi ndodhen gati në gjithë kohën e votimit dhe numrohen votat ashtu dhe ata qi votuen, dhe mbas kësaj vepre bahet llogarija e votavet të çdo të zgjedhuni, ata qi kan fitue vota ma shumë zgjidhen zgjedhsa të dytë.

Art. 47. — Për të gjitha veprat qi përmban Art. 46, redaktohet nji proces verbal i cili si datohet, nënshkruhet prej Komisis dhe Pleqvet të Katundit qi ndodhen.

Art. 48. Veç këtij proces-verbali edhe për çdo zgjedhës të dytë redaktohet atë ditë nji shkresë e veçantë e nëshkrueme prej misvet të Komisis me të cilën këtij i bahet me dijtë se me votat relative qi fitoj, u zgjodh në atë zonë zgjedhës i dytë. Këto shkresa u kumtohen zgjedhsvet me anën e Komisis së zgjedhjeve, dhe për kumtimin e bamun merret nji diftesë e nënshkrueme prej ç' do cili qi i bahet komunikimi.

Art. 49. – Proces-verbali i zgjedhievet, dëftesat e komunikimit aahtu edhe të gjitha votat për ç' do zonë, me kohë i dërgohen Bashkis së qendrës së Prefekturës dhe Nënprefekturës.

Art. 50. – Kur Komisija mbaron zgjedhjet në nji zonë ele-

ktorale, kjo me të shpejtë shkon në qendrën e nji zonës elektorale tjetër e cila ndodhet nen kompetencën e vet dhe ban zgjedhje dhe në këtë zonë, me atë mënyrë dhe me ato formalitete qi i bani dhe në zonën e parë. Gjithashtu Komisija vepron për gjith zonat elektorale qi gjinden në kompetencën e vet.

Art. 51. — Të gjithë kundërshtimet për ilegalitete në zgjedhjen e zgjedhjeve të dytë i drejtohen mbrenda pesë ditve ç' nga dita e zgjedhjes Gjykatësit Paqtues kompetent, i cili vendos në pesë ditë mbi vleftën ligjore të këtyre kundërshtimeve. Në vendet ku detyra e Gjyqit Paktues u ngarkohen Gjyqeve Fillore, në vend të gjykatësit qi kundërshtohet merret nji avokat. Në rasë t' anulimit të zgjedhjes bëhen zgjedhje të reja në qarkun relativ mbrenda 7 ditve, po kurdohrë përpara ditës së caktueme për zgjedhjen e misevet të Dhomës së Deputetve.

Art. 52, — Ndër ato vise qi s' ka Bashki, Pleqsit e katundeve t' atyne viseve mblidhen dhe zgjedhin 4 vetë prej tyne. Këta 4 vetë, do të zajnë vendin e Këshillit Bashkiës s'atij vendi

Kaptin' e VII.

Mbi votimin e zgjedhjes së misvet të Dhomës së Deputetvet

Art. 53. — Në gjijh Shtetin për nji ditë veprohen zgjedhjet për Dhomën e Deputetvet. Këjo ditë caktohet në dekretin për veprimin e zgjedhjevet.

Art. 54. — Dëputetët zgjidhen prej zgjedhsavet të dytë me votim të fshehtë. Votimi i nji qarku elektoral, bahet në qëndrat e ç' do Nënprefekture me zgjedhsat e dytë t' atij qarku.

Art. 55. — Në ç' do Nënprefekturë formohet nji komisi për marrjen e votavet e përbame prej gjyqtarit mâ të naltë të vendit si kryetar e prej këshillit të Bashkis. Detyrën e sekretarit do t' a bajë kryesekretari i Bashkis.

Art. 56. — N' ato Prefektura ose Nënprefektura qi s' kanë Bashkina, vendin e tyne në Komisit' e parapame n' art. 55 të kësaj ligjë, e xenë Pleqsija e tregueme n' art 52, dhe ato vënde qi s' kanë gjykata, Ministrija e Drejtësis për të mbushun këtë nevojë, detyrohet me dërguem zavendsa gjyqtarësh.

Art. 57. — Votimi bahet me bileta të nji tipi uniformë, dhe prej karte të bardhë me gjatësi e gjansi 12 centimetrash. Këto bileta kanë sipër vulën e Bashkis së vendit dhe atje ku s' ka Bashki, atë të Kryeplakut mbi të cilën vihet dhe nënshkrimi i gjykatësit.

Art. 58. — Ditën e caktuemë për zgjedhjen e deputetvet, Komisija e parapams n' art. 55 të kësaj ligjë, prej orës 9 deri më 5, ndodhet në sallon edhe qysh nga kjo kohë, fillon zgjedhja e mbaron n' orën e mbarimit të punës si mbas këtij orari.

Art. 59. — Në sallën e zgjedhjeve munden me u ndoth edhe kandidatët Deputetët ose nji përfaqsues i secilit kandidat.

Përfaqësimi bahet me nji letër ose telegram të kandidatit të drejtuemë kryetarit të Komisis.

Art. 60. — Kryetari i komisis i ep ç' do zgjedhësi të dytë biletën e votës dhe ky shkron emnat e atyne qi dëshiron të zgjedhë misa të Dhomës së Deputetvet. Zgjedhësi i dytë ka të drejtë të zgjedhë nga kandidatët kaq veta për misa të Dhomës së Deputetvet, sa mundet me zgjedh qarku i asaj prefekturë. Shkrimi i votës bahet mbrenda në sallën e zgjedhjevet ose jashtë.

Art. 61. — Vota e shkrueme hidhet me dorën e zgjedhësit n' arkën e votave nga nji vrimë e vogël sipër asaj. Arka qysh përpara fillimit të të zgjedhjeve ndodhet e mbyllun dhe e vulosun me dyllë të kuq me vulën e Bashkis dhe të gjyqit. Komisija përpara se të hidhet vote, në mënyrën e sipërtregueme, kqyrë identitetin e cilsin e zgjedhësit. Gjithashtu kqyr pa e kënduem, edhe votën se mos zgjedhësi mban në dorë të vet ma tepër se nga nji votë, më qëllim qi t'a hedhi bashkarisht.

Atje ku s' ka bashkina, vendin e vulës së bashkis e zen ajo e kryeplakut të katundit të qendrës. Zgjedhësit të dytë i merret letër-zgjedhja për zgjedhjen e tij si zgjedhës i dytë mbasi ay të ketë hedhun votën e vet për zgjedhjen e Deputetvet.

Art. 62. — Deri sa të kenë votuem të gjithë zgjedhësit e dytë të qarkut t' asaj nënprefekturë, Komisija për marrjen e votavet, gjith ditën e zgjedhjeve ndodhet gati në salllonin e zgjedhjeve në gjith orët e punimit si mbas orarit të caktuem n' art 58 të kësaj ligjë.

Art. 63. — Kur votojnë gjithë zgjedhësit e dytë, ose mbaron koha e punimit t' asaj dite, Komisija çfaq mbarimin e zgjedhjevet dhe hapë arkën e votave, dhe mbasi numron votuesit dhe votat, ban numrimin e votavet të dhanuna për ç' do kandidat. Për këto vepra redaktohet nji proçes-verbal në dy kopje njeshë, të cilat, mbasi datohen, nënshkruhen prej të gjithë pjestarvet të Komisiis.

Art. 64. — Nga proces-verbalet e redaktueme si mbas art. të ma sipërm, njani i dorëzohet Nënprefektit edhe tjetri Kryetarit të Bashkis së vendit.

Proces-verbali i dorëzuem Bashkis, ruhet n' arshivën e saj, dhe ay i dorëzuem Nënprefektit, të nesërmen i dërgohet Pre.ekturës nga e cila varet Nenprefektura me mjetet mâ të shpejta.

Atje ku s' ka Bashki proces-verbali merret prej Nenprefekturës dhe ruhet n' arshivën e asaj.

Art. 65. — Posa t' i mrrijnë Prefekturës proces-verbalet e zgjedhjevet nga të gjitha Nënprefekturat q'i varen, Prefekti asht i detyruem qysh të nesërmen e mrritjes së tyne të mbledhë në sallën e zgjedhjevet të qendrës së tij Komisin për marrjen e votave dhe inspektimin e votimit prej zgjedhsave të dytë. Komisija e përmendun kqyrë votat e fitueme në ç' do Nënprefekturë prej ç' do kandidati, dhe nzjerr shumën e votavet të secilit prej tyne. Ata qi kanë fitue votat e shumta deklarohen të zgjedhun por tue u rujtun sasija e përfaqësimit të fevet ndëpër Prefektura si mbas Art. 6 të kësaj ligje. Këjo sasi e nevojshme ruhet edhe sikur kandidat e asaj feje në pakicë të kenë vota ma të pakta nga kandidatët e fesë tjetër në shumicë.

Art. 66. — Zgjedhja e misëvet të Dhomës së Deputetvet lidhet me nji proces-verbal ku tregohet shqyrtimi i proces-verbaleve të Nënprefekturave dhe përfundimi i fitimit të zgjedhunve me shumicë relative. Ky proces-verbal redaktohet në dy kopje njesh edhe mbassi datohet e nënshkruhet prej të gjithë misëvët të Komisis, njana i epet Bashkis së vendit dhe tjetra me anën e Prefekturës i paraqitet Ministris së P. të Mbrendëshme.

Art. 67. Pas mbarimit të zgjedhjevet me një shkresë të nënëshkrueme prej Prefektit dhe Kryetarit të Bashkis, i bahet me dijtë me të shpejtë secilit veçanërisht prej të zgjedhunvet, për zgjedhjen e tyne si deputet nga qarku i asaj Prefekture.

Art. 68. — Atje ku s' ka Bashki, proces verbali i përmëndun n' Art. 66 të kësaj ligje ruhet në Arshivën e Prefekturës, dhe shkresa e përmendun në Art. 67, nënshkruhet prej Prefektit dhe Kryeplakut të katundit të qendrës së Prefekturës.

Art. 69. — Kur dy a ma shumë kandidatë me numër të njinjishëm votash fitojnë në zgjedhjet po vijnë në shkallë të mbrame ndaj kandidatvet të tjerë fitues, atëhere përmbi këta, mbrenda nji javë bahen zgiedhje të reja veçse në dhaçin dorëheqjen të tepërmit. Në qoftë se edhe zgjedhjet e dyta përfundojnë në kët rezultatë atëhere e Komisija e parapame n' Art. 65 të kësaj ligje, heth shortë midis tyne dhe ay qi fiton quhet i zgjedhun.

Kaptin' e VIII.

Mbi gjykimin e zgjedhjevet

Art. 70. — Për gjykimin e zgjedhjevet në rasë kundërshtimi për ilegalitete, asht kompetent Dhoma e Deputetvet, e cila proçedon në kët gjykim si mbas Rregullores së Brendëshme në veprim.

Zgjedhjet e njanit ose të ma shumë Deputetve të nji qarkut elektoral, anulohen kur shifet se në zgjedhjet e kundërshtumuna, janë bamë kaq vepra ilegale, sa po t' mos qenë bamë ato, rezultati i të zgjedhunit ose i të zgjedhunvet, do t' ishte qarisht në disfavorin e tij ose të tyne. Gjith ashtu për të tilla shkake, anulohen prej giyqit edhe zgjedhjet e zgjedhsavet të dytë. Kundërshtimet do t' i paraqiten Kryesis së Dhomës së Deputetvet mbrenda dhet ditve nga e nesërmja e zgjedhjes së Deputetvet.

Art. 71. — Në rasë të tillave kundërshtime për të dhanë mbi to Dhoma e Deputetvet nji gjykim të drejtë, Ministrija e P. të Brendëshme asht e detyrueme të paraqesë të gjitha votat e përdoruna në zgjedhjen e Deputetve ashtu edhe të gjitha aktet relative për zgjedhjen e të kundërshtuemve.

Art. 72. — Kur zgjidhet nji Deputet pa mos pasun cilsit e duhuna si mbas kësaj ligjë, ose zgjidhet tue u ndodhun nëpunës nga ata qi ndalohen me u zgjeth si mbas Art. 11 të kësaj ligjë, kjo zgjedhje do të quhet e anulueme vetiu ndaj Dhomën e Deputetvet.

Art. 73. — Në rasë anulimi zgjedhjesh, për vendet ksisoj të lirueme, bahen zgjedhje suplementare me ata zgjedhës të dytë por tue u ruejtun të gjitha formalitetet e zgjedhjevet të përgjithëshme.

Kaptin' e IX.

Mbi të drejtat e shpërblimit të misavet të Dhomës së Deputetvet

Art. 74. — Deputetët marrin shpërblimin e caktuem në Statut ç' prej ditës së zgjedhjes deri ditën që zgjidhen Deputetët e ri, marrin edhe shpenzimet e udhtimit dhe në rasë misionit marrin djetet e caktueme me ligjë.

Art. 75. — Deputetët, të cilvet u-anulohen zgjedhjet, kanë të drejtë shpërblimi, deri ditën qi u-anulohet zgjedhja e tyne.

Kaptin' e X.

Mbi fajet elektorale

Art. 76. — Ata qi si mbas Artikujve 16 e 17 të kësaj ligjë, redaktojnë lista elektorale, dënohen me burg nji deri me dy vjet edhe me humbjen e të drejtavet politike deri më 5 vjet, në qoftë se, duke ditun, regjistruan n' atë, votues nga ata qi nuk kanë mbushun moshën legale ose qi nuk zotnojnë cilsit e lypuna prej kësaj ligje. Gjith ashtu dënohen në qoftë se, tue ditun, nuk regjistruan ata qi kanë mbushun edhe cilsit e tjera ligjore. Në qoftë se nga pakujdesija bajnë njanën ose tjetrën prej tyne, edhe kjo pa kujdesi shkaktoj mos votimin e tyne, dënohen me gjobë nga 20 e deri me 100 fr. ari.

Art. 77. — Në qoftë se ay qi nga kjo ligjë ngarkohet me i regjistruem ata qi si mbas nji kundërshtimi, dhe me vendim si mbas Art. 23 të kësaj ligjë, kanë të drejtë të regjistrohen në listat elektorale tue dijtun nuk i regjistron, dënohet me nji muej e deri në tre muej burg dhe në qoftë se këtë e bani nga pa kujdesija, dënohet me 20 deri me 100 fr. ari gjobë.

Art. 78. — Nëpunësit e Drejtësis qi mohojnë ose nuk kujdesohen në të kryemit e detyravet qi u-ngarkohen nga kjo ligjë, ose si-domos u-kontravenë detyravet të tyne, dënohen me nji muej deri në tre muej burg dhe me pushim të përkohshëm deri më 6 muej. Gjith ashtu me kët dënim dënohen edhe nëpunësit e Administratës, Kryetarët e Bashkivet dhe Pleqësit e katundeve në qoftë se veprojnë si u tha në paragrafin e parë të këtij Art. për nëpunësit e Drejtësis.

Art. 79. — Avokatënvet qi si mbas Art. 34 të kësaj ligje u-ngarkohen prej Ministris së Drejtësis detyrat e zavendsit të Gjyqtarit, janë të detyruem me e pranuem kët detyrë pa kundërshtim veçse në ndodhen të smunë me nji mënyrë qi nuk mund të dalin jashtë shtëpis së vet; për ndryshe dënohen me nga 50 deri me 200 fr. ari dhe me ngritjen përkohësisht të lejes s' avokaturës deri më 4 muaj.

Art. 80. — Dënohet me burgim nga nji vjet deri më 3 vjet dhe me humbjen e të drejtave politike për pesë vjet ay që rrëmben ose si-do-mos thyen arkën qi ka votat ose prishë proces-vèrbalet e zgjedhjeve ose hethë n'arkë mâ shumë se nji votë.

Art. 81. — Ay ose ata qi guxojnë të shtojnë emna nalt ose

poshtë votës së hedhun n' arkë, ose ata qi prishin emnat e shkrueme në votën e hedhun dhe shkruejnë ose nuk shkruejnë emna të tjerë, dënohen me nji vjet e deri më tre vjet burg, dhe në janë nëpunsa, hiqen dhe nga puna.

Art. 82. — Cilido qi urdhnon ndërhyrjen në zgjedhje të fuqis ushtarake, ose vepron ndërhyrjen me ç' do organ të fuqis publike, në qoftë se âsht nëpunës civil, dënohet me burg deri më 6 muaj dhe me heqjen nga puna, dhe në qoftë se âsht ushtar, me 6 muaj deri nji vjet.

Art. 83. — Ata qi ven në vend të nji zgjedhësi qi nuk ka votue edhe paraqiten për votim me emna të rrema të tyne, dhe kërkojnë të votojnë, dënohen me nji javë deri në nji muaj burg, dhe ata qi votojnë në kët mënyrë, dënohen me burg nga nji muaj deri në 6 muaj.

Art. 84. — Ç' do kundravajtje tjetër të kësaj ligjë e cila nuk parashikohet nga dispozitat penale të kësaj ligjë ose të ligjës penale, dënohet me 50 deri më 200 fr. ari.

Art. 85. — Ç' do vepër e dënueshme qi ka relacjon me zgjedhjet dhe parashikohet nga kjo ligjë ose Nomi Penal, dënohet edhe në qoftë se vërtetohen ose anulohen zgjedhjet prej Dhomës së Deputetve.

Art. 86. — Për të gjitha fajet elektorale kohë-kalimi âsht gjashtë muejsh ç' prej datës së ngjarjes.

Art. 87. — Dënohet me gjobë prej 10 deri më 50 fr. ar zgjedhësi i dytë qi pa shkak të justifikueshëm nuk shkon të votojë.

Art. 88. — Për me gjykue fajet elektorale, janë kompetentë gjyqet ordinare të Shtetit.

Dispozita të mbrame

Art. 89. — Padija për ndjekjen e fajevet të parapame në Kaptinën X ushtrohet prej ç' do qytetasi shqiptar.

Art. 90. — Ligja mbi gjykimin e nëpunësave, s' ka fuqi për fajet e parapame në Kaptinën X.

Art. 91. — Ushtarët për gjith ditën e votimit mbahen mbyllun në kazermat e veta.

Art. 92. — Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes.

Art. 93. — Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Drejtësis janë të detyrueme me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Drejtësiës
P. POGA

Ministri i Financavet
e Zav. Ministri i P. Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i P. Botore
e Zav. Ministri i P. Mbrendshme
K. KOTTA

Pëlqej ligjin mbi zgjedhjen e misave të Dhomës së Deputetve pranue prej Kuvendit Kushtetues si mbas shkresës së Kryesis së Tij Nr. 105 d. 2-III-1925 dhe dekretoj zbatimin e tij.

Tiranë, me 14 III-925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 9.

DEKRET-LIGJË, 13 Mars 1925

Mbi ndalimin e hyrjes të ç' do far puntori të huej në Shqipni

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Mars 1925 Nr. 11)

Art. 1. — Ç' prej datës së shpalljes së këtij Dekret-Ligji ndalohet hyrja e ç' do far puntori të huaj në tokën e Republikës Shqiptare.

Art. 2. — As nji puntor i huaj i ç'do nënshtetsie qi t' jet dhe për ç' do qellim qi t' udhëtojë në Shqipëri nuk mundet të pranohet.

Art. 3. — Tregtarët Industrialët ose ata qi kanë nji specialit të posaçmë me nënështetësië të huej e qi duen të vizitojnë Republkën Shqiptare detyrohen kur të kërkojnë vizën e hyrjes në tokat e Republikës t' u tregojnë Përfaqësive Shqiptare ose Konsullatave letër këmbimin, emnin, Firmën e Tregtarit, Industrialit Mjeshtrit Shqiptar me të cilën asht në maredhanje dhe vjen për t' ushtruar mjeshtrin e tijë.

Art. 4. — Përfaqësit Shqiptare dhe Konsullatat janë të detyruar kur të vizojnë pasaportat të shenojnë ndë te: a) Tregtari, Industriali, ose Mjeshtri qi udhëton në Shqipëri ç' far njeri asht, me cilin tregtar Shqiptar asht në maredhanje, këtë me ç' mënyrë e vërteton.

b) Emri, Vendi, Firma e Tregtarit Shqiptarë qi asht në maredhanje me të huejin, cila ësht kjo, me se vertetohet.

Art. 5. – Autoritetet e Detit dhe të Kufinit detyrohen të kërkojnë gjith ato dispozita qi u shenuen n' alinjatin a, b, të nenit 4 për Tregtarët Industrialët e Mjeshtrit e huej që do të të vinë në tokat e Repubiikës.

Art. 6. – Kjo dekret-ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes.

Art. 7. Dispozitat e ligjevet të tjera qi janë në kundërshtim me këtë dekret-ligjë janë të pa fuqishme.

Art. 8. – Ministrija e P. të Mbrendshme e Jashtme dhe Komandat e Ushtris e Gjindarmëris ngarkohen me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Tiranë, 13-III-25.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. P. Botore e Bulqësis
Zav. M. P. Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 10.

DEKRET-LIGJË, 11 Mars 1925.

Mbi ndryshimin e artikuliit 1, 2 e 3 të ligjit mbi internimin e fëmijve e konfiskimin të pasunis t' Aratisunve

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Mars 1925, Nr. 11)

Neni 1) Të pandehunve me krim e delikt që aratisen e qi nuk dorëzohen mbas 15 ditëve të dorëzimit të letër shterngimit, ju konfiskohet pasunija e tyre e tundëshme dhe e patundëshme dhe në qoftë se ajo pasuni ka dhe pjesëtarë të tjerë ju ndahet pjesa e tyre me anë të pleqësis së Lagjes a të katundit dhe ju shitet pjestarëve të pafajshëm, në mos e blefshin ata shiten në adjudikat dhe të hollat i dorëzohen Financës së vendit, në mos daltë kush blerës pasunija e pa tundëshme rregjistrohet si pasuni e Shtetit.

Krimineleve t' aratisun ju internohen gjith fëmija mëshkuj e femna qi gjenden në nji zjarm e banojnë tokërisht të pandamun.

Përjashtohen nga internimi pjesëtarët e gjinisë qi janë uloga e studenta aktivë.

Vendi i internimit caktohet nga Ministrija e Mbrendshme dhe vazhdon deri sa i aratisuni t' i dorzohet Qeveris ose të falet nga ana e Kryetarit të Republikës.

Neni 2) Për ata qi mbajnë e fshehin t' aratisunit, lehtësojnë

aratin e tyne me dashje e pa shtrengim nga ndo nji anë veprohet si mbas nenit 1.

Neni 3) Në qoftë se t' aratisunvet të cilvet do t' u konfiskohet pasunija e do të u shitet ose do të ragjistrohet si pasuni e Shtetit; kur t' aratisunit i dorëzohen Qeveris ose falen nga ana e Kryesis së Republikës do t' u kthehen të hollat e vleftës të pasunis tyre nga ana e Arkës ose pasunija qi do të jetë e rregjistrueme si pasuni e Shtetit.

Neni 4) Ky Dekret-ligjë hyn fuqi që nga dita e shpalljes në fletoren Zyrtare.

Neni 5) Ministrija e P. të Mbrendshme dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Tiranë, me 11-III-25

Kryetari i Rebublikës
A. ZOGU

Ministri j Financavet
e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri Drejtësiës
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës
Zav. Ministri i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 11

LIGJË, 6 Mars 1925

Mbi përjashtimin nga taksa doganore deri në 8000 kuintal misër

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Mars 1925, Nr. 11)

Art. 1 — Përjashtohet nga taksa doganore deri në 8000 kuintal misër qi do t' importohet nga viset e Jugosllaviës për ushqimin e popullsiës së Prefekturës së Kosovës.

Art. 2. — Sasija e misrit të caktuem n' art. 1, lejohet vetëm për popullsin e Prefekturës së Kosovës.

Art. 3. — Kjo ligjë vihet në veprim nga data e çpalljes dhe ka fuqi deri në fillim të vjeshtës së dytë 1925.

Art. 4. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Financavet
MUFID LIBOHOVA

Pëlqej ligjën e sipërme mbi importimin e lirshëm të misrit për nevojat e populliës Kosovës pranue prej Kuvendit Kushtetuës si mbas shkresës Kryesiës së tij me Nr. 79-I, datë 2-III-925. dhe dekretojë zbatimin e saj.

6-III-925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 12.

LIGJË, 7 Mars 1925.

Mbi përmbledhjen e budgetit të parapameve e të hymeve e të dalunave për ushtrimin financjar prej 1-IV-1925 deri 31-III-1926

(e botueme në Fletornn Zyrtare, 17 Mars 1925, Nr. 11)

Pjesa e rendëshme e parendëshme

	Kompetenca për ushtrimin financjar 1925-1926	OROE
Për Ministrin e Financavet	2.633.436	
„ Ministrin e Drejtësis	900.000	800,000 për Ministrin e Drejtësisë dhe 100,000 për Sheriatë.
„ Ministrin e P. të Jashtme	509.920	505,720 për M. e Jashtme dhe 4,200 rrogë për legjistin.
„ Arësimin	1.892.746	
„ Ministrin e P. të Mbrendshme	1.572.160	1,552,160 për M. Mbrend. dhe 20,000 për ndërtesa Qeveritare.
„ Minist. e P. Botore e Bulqësis	1.800 000	
„ Kom. e P. të Fuqis Armate	5.746.260	
„ Drejtorin e P. të Post-Telegr.	710.000	
	15.764.522	
të hyme	15.781.150	
Diferenca	16.628	

Ministri i Drejtësis
Zav. Min. Arsimit
P. POGGA

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Minis. P. Botore e Bul.
e Zv. M. P. të Mbrendë.
K. KOTTA

Pëlqej përmbledhjen e shumave mbi të hymet e të dalunat të budgetit t' ushtrimit Financjar 1. IV. 925-31-III 926 pranue prej Kuvendit Kushtetues si mas shkr. së Kryesis së tij Nr. 21-II datë 2-III-925 dhe dekretoj zbatimin e saj.

Tiranë, me 7-III-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

BKSH

Nr. 13

KONTRATË, 14 Mars 1925

Mbi shërbimin me aeroplanë me shoqërin „Adria Aero Lloyd"

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Mars 1925, Nr. 11)

Ndërmjet Shkëlqesis së Tij, Ministrit të Punve Botore e Bujqësis, Kostaq Kotta, qi vepron n' emën të Qeveris Shqiptare me nji anë, e Shoqënia „Adria Aero Lloyd" e përfaqsueme prej të ngarkuemit me fuqi Zotni Otto Habermehl, qi banon po në Tiranë, m' anë tjetër, u vendos si vijon:

Artikulli i Irë.

Objekt i konçesjonit.

„Qeverija e Shqipnis qi do të quhet tash e mbas „Qeverija„ i nep Shoqënis „Adria Aero Lloyd" qi do të quhet tashti e mbas „Shoqënia" për nji afat 10 vjetësh të drejtën ekskluzive të shërbimit t' aviacjonit në Shqipni për të mbartunit e udhtarvet e të letravet ose kolí postavet e të gjanavet tregtare mbi vijat në të cilat Shoqënija do të jetë e zoja me shërbyem.

Në kjoft se nji komunikacion ajruer me vendet fqinj do të bahej i nevojshëm, Shoqënija do t' a ketë të drejtën më e shtrim shërbimin e vet mbi vendet fqinj, por me rezervë që natyrisht t' a ketë pëlqimin e të gjitha vendevet t' interesueme.

Po të jetë se nji Qevëri e hueja ose nji Shoqëni aviacjoni do të kërkonte të drejtat me aterizue në tokë të Shqipnis e me mbifluturue tokën Shqiptare, Qeveria, në marrëveshtjen qi do të lidhi do të ketë parasyësh interesat qi Shoqnija do të munt të fitonte në këtë rasë mbi bazën e reciprocitetit. Avionet e Shoqnis do të kenë armët e Shqipnis.

Rregulloret për shërbimin e aeroplanavet mbrenda Shqipnis si edhe me vendet fqinj, do të vendosen, në themel të rregullorevet qi drejtojnë komunikatën ajrore ndërkombëtare, prej Qeveris me bashkveprimin e Shoqnis.

Artikulli II

Shoqënia zotohet me ngrehun shërbimin e aviacionit ndërmjet qytetevet me randësi të Shqipnis ndërmjet të cilavet çfaqet nevoja e marredhanjevet të shpejta, e me filluem këtë shërbim

mbrënda nji afati ma së shumti prej gjasht muejsh tue filluem me ditën e ratifikimit të kësaj marrëveshtje. Veç kësaj Shoqënija zotohet me bartun postën me kushtet e përcaktueme n' artikullin III. Për vjetin e parë Shoqnia do të vendojë shërbimin udërmjet Qytetevet Shkodër, Tiranë, Korçë, Vlonë.

Në qoft se Shoqnija nuk e plotson këtë kusht, Qeverija ka të drejtë me e prishë konçesjonin.

Shoqnija zotohet me shtrimë kët shërbim mbas vjetit të parë mbi tjerat qytete të vendit për të cillat nevoja marrëdhanjesh të shpejta do të provohej dhe mundësija e aterimit nuk mungon.

Asht vendos, qi Shoqnija e ka për detyrë me e njoftë nevojën e dukshme të komunikatës në të gjitha rasat kur paraqiten tre udhtarë paguesa në stacjonet e nisjevet,

Për të parin vjet Shoqnija detyrohet me përshkuem me ose pa udhtarë, të paktë dy herë në javë vijën Shkodër, Tiranë, Korçë, Vlonë.

Po qe se për arësye të kohës së keqe qi duket, nji ose disa nisje do të shtyhen për ma vonë, udhtimet qi s' janë bamë do të bahen në javat ose muejt qi vijnë pas.

Në qofë se mbassi të jetë lajmue, Shoqnija prej Qeveris nuk do t' i përgjegjesh, mbrenda afatit të kontratit, nevojës së dukshme të komunikatës, Qeverija ka të drejtë me e prishë konçesjonin.

Në rasë prishjeje të kontratës prej Qeveris, Shoqnija detyrohet me e ndaluem shfrytimin e me i lishuem vendet e atërizimit në tre muej, tue filluem me ditën e notifikimit të prishjes ose të vendimit arbitrimit.

Me anë tjetër po të jetë se Shoqnija do të konstatonte, mbas vjetit të parë, tue nisun me datën e fillimit të mbartjevet, se frytet janë të pamjaftueshme për shfrytim t' a ketë po të drejtën me e prishun kontratën e me ndaluem shfrytimin:

1) Me nji paralajmim prej tre muejsh me mbarimin e të parit vjet tue nisun nga data e fillimit të mbartjevet.

2) Me nji paralajmim prej gjashtë muejsh mbas mbarimit të vjetit të parë.

Për sa i përket vendevet t' uljes e hangarevet t' aviacjonit kushtet e artikullit 7 do të hyjnë në fuqi.

Artikulli III.

a) Shoqnija lidhet me bartun letrat e koli postë të vogjël me ose pa vleftë ndërmjet stacjonevet t' itinerarit të saj.

b) Pesha ma e madhe për të cillën asht e detyrueme Shoqnija me e bartun për shërbimin postar në secillin udhtim asht 100 kilogram.

c) Tue e filluem 2 muej qysh prej nisjes së shërbimit t' aviacionit, Shoqnija asht e detyrueme me i dhanun Administratës së Postavet lajme mbi udhtimet e rregullshme.

d) Shoqnija merrë përgjegjsinë deri më 20.000 (njizet mijë) fr. ari për çdo udhëtim për humbjet materjale qi do të mundet me pasun posta për faj të zyrtarvet të Shoqnis, si mbas rregullorevet në veprim për aviacjonin ndërkombtar.

Kjo garanti duhet të depozitohe prej nji Shoqnije sigurimi, dispozita t' Administratës së Postavet, si mbas rregullores në fuqi për aviacjonin ndërkombtar për sa i përket shërbimit postar ajruer.

Detyra e Shoqnis kufizohet në të dorzuem, sasin e thasvet në nji gjendje të mirë të mbylljes.

e) Moskuptimet mbi përgjegjsin e Shoqnis për sa i përket humbjevet qi munt të ngjajnë do të zgjidhen prej gjykatoreve kompetente.

f) Dorëzimi i valixes postare prej Postës agjentavet të Shoqnis e prej agjentavet Postës, do të bahet në stacjonet e aviacjonit.

g) Shoqnija detyrohet me nderuem të drejtën regaliane të Postavet, por ka dhe ajo të drejtë me e dërguem korespondencën e vet qi i përket shërbimit.

h) Shoqnija lidhet me bartun falas korespondencën e Qeveris me thasë të veçantë qi nuk do të kalojnë së bashkut peshën neto prej 1 kilogrami për ç' do udhtim.

Gjith' ashtu dërgesat ari qi nuk do t' a kalojnë së bashkut peshën e 5 kilogramavet për ç' do udhtim.

Të gjitha tjerat korespondenca e koli që do të barten nga Posta me anën e shërbimit ajruer, duhet të kenë pullat si mbas tarifës së vëndit.

Qeverija i garanton Shoqnis të vuemit rregullisht të pullës në dërgesat Postare e ngjitjen e pullavet mbi takse e lidhet me sqyrtue shërbim postuer tuë shikjuem herë pas here dërgesat si mbas kërkesës së Shoqnis.

i) Administrata e P. T. T. si këmbim i siguron Shoqnis faljen për transmetimin në Shqipni të gjitha komunikimevet telefonike e telegrafike qi i përkasin shërbimit t' aviatës e sherbimit meteorologjike.

k) Administrata autorizon Shoqnin me ngrehun nji vijë telefonike prej stacjonevet t' aviatës në zyrat e telegrafës në qytet për transmetimin e komunikimevet të përmenduna nën „i".
Telegramat e shërbimit duhet të hartohen në gjuhë të qiartë e të kuptueshme e do të konfirmoben ma vonë me shkrim.

m) Ç' do dërgesë postarë për t' u barton me avion do të ketë pullat si për bartje toksore. T' ardhunat e këtyre pullavet i merr vetëm Administrata e Postavet.

Për bartjen me avion do të paguhet nji shtesë nën formën e afrankimit me pulla të veçant të quejtuna pulla për avion.

T' ardhunat e shitjes së pullavet për avion, edhe pse shitja të bahet për qëllim afrankimi ose kolekcjoni, po të jetë se pullat janë në qarkullim do t' i derdhen me nga $25^0/_0$ Administratës së P. T. T. e $75^0/_0$ Shoqnis.

T' ardhunat e shitjes së pullavet jasht kursit do të derdhen me nga $50^0/_0$ Administratës së P. T. T. e $50^0/_0$ Shoqnis. Shitja e stokavet të pullavet jasht kursit do të bahet në nji ose ma shumë hera si mbas marrëveshtjes ndërmjet Administratës së Postavet e Shoqnis.

n) Në rasë qi Shoqnija do të çelte nji shërbim kah vendet e hueja, lidhet me e kryem bartjen e postës mbi bazat të tregueme ma sipër pa tjera shpenzime për postën e Shqipnis e tue nderuem rregulloret ndërkombëtare.

o) Vendimet mbi të vuemit jasht kursit të pullavet t' avionit e mbi nxjerrjen e pullave të rea si edhe shitja e stokut qi mbetet të pullavet të vueme jasht kursit, nuk do të meren veçse mbas nji kuptimit ndërmjet Qeveris e Shoqnis.

p) Rregullimi i llogarivet mbi shitjen e pullavet t' avionit e pagimin e shumavet qi i përkasin Shoqnis do të bahet krye muejit, në funt të çdo muejit për muejin e kaluem.

q) Shoqnija detyrohet me paguem $75^0/_0$ (shtat dhet e pësë për qind) për shpenzimet e bamuna për shtypjen e pullavet Fabrikimi i pullave do të vendoset me bashkëkuptim midis Qeveris e Shoqnis. Përgatitja e pullavet do të bahet në nji atelier të dorës së parë i cili do të ketë të gjitha garantit për cilsin e pregatitjes e sigurim kundër shpërdorimevet.

Ministrija e Financavet do t' i mbajë këto pulla t' avionit në depozitë e në fund të çdo muejit do të lajmëroj sasin e vleftën e pullavet qi dorëzojë për shërbim të postës, mbrenda atij mueji.

Artikulli IV

Tarifë

Shoqnija asht e lirë me vënduem tarifët për mbartje e udhtarvet e gjanave tregtare mbrëndë pes vjetvet të para.

Tue filluem me vjetin e gjashtë, Qeverija do të kontrollojë tarifët tue u bazuem mbi përfundimet e vjetvet të përparshme e tue i lanun Shoqnis nji fitim deri 10%

Artikulli V.

Kontroll

Qeverija e rezervon të drejtën me emnuem nji antar të Këshillit t' Administratës së Shoqnis.

Artikulli VI.

Dorëzimi Hangarësh e vende t' aviatës

Qeverija do të vënë në dispozitë të Shoqnis falas e për krejt kohën e konçesjonit:

1) Hangarët e aviatës të Tiranës e Vlorës.

2) Vendet e aterizimit qi ka në Tiranë, Durrës e Vlorë.

Dorëzimi i këtyne Hangarëvet e tokavet do të bahet mbrenda nji afati prej 1 mueji mbas ratifikimit të kësaj marrëveshtje.

3) Qeverija merr mbi vehte me vuem gjithashtu falas në dispozitë të Shoqnis edhe vendet tjera të nevojshme për aterim të cilat do të zgjidhen prej nji komisionit të Qeveris i këshilluem prej Shoqnis.

Këto vende t' aterimit për vijën e parë duhet të jenë të dorëzueme ma së vonit në dy muej mbas ratifikimit. Kur zgjanimi i shërbimit mbi vija të rea do të nevojit krijimin e vendevet të rea, aterimi, tokat e nevojshme do të zgjidhen po në këtë mënyrë e duhet të do rëzohen mbrenda nji afati prej dy muajsh mbas kërkimit të Shoqnis adresuem Qeveris.

Artikulli VII.

Kthim i tokavet dhe i hangarëve

Në mbarim të konçesionit Shoqnija do t' i-a kthejë Qeveris tokat e aterimit e Hangaret e Tiranës e Vlorës në nji gjen-

dje të mirë mbajtje normale. Veç kësaj Qeverija e rezervon drejtën me blemë tre nga Hangaret e ngrehun prej Shoqnis me çmim të ditës qi do të caktohet me arbitrim.

Artikulli VIII.

Shërbim i rregullit

Shërbimi i rregullit e i siguris në vendet e aviatës asht në barrë të Qeveris.

Artikulli IX.

Lirim Doganet

Qeverija i akordon Shoqnis të drejtën me importue pa pagesë doganore avionet, copat për këmbim, aparatet veglat e materialet e nevojshme për shfrytim, qi do të caktohet prej Ministris P. Botore.

Por përjashtimi nga tagri doganuer për benzino, voj-gurit e tjerat langë ynyret, do të pritet posa qi këta artikuj do prodhohen e shiten në vend.

Shoqnija duhet të mbikëqyri me kujdes përdorimin e landavet t' importueme pa tagër doganuer e do t' i-a lajmojë secillën rasë shpërdorimi autoritetevet për të mundun këto me dënuem fajtorët si mbas ligjëvet; në rasë të përkundërt Shoqnija do të konsiderohet përgjegjse për këtë kundravajtje.

Po qe se në mbarim të konçesjonit Shoqnija do të donte me shitun në vend sendet e importueme pa tagër doganuer do të paguaj tagret doganore për këto sende në çastin e shitjes.

Artikulli X.

Për garanti të të kryemit të kushtevet të veta Shoqnija do të depozitojë nji peng prej 5000 frang arë në nji arkë të Shtetit (qi do të caktohet) mbreda 15 ditve mbas lajmimit të ratifikimit të konçesjonit përndryshej kontrakti konsiderohet i prihun e i pa vleftë.

Ky peng do t' i këthehet Shoqnis posa qi t' a ketë bam të parën bartje si mbas intinerarit të saj.

Instalacjonet e Shoqnis do të shërbejnë për krejt kohën e kontraktit si peng i marrshëm për të garantuem detyrat e Shoqnis.

BKSH

Artikulli XI.

Prishja e konçesjonit

Në rasa kur Shoqnija nuk do të kishte filluem shërbimin e aviatës si mbas artikullit II në nji afat ma së shumti prej gjashtë muejsh mbas të vuemit në dispozitë të sendevet t' aterimit e të hangarevet kësaj do t' i merret konçesjoni i saj' si edhe pengu, përveç në rasa të fuqís së jashtzakonshme.

Artikulli XII.

Nënshtetsija e nëpunsavet

Personali i përdorun për shfrytim do të jetë i nënshtetsis Shqiptare, përveç personalit drejtues e specialistat do të mund të jenë të huej.

Në rasë lufte ndërmjet Shqipnis e nji vendi tjetër Qeverija i rezervon vehtes të drejtën me ndalue shërbimin e avionëvet, pa shpërblim.

Artikulli XIII.

Zgjedhja e vendit të banimit e të juridiksjonit

Shoqnija zgjedh për banim e zbatim të këtij konçesjoni qytetin e Tiranës e do t' i shtrohet kompetencës së gjykatavet e ligjevet Shqiptare e rregulloreve ndërkombtare qi zbatohen mbi këto çashtje.

Në rasë vështirsije ndërmjet Qeveris e Shoqnis, anët lidhen me i thirrun një arbitrimi.

Secilla anë emnon nji arbitër; të dy arbitrat emnojnë të tretin arbitër. Po qe se dy arbitrat nuk kuptohen mbi të tretin arbitër, ky do t' emnohet prej Gjyqit të Diktimit të Tiranës. Po qe se njena anë nuk do t' a ketë emnuem arbitrin e vetë në nji afat prej tet ditësh mbas kërkimit t' anës tjetër kjo do t' a ketë të drejtën me emnuem të dytin arbitër.

Artikulli XIV.

Ky kontratë asht bamë në Frengjisht e Shqip. Në rasë mos kuptimi mbi interpretim, tekstit Frengjisht i zihet besë.

U ba në Tiranë, me dy eksemplar, dhe u nënshkrue sot me.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
e Zav. M. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Min. i P. Botore e Bujqësis
Zav. Min. i P. të Mbrend.
K. KOTTA

Pëlqej këtë Kontratë të lidhun në mes të Ministrit Punve Botore e Bulqësis e të Shoqnis Adria Aero Lloyd mbi shërbimin Postar me Aeroplana në Shqipni, aprovue dhe prej Kuvendit Kushtetues si mbas shkresës Kryesis së Tij Nr. 82-I datë 1-III-25 dhe dekretoj zbatimin e saj.

Tiranë, me 14-III-925.

Kryetar' i Republikës
A. ZOGU

Nr. 14.

DEKRET-LIGJË, 11 Mars 1925.

Mbi përjashtimin nga xhelepi të sasis deri 100 berrave

(e botneme në Fletoren Zyrtare, 24 Mars 1925, Nr. 12)

I. – Përjashtohen nga taksa e xhelepit sasit e berravet (dhen dhi) të cilat së bashku nuk e kapërcejnë njiqind (inklusiv) Sasit mbi njiqind berra i shtrohen taksës së xhelepit vetëm për pjesën qi kapërcen numrin njiqind (eksklusiv).

II. – Ky dekret-ligjë hyn në fuqi dysh ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare

III. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij dekret ligji.

Tiranë, me 11-II-925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financave
Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore
e Zav. M. i P. të Mbrendëshme
K. KOTTA

Nr. 15.

LIGJË, 7 Mars 1925.

Shtojcë e Tarifës Doganore 1923-1924

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Mars 1925, Nr. 12)

Nr. Rend.	Nr. Tarifës	EMNI I GJASË	Për kvintal fr. ari
1	20 d	Bar për me xanë djathë	100
2	32 b	Elb i regjun (Malto) për fabrikimin e alkoolit	5
3	48 b	Miell patatesh (fecola)	80
4	71 b	Perce bimësh (crine vegetali) për me mbushë dyshekë	5
5	76 b	Çokolatë	100
6	82 b	Kem (incenso), buhur	60
7	99 b	Alkool për nevojë të barnatarve deri 75 Kgr. në vjetë si mbas dishmis të mjekut të Bashkis e të Këshillit Administrativ të vendit	20% advaloren
8	179 a b c	Letra cingarit	Monopolizue
9	189	Letra lojet	Monopolizue
10	223	Kariqa për gjoje peshkut prej spaget etj.	50
11	254	Pëlhurë mendashi artifical, si Zharse etj.	750
12	167 d	Tjera pupla	1000
13	283	Qymyr metalit gurit, kok	1
14	284 b	Baterië për fener e kandil eletrikut	20
25	289 abc	Shkrepca	Monopolizue
16	349 b	Enë hekurit të kallajtisuna, (ferro smaltato)	40
17	386 b	Kutija teneqet bosh me etiketë për me i mushë me bojë këpucësh	10
18	401	Makina industrijet e veglat përkatëse të tyne	Tagri falun
19	419 b	Vojnat tjera për qëllim industrijet të sapunit	3
20	481 b	Acido solforico (Itizapë)	3
	c	Acido muriatico (tuz ruhi)	10
	d	„ lattico	10
21	483 b	1 Kininat e gjith barnat me këtë êmën	Tagri falun
		2 Të gjitha serum e vaksinat	„ „
		3 Neosalvarsan dhe extrait e thére de fungere male	„ „

22	485	Essenza e vojna profumeriet për qëllim industrijet sapuni	5 % advalorem
23	486	Njyrë për flokë	500
24	486	Pastë e pluhun dhambësh dhe të gjithë langjet antiseptike për pastrim të dhambëvet.	Tagri falun

Ndryshohet krejt e bahet

Art. 4-13 i tarifës. Përjashtohen nga tagri doganuer barnat e veglat e mjekimit qi sjellen prej Bashkive e Spitaleve të Shtetit, për smutoret e tyne, e që përdorën për të smuerit e papasun.

Art. 4-24. Thasët e fuçijat e ênët e tjera të reja ose të përdorueme që importohen për t' exportue prodhime vêndi janë të faluna prej tagrit doganuer po tagri i importimit do të sigurohet me një dorëzaní, me konditë që mbrênda nji vjeti t' exportohen me prodhime vêndi për ndryshe të kaluemen këjo kohë tagri i merret rregullisht.

Art. 13

1. Gjanat që exportohen prej Shqipnijet janë të faluna nga tagri doganuer për veç serës (ziftit) e landës (përshihen edhe druët për zjarm) të cilat paguejnë 2% ad valorem.

2. Tagri transitës që âsht marrë 2% ad valorem bâhet 1%.

3. Transita për tokë e alkoolit e gjanave të monopolizuëme âsht e ndaluëme.

Për ujë asht e lirë me kondicjon që të bihet dishmija e të mërrijtunit të gjâsë prej Doganës së Shtetit të huaj ku âsht shkarkue gjâja, e vërtetueme dhe prej Konsullatës s' onë po kje se ndodhet n' at vênd.

Ndryshohet krejt e bahet

Art. 1 i Ligjës taravet. Në qoftë se tregtari nuk shênjon në diftim (deklaracion) peshën netto reale të gjasë, s' importueme; tagri doganuer paguhet mbi peshën që nxjerret tue zbritë tarën ligjore prej peshës lordo të kolivet, d. m. th. se përposë peshës së vërtetueme prej Doganës, paguhet tagri edhe për diferencën e peshës që mbetet. Përjashtohen prej këtij veprimi gjânat që paguajnë 20% ad valorem si medicinali etj.

Art. 14

Teshat qi i hupin rrugës tregtarvet e qi hupja e tyne vërtetohet rregullisht nuk paguajnë taksë Doganore.

Art. 15

Artikujt qi janë paksuë vêhen në veprim mbas dy muajvet dhe të tjerat qi janë caktue rishtas; ato qi kanë mbetë si çë kanë qênë ose janë shtuë vêhen në veprim që ditën e shpalljes edhe bashkë me tarifën Doganore në veprim vazhdojnë në fuqi deri sa të dalë nji tjatër tarifë Doganore.

Ministri i Financave
MUFID LIBOHOVA

Pëlqej shtojcën e sipërme të tarifës Doganore 923-924 pranuë edhe prej Kuvêndit Kushtetues si mbas shkresës Kryesis së tij Nr. 51-I datë 2-III-925 dhe dekretoj zbatimin e sajë.

Tiranë, 7-III-1925 *Kryetari i Republikës*
A. ZOGU

Nr. 16

DEKRET-LIGJË, 8 Mars 1925

Mbi pranimin e konvencionit me hekurudhat e Shtetit Mbretnor t' Italis mbi kërkimin e vajgurit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Mars 1925, Nr. 12)

Ndërmjet t' Exelencës së Tij Ministrit të P. Botore e Bulqësiës vepruës n' emën e për njehsi të Shtetit Shqiptar, për t' u shenjue tash e mrapa si «Shteti», në njenën anë:

E të Hekur-udhave të Shtetit Mbretnor t' Italiës të përfaqësueme prej Z. Ugo Piolti i emnuem posaçërisht dhe fuqiplotë, për t' u shenjuë tash e mrapa si „Konçesionari" (term që shënon Hekur-udhat e Shtetit Mbretnor t' Italiës si edhe Shoqniët t' organizuëme prej tyne si kur flitet n' artikullin 9 të këtij konvencioni), në tjatrën anë:

Asht konvenue e vendue çka vazhdon:

Art. 1

Shteti i akordon Konçesionarit të drejtën eksklusive për kërkim dhe shfrytzim të vojgurit, gaz natural, bitum e shkame

asfaltike të cilat prodhojnë vojguri tuej i distilue ndër tokat e me konditat e përmbajtuna në kët konvencion.

Ar. 2

Periudha e Kërkimeve

Konçesionari detyrohet me tregue në nji afat dy muejsh tuej nisë që nga data e nënshkrimit të këtij konvencioni kufiët e tokavet (përimëtres) që i konsideron për me ba kërkimet dhe me këto kondita:

a) Sasia e përgjithshme e përimëtrave të mbajtun nuk ka me mujt me përfshië nji sipërfaqe ma të madhe se 50.000 (pesdhetmij) hektar.

b) Nga caktimi i përimëtravet kan me u përjashtuë vendet (localités) e ndaluëme prej ligjës, si edhe tokat mbi të cillat, partië të treta kan fituë të drejtën për eksploration dhe për shfrytzim të substancave të treguëme në art. 1 përpara nënëshkrimit të këtij konvencioni.

c) Numri i përimëtrave nuk ka me muëjt me kenë ma tepër se katër.

Art. 3.

Konçesjonari ka me pasë të drejtën eksklusive, mbrenda tri vjetëvet tuj nisë që nga data e shpalljes të ratifikimit të këtij konvencioni në gazetën zyrtare, me ba ner perimetrat e treguëme n' artikullin e ma parshëm, të gjitha punimet e kërkimit, si në sypërfaqe, ashtu në thellësi, me qëllim që me abulue substancat e tregueme n' art. I. Kjo perjudhë tri vjeteshe qi tash e mrapa ka m' u shenjue „Perjudha e Kërkimit" në marreveshtje të përbashkt ka me muejt me u zgjatue rizhtaz për nji afat t'arsyeshëm. në kjoftë se ka nevojë nga rrethana (circontances) të pouaçme.

Art. 4.

Për veç punimeve sypërfaqore e të kërkimeve me pusa e galeriena, Konçesjonari detyrohet me shbirue (forer) mbrenda përjudhës së kërkimeve, të paktën shtat pusa prej të cilëve tre do të kuptojnë nji thellësi 1000 (njimi) metrash, për veç rases kuer gjindet vojguri në nji thellësi ma të pakët.

Art. 5.

Koncesjonari nuk ka me mujt me disponue mbi mineralet e

nxjerruna mbrenda perjudhës së kërkimit veç se për analiza e arova industriale e kte në nji masë pa kapërcye 100 (njiqind) tonelatë për gjith se cilën substancë të tregueme n' art. I. Por gjithnji ky ka me mujt me i përdorue lirisht n' ato sasie që janë të nevojshme për punimet e kërkimit.

Në rasë që produkcioni, mbrenda kësaj perjudhe do të jet ma i madh se sasinat e sipër-përmenduna, Shteti ka me akordue nji leje përdorimit të lirë me të drejt eksportimit, mbasi të paguhet përpara nji redevance 13,5 (trembëdhet e gjysë) përqind të sasinave të tregueme në leje.

Art. 6.

Konçesjonari ka me i paraqitë Shtetit krye gjasht muejsh nji raportë që të përmbajë studimet e punimet e bame për kërkim dhe përparimin e tyne mbrenda gjashtmujorit të para-kaluem. Kësaj raporte ka me u bashkanjit planet e hartat e nevojshme dhe Konçesjonari do të japin të gjitha informatat suplementare që Shteti mund të kërkojnë.

Art. 7.

Perjudha e shfrytzimit

Në çë farë do kohet përjudhës së kërkimit ose në mbarim të kësaj perjudhe, në kjoft se Konçesjonari e gjykon se eksiston vojguri për sasina të shfrytzueshme tregtarisht, ka me pas të drejtë me zgjedhë në perimetrat e treguem n' art II. sypërfaqet nër të cillat aj ka me pas të drejt ekslusive për kërkime të ma-pastajshme e për shfrytzim të substancave të tregueme n' art. 1, deri me 31 Dhetuer 1985, dhe me konditat e tregueme nër artikujt qi vazhdojnë. Periudha e përfshime mbrenda të zgjedhunit të sypërfaqeve të sypër përmenduna dhe data 31 Dhetuer 1984 ka m' u shenjue si „Periudha e Shfrytëzimit".

Art. 8.

Të zgjedhunit e sypërfaqeve që konçesjonari ka me majtë për me ba nër to punimet që i përkasin periudhës së shfrytzimit i nënvehet konditavet që vazhdojnë:

a) Sypërfaqet e zgjedhuna, krejtësisht nuk do të kalojnë 30.000 (tridhetmi) hektarët.

b) Këto sypërfaqe nuk do të kapërçejnë caqet e përimëtravet të treguëme n' art. 2.

Art. 9.

Me qëllim që me i dhanë nënshtetasvet Shqiptar posibilitetin me marrë pjesë në sipërmarrjen qi ban objekt të këtij konvencionit, Konçesjonari detyrohet me formuë, nër katër muajt e parë të perjudhës së shfrytzimit, nji ose ma shumë shoqëniëna anonime qi të kenë për qëllim zbatimin e programit të shfrytëzimit dhe ma të madhin zhvillim (developpement) të dobinavet (benefices) që rrjedhin prej këtij konçesjoni. Konçesjonari do t' i lëshojnë (céder) shoqëniënavet të sypër-përmenduna të gjitha të drejtat qi i janë akorduëm me kët konvencion. Kapitali i këtyne shoqëninave nuk ka me ken ma i vogël se 10.000.000 (dhet miljon) fr. ar dhe ka me muëjt me u-shtue (augmenter) si mbas nevojave të sipërmarrjes.

Ky (kapitali) ka me u nda nër akcione e vleftat nominale jo ma të nalta se 50 (pesdhet) fr. ar, prej të cillit 40 % ka me u rezervuë, për tre muaj rresht, nënshkruësvet nënshtetas Shqiptar. Në kjoft se në fund të kësaj perjudhe tremuajshe të gjitha ose nji pjesë e akcionavet të rezervuëme për nënshkrim kombëtar nuk ka me kenë e nënshkruëme, kanë me u lanë këto të gjitha ose kjo pjesë e pa nënshkruëme në dispozicion të Qeveris Shqiptare për dy muaj që të mund të bahet nënshkrimi prej Thesariës së Shtetit. Në fund të këtyne dy muajve, akcionet e rezervuëme që nuk janë nënshkrue prej Shtetit ose prej nënshtetasve Shqiptar, kan me u liruë nga ç'do të drejtë optioni dhe Konçesjonari ka me muëjt me disponuë mbas dëshirit të vet.

Shteti ka të drejtën me emnuë nji antar në Këshillin e administratës të Shoqniënavet të sypër përmënduna. Nji kopje e bilançave vjetore të shoqniënavet ka me ju komunikue Shtetit.

Art. 10.

Konçesjonari detyrohet me i paguë Shtetit, Mbrenda të gjith periudhës të vleftës (validitè) së këtij konvencioni nji taks fikse dhe nji redevancë për pjestimore. Taksa fikse ka me u paguë nji frank e gjysë ar (1.50) për nji viet e për nji hektar toket të dhanun Konçesjonarit. Kjo taksë ka me u paguë të parën herë për dy vjet paradhanje, mbrenda muajit që vjen mbas ratifikimit të këtij konvencioni.

Redevanca për pjestimore ka me u paguë krye tre muajsh në përpjesjim të trembëdhet e gjysë (13.5) për qind të prodhi-

mit të vojgurit të pa punuëm (brut) që asht bajtë prej pusave nër reservuarë, tue zbritë sasiënat që janë konsumue për punimet e shfrytzimit. Shtetit ka me pas të drejtë me kërkuë (prètendre) kët redevancë në natyrë ose në të holla. Në fund të ç'do tremujorit të perjudhës së shfrytëzimit, Konçesjonari do t'i paraqesin Ministriës së P. Botore e Bulqësiës, nji raportë mbi sasinat e vojgurit të pa punuëm të prodhuëm dhe mbi mëndyrën që asht disponue. Redevanca ka me i njehsue (calculée) mbi sasinat e treguëme nër këto raporta.

Art. 11.

Mbrenda periudhës së shfrytëzimit Konçesjonari detyrohet me vuë në zbatim programin e thellimit (forage) qi vazhdon:

Në vjetën e parë 1000 metra.

Në vjetën e dytë tjera 2000 metra.

Në vjetën e tretë të tjera 3.000 metra.

Në vjetën e katërt të tjera 4.000 metra.

Në vjetën e pestë të tjera 4.000 metra.

Në kioftë se në një vjet numri i metrave të thellimit kapërcen minimum të nalt-treguëme, sasia e ma tepërt ka me u zbritë prej minimum-it të metrave që do të shbirohen (forer) nër vjetët vazhduëse. Programi minimum i thellimit ka me muëjt me u ndaluë (suspendre) në rasë të nji prodhimit të jashtzakonshëm i cili kishte me penguë zaptimin (capture) të nji pjesës së vojgurit që del nga sondat. Kështu vlen edhe kur prodhimi i vojgurit të kaptojë (atteindre) 150.000 (njiqindepesdhetmijë) tonelatë në vjetë dhe për aq kohë deri sa prodhimi nuk ka me zbritë nën kët sasië. Në rasë kur zorime serioze pengojnë zbatimin e programit minimum të thellimit çashtja do t'i parashtrohet komisjonit mixtë t' ekspertave (Art. 21) i cilli ka me pas fakultetin me akordue nji zbritje të arësyëshme të programit.

Mbas pes vjetvet të para periudhës së shfrytzimit, Konçesjonari detyrohet me vazhdue dhe me zhvillue në ma të naltën gradë që asht e mundun shfrytzimi i gisementave vojguror tuej ba të gjitha mundimet e mujshme e t'arsyëshme, dhe ka me e rregullue mbi këto parime (programin e thellimit, mas konsultimit me komisjonin mixt.

Art. 12.

Konçesjonari ka me pasë të drejtën me e lëshuë (abando-

ner) çdo pjesë toket të përfshiëme nër sypërfaqet e majtuna për shfrytzim. Ky lëshim e liron nga të gjitha detyrimet e caktuëme prej këtij konvencioni, për sa i përket tokave të lëshuëme.

Art. 13.

Konçesjonari detyrohet me ngref (installer) në Shqipnië nji rafinerië në rasë që të konstatohet se kapaciteti vjetor i prodhimit të pusave n' ushtrim (exercice) t' arrijnë 50.000 tonelatë vojguri të nji kaliteti qi i jep dorë industrialisht për rafinim.

Art. 14.

Në fund të periudhës së shfrytzimit (d. m. th. mbas 31 Dhetuer 1985) të gjitha sondat, pusat, galerinat, instalacionet e konstrucionet qi eksistojnë në Shqipnië dhe janë të Konçesjonarit, kan me ju lëshue gratis Shtetit pa kurr farë detyre.

Art. 15.
Instalacione e ndërtime

Konçesjonari ka me pasë të drejtën me ndërtuë, me u shtruë (exercer) e me majtë: Rruga ordinare, dekovile, tramvaje, hekurudha, teleferike linje qyngash për vojguri (conduites) për uj o për gaz, ura, rreshtime (quais) limane, rezervuare, depo, stacione pompash, rafinerina, uzina e banime, telegrafa pa tel, linjë telefonike e telegrafike; përfund të gjitha instalacionet e ndërtimet qi kan me kenë të nevojshme për drejtimin e mirë të sipërmarrjes qi ban objokt të këtij konvencioni, në kjoft nevoja edhe jasht sypërfaqeve të dhanuna për shfrytzim. Shteti detyrohet me i akordue gratis nër tokat e ujnat shtetnore qi nuk i janë dhanë personave të treta, kalim të lirë, dhe tokat e nevojshme për instalacionet e ndërtimet e sypër-përmenduna, si edhe me ba ekspropriacionin në konformitet me ligjët në fuqië, në rasë kur instalacionet e ndërtimet do të xanë tokat ose ujnat privat ose të dhanuna përpara të tretve për të tjera qëllime.

Të gjitha shpenzimet e nevojshme si edhe shpërblimet e ekspropriacionit ka me ken për barrët e Konçesjonarit. Këto shpërblime ka me u njehsue pamvarësisht nga çdo konsideratë që rrjedhë nga kënja (existencë) e konçesionit qi përban objektin e këtij konvençioni.

Art. 16.

Konditat e Përgjithshme

Konçesjonari detyrohet me shpërblye në nji mëndyrë të drejtë-personat e treta qi mund të jenë të damtuëme prej punimevet të cilat lejohen prej këtij konvencioni. Shpërblimi ka për t' u caktue në mëndyrë miqësore ndërmjet të dy palvet, e në rasë nji mos marrëveshtje ka me u ba, çashtja caktue me arbitrage. Në kjoftë se arbitragi nuk ka me u ba, çashtja ka me me ju parashtrue gjykatorëvet të vendit.

Art. 17.

Nëpunësit e punëtorët e marrun (engages) prej konçesjonarit në tokë shqiptare, kan me ken nënshtetsiet shqiptare përveç drejtorave, teknikve, specjalistave. Me gjith këtë nen rasë që punimet do të pengoheshin seriozisht nga shkaku i mos mjaftimit i puntoris lokale, ka me ju dhanë leje Konçesjonarit me pruë puntorë të huej në numër të mjaftuëshëm si mbas mendimit të favorshëm të Komisjonit mixte.

Art. 18.

Në rasë që punimet pengohen ndalohen ose priten nga shkaqe të forcës majore (forcë majeure) detyrimet e Konçesjonarit kan me u ndalue për sa të ngjasin rasat e forcës majore, e ky afat nuk ka me û niehsue nëpër periudhat e kohës së parapame si maximun në kët konvecion. Në kjoftë se ngjajnë mos-marrëveshje mbi vleftën e rasave të forcës majore, çashtja ka me ju parashtrue kolegjit t' arbitragit të parapame n' artikullin 24.

Art. 19.

Konçesjonari ka me pasë të drejt me importue në Shqipnië, të lirë nga çë do takse doganore a tjetër, makinat prodhimet e materjalet qi ka me pasë nevojë për ushtrimin e të drejtave që i janë njoftë me kët konvencion.

Art. 20.

Konçesjonari ka me u përjashtue prej të gjitha taksave e tragrave të tashme e t' ardhshme mbi kapitalin e angazhuëm,

t' interesavet dhe të fitimeve që rrjedhin, të tokave në konçesjon, mbi prodhimin e exportimin e prodhimeve përveç atyneve që janë parapamë në kët konvention.

Art. 21.

Nji komisjon mixt ekspertash ka me u formue, i përbamë prej gjasht antarësh, prej të cilëve tre kan me u emnue prej Shtetit, e tre prej Konçesjonarit. Ky komision ka me vertetue kondidat e tokavet e ka me veshtruem përmbushjen e detyrimevet të Konçesjonarit. Komisjoni ka me pasë fuqi me zbritë programin minimum të thellimit si mbrenda periudhës së kërkimit ashtu edhe n' at të shfrytzimit, në rasë kur rrethana të veçanta kishin me justifikue kët zbritje. Komisjoni ka me pasë edhe fuqi me vendue e (deliberer) mbi të gjitha çashtjet teknike e legale që janë për me u ba mbi nji interpretim të dyshimtë të konditave të këtij konvsncioni ose qi kishin me mujtë me lindë prej nji rasës së pa parapaëme ose të pa-parashme e cila mund të zgjidhet miqësisht. Vendimet e Komisjonit mixt kan me u ba me shumicë votash, e në kjoftë se kjo shumicë nuk ka me mujt me u formue çashtja ka me ju parashtrue arbitragit të parapaëm n' artikullin 24.

Art. 22.

Në kjoft se Konçesjonari nuk përmbushë detyrimet e veta që rrjedhin nga ky konvecion, Shteti ka me pas të drejtën me i drejtue nji vrejtje (intimation) tuej i ba me dijt që mbrenda nji afati tremujsh të përmbushin detyrimet e marruna.

Në kjoft se në mbarim të këtij afati, Konçesjonari nuk ka plotësue detyrimet, Shteti ka me ju sjellë me nji herë arbitragit si mbas art. 24. Në kjoft se mbas arbitragit, Konçesjonari vazhdon në mos-përmbushjen e detyrimeve të veta Shteti ka me pas të drejt me prishë konvencjonin.

Art. 23.

Në kjoft në konformitet me artikullin 13, Konçesjonari instalon nji rafinerie në Shqipnie ka me ken i detyruem me i dhanë prodhimet e veta Qeveriës Shqiptare me çmimet e ditës tuj e ba nji zbritje 10% (dhet përqind).

Sasiënat që Konçesjonari do t' japin me konditat e sypërthanuna nuk do të kalojnë as njiherë 20% (njizet përqind) të prodhimit të përgjithshëm të rafineriës.

Art. 24.

Në rasë të nji mos-marrëveshtje, çfaret-do, ndërmjet të Shtetit e Konçesjonarit, mbi të drejtat e detyrimet e të dy palëve kontraktuese, që rrjedhin nga dispozitat e këtij konvencjon, çashtja ka me ju parashtru nji kolegjit arbitragit i përbaëm prej tre antarësh, prej të cilve njeni ka me u emnue prej Shtetit, e tjetri prej Konçesjonarit, e i treti ka me u zgjedhë në marrëveshtje prej dy arbitrave të parë. Në kjoft se dy arbitrat e parë nuk bjen në godi për me emnue arbitrin e tretë ka me u formue nji kolegë arbitragi i ri i përbam prej pesë antarësh, prej të cilve dy kanë me u emnue prej Shtetit e dy të tjerët prej Konçesjonarit e i pesti ka me u zgjedhë me shumicë votash prej katër arbitrave të parë. Në kjojt se edhe në zgjedhjen e arbitrit të pestë nuk do të jetë e mundun me j'a arritë nji marrëveshjes, emnimi ka me ju parashtrue Gjyqit të Diktimit Shqiptare. Vendimet e kolegjit t' arbitragit do të jepen me shumicë votash. Pritja e gjykimit t' arbitravet nuk ka me mujt me shkaktue ndalimin e ushtrimit të konçesjonit.

Art. 25.

Për me garantue zbatimin e mirë të detyrimeve që rrjedhin nga ky konvencion, Konçesjonari ka me i pague në kasë të Ministriës së Financavet Shqiptare, nër tridhet dit mbassi të nënshkruhet ky konvencion, shumën e 150.000 (njiqindëpesdhëtmi) frank ar e cilla ka me u ba pronsi e Shtetit në rasë të prishjes së këtij konvencioni për shkak mos përmbushjet nga ana e Konçesjonarit.

Kjo shumë ka me ju këthye konçesjonarit :

a) Në kjoft se ky konceesion nuk ka me u ratifikue.

b) Në kjoft se Konçesjonari lëshon në ç' farë do kohet konçesjonin edhe të drejtat e përkatëshme por me konditë qi të ketë përmbushë të gjitha detyrimet e parapaϵme prej këtij konvencjoni ; përfund ka me u kthye në mbarim të konçesjonit.

Art. 26.

Për zbatimin e këtij konvencjon i cili ka me j' u shtrue juridikcionit të Ministriës P. Botore e Bujqësiës, Konçesjonari zgjedhë për banim Kryeqytetin e Shqipniës dhe ka me ju nënvue ligjeve të vëndit deri sa këto mos të kundërshtojnë me çka asht kontraktue në këtë konvencion.

Art. 27.

Ky konvencion asht ba shqip e Frengjishtë dhe në katër exemplarë të nënshkruëme prej të dy palve kontraktuëse. Dy exemplarë (nji tekst shqip e nji tekst Frengjisht) kan me u rujt në arkivët e Shtetit, e dy të tjerat, (nji teks Shqipe e nji tekst Frengjisht) kan me ju dhanë Konçesjonarit. Parashifet e konvenohet posaçisht se në rasë dyshimesh ose mos-marrëveshtjesh të shkaktueme prej ndryshimesh interpretimit ose redaktimit, vetëm tekstit Frengjisht i zihet besë.

Art. 28.

Ky konvencion asht i vlefshëm për një perjudh 20 (njizet) vjetësh tuej nisë që nga data e nënshkrimit të tij.

Me gjith këtë Qeverija detyrohet me ja paraqitë Parlamentit për ratifiktm nji Dekret-ligjë e cila zgjaton ngjatjen e vleftës të këtij konveecjoni deri me 31 Dhetuer 1985.

Në tekstin e këtij konvencjoni për ratifikim, knptohet ratifikimi i Dekret-Ligjës së sypër-përmendun mbi zgjatimin e konçesjonit deri me 31 Dhetuer 1985.

Ba në Tiranë me 12 Mars 1925.

Për Qeveriën Shyqptare:	Për Hekurudhat e Shtetit
Ministr' i P. Botore e Bujqësiës	Mbretnor t' Italiës:
KOTTA	UGO PIOLTI

Kjo kontratë asht njinji me kontratën e aprovueme me dekretet e Këshilit Ministrial e të Kryësis Republikës së Shqipniës me datë 9 Mars 1925.

UGO PIOLTI K. KOTTA

Nr. 17.

DEKRET-LIGJË, 24 Mars 1925.

Mbi ndalimin e eksportimit të gjas së gjallë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Mars 1925, Nr. 12)

Art. 1. — Ndalohet eksportimi i delevet, e myshqerave, i qingjave femër dhe i Myzetavet (dema).

Art. 2. — Ndalohet eksportimi i qeve, buajve, i lopëve, i buallicave, i pelave deri me 8 vjeç asht i lirë eksportimi i gjasë në fjalë qi kalojnë 8 vjeçët.

Art. 3. – Eksportimi i dhive, i kuajve, i thive (derra) i keçave, (kecër) i sqepve, i mushkave, i deshve, i gomarve dhe gjith gjasë së gjallë qi nuk i përshiën neni 1 e 2 i këtij ligji pa as nji kunditë ashtë i lirë.

Art. 4. – Ky dekret-ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. – Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij ligji.

Tiranë, me 24-III-925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Drejtësiës
P. POGA

Ministri i Financavet
e Zav. Ministri i P. Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës
e Zav. Ministri i P. Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 18

DEKRET-LIGJË, 29 Mars 1925.

Mbi rregullimin e Pasunis së Shtetit qi ndodhet në Sarandë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 1925, Nr. 13)

Na, Kryetari i Republikës Shqipëtare tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer Nr. 154 datë 23-III-1925.

DEKRETOJMË

Art. 1. – Për rregullimin e pasunis së Shtetit qi ndodhet në Sarandë formohet nji komisjon i posaçëm prej nji kryetari, dy antarësh, nji Kryesekretari dhe nji Ndihmës sekretari. Përveç Sekretarëve këta do të emnohen prej Këshillit Ministruer si mbas propozimit qi do të bajë Ministrija e Financavet ku do t' i u caktojë dhe rrogat e tyne.

Detyrat e Komisjonit janë:

a) Me rregjistrue në nji rregjistër të posatshëm gjithë tokat dhe godinat qi janë pasuni Shteti;

b) Me shqyrtue dokumentat t' interesuemvet qi pretendojnë zotnimin e këtyne godinave a po tokave dhe do t'i caktojnë me

vendim vleftjen (derexhei ihtixhaxh) e këtyne dokumentave, për veç t' atyne qi ka fillue gjyqi ma parë se të formohet komisjoni.

c) Do të mbëledhin gjithë qiranat e prapambetuna deri në ditën qi do të formohet komisjoni i cilli do të caktojë çmimin e qirave tue marrë edhe mejtimin e dy ekspertave qi do t'emnohen prej komisjonit;

c) Do të pajtojnë të gjithë godinat a po tokat tue veprue si mbas Ligjit në fuqi, por nuk do të bahet dorëzimi provizor pa marrë pëlqimin e Ministris së Financavet, dhe kontratat do të lidhen ndërmjet pajtimtarit e të Zyrës së Financës kompetente.

Art. 2. – Komisjoni, shqyrtimet do t' i bajnë mbi dokumenta, dhe mendimet i nep me shumicë votash. Në mungesë të nji antari do të Zavendësohet prej Kryesekretarit.

Art. 3. – Ç' far do vendimi qi nep komisjoni do t' i paraqiten për aprovim Ministris së Financavet dhe mbas aprovimit i komunikohet t' interesuemvet, 15 dit pas komunikimit vehet në zbatim.

Art. 4. – Në qoftë se t' interesuemit nuk i drejtohen gjyqit mbrenda 15 ditve mbas datës së Komisionit, vendimi i Komisjonit mer formën e preme.

Art. 5. – Drejtimi i t' interesumvet në Gjyqë nuk ndalon zbatimin e vendimit të dhanun prej Komjsjonit.

Art. 6. — Vendimet e dhanuna dhe t' aprovume prej Ministris, Komisjoni i a dorzon Zyrës së Financavet kompetente për t' i vue në zbatim me anën e Zyrës së Përmbarimit mbassi t' ja u kenë komunikue t' interesumvet.

Art. 7. – Për shka nuk përmban ky dekret-ligjë do të veprohet si mbas ligjeve në fuqi.

Art. 8. – Ky dekret-ligjë hyn në fuqi në ditën e shpalljes.

Art. 9. – Ministrija e Financavet dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e këtij dekret ligji.

Tiranë, me 29-III-1925.

Kryetari i Republikë
A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Mieistri Drejtësis
P. POGA

Ministri i *P. Botore e B.*
e Zav. Ministri P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 19

DEKRET-LIGJË, 29 Mars 1925

Mbi huan e 400,000 fr. ari Bashkis Tiranës

(e botueme në Fletoren Zyrtare 1 Prill 1925 Nr. 13)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer Nr. 150 me 23-3-25.

DEKRETOJMË

Art. 1. – Qeverija i jep hua Bashkis së Tiranës Fr. ari 400.000 (katërqindmij) prej bankanotavet qi do t' emetohen nga Banka Kombëtare.

Art. 2. – Të hollat e përmenduna n' art. 1. do të prishen vetëm ndër vepra botore (komunikasione, kanalizime konduktura etj.) e jo në shpenzime të vdekuna e do mund të kontrollohen kur t' a shofë nevojën Këshilli Ministruer.

Art. 3. – Bashkija e Tiranës për pagimin e kësaj huaje me gjith kamatë garanton me sa të ketë me pasunin e patundahme të saj.

Art. 4. – Kamata do të jet $4^0/_0$ e fjeshtë në vjetë.

Art. 5. – Bashkija detyrohet me shlye vetëm mbrenda 16 vjetësh tue paguem në rata të njënjëshme kryegjaje e kamatë. (25.000 kapital e 8.500 kamatë 33,500) në vjetë.

Art. 6. – Në qoftë se me të kaluem t' afatit (16 vjet) Bashkija nuk ka me pase të kryeme së paguemi të gjithë detën, Qeverija për të sigurue vetëm të drejtat e saja rezervon të drejtën e shitjes së pasuniës qi vjen si garanti a të rregjistrimit definitiv n' emën të saj.

Arj. 7. – Ky dekret ligjë hyn në fuqi nji muej mbrapa se të vehen në cirkulacjon bankanotat.

Art. 8. – Ministrija e Drejtësis e P. të Mbrendshme e Financavet detyrohen me zbatimin e këtij dekret ligji.

Tiranë, me 29-III-925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësiës
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës
e Zav. Min. i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 20.

DEKRET-LIGJË, 24 Mars 1925

Mbi kredin e 10.000 fr. ari për vrasje t' aratisunish

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 1925, Nr. 13)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer.

DEKRETOJMË:

Art. I. – Të çelet nji kredit i ri prej 10,000 (dhetëmijë) Fr. ari nën titullin „shperblim" për t' i bamë ballë pagimit të shperblimeve t' atyne qi vrasin ndonji t' aratisun të rrezikshëm si mbas ligjit të posatshëm me datë 30-III-1925.

Art. II. – Ky kredit shtohet në budgetin e prishjeve t'ushtrimit Financiar 1925-1926 të degës relative.

Art. III. – Ky dekret-ligjë hyn në veprim me 1 Prillë 1925.

Art. IV. — Ministrija e P. të Mbrendshme dhe ajo e Financavet detyrohen me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Tiranë me 24-III-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBPHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës e Zav. Min. i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 21.

DEKRET-LIGJË, 29 Mars 1925.

Mbi shtimin e një krediti prej 10.000 fr. ari në budgetin e Ministris Mbrendshme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 1925, Nr. 13)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare tue pamë vendimin Nr. 156 datë 23-III-925 të Këshillit Ministruer.

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Shtohet në shpenzime të pa rendëshme të buxhetit të Ministris së P. të Mbrendëshme nji fondë prej 10.000

(dhetmij) Fr. ari, për t' i bamë ballë pagimit të bartjes qi kje bamë prej Durrësit në Dibër të misrit dhurue prej Inglizve për nevojat ushqimore të Malsinave.

Art. 2. – Ky dekret-ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes.

Art. 3. – Me zbatimin e këtij dekret-ligji ngarkohet Ministrija e P. të Mbrendëshme e ajo e Financavet.

Tiranë, me 29-III-925 *Kryetari i Republikës*
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bujqësis
e Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
K. KOTTA

Nr. 22.

DEKRETLIGJË, 8 Mars 1925.

Mbi pranimin e të vumit në zbatim të kontratës me shoqërinë e udhave të hekurta të Shtetit Italian

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 1925, Nr. 13)

Mbasi u pa vendimi i Këshillit Ministruer me datë 8 Mars 1925, i cili aprovon kontratën e bame ndërmjet Ministrit të P. Botore e të Z. Ugo Piolti-t, përfaqësues' i Administratës t'udhave të hekurta të Shtetit Italjan mbi nji konçesjon në favor t'Aministratës në fjalë për gërmime e shfrytëzim të voj gurit dhe idrokarburantave kësilloj, në konditat të përmbajtun në kontratën e sipërthanun.

Mbasi u pa artikulli 177 i Statutit;

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Pranimin e të vuemit në zbatim të Kontratës qi ngjitet këtij dekreti të bëmë ndërmjet të Ministrit të P. Botore dhe të përfaqësuësit t' Administratës s' udhave të hekur të Shtetit Italjan e cila fillon prej datës 7 Mars 1925 dhe mbaron me 7 Mars 1945.

Art. 2. – Urdhënohet me nji herë zbatimi i këtij dekret-ligji.

Tiranë, me 8-III-1925 *Kryetari i Republikës*
A. ZOGU

Ministri i Financave
Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i P. Botore
e Zav. M. i P. të Mbrendëshme
K. KOTTA

Nr. 23.

DEKRET-LIGJË 8 Mars, 1925

Mbi zgjatjen e afatit të Konçesionit të vojgurit të hekur udhave Italiane

(e botueue në Fletoren Zyrtare 1 Prillë 1925, Nr. 13)

Mbassi u pa-Dekreti me datën 8 Mars 1925 qi aprovon, për nji kohë njizet vjetësh, tue fillue prej 7 Mars 1925 kontratën e lidhun ndërmjet Ministrit Punvet Botore e Përfrqësuesit t' Administratës së Udhëve të Hekurta të Mbretnis Italjane, për kërkime (gërmime) e shfrytësim të voj-gurit e të idrokarburantave kësi lloji.

Mbassi u-pa art. 88 i Statutit e u muer vendimi i Këshillit Ministerial.

DEKRETOJMË:

Art. I. Zgjatimi deri me 31 Dhetuer 1985 t' afatit të kësaj Kontratë tue mbetë të gjitha konditat të tjera siç janë.

Art. 2. — Ky Dekret-Ligjë ka me u paraqitë në Parlament për me u kthe në Ligjë.

Art. 3. — Urdhënohet me nji herë zbatimi i këtij Dekret-Ligji.

Tiranë, mè 8 Mars 1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Mnistri i P. Botore e Bulqësis
Zav. Min. i P. të Mbrëndëshme
K. KOTTA

Nr. 24.

DEKRET-LIGJË, 16 Mars 1925.

Për konçesjonin e shfrytzimit të pyjevet shtetnore që gjinden gjatë dy brigjeve të lumit Drî ç' prej Vau-i Dêjës deri n' Ura te Vezirit me Pietër Taragjain

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 1925, Nr. 13)

1. Qeverija Shqiptare i ep z. Pjetër Daragjati, nënshtetash shqiptar, i quajtun tash e mrapa „Konçesjonari" vepruës për njehsi të vetën ase n' emën të nji shoqënis anonime që aj detyrohet të formojë e cilla do të majnë emnin „Shoqëni Anonime Daragjati për Industrin e Drunit" konçesjonin për shfrytëzimin e të gjitha pyjevet shtetnore qi gjinden gjatë të dy ana-

vet të Lumit Drî me çë do llojë druje, ç' prej Vau-i Déjës e deri të Ura e Vezirit si edhe për shfrytëzimin e të gjitha pyjevet shtetnore të tjera që gjinden në të dyja anët e lumnave Pron' i Leshës, Gomine, Gozke, Siriçi, Krumë, Valbone, Lum' i Nikajt, Lesnigja, Pron' i Nërtushës, d. m. th. ato pyje të Shtetit qi quhen pyjet e Qerretit, Pukës, Iballës, Fletit, Sakatit, Kosturit, Krasniqit, Nikajt, Merturit, Shalës, Shoshit e Shllakut, qi janë të shenjueme në kartën gjeografike ktu të bashkanjitun.

Përjashtohen nga ky konçesjon ato pyje qi njifen privatë si mbas dokumentave zyrtare, si edhe të drejtat qi si mas ligjës në fuqië kanë banuesit e atyne komuneve ase katundeve.

2. Konçesjoni ngjatë 20 (njizetë) vjetë tue fillue prej datës së nënshkrimit të kësaj kontrate.

Konçesjonari detyrohet me shfrytue pyjet e nalt përmenduna tue i nda në pesë zona paralele me Drî, punimi i cilli do të bahet të shumtën në pesë vjet për çë do zonë, tue pasë për detyrë me ndërtue dora-dorë udhët si mbas nevojës për shfrytzimin e zonave qi vijnë mprapa.

Kurse nji nga zonat nuk përmbushë sasiën landore qi lypset për pesë vjetë, konçesjonari detyrohet me shfrytzue zonën e ma-mrendshme.

3. Konçesjonari do t' japin tituj pasunie ase garancie bankare për 100.000 (njiqindmi) Frank ar, si dorëzanie për zbatimin e kti konçesjonit e për aq kohë deri sa investicjoni i instalimeve të konçesjonarit të mbulojnë shumën prej 200.000 (dyqindmi) frank ar.

4. Konçesjonarit i epet nji afat nji vjetët tue nisë ç' prej datë së nënshkrimit të konçesjonit, për të plotsus ngrehjen e sharrave, caqet e të premit, rregullimin e Drinit për përdorim të vetin, tue u mundue m' e ba të lundruëshëm për ç' do mjet mbiujse për shërbimin e bartjes së drujve prej Urës së Vezirit në Va-të-Dêjës e kte pa pengue lundrimin e përgjithshëm dhe pa ndryshue gjendjen e sotshme të katarakteve e kaskadave. Katarakta e kaskada quhen ato vende ku uji i lumit rrëzohet prej ndonji naltësie dhe bjen prap në shtratin e vet.

Me gjith këtë konçesjonari detyrohet me fillue nga importimi i veglave dhe nga premja e drujve mbrenda 6 (gjasht) muajve mbas ratifikimit të këti konvencioni.

5. Qeveria Shqiptare detyrohet me i dhanë konçesjonarit të gjitha lehtësinat e nevojshme për shfrytëzimin e pyjevet mbren-

da caktimit të ligjeve të ndryshme të Shtetit, dhe e auktorizon me goditë gjatë Drinit e të lumnave rruga e tjera qi do t' jenë të domosdoshme për bartjen e drujvet mbasi të kenë aprovimin e pëlqimin e Ministris së Punëve Botore e Bulqësis.

6. Po kje se punët themelore ndalohen për shkaqe të fuqiëve t' epra (forces majeures) konçesjonari do të gëzojë nji zgjatim kohë për aq sa ngjatë ndalimi i punës. Për shkaqe të fuqive t' epra përfshihen edhe revolucjonet lokale dhe lufta.

7. Tokat e Shtetit mbrenda zonës së konçesjonit qi do të përdoren për nevojat e kësaj sipërmarrje i epen konçesjonarit gratis. Konçesjonarit i epet edhe e drejta me hapë gurore (gur për ndërtesa, furrë gëlqerje, tullash) pa pague ndonji taksë deri sa këto të përdoren vetëm për qëllimin e shfrytëzimit të pyjeve të naltpërmënduna, tue j' u shtrue rregullave qi cakton ligja e posaçme.

9. Të premit e drujve do të bahet me mjeshtri si mbas rregullave të ligjës së pyjevet sod në fuqi e konçesjonari do t' i përdorin të tretunat e drunjve pa ndonji shpërblim deri sa të përdoren për nevojë të konçesjonit; për pjesën tjetër kso lloje konçesjonari do të paguaj $3^0/_0$ (tri për qind) përmbi shumat e taksave qi paguen për landë.

Konçesjonari ka të drejtë të presin ç' do llojë druje në zonën e konçesjonit (nji herë të vetme dhe jo nga ato që mjellen ose bijn ristazi) e në nji sasië të pa-kufizuëme si mbas nevojës për me ushqye stabilementat e vet e për punë të kontraktueme, edhe në kjoftë se pyjet shfrytëzohen para mbarimit t' afatit të konçesjonit.

Në vjetën e parë konçesjonari detyrohet të presë të paktën 10.000 m^3 dru, në vjetën e dytë 25.000 m^3 dhe për vjetët e tjera detyrohet me pre të paktën nga 50.000 m^3 dru dë vjetë.

Konçesjonari detyrohet me pyllzue rishtszi tokat e shpyllzueme e kte si mbas ligjës së pyjevet sod në fuqi.

Konçesjonari detyrohet me i dorëzue Qeveris Shqiptare nji sasië drujë që Qeverija do të kërkojë në masë të nevojës për ndërtesa thjesht Qeveritare dhe sidomos për ura në Prefekturën e Shkodrës. Sasia e drujve që konçesjonari do t' i japi Qeveris nuk do të kalojë ma tepër se $5^0/_0$ (pesë për qind) të prodhimit vjetuer.

Çmimi që do t' i paguhet konçesjonarit për kët landë ka me përshië vetëm taksën e paguëme, shpenzimet e punimit e të transportit.

9. Konçesjonari detyrohet me ngrehë stabilimenta të para, sharra idraulike, me avull, ase me elektrik n' at madhësi të fuqiës së sipërmarrjes. Ka të drejtë me ngrehë edhe ç' do tjetë industrie qi rrjedh nga druni, si fabrika kartë, shkrepsash, fuçijash, orëndish etj. tue paguë taksat qi janë caktue prej ligjeve sot në fuqië.

Konçesjonarit i epet edhe e drejta me përdorë për të gjith kohën e konçesjonit gratis forcën idraulike për përfitim të energjiës elektrike si për dritë ashtu për fuqië sjellëse, mbrenda zonës së konçesjonit për punime të sipërmarrjes së vet e me të drejtë përndamjet për njehsi të vetën edhe jashtë zonës për industrië të tretëve.

10. Qeveria Shqiptare dteyrohet me përjashtue nga çdo tagër importacjonit maqinat, veglat, mbiujset ç'do llojë, për shfrytëzim për përdorim e punim të druës e të qymyrit etj.

Përjashtohen nga ç' do taksë kapitalet e investuëme për zbatimin e kontratës përveç taksës mbi fitime të cillën konçesjonari do t' a paguëj si mbas ligjës, taksë e cilla nuk do të kapërcejë atë të parapame prej ligjës sot në fuqië.

Përjashtohen nga taksa e eksportacjonit të gjitha druët e punuëme a të pa-punuëme të shfrytëzuëme në pyjet qi përfshiën ky konçesjon.

11. Konçesjonari do të paguëj për m^3 të ç' do llojë druje të pa-punuëme e të matun në kamë e në pyllë fr. ari 3.50 (tre-e-pesdhet) e për ç' do llojë dru lisit (chéne) fr. ar 4 (katër) gjith ashtu si cakton ligja në kët rasë e pagesa do të bahet tue j' u pështetë ligjës sot në fuqië e sidomos art. 107 të saj.

12. Konçesjonari ka të drejtë me pasë për të gjithë kohën qi ngjatë konçesjoni nji shërbim telefonik nga e për të gjitha caqet e punve e të stabilimentave, prej Vaut-të-Dêjës e deri te Ura e Vezirit e lidhun me qendrën e konçesjonarit në Shkodër. Ashtu edhe të drejtën për shërbim lundrimi me avull ase me motor mbi Drî prej Vaut të-Déjës e deri te Ura e Vezirit e të gjith këtë për përdorim të vet e me qëllim shërbimi ndër popull mbas tarifës qi konçesjonari do të caktojë në marrëveshtje me Qeverië Shqiptare. Ushtria në shërbim do të transportohet gratis.

13. Të gjitha druët qi do t' i duhen konçesjonarit për me goditë caqet e punimit, stabilimentat etj. nuk do të randohen me asnji tagër pyjor por do t' jenë të preme gratis për të gjith kohën e konçesjonit.

14. Konçesjonari detyrohet me shtië në punë të gjithë puntorë shqiptar përposë teknikëve specialistëve të cillët nuk mund të gjinden në Shqipni.

15. Konçesjonari do të mjekojë me mjekun e vet puntorët e sëmurë a të plagosun. Mjekimi dhe barnat do t' u epen puntorve gratis. Konçesjonari do të përkujdeset qi sendet e ushqimit të nevojshme për puntor e qi do t' ju shiten në pyllë mos të kalojë çmimet e tregjeve t' afërme.

Qeveria i ep Konçesjonarit të drejtën me mjellë e me kullotë ndër tokët mbrenda zonës së konçesjonit në masë të kufizuëme sa me i ba ballë nevojave t' ushqimit të puntoriës e të bagtiës së marrun në punë për shfrytëzimin e pyjeve.

16. Konçesjonari detyrohet me lanë të lirë me kaluë pa pagesë ç' do privat a konçesjonar tjetër nëpër rruga e ura të ndërtuëme prej tij.

17. Konçesjonari nuk ka të drejtë me j' a transferuë kët konçesjon nji personës a shoqëniës tjetër pa marrë përpara pëlqimin e Qeveriës Shqiptare.

18. Në fund t' afatit të konçesjonit Qeveria zen vendin e konçesjonarit në të gjitha të drejtat e hynë në gëzimin e prodhimeve tue ju dorzuë gratis Qeveriës stabilimentat e ndërtuëme mbrenda zonës së konçesjonit.

Maqinat, sharrat, veglat, mbiujset etj. i epen Qeveriës tue j' a shitun, në kjoftë se i duhen, tue caktuë çmimin e tyne me nji komisjon të veçantë i emnuemë nga të dyja anët kontraktuëse.

Po kje se Qeveria don të përsërisi, konçesjonin në kët rasë konçesjonari ka të drejtën e parapëlqimit (preference).

19. Të dyja anët kontraktuëse zgjedhin si ndejë për zbatimin e kontratës, kryeqytetin e Shqipniës dhe i shtrohen kompetencës së Gjykatoreve. Në rasë që ndërmjet të Qeveriës Shqiptare e të konçesjonarit dalin kundërshtime, anët kontraktuëse detyrohen reciprokisht me ju sjellë nji arbitrazhit përpara se me j' u drejtue Gjyqit.

Në kjoftë se mbas vendimit të Gjyqit konçesjonasi rezulton se nuk ka përmbushë detyrimet e marruna më kët kontratë, kontrata prishet dhe garancia e parapame n' art. 3 shkon për dobië të Qeveris Shqiptare.

KONÇESJONARI

Për Qeverinë Shqiptare:
Ministri i P. Botore e Bulqësis

BKSH

Këshilli Ministruer në bisedën e tij Nr. 125 datë 14-III-925 vendosi pranimin e kësaj kontratë.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
e Zav. M. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Min. i P. Botore e Bulqësis e
Zav. Min. i P. të Mbrend.
K. KOTTA

Pelqej këtë kontratë dhe urdhënoj zbatimin e saj.

Tiranë, me 16-III-925.

Kryetar' i Republikës
A. ZOGU

Nr. 25.

DEKRET-LIGJË, 2 Prill 1925

Mbi faljen e delikteve ordinare dhe të krimeve vetëm për çështje nderi deri me 21-I-925 q' u vendos rregjimi Shtetnuer në Republikë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 6 Prill 1925, Nr. 14)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer ashtu dhe artikullin 78 të Statutit,

D E K R E T O J M Ë :

1. Falen ato delikte dhe kontravajtje (kabahat) ordinare të atyne qi janë gjykue me dënim burgu deri dy vjet e posht dhe t' atyne të pagjykuem qi dënimi i tyne nuk rezulton dënimin ma tepër se dy vjet të fajeve të ndodhuna deri me 21-I--925 qi u vendosë rregjimi Shtetnuer në Republikë qofshin guximtarët të reshtuem ose të burgosun ose të lirë ashtu dhe gjobat qi u përkasin delikteve dhe kontra vajtjeve.

2. Falen dy të tretat e delikteve ordinare t' atyne qi janë dënuem me burg jo ma tepër nga tre vjet deri në atë datë 21-I-925, ashtu dhe t' atyne qi janë dënuem në ç' do krim i falen dy të tretat.

3. Falen krimet ordinare vetëm t' atye qi janë dënue me gjygjë të premë ose të pa premë për çështje nderi të ngjatuna deri në datë 21-I-925 fajtorët qofshin të rreshtuem ose t' aratisun, ose të burgosun si dhe t' atyne qi ndodhen nën gjygjë e nuk asht dhanë vendimi nga ana e gjykatavet kompetente.

BKSH

4. Falet Maliq Kaçiu dhe Myhedin Kaçiu të dy nga katundi Bozhaj i Vlonës sshtu dhe Abas Kupi e Ibrahim Kupi nga Kruja.

5. Dispozitat e neneve të sipërme nuk kanë influencë mbi të drejtat private.

6. Ky dekret-ligjë hyn në fuqië qysh prej ditës së dekretimit

7. Ministria e Dretësiës ngarkohet me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Tiranë, me 2-IV-925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. P. Botore e Bulqësis
Zav. M. P. Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 26.

DEKRET LIGJË, 15 Mars 1925.

Mbi pranimin e Konvensionit për themelimin e Bankës dhe operacionet e huas

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 18 Prill 1925, Nr. 15)

Mbasi u pa konvencjoni (marrëveshtja) me datë 15 Mars 1925 e nënshkrueme prej Zotit Ministrit të Financavet dhe Grand Ufficiale Mario Alberti:

Mbasi u pá artikulli (neni) 88 i Statutit; u muer vendimi i Këshillit Ministruer;

DEKRETOJMË

Art. 1. – Asht i pranuem konvencjoni i nënshkruem ndërmjet të Zotit Ministrit të Financavet dhe Grand Ufficiale Mario Alberti për themelimin e Bankës Kombëtare të Shqypnis edhe operacjonet përkatëse të huasë.

Art. 2. – Konvencjoni i naltëpërmendun do t'i paraqitet Parlamentit për ndrrimin e tij në ligjë.

Art. 3. – Për zbatimin e këtij dekreti ngarkohet Ministrija e Financavet.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Unë Ahmet Mufid Libohova Ministri i Financavet e zavëndës Ministri i Punvet të Jashtme në përfaqësim të Shtetit Shqiptar nga njera anë e Gr. Uff. Mario Alberti nga tjetra anë, si përfaqësonjës i grupit financjar i rekomanduar nga Qeveria Italiane, kemi stipulue si vijon:

1. Grupi italjan i përfaqësuëm nga Gr. Uff. Mario Alberti, ka për të formuëm mbrenda nandëdhjet ditëvet prej ratifikimit të kësaj kontrate "Banca Nationale Shqiptare" me nji kapital nominal prej fr. ari 12.500 000 (dymëdhet miljon e gjysëm) i ndam në katërqind e nandëdhet e pesë akcjone ordinarë me me vleftje secilla 25 fr. ari e në 100.000 akcjone themeltarë me vleftje secilla prej fr. ari 1.25. Prej nji kapitalit të tillë nominal 2.500.000 fr. ari kanë për të qënë të nënshkruara me nji herë e banka ka për të mundë me filluëm aktivitetin e saj porsa të ketë dhënë provë Qeveriës Shqiptare se ka effektivishtë versun pranë nji bankës ma në zë në Svicër shumën në 2.500.000 fr. ari ose ekuivalentin e saj.

2. Shtetasit Shqiptar kanë për të pasur të drejtë me marrun pjesë në sottoscritionin e kapitalit deri në masën 49 % të kapitalit akcjonar.

3. Drejtorija qendrore e bankës ka për të pasun ndënjtjen e saj në kryeqytetin e Shqipnis.

4. Kjo konventë ka për të pasur nji afat prej 50 vjeç, me fakultet zgjatimi si mbas nji marrëveshtjes ndërmjet të së dy palëvet.

5. Banka ka për të qënë e përbaëme n' armonië me ligjët e Shtetit e ka për të mundur me çelun dega si në Shqipnië ashtu edhe përjashta.

6. Banka ka për të pasur, ashtu si më këtë konventë lejohet, këto të drejta e fuqiëna qi vazhdojnë:

a) me marrë mbi vehte (intreprendece) çdo llojë operatë bankare e financjare;

b) privilegjin eksklusiv me qitë kartë monedhë, qi ka për të pasur nji kursë ligjuër e nji fuqië të pa tundshme për pagesat në Shqipnië;

c) me pregatitë të gjitha „coniazione" e misjonit e monedhës prej metali, fitesat e të cilëvet kanë për të qënë të ndame në pjesa të njinjishme midis të Shtetit e të Bankës;

d) me marrun depozitë fondet e Shtetit e pasun shërbimin e thesarit (tesoseria) me pazaritë (negociare) huan qeveritare e të Bashkiëvet.

7. Gjith ç' ka nevojitet për ndërtesën, instalimin e të shtruarit e ndërtesavet të bankës ka për të qënë i përjashtuëm nga të drejtat doganore. Me të marrun fund konçesjoni i ndërtesavet të bankës kan për të qenun të zotuëme nga Shteti Shqiptar me nji vleftje si çka për të qënë të çmuëme, çmimi ka për të qënë i caktuëm nga nji çmuës i zgjedhun mbas nji marrëveshjeje midis të Shtetit e të bankës.

8. Të gjitha kapitalet e vleftjet (valori) privatë qi kanë për t' ju mbështetun bankës kanë për të qënë të lirë prej çdo konfiskimit qoftë direkte ose indirekte, prej sekvestrimit e kontrollimi nga ana e Shtetit, përveç në rastin e nji vendimit të gjyqit formal e ligjor të gjykatorevet ordinare, me qenë se banka i shtrohet plotësisht ligjavet të Shtetit.

9. Drejtorija qendrore e bankës, me ndënjtjen në kryeqytetin e Shqipniës, ka për t' u përbënë prej dy misavet italjanë e dy Shqiptarë; kryesia ka për të qenë e ngarkuëme njenit ndër dy misat italianë, qi ka për të pasun votën përfunduëse. Dy misat shqiptarë kanë për të qënë t' emnuëm nga Qeveria.

Deri sa banka nuk ka për të pasur zhvillimin e nevojshëm misat e Drejtoriës qendrore të naltpërmendurë mund të jenë të zbritun ndër dy misa, njeni italjan me votë përfunduëse, tjetri shqiptarë,

10. Në këshillën e administratës të bankës nji misë e nji komiser (sindaco) kanë për të kenë të shënjuëm prej Ministris së Financavet të Shqipniës.

11. Banka do të gatojë nji rezervë metalike (arë ose sermë në shufra o monedhë) me nji vleftë të nji të tretës të bankarotavet të lëshuëme. Për mbulimin e kusurit ka për të caktuë vendim të pa tundshëm Statuti i bankës i cili ka për të qënë i inspiruëm nga parimet që ka për të caktuëm sekcjoni financjar i Lidhjes së Kombevet për krijimin e bankavet që presin të holla të ngrehuna në hijen e saj në këto vjetët e fundit.

12. Qeveria ka për të pregatitë çpalljen e të gjitha ligjavet të nevojshme për funkcjonimin e rregullshëm e për nji qëndres razionale të monedhës, si dhe ligjat qi dishiplinojnë kurset bankare, obligacjonet, vleftat etj.

13. Ky konçesjon ka karakter të nji ekskluzivitetit absolut e të pa tundshmë,

14. Banka, përveç të marrunit pjesë të 10% që i ruhet Shtetit Shqiptar në fitimet netto të përndamë, nuk ka për të

qënë e detyruëme të paguëj asnji vergji ose taksë, për veç të drejtës të patentës, (vergji mbi t' ardhunat) në masën e ligjavet që ndodhen tash në fuqië.

15. Banka ka për të qënë e administruëme për sa të jetë e mundun në konformitet me praktikën e me zakonet e Bankave Italjane, në mbledhjet e përvjetëshme në të cilat se e cili aksjon ka për të pasur të drejtë vote kanë për t'u mbajtur n' armonië me dispozitat e legjislaturës italjane për sa i përket shoqëniës për aksjone (in materia di societa per azioni).

16. Të përndamit e fitimevet e shënimet e reservës kanë për të qënë të vendosuna në konformitet të Statutevet nga Këshilli administruer, i cili do mund të mblidhet në Shqipnië ose n' Italië e të paraqiti mbasandej pëlqimin e mbledhjes t'aksionistavet. Shteti Shqiptar ka për të marrun 10% të dobiës netto të përvjetshëm.

17. Se i cili aksionist asht përgjegjës deri në konkurencën e shumës t' aksioneve të nënshkruëme.

18. Banka asht e detyruëme me përmbajtë mbrenda nji muaji ç' prej fillesës së aktivitetit të sajë; shoqënin për shvillimin ekonomik të Shqipniës, n' Italië e në Shqipnië ose gjetkë, me nji kapital prej 15.000.000 L. Italjane i ndamë në 150.000 aksjone ordinare prej L. Italjane 100 se e cila ose vleftën e sajë. Nr. 10.000 të ktyne aksioneve kanë për të qënë të dorëzuëme fal (gratuitimente) Qeveris Shqiptare.

19. Shoqnija, duhet t' i gjejë Qeveris Shqiptare nji huva prej 50.000.000 fr. ari prej të cilave fr. ari 7.500.000 (shtatë miljon e gjysëm) kanë për të qënë të dorëzuëme në të parin vjetë; fr. ari 7.500.000 (shtatë miljon e gjysëm) në të dytin vjetë; fr. ari 10.000.000 (dhet miljon) në të tretin vjetë; fr. ari 12.500.000 (dymëdhetë miljon e pesqindmië), në të katërtin vjetë; fr. ari 12.500.000 (dymëdhetë miljon e pesqindmië) në të pestin vjetë.

20. Interesat nuk kanë për të kapërcyë të 7.50% përveç se kuër në kohën e misjinevet përqindja e ditës në pazar për të tilla operacjone të jetë ma naltë. Shpenzimet për emisjonë, të cilat hinë provigjonet, senserinat e të tjera për se cilën huva, nuk kanë për të kaluëm kufinin e përgjithëshmë t' aplikuëme nga ma të parët trupe financjare italjane në të tilla raste.

21. Kalimi i afatit për të tilla huva nuk do të kalojë 40 vjet.

22. Huaja ka për të qënë e përdorun eksklusivisht për kto vepra publike qi vazhdojnë:

BKSH

a) Rruga
b) Të thamë ballangjesh e kënetash.
ç) Shvillim bujqësie.
d) Ndërtesa urash.

23. Shoqnia mund të formojë kompanira të nevojshme që t' i marri mbi vehte të tilla punë o mund t' i marrë ajo vetë, ose ka për t' ja mbështet Shoqninave qi kanë qënë edhe ma parë, secilla e ktyne veprave ka për të qënë e mbaru(ime me nji pjesë të mjaftuëshme të huas.

24. Shoqnija, mbrenda tre muëjve të themelimit të sajë do të marri mbi vehte ose do të dojë të tjera shoqnina të lidhuna me të marrë për barrë të parat vepra Botore dhe ashtu si çë ka për të qënë të prozhetue më në marrëveshtje me Qeverin ose do të api nji të katërtën e huas të vjetit të parë. Por në qoftë se huaja nuk do të epet, Banka asht e detyruëme me paradhane për këtë vjetë Qeveriës, kundra bonave thesare, me skadencë të afërme, fr. ari 2.500.000 (dy miljon e gjysëm) ka për të dhanë në mbarimin e nandë muajve e restua në fr. ari 2.500.000 (dy miljon e gjysëm) me mbarimin e vjetës. Në qoftë se në fundin e vjetit të parë shuma e naltpërmëndun në fr. ari 7.500.000 (shtatë miljon e gjysëm) nuk ka për të qënë e dorëzuëme, Shteti Shqiptar ka për të qënë i lirë me bamë huana me të tjerë e nuk ka për të pasun asnji pengim ndaj Shoqniës.

25. Të ngrehunit (rimborso) të kapitalit, e pagimi i pagesave relative, i përdorun në përfundimin e veprave botore të naltëpërmenduna, ka për të qënë i garantuëm nga shteti Sbqyptarë me anë të burimeve qi vazhdojnë:

Të hyme Doganore
(gadi) Fr. ari 6.000.000 (gjashtë miljon).
Monopolet e Shtetit mbi krypë kart cingaresh, shkrepca;
(gadi) Fr. ari 2.500.000 (dy miljon e gjysëm) për ç' do vjetë në të tanë Fr. ari 8.500.000 (tetë miljon e gjysëm). Në rastë që mbas nji paksimi të ardhunave nga taksat e virgjinave në fjalë shuma e parapame 8.500.000 (tetë miljon e gjysëm) do mund të ketë nji paksim sensibile, Shteti Shqyptar asht i detyruëm me përmbushun defiçitin tue shenjuem t' ardhunat e vergjinave të tjera ose me të tiera aktivitete. Të përmendunat Fr. ari 8.500.000 kanë për të qënë të shenjuëme n' amortamenton e në dagimin e interesavet proporsjonalisht me sominìstrimin e huas.

26. Kur ka për t' u pamë nevoja me filluem ekzakutimin e

veprave botore shteti ka për t'ju mbështetun Bankës për me ekzekutue e për me marrë ofertat e nevojshme. Qeverija ka për të emnuem nji Komisjoni i cili, bashkash me Bankën ka për t' u kujdesuem për shqyrtimin e ofertavet të tyne. Shoqnija e kompanirat me kto të lidhuna kanë për të pasur të drejtën me paraqitun orfertat për ekzekutimin e ktyne veprave botore e, me kondita të njinjishme ato kanë për të pasun të drejtën e preferancës.

27. Veprat botore për të cilat Shoqnija ka për të pasun të drejtën e proferancës janë këto pika:

a) Udhat e hekurta e tranvaje;
b) Ndërtesa limanesh, udhash urash.
ç) Bonifike e të thamje.

28. Qeverija Shqiptare ka për të pasun të drejtën me emnuem dy administrator në kshillin e shoqniës.

29. Banka, shoqnija e kompanirat me këto të lidhuna kanë për të përdorun qytetas shqiptarë deri me 50% në të dytën e në të tretën kathegorië të naltëpërmenduravet. Ekspertat teknikë janë të përjashtuëm. Proporcjoni i caktuem në favor të qytetasve Shqiptarë mundet me u modifikuem në rastin e nji imposibilitetit me gjetur në Shqipnië nji numër të mjaftuëshëm njerzish qi të jenë të zotët për shërbimin në fjalë.

30. Ç' do konflikt qi të ngjajë n' aplikimin e ksajë konvente ka për të mbështetun ndreqja e sajë nji trupit të përbërë prej tre pleqsh, njeni i emnuem nga banka e nji tjetër nga qeverija. I treti mis ka për të qenë i zgjedhun në marrëveshtje prej të dy të parve. Në rast që të mungojë akordi në mjes të dy të naltëpërmendunve për të zgjedhunit e të tretit mis, ky ka për të qënë i zgjedhun nga Kryetari i kortës juridike supreme të konfederatës elvetike.

I nënshkruëm i vulosun i liqensuëm nga të dy të naltpërmenduvet, në kopje të duplikuëme nji në gjuhën Italisht e tjetra në gjuhën Shqip. Në rast kundërshtimi ka për të pasun besim teksti në gjuhën Italisht me që asht i njoftun prej dy firmatarvet.

Tiranë, me 11 Mars 1925

Nënshkruë

MUFID LIBOHOVA — MARIO ALBERTI

Shpallje e nënshkrimevet

Po botojmë shkurtimin e koncesjonit që Shteti i jonë i dha Bankës Credito Italiano për Bankën Kombëtare *të Shqipërisë.*

1. Banka Kombëtare Shqiptare do të jetë e përbame si mbas ligjëve të shtetit Shqiptar në bazë të konditave qi vijojnë.

2. Banka do të ketë këto të drejta:

a) Me sypërmarrë ç' do veprim bankar e Financjar.

b) Me vue në zbatim privilegjin esklusiv për të qitun kartë-Monedhë qi do të ketë kurs legal e fuqi të plotë për pagesa në Shqipni.

c) Me marrë për sipër të gjitha të shkriemet e të qitunit e monedhave metalike fitimi i të cilave do të ndahet në pjesë të njinjishme ndërmjet të Shtetit e të Bankës.

d) Me marrë depozitë fondet e Shtetit dhe me pasë detyrën e thesarit të Shtetit.

e) Me bâ marrëveshtje për huana qeveritare e të Bashkijash.

3. Direkcjoni Qendruër i Bankës do të jetë në kryeqytetin e Shqipnisë. Ajy do të jetë i formuëm prej dy antarve Italjanë e dy Shqiptarëve. Kryesija do t' i jepet njenit prej misavet italjanë, i cilli do të ketë votën përfunduëse. Të dy antarët shqiptarë do t' emnohen nga Qeverija Shqiptare.

4. Në këshillin e administratës të Bankës nji antar dhe nj komiser do t' emnohen prej Ministris së Financavet.

5. Të gjithë kapitalet e vleftjet private të depozituëme në Bankë do të jenë kurdoherë të lira nga ç'do konfiskim, direkt ase indirekt, sekuestrimi, apo kontrolli nga an' e Shtetit, me përjashtim të nji vendimi të gjyqit ordinar formal edhe legal, mbassi Banka asht e shtruëme pa ndonji përjashtim ligjave të Shtetit Shqiptar.

6. Banka duhet të përbajë nji rrezerve metalike (ar apo argjent me thupra (shufra) ase monedhë sa nji e tretë e vleftjes të Banknotave të qituna. Për mbulimin e tepricës Statuti i Bankës do të caktojë rregullat precise e do të jetë i frymzuem në parime të caktuëme nga seksjoni Financjar i Lidhjes së Kombeve për krijimin e bankave emisjoni, të krijuëme nën hijen e saj ndër këto vjetët e fundit.

7. Banka, tue përpjestuem pjesën 10% të riservuëme Shtetit Shqiptar mbi fitime netto, nuk do t' i shtrohet asnji vergjije, apo taksit përveç taksit të patentës si mbas ligjave qi ndodhen sot në fuqië.

8. Banka do jetë e administruëme për sa të jetë e mundun simbas praktikës e zakonit bankar Italjan. Mbledhjet e përjetëshme në të cilën ç' do aksion ka të drejtën e nji voti, do të

BKSH

mbahen si mbas dispozitave e legjislacionit Italjan qi flasin për me shoqnina për aksjone.

9. Pjestimi i fitimeve e pjesa qi do t' i lihet reservës do të bahen si mbas statutevet të venduëm. Kshilli Administratës qi do mundet të mblidhet në Shqypni, apo n' Italië dhe mandej do t' i parashtrohen mbledhjes t' akcjonistave Shteti Shqyptar do të marrë 10% mbi fittime netto të përvjetëshme.

10. Ç' do akcjonist asht përgjegjës vetëm për shumën qi përshijnë aksionet e nënshkrueme.

11. Banka do të ketë nji kapital emnuer (nominal) prej Fr. ari 12,500,000 (dymëdhetmilion e pesëqindmij) të ndame në 495,000 (katërqind e nandhetepesë mij) aksjone ordinare me vleftë se e cila prej Fr. ari 25, dhe 100,000 aksjone themeluëse me vleftë prej fr. 1.25 se e cila.

12. Nënshtetasit Shqiptarë do të kenë të drejtë me marrë pjesë në nënshkrimet e Bankës deri në fr. ari 6.125.000 i kapitalit nominal qi i përgjegjen 245.000 akcjoneve ordinare me vleftë fr. ari 25 se e cila.

13. Nënshkrimet pranohen ç' prej ksaj díte pranë Ministriës së Financavet në Tiranë, pranë Drejtorive të Zyravet Financjare të Prefekturave e të Nënprefekturave e pranë Legacjoneve e Konsullatave Shqiptare përjashta. Koha e caktuëme për nënshkrimet mbaron pa ndonji përjashtim dhe pa ndonji zbatim më 30 Maj 1925.

14. Po sa të nënshkruhen akcjonet nënshtetasit Shqiptarë duhen të derdhin dy të dhetat (2/10) e vleftës emnore (nominale) t' akcjoneve të nënshkruëme d. m. th. fr. 5 për ç'do akcjon. Shumat e derdhuna në këtë mënyrë do të jenë nga autoritetet e naltpërmënduna të rregjistruëme ndër rregjistra të posaçmë në favor të ç'do nënshkruësi, të cilve do t' u dorëzohen me kujdes të Ministris së Financavet diftesat e marrjes (buoni di versamento) të cilat mandej do të ndryshohen në çertifikata akcjonare.

Derdhjet e të hollavet mund të bahen edhe pranë Bankës Credito Italiano në Milan, Romë e Bari.

15. Në rasë qi shuma e akcjoneve të nënshkruëme të jetë ma e naltë se sasija e akcjonevet disponibël, Ministrija e Financavet do të shikojë ndamjen e akcjoneve në proporcjon me numrin e akcjoneve të nënshkruëme.

16. Derdhja e të dhetshave të tjera do të bahet drejt për drejt në Bankën Kombëtare të Shqipnis, mbasi ajo të ketë hyë në funksjon.

Nr. 27.

DEKRET-LIGJË, 16 Prill 1925.

Mbi përjashtimin nga tagri doganuer të kafshëve t' importueme për damazllëk

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 18 Prill 1925, Nr. 15)

Mbasi u pa vendimi i Këshillit Ministruer me datë 28-III-1925

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Përjashtohen nga tagri doganuer ç' do llojë kafshe qi importohet në Shqipni për marë (damazllëk).

Art. 2. — Importuesi për këtë qëllim do të paraqesë kërkesë në Ministrin e Punve Botore e Bulqësis tue tregue sasinë e llojën e Kafshëve qi do t' importojë.

Art. 3. — Ministrija e Punve Botore e Bulqësis mas shqyrtimit vërteton sasiën e llojin e kafshëve qi do t' importohen dhe në bazë të kësaj zyrat doganore do të lanë të lirë nga tagri importacjonit kafshët qi përmendën në te.

Art. 4. — Ky dekret-ligjë hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes.

Art. 5. — Ministrija e P. Botore e Bulqësis dhe Ministrija e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij dekret-ligji.

16-IV-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri Drejtësiës
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës Zav. Ministri i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 28.

DEKRET LIGJË, 16 Prill 1925.

Mbi krijimin e një pulle për Kryqin e Kuq

(e botneme në Fletoren Zyrtare, 18 Prill 1925, Nr. 15)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare tue pa vendimin e Këshillit Ministruer me datë 28-3-925.

DEKRETOJMË:

1. Anulohet pulla për emigrant e krijohet nji pullë për fitim të Kryqit të Kuq Shqiptar me vleftje 10 qindarësh.

Instituti i Kryqit të Kuq Shqiptarë merr përsipër edhe ndihmën e emigrantave.

2. Pulla e Kryqit të Kuq Shqiptar ka me ju ngjitun ç' do akti qi i shtrohet pullës së Monopolit.

3. Pulla e Kryqit të Kuq administrohet prej këtij, por shtypet e ruhet nënkontrollin e Ministriës së Financavet.

4. Dispozitat e tjera në fuqi për pullat e Monopolit, zbatohen edhe për pullën e Kryqit të Kuq.

Dispozita të përkohëshme

5. Deri sa të shtypen pullat e veçanta, Kryqi i Kuq do të përdorë pullat e shtypuna për muhaxhirët tue u vumun nji surcharge nën kontrollin e Qeveris.

6. Kjo dekret-ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

7. Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj dakret-ligje.

61-IV-1925

Kryetari i Rebublikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGGA

Minis. P. Botore e Bul.
e Zv. M. P. të Mbrendë.
K. KOTTA

Nr. 29.

LIGJI, 3 Mars 1925

Konventë vendosje në mjes të Shqipnis e të Tyrqis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1925, Nr. 16)

Shteti Shqiptar më nj' anë Republika Turke më tjetrën

T' amshuem prej dëshirit me fiksuem Konditat e vennosjes të nënshtetasvet Shqiptarë në Turqi e të nënshtetasvet Tyrqë në Shqipni, kanë vendosun t' apin fund nji Konventës e për ketë qëllim, kanë emnuem për Fuqiplotës të tyne :

Eshref Bey Frashëri, Kryetar i Parlamentit e i Dërgatës Shqiptare

Xhaferr Bey Villës, Sekretari i Përgjithshëm i Ministris P. të Jashtme të Shqipnis.

Nezir Bey Leskovikun, mis i Dërgatës Shqipëtare.

BKSH

Republika Tyrke

Shukri Kaja Bey, Deputet i Menteshehut në Asamblen e Madhe Kombtare të Tyrqis, të cilët, mbasi qi paraqiten fuqiplot-et e tyne të vërtetuëme në të tanë formën e duhun, i kanë dhanë fund kètyne dispozitavet:

Art. 1. – Nënshtetasit e sëcilës anë Kontraktuëse kanë për të pasun të drejtë m' u vendosun e me banuem në tokën e tjetrit e kanë për të mundun: nga ky shkak, me shkuem, me ardhë e me u sjellun lirisht tue u konformue me ligjët, e me rregullat në fuqi të vendit.

Art. 2. – Kuptohet se dispozitat e kësaj Konvente, tue mos pasun për objekt çështjen e emigracionit, nuk i bijnë asnji pengim të drejtës qi secila pjesë Kontraktuëse ka me autorizuem ja se me ndaluem lirisht emigracjonin në vendin e vet.

Art. 3. – Nënshtetasit e të dy anëvet kontraktuëse kanë për të pasun në tokën e tjetrit, baras me qytetarët, të drejtën me ekzersituem ç' do lloj industrijet e tregtije si dhe m' u marrun me të gjitha zejet (zanatet) e profecjonet, përveç t' atyneve që janë të rezervueme vetëm për qytetarët si mbas ligjëvet e të rregullave përkatse a se, si mbas nji përdorimit të motshëm që është në Tyrqi (hamaj, Maunaxhi etj.)

Nënshtetasit e secilës anë kontraktuëse nuk kanë për të paguem për banim e vendosje në tokën e tjetrit si edhe për ekzersisin e të ç' fardo lloj tregtije, industrije, zanati e profesjoni asnji vergji, taksë a se ngarkesë tjetër, të ç' fardo natyre që të jenë përveç atynevet qi mirren nga nënshtetasit.

Nënshtetasit e të dy anëvet Kontraktuëse në tokën e tjetrit për personat, pasunit e të drejtat e për interesat edhe për fitimin e atyne pasunivet dhe për pronësin ashtu edhe transfe-ratat (intikal) qi do të ju bahen të tjerve në mënyrë shit-blerje transferat (intikal) e traahigimit, nuk kanë me qenë të detyruem të paguejnë në tokën e tjetrit asnji taksë ose vergji a ngarkesë ma të tepërt, përveç se atyne, që mund të ju ngarkohen nënshte-tasvet të vendit.

Art. 4. – Në rast kur njeni ndër anët kontraktuëse, qoftë në vijim të ndonjë vendimit legal, qoft si mbas ligjëve ase re-gulloreve mbi policiën e veseve, (moeurs) mbi policiën shënde-tësore ase për mbi atë të lypësiës (mendicite) ase për shkak të qetësiës së mbrendshme të Shtetit, do të ekspulsojë si masë

vehtjake, nënshtetasit e anës tjatër kontraktuëse, kjo anë detyrohet me i pranue ata edhe fëmijët e tyne. Të bartunit deri në kufi, të njerzvet të ekspulsuem do t' i ngarkohet asaj anë që i ekspulson.

Art. 5. — Nënshtetasit e secilës anë kontraktuëse do të kenë, me kondita të reciprocitetit, në tokën e tjetrit, të drejtën e blerjes, të pronësiës dhe me shit ç'fardo pasuni të tundshme e të patundshme me përjashtim të pasunive bulqësore tue u mbështetë (se conformer) ligjave e regulloreve të vendit. Munden të kenë në pronim me akt shit-blerjeje, ndrimi, faljeje, testamenti ase me ç' fardo akti tjetër ashtu edhe që të shtijen në pronësi me rrugën e trashëgimit si mbas ligjës ase në vijim të dispozitave midis të gjallve ase testamentarve.

Nuk kan për të qenë të ngarkuem me as ndonjë rast të parathanun me ngarkesa, taksa ase vergjina, me ç'fardo emni që të jetë, tjetër ase ma tepër se ato qi janë ase kanë me qenë të vuëme për nënshtetasit.

Art. 6. — Nënshtetasit e të nji anës Kontraktuëse nuk kanë për të qenë të shtrënguem në tokën e të tjetrës anë, të bajë ndonji shërbim ushtriak as në fuqitë toksore e detare as një regjimentat ase milicjet kombëtare si dhe nuk kanë për të pasun nonji detyrë ase barrë që zën vëndi e shërbimit ushtrijak.

Ata kanë për të qenë të përjashtuem nga ç' do shtrengesë huajë (emprunt forcé) kanë për të qënë po ashtu të përjashtuem nga të gjitha ndihma me të holla të marruna për qëllime lufte qi nuk kanë për të qënë të impozueme legalisht nënshtetasve.

Art. 7. — Shoqëniët anonime ase të tjera tregëtare e industriale që kanë qendrat e tyne shoqënorë në tokat e njenës nga anët kontraktuëse dhe që janë themeluem si mbas ligjëve të asaj anë, do të quhen baras si mbas ligjës (dumente) themeluëme mbi tokën e anës tjetër, dhe kapaciteti edhe e drejta e të paraqitunit (ester) në gjyq do të caktohen me ligjat e vendevet të tyne origjinal. Këto do të kenë, me konditë reciprociteti tu u bind ligjavet të vendit, të drejtën e vendosunit dhe të ekezerstimit në tokën e anës tjetër ç' far do soj industrije e tregëtije dhe të blejë ç' fardo send të tundshme qi do të jetë e nevojshme për veprimin e Shoqënisë, por kuptohet se në këtë rast së qëllimi i vetëm i shoqënis nuk ka me qenë blerja.

Shoqëninat anonime të tjera tregtare ase indistrijale të

secilës anë Kontraktuëse nuk kanë për të qenë të shtrëngume, në tokën e tjetrës anë, n' asnji mënyrë të paguejnë të drejta, taksa,, vergjina, të shfardo titulli qi t' jenë përveç t' atynevet qi kërkohen shoqëninavet kombëtare për eksersimin e tregtis a se t' industris.

Kuptohet por, se eksepcjoni i parapame në paragrafin e parë t' Art. 5 aplikohet gjithashtu pasuninavet të patundshme qi shoqëninat mund të blejnë në virtyt të paragrafit parathanë.

Art, 8. — Nënshtetasit e secilës anë Kontraktuese nuk kanë për të mujt në tokën e njëni tjetrit me qenë t' ekspropjrume nga pasuninat private, as nga të gëzuemit e pasunjnavet të tyne, t' jenë dhe për kohësisht, vetëm për çeshtje ligjërisht të njohtuna në dobijnë publike e kundra shpërblimit të vleftësisë tyne.

Art. 9. — Nënshtetasit e secilës anë Kontraktuese, për sa i përket mbrojtjes legale e gjyqësore të personavet e të pasunivet të tyne, kanë për të gëzuar në tokën njenji-tjetrit, nji tratament të njinjishëm me bashkombëtarët.

Art. 10. — Këjo konvete ka për të hyem në veprim nji muej mbs datës të shkëmbimit të ratifikimevet e ka për të pasur vleftjen për dye vjetë. Por në qoftë se konventa nuk denoncohet nga njenë a se tjera e të Naltavet anë kontraktuese pak s' paku gjashtë muai përpara se t' i mbarojë afati dy vjetëvet të nalt-treguëme, Konventa mbetet në veprim deri sa të denoncohet, në rastin e nji denoncjeje, këjo denoncje nuk do mund të prodhojë efektet e saja veç mbasi qi të kryhet periudhi i nji kohe prej gjasht muajsh.

Këjo konventë ka për të qenë e ratifikuëme e ratifikimet kanë për t' u shkëmbyëme n' Angore sa më parë qi t' jetë e mundun.

Me këtë besim Fuqiplotësit respektiv kanë nënshkruëm këtë konventë tue i vuëm vulat e tyne.

I parashtruem në duplikatë n' Angore me.....

Pëlqej këtë marrëveshtje të vendosun në mes të Republikës Shqiptare e të Republikës Turke, pranuë edhe prej Kuvendit Kushtetuës si mbas shkresës Kryesis së Tij Nr. 40. III. datë 22-II-1925 dhe urdhnoj zbatimin e saj.

Tiranë, 3-III-1925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore e Buiqësis
e Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
K. KOTTA

Nr. 30.

LIGJË, 3 Mars 1925.

Marrëveshje për mbi nënshtetësi në mes të Shqipnis e të Turqis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1925, Nr. 16)

Art. 1. – Njerzët origjiner të tokavet të Shtetit Shqiptar dhe banuës në tokat e Shtetit të sipërthanun, që nga hyrja në fuqië të kësaj marrëveshjeje do të bahen nënshtetas të Shtetit Shqiptar.

Art. 2. – Njerzët origjiner të tokavet të Shtetit Shqiptar dhe banuës në Turqi në kohën që hyn në fuqi kjo marrëveshje mbeten nënshtetas turk.

Art. 3. – Njerzët origjiner të tokavet të Shtetit Shqiptar, në moshën ma nalt se tetëmbëdhet vjet banuës në Turqië munden në një afat nji vjetsh tue fillue nga hyrja në fuqi të kësaj marrëveshjeje të lenë nënshtetësinë turke për me zgjedh e me marrë nënshtetësinë shqiptare.

Njerzët që kan me dasht me zgjedh në këtë mënyrë nënshtetësinë shqiptare, detyrohen në motin që vazhdon mbasi të hyjë në fuqi kjo marrëveshje, të qisin prej doret gjith pasuniët e tyne të tundshme e të pa tundshme, dhe me pague gjith borxhet qeveritare e vehtjake dhe të shkëputin gjith marrëdhanjet e tyne e të ikin nga Turqija me konditë që mos të kthehen ma atje.

Por asht vendos që këta njerz do të quhen si nënshtetas turk deri me atë kohë që do të përdorin të drejtën e tyne të zgjedhjes e të dalin jashtë kufinit të Turqiës.

Art. 4. – Turqit me moshë ma tepër se tetëmbëdhetë vjeç, banuës në tokën e Shtetit Shqiptar dhe që në konformitet me përmbajtjet e kësaj marrëveshjeje do të ken fituë nënshtetësinë shqiptare nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshtjeje mbrenda në atë mot do të kenë lehtësinë të rikthehen në nënshtetësinë turke dhe do t'i shtrohen përmbajtjes së artikullit 3.

Art. 5. – Njerzët origjiner të tokavet të Shtetit Shqiptar që tue mbet në Turqi do të ruajnë nënshtetësinë turke, ashtu dhe njerzit origjiner nga Turqija, do t'i kenë pasuniët e pronat e tyne që ndodhen në Shqipënië. Ashtu dhe ata që kanë nënshtetësinë Shqipëtare do t'i kenë gjithë pasuniët e pronat e tyne në Turqi.

Art. 6. — Grat e martueme do të gjyrmojnë konditat e burravet të tyne dhe fëmija në moshën ma të vegjël se tetëmbëdhet vjeç do të gjyrmojnë konditat e prindvet të tyne, për gjith ato që i përkasin zbatimit të përmbajtjes së artikujve parakalueme.

Art. 7. — Ata që kanë lind në tokat e shtetit Shqipëtar, edhe që në datën e të hyemit në fuqi të kësaj marveshtjeje ; tue mbajt nenshtetësinë tyrke ndodhen jashtë tokave tyrke e Shqipëtare, do të jenë të lirë me zgjedhë nënshtetësinë Shqiptare tue i dhanë autoriteteve konsulare të Turqiës një deklaratë, mbrenda gjasht muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marëveshje.

Pëlqej këtë marrëveshtje të vendosun në mest të Republikës Shqiptare e të Republikës Turke pranue edhe prej Kuvendit Kushtetues si mbas shkresës Kryesis së tij Nr. 40-3 datë 22-2-925 dhe urdhënojë zbatimin e saj

Tiranë, me 3-III-1925

Kryetari i Repupblikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Ministri i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore B.
Zav. Ministri i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 31.

LIGJË, 3 Mars 1925.

Traktat miqësie nërmjet të Shtetit Shqiptar e të Republikës Turke

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1925 Nr. 16)

Tue marrun parasyshë intimitetin e lidhjevet qi pesë shekuj njisije politike kan lanë në jetën e në traditën e dy Pojpujvet,

Tue shtyem nga dishiri resiprok për të forcuem e për të vendosun marëdhënje të nji miqësije të sinqertë sa ma parë qi t' jetë e mundun,

Të bindun se, nji herë e mirë të vendosuna, marëdhënjet në mjes të dy Shtetevet kanë për t' i vjeftë përparimet e begatis të dy Kombevet respektive,

Kanë venduem t'i apin fund nji traktati Miqësije e kanë për këtë qëllim, emnuem për Fuqiplotësa të tyne:

Shteti Shqiptar

Eshref Bey Frashëri, Kryetar i Parlamentit e i Dergatës Shqiptare:

Xhafer Bey Villes, Sekretar i Përgjithëshëm i Ministris P. të Jashtme të Shqipnis.

Nezir Bey Leskovikun, mis i Dërgatës Shqiptare.

Republika Turke

Shukri Kaja Bey, deputet i Menteshahut në Asamblen' e Madhe Kombëtare të Tyrqis:

Të cilët, mbas qi paraqitën Fuqiplotjet e tyne, të vertetueme në të tanë formën e duhun, i kanë dhanë funt këtyne dispozitavet:

Art. 1. – Ka për të qenë nji pagja e pa tundshme e nji miqësi sinqeri e përgjithëmonshme në mes të Shtetıt Shqiptar e të Republikës Tyrke, e gjithashtu në mes të qytetarëvet të dy Shtetevet.

Art. 2. – Të dy Anët e Nalta Kontraktuese janë d' akord për të vendosun marëdhanëje diplomatike në mjes të dy Shtetevet, në konformimin e parımevet të drejtavet të njerzvet.

Të dy palët kan pranue se Agjentat Diplomatik e Konsullor të tyne kanë për të gëzuem në tokën e të njeni-tjatrit privilegja, nderime e përjashtimet imuniteti në konformitet të principëvet të naltë-tregueme me konditë reciprociteti.

Art. 3. – Të dy Anët e Nalta Kontrakiuese janë d' akord me datën e sotshme, për me lidhë nji Konventë mbi banim e mbi mareveshtje nënshtetësije.

Art. 4. – Ky Traktat ka për t' u ratifikuem e ratifikimet kanë për të qenë të shkëmbyeme n' Angore sa ma parë qi t'jetë e mundun.

Traktati i përmendun ka për të hyem në veprim pesëmëdhjetë ditë mbas shkembimit të ratifikimevet.

Për vertetimin e të thanjevet Fuqiplotësit respektive kanë nënshkrum këtë Traktat tue i vuem vulat e tyne.

Parashtruem në duplikatë n' Angor me...

Pëlqej këtë Traktat të vendosun në mest të Republikës

Shqiptare e të Republikës Turke, pranue edhe prej Kuvendit Kushtetues si mbas shkresës Kryesis së tij Nr. 40-III datë 22-II-925 dhe urdhënojë zbatimin e tij.

Tiranë, me 3-III-925.

Kryetvr i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drjetësis
P. POGA

Ministri i P. Botore e B.
e Zav Ministri P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 32.

DEKRET-LIGJË, 16 Prill 925

Mbi shpernguljen e qendrës së nënprefekturës së Dukagjinit prej Prekali në Kodrën e Shengjergjit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1925 Nr. 16)

Na, Kryetari i Rekublikës Shqiptare tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 28-III-925.

DEKRETOJMË:

1. — Shpërnguljen e qendrës së Nënprefekturës Dukagjin Prej Prekali në Kodër të Shengjergjit edhe suprimimin e krahinave, Shalë, Shosh e Theth t' asaj Nënprefekturë.

2. Rikrijimin e krahinave Reç e Luzni të Prefekturës së Dibrës dhe Kelmend të Shkodrës.

3. — Shpenzimet e krahinave të rikrijueme do të përballen prej atyne qi suprimohen.

Ky dekret-ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes në fletoren Zyrtare.

5. Ministrija e P. të Mbrendshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin këtij dekret-ligji.

Tiranë, me 16 IV-925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Ministri i P. të Jashtëme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i P. Botore e B.
e Zav. Min. P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 33.

DEKRET-LIGJË, 16 Prill 925

Për dame

(e botueme në Fletornn Zyrtare, 29 Pril 1925, Nr. 16)

Parathanie

Neni 1. Ç' do njeri ka të drejtë të përdorë si të dojë vendet qi i ka në zotnim të tij mbas ligjevet vepruese.

I.

Damet dhe mënyra e dënimit

Neni 2. As njeri s' ka të drejtë pa leje të zott të hyjë vetë a të lëshojë, me qëllim, a pa kujdesisht, bagti të vogla e të mbëdha e shpeza damtuesa n' ara të mbjelluna e të pambjelluna të cilat lihen për prehje e përmirësim, edhe për fitim nga bari që quhet cimbile, në pyje e në ç' do vend që ka dru me pemë e pa pemë këto vende qofshin të thuruna e të pa thuruna si, ullishte, vneshta etj. Kundra vepruesit do të dënohen mbas kësaj ligje prej këshillave të bashkivet a prej këshillavet pleqsore të katundevet.

Neni 3. Ata që hyjnë në vendet e shënueme në nenin 2 e qi bajnë dëme tue shkelun thyejnë, e vjedhin bimët a pemë ase lëshojnë bagti e shpeza të cilët shkaktojnë këto drme gjykohen me shperblim të damit si mbas çmimit të çmuesve dhe gjobiten me 10 deri në 100 fr. ari. Në qoftë se shkaktuesi i damit me bagti, a shpeza nuk asht i zoti i tyne, atëhere shperblimi i damit të shkaktuem i ngarkohet të zotit të gjasë dhe ruejtësi (bariu) dënohet vetëm me gjobë.

Në qoftë se veprat e sipër-tregueme sjellin edhe dënim mbas ligjës ndeshkimore, lajmërohet Prokurorija a Gjykata ose Gjykatësi kompetent për të bamun ndjekjet 'igjore.

Neni 4. Ata qi lëshojnë me qellim a pa kujdesisht bagtit a shtazat n' ato vende që u shenuen në nenin 2, n' ugare e në vende të mbjelluna, por edhe të pambime, vetëm, tue e shkelun pa shkaktue ndo nji dam tjatër, dënohen me gjobë prej 10 gjer në 100 fr. ari.

Neni 5. Kur i zoti ase ruajtësi i vendeve të përmenduna në nenet e sipërme gjejnë bagtit e shtaza damtuese mbrenda n'ato vende ka të drejtë t' i marrë e t' i çojë në Bashki ase në Kë-

shillë të Pleqsis së katundit; i zoti gjasë asht i detyruem të çfaqet në tri dit e sipër për të marrë në dorëzim gjanë e vet mbasi të paguaj shperblimin edhe gjobën e caktueme; në qoftë se i zoti i gjasë nuk paraqitet n'afatin e caktuem për t'i marrë në dorëzim, atëhere gjaja e tij nxiret n'ankan nga an' e Bashkis së qytetit e shitet në dhjetë ditë; nga të hollat e shitjes paguhen çperblimet e gjobat dhe shpenzimet e ushqimit etj. të gjasë dhe teprica i dorëzohet të zotit.

Në qoftë se gjaja e gjallë asht nji numur të madh, atëhere shitet vetëm një sasi sa të sigurojë pagesat e sipër-tregueme e teprica e gjas i këthehet të zott.

Në qoftë se i zoti a ruejtësi i gjas me ç'farë mënyrë i kundërshton mrrrjes së gjas, veçanërisht dëdohet edhe për këtë vepër me nji gjobë jo ma tepër se 100 franga, dhe në përdorte reptësi ose kundërshtim dërgohet në Prokurorie, ose në Gjykata të posaçme për dënim pas K. P.

Neni 6. Gjyqimi për damë bahet në Këshilla të Bashkis të ç' do qyteti a n' ato të pleqsis së katundevet ku bahet dami; në qoftë se dami bahet në nji katund të vogël i cili nuk ka pleqsi atëherë giykimi bahet në Bashki të qytetit a në këshillë të pleqsis së krahinës si mbas lidhjes qi ka aji katund.

Neni 7. Si kur se u tregua edhe në nenin 3. Këshillat e përmenduna në këtë ligjë janë të detyrueme t'apin vendim vetëm mbi shperblimet e gjobat dhe nuk kanë kompetencë të gjykojnë çeshtjet qi u përkasin gjyqevet të Drejtësis.

Neni 8. Gjykimet e këshillavet do të bazohen mbi raportat që do të apin ruejtësit për damin e bamun dhe mbi ato të çmuesvet qi tregojnë arësyenat mbi sasin e shperblimit. Këshillat e Bashkivet përbahen prej 5 dhe ato të katundevet prej tre vetëve.

Vendimet epen me vota të përbashkëta a me shumicë, pra në këshillat e bashkivet shumica asht prej 3 dhe në katunde prej dy vetash.

Neni 9. Më parë këshilia thërret damtuesin edhe të damtuemin dhe mbasi e pyet këta e shqyrton raportat e ruajtësvet e të çmuesve ep vendimin e duhun.

Në qoftë se njena a të dy palët i kundërshtojnë sasis së damit tue thanë se asht çmue shumë a pak, atëherë këshillat në fjalë autorizojnë çmusit e dy katundevet fqinjë për t'i çmuem përsëri, raporta që do t' apin këta asht e preme. Në qoftë se i damtuëmi e ka caktue vetë sasin e damit dhe raporti i çmuës-

ve të dytë cakton një sasi ma të madhe, ky raport nuk ka fu qi për tepricë. Kur raporti i çmuësve të dytë vërteton raportën e çmuësve të parë shpenzimet e çmuësve të dytë i ngarkohen atij qi ka shkaktuem riçmimin.

Letër vendimet e dhanuna mbasi të shkruhen shkurtazi e mbasi të vulosen me vulë zyrtare të Bashkis a të katundit e të nënshkruhen prej kryetarvet të këtyne, vihen në përmbarim përkohësisht.

Neni 10. Vendimet e këtyne këshillave me gjith qi përmbarohen përkohësisht si u tregua në nenin e sipër-përmendun mund t' apelohen në gjyqin kompetent mbrenda 10 ditvet tue fillue nga e nesërmja e shqyptimit të vendimit i cili mund të jetë dhanë faqsisht a në mungesë. Gjyqet gjykimet i bazojnë në këtë ligjë e ligjet vepruëse.

Vendimet e dhanuna apelisht janë të preme.

Neni 11. Raportat e ruëjtësvet e të çmuësvet shkruhen e nënshkruhen prej tyne dhe njihen akte zyrtare; por në qoftë se nga an' e nji gjyqi kompetent vërtetohet se këto raporta nuk i përgjegjen së vërtetës, raportuësi quhet si falsifikus dhe dënohet në bazë të ligjës ndëshkimore; veçanërisht i ngarkohet edhe sasija e damit dhe e gjobës që ka shkaktue vendimi si edhe shpenzimet e Gjyqit.

Neni 12. Damet e përmenduna në këtë ligjë, në qoftë se bahen nga an' e ruejtësvet, çmuësve, a pleqsis s' atij katundi ku ndodhet dami, çmimi e gjykimi bahet në qendër të Krahinaris a të Bashkis së qytetit ku asht lidhun katundi, në qoftë se dami bahet nga ana e ruejtësve, çmuësve a pleqsis së qendrës së Krahinës, çmimi e gjykimi i përket këshillit të Bashkis së qytetit dhe kur do të bahet nga ana e atyne të qytetit i përket Gjyqit Paqtuës të vendit për tue ndjekun rregullat e kësajë ligje.

Ruajtësit, çmuesit, pleqësija e katundeve dhe pjestarët e Bashkivet në rasë përsëritjeje të damit, hiqen edhe nga detyra.

Neni 13. Dispozitat e kësaj ligje kanë fuqi për ato vende qi nuk janë të konstatueme d. m. m. th. se në qoftë se dëmtuësi kundërshton tue thanë se vendi i damit asht në zotnim të tij tregon edhe dokumenta, atëhere Këshillat e përmenduna zgjidhjen e çashtjes i a sjellin gjyqit kompetent.

Në qoftë se gjyqi pretendimin e zotnimit nuk e sheh t' arsyshme, ban veprimet e duhuna në bazë të kësaj ligje, në rasë të kundërtë e zgjith çashtjen themelisht si mbas ligjëvet në veprim.

Neni 14. Kur Këshillat e katundit, a të Bashkis nuk duan t'a shikojnë padin e dëmtuësit, personat që formojnë këto këshilla merren ndën gjyq dhe po të provohet rregullisht faji i tyne, dënohen mbas nenit 102 të ligjës ndeshkimore tue u vëndosë së bashku edhe heqja e tyne nga detyra.

II.
Ruajtësit dhe detyrat e tyne

Neni 15. Ç' do qytet a katund, si mbas nevojës, duhet të ketë nji a ma shumë ruejtës për të ruejtun vendet e tregueme në nenin 2.

Neni 16. Ruajtësit emnohen nga ana e Bashkivet e e pleqsivet të katundevet në fillim të Janarit për nji vit me nji rrogë të pranueme nga të dy palët; emnimi i këtyne vërtetohet nga ana e Prefektit, Nënprefektit, Krahinarit si mbas lidhjes qi ka në vendet administrativisht.

Fillimi i këtyne në detyrë bahet mbasi të betohen para këshillavet kur në qytete a katunde ndodhet ndo një njeri qi ka prona të shumta e qi ska ruejtës të veçantë, në rasë t' emnimit të ruejtësve do të meret edhe mendimi e pëlqimi i këtij.

Neni 17. Ruajtësit do të jenë nënshtetas Shqiptar; do mos të jenë ma të vogjël se 25 e ma të motshëm se 50 vjetësh; do të jenë njerz të ndershëm e nuk do të jenë njerz të dënuëm me krim a delikt më shumë se tre muaj burgim; me këtë rasë nuk do të pranohen ata që janë dënuëm me burgim për kusari a kurvëri; në zgjedhje të ruajtësve preferohen ata qi dijnë me shkrim e këndim gjuhën zyrtare.

Neni 18. Detyrat e ruejtësve asht mirë-ruejtja e vendeve të shenuëme në këtë ligjë; në rasë të vjedhjes a të dëmit detyrohet të zajë vjedhësin a damtuësin vetë ase bagtit e shpezët damtuëse dhe t' i çojë në pleqsi të Bashkis a në atë të katundit për veç kësaj ban raportin e duhun lajmon dhe çmuësit për të çmuëm damin.

Neni 19. Kur ruajtësit mbrenda 10 ditëve nuk mund të zbulojnë damtuësit a vjedhësit, detyrohen si këta vetë ashtu edhe dorëzanësit e tyne të paguajnë damet si mbas raportit të çëmuësvet.

Neni 20. Ruajtësit para se të fillojnë shërbimin janë të detyruëm të tregojnë nji dorëzanës i cili të jetë i zoti me paguë

shpërblimet e damevet në rasë kur ruajtësit nuk mund t' i zbulojnë damtuësit a vjedhësit në kohën e caktuëme në nenin e sipërmë.

Dorëzanija do të vërtetohet prej Noteris pa takës.

Neni 21. Qeverija asht e detyruëme t' u apë leje ruëjtësve për të mbajtë armë.

Neni 22. Ruëjtësit që do t' emnohen për pasunit e Shtetit dhe ata për pasuni private do të kenë cilsit e ruajtësve qi tregon këjo ligjë dhe emnimi i tyne do të bahet mbas rregullavet të kësaj ligjë.

III.

Çmuesit dhe detyra e tyne

Neni 23. Këshillat e Bashkivet e të katundevet në fillim të Marsit të ç' do viti do të zgjedhin nga 3 çmuës; këta do të jenë njerz të ndershëm e të provuëshëm në bujqësi, do të kenë mbushun 30 vjetët, nuk do të jenë dënuëm me krim e delikt ma tepër se tre muaj burgim; por dënimi i tyne po të ketë rrjedhun prej kusaris a kurvëris sa do i vogël qi të jetë ndalon zgjedhjen e tyne.

Mbasi të zgjidhen betohen para këshillavet përkatëse se nuk do të ndahen nga e drejta dhe nuk do të mbajnë anësi.

Neni 24. Çmuësit detyrohen t' i çmojnë damet që i tregon ruajtësi tue bamun nji raportë i cili do të përmbajë vendin, llojin e sasin e damit dhe arësyënat e hollësinat mbi caktimin e sasis së damit, dhe ky nënshkruhet vuloset prej tyne dhe prej ruajtësit me qëllim qi të kuptohet se çmimi asht caktuë në prani të tij.

IV.

Përmbarimi

Neni 25. Vendimet e këshillavet përmbarohen me nji herë prej Krahinaris ose Gjindarmerisë.

Krahinaria e Gjindarmëria mè shpejti thëret të dënuëmin për të paguëm damet e gjobën mbas letrë vendimeve mbrënda tri ditëvet, në qoftë se i dënuëmi në kët afat nuk paguën damin e gjobën jo ma tepër se tre muaj; dhe, nga ana tjatër i shitet pasunija e lujtshme e në mos mjaftoftë këjo edhe pasunija e palujtëshme tue marrë para syshë dispozitat e kushtet qi përmbajnë ligjat vepruëse.

V.
Nene të veçanta

Neni 26. Nga gjobat qi do të merren në bazë të kësaj ligjë do të paguhen rrogat e rruajtësve. Tepricën këshillat e përmenduna e shpenzojnë në zbukurim të qytetevet e të katundevet.

Neni 27. Në qoftë se gjobat nuk mjaftojnë atëherë rrogat e ruajtësve do të paguhen si mbas lidhjes të zott e vendeve qi ruhen përpjesësisht me sasin e tokës e të pemvet si mbas zakonit të vendit: përpjestimi i pagesës për rroga të ruajtësve bahet në fillim të vjetit nga ana e këshillavet dhe shpallet qi kështu t'interesuëmit të mbrojnë të drejtat e veta.

Neni 28. Çmuësve do t' u paguhet nji shpërblim nga dy deri katër franga ari si mbas largësis së vendit të çmuëm. Këto të holla do të nxirren nga damtuësi bashkë me shpërblimin të damit e të gjobës.

Neni 29. Këshillat e Bashkive e të katundevet janë të detyruëme të mbajnë dy rradhorë, në njenin do të rregjistrojnë shkurtas vendimet e dhanuna mbi dame e gjobë dhe në tjetrin sasin e gjobavet me gjithë hollësinat edhe ku e si u shpenzuan këto.

Neni 30. Krahinarët në krye të ç' do 3 muëjve janë të detyruëm të kontrollojnë rradhorët e gjobavet të këshillavet të katundeve ku për këtë pikë do të bajnë nji raportë në dy kopje nga të cilat njanën do t' i a dërgojnë Prokurorit, a Gjyqit kompetent ku nuk ka Prokurorë, dhe tjatrën do t' a ruajnë në arshivë të Krahinaris; gjith ashtu Prokurori a Gjyqtari kompetent i vendit në kohnat e sipërtreguëme kontrollojnë radhorët e këshillave të katundevet e të Bashkive dhe raportat i ruajnë n' arshivat e tyne dhe në parapamje abuzimi shkaktarët i dërgojnë në gjyq.

Neni 31. Ky dekret ligjë hyn në fuqi 15 dit pas shpalljes.

Neni 32. Ministrija e Drejtësis, e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Bulqësis janë të detyruëme me zbatimin e kësaj ligjë.

Tiranë, me 16-IV-925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësiës
P. POGA

Ministri i P. Botore e Buiqësiës
e Zav. Ministri i P. Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 34.

DEKRET-LIGJË, 11 Prill 1925.

Mbi tarifën postare aerore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1925, Nr. 16)

Mbasi u pa vendimi i Këshillit Ministruer me datë 28 III 925.

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Pranimin e të vuëmit në zbatim të dy tarifave qi i njiten këti dekreti mbi taksat e korrespondencës e kolipostave qi do të përdoren për shërbimin postar t' aeroplanave të Shoqënis Adria Aero Loyd në bazë të kontratës së bamun për këtë qëllim.

Art. 2. – Me zbatimin e këtij dekret-ligji ngarkohet Ministrija e P. Botore e e Bulqësis dhe ajo e Financavet.

Tiranë, me 11-IV-1925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Ministri P. Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësiës
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës
e Zav. Min. i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Tarifa e taksave qi asht sot në veprim me gjithë taksat e tarifës qi do t'i aplikohet shërbimit t'aeroplanavet

OBJEKTI		Tarifa qi asht sot në veprim	Tarifa qi do të përdoret për shërbimin e aerop.	Shuma e Përgj.	VREJTJE
	Pesha	taksa fr. q.	taksa fr. q.	fr. q.	
1 Letër ordinare	deri 15 gr.	0.10	0.20	0.30	
	prej 15-30	0 20	0.30	0.50	
	„ 30-50	0.40	0.60	1.–	
	„ 50-150	1.–	1.–	2.–	
	„ 150 250	1.70	1.50	3.20	
	për çdo 100 gr. ma tepër mbi 250 gram	–	0.50	–	
2 Karta postale pa përgjigje	–	0.50	0.15	0.20	
3 Karta postale me përgjigje	–	0.19	0.30	0.30	

BKSH

OBJEKTI	Pesha	Tarifa qi asht sot në veprim taksa fr. q.	Tarifa qi do të përdoret për shërbimin e aeropl. taksa fr. q.	Shuma e Përgj. fr. q.	VREJTJE
4 Dokumenta arke të lidhura	deri me 15 gr. e për çdo 50 gr.	0.10	0.29	0.30	Pesha s'ka me kalue 2 kg.
5 Të shtypuna të përkohshme d. m. th. revista, katalog libra etj.	deri më 75 gr. për çdo 75 gr.	0.05	0.15	0.20	
6 Fletore të dërgueme prej editorit ndër paqeta pa drejtime	deri 75 gr. e për çdo 75 gr.	0.01	0.05	0.06	
Fletore të dërguëme veças	copë	0.01	0.05	0.06	
7 Letra ftimi për vdekje ose martese etj.	–	0.05	0.15	0.20	
8 Mostra tregtije	deri 100 gr.	0.10	0.30	0.40	
	prej 100-250	0.15	0.60	0.75	
	,, 250-350	1.35	1.–	1.35	
9 Faktura tregtijet	–	0.05	0.15	0.20	

Tarifa e taksave të koli-postave

Pesha	Tarifa ordinare Taksa fr. q.	Tarifa qi do të përdoret për shërbimin e aeropl. Taksa fr. q.	Shuma e përgjithshme fr. q.
Deri 250 gram	0.75	1.–	1.75
Prej 250-500	1.75	2.–	3.25
,, 500-1 kg.	1.75	3.–	4.75
,, 1 kg. 2 ,,	2.50	4.50	7.–
,, 2 ,, 3 ,,	3.25	5.–	9.25
,, 3 ,, 4 ,,	4.–	7.50	11.50
,, 4 ,, 5 ,,	4.75	9.–	13.75

BKSH

Nr. 35.

DEKRET-LIGJË, 29 Mars 1925

Mbi ngritjen e moratoriumit në Korçë e në rrethinat e saj

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 2 Maj 1925, Nr. 17)

Na Krytari i Republikës Shqipëtare, tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer Nr. 151 datë 23-III-1925.

DEKRETOJMË:

1. Ngrihet moratoriumi në Korçë e në rrethinat e saj krejt pa as një përjashtim (eksepsion).

Neni 2. Popullsia e Korçës e e rrethinavet të saj ashtë e lirë të mprojë të drejtat e veta që i patën kenë ndalue nga shkaku i moratoriumit tue u bindun ligjëve në veprim të Republikës.

Neni 3. Me shpallien e këtij dekret-ligji dispozitat e gjithë ligjeve të moratoriumit e të ligjit me datë 15-II-1925 mbetën pa fuqi.

Neni 4. Ky dekret-ligjë hyn në fuqi qysh prej datës së shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Neni 5. Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Tiranë me 29-III-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bujqësiës
e Zav. Min. i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Nr. 36.

DEKRET-LIGJË, 2 Maj 925.

Mbi pranimin e Konventës me Shoqntn Italiane të Selenicës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Maj 1925, Nr. 18)

Massi u pa vendimi i Këshillit Ministruer me datë 28-III-925 dhe artikulli 117 i Statutit.

DEKRETOJMË:

Art. 1. Pranimin e të vuemit në zbatim të kontratës qi i ngjitet këtij dekreti të bamun ndërmjet Z. Kostaq Kottës, Ministër

i P. Botore e Bulqësis e të Z. Ingjinier Nobili Gjovani, Drejtur e Prokuror i Shoqënis Italjane të Minierave të Selenicës me banim në Romë Piazza S. S. Apostoli 81, mbi një konçesion në favor të Shoqënis në fjalë për gërmime e shfrytzim të vojgurit dhe t'idhokarburave këstilloji me konditat e përmbajtuna në kontratën në fjalë për nji kohë 20 vjetshe.

Art. 2. Me zbatimin e këtij dekreti detyrohet Ministrija e P. Botore e Bulqësis dhe ajo e Financavet.

Tiranë, me 2-V-1925. *Kryetari i Republikë*
A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri Drejtësis
P. POGA

Ministri i *P. Botore e B.*
e Zav. Ministri P. të Mbrendshme
K. KOTTA

KONVENCION

Në mes të Qeveriës Shqyptare e përfaqësueme prej Shkëlqesis së tij Ministrit P. Botore e Bujqësiës, qi ka m'u shenuem në vijim si „Qeveri" e Z. Giovani Nobili Drejtuer e fuqi plot i Shoqniës Italjane të Minierave të Selenicës qi banon në Romë, Piazza S. S. Apostoli 81, qi ka m'u shenuem në vijim si „Shoqni" asht venduem sa vijon:

Art. 1. Qeverija i nep Shoqniës nji leje kërkimi qi i nep të drejtë Konçesjonit, transportimit, përdorimi punimi (traitemet) edhe për tregim të prodhimeve, si që e pranon teksti i Konvencionit për voj-guri, hydrokarbure të forta, të langta e gazoze, skiste bituminoze, argjile e ranë bituminoze, mbi nji sypërfaqe prej 2140 hektar e ma sigurisht e, f, a, të shenuem në planin ropografik këtu bashkalidhun ku a, b, c, d korrespondojnë drejtësisht ndër qendrat e katundeve të Risilis, Libonjës, Penkovës, Peshkopis, edhe në të djatht të kreut t' urës së Droshovicës edhe F në qendrën e katundit Kishbardhë ku kryqzohen tri rrugat me majën 204.

Konçesjonari ka të drejtën eksklusive për me bam në ketë zonë të gjitha punimet e kërkimeve, me përdor ujnat për instalime eventuale hydroeletrike tuej u përmbajt gjithnji ligjeve Shqyptare, edhe në mâs vetëm për nevojat e kësaj sypërmarrje.

Art. 2. Leja e kërkimeve ka me pas nji afat tri vjetësh që prej datës ratifikimit këti konvencioni vetëm në rasë ku Shoq-

nija kishte me gjykuem ma oportune për me e kërkuem konçesjonin definitiv para mbarimit të kësaj kohe.

Art. 3. Shoqnija ka me pasë të drejtë me importuem në Shqypnië të gjitha maqinat të gjith materjalet e nevojshme për punimin të përjashtuëm prej ç' do far taksit doganuër, edhe kjo, si mbrenda periudhës së kërkimeve ashtu edhe mbrenda periudhës së Konçesjonit.

Art. 4. — Shoqnia ka me pasë të drejtë me eksportu për provim industrial e përjashtuem prej ç' do farë taksesh, prodhimet e nxjerruna në sasi qi të mos kapërcejnë, (maksimum 100 tonë) në qoftë se ka ma nevoja, ajo ka me mujt me disponuë sasina ma të mdhaja me lejen ma par të Qeveris e tuj paguem nji taks përpjestimtar.

Ar. 5. — Puntorët e përdoruem ndër punime kan me qenë nënshtetësijet Shqypëtar për pos specialistëve, teknisienve edhe ekspertave. Ato kan për tu siguruem si duhet kundra rreziqeve në punë.

Art. 6. — Mbrenda kërkimeve për pos vjetës së par të caktuem për instalacjone, Shoqnija detyrohet me mbajtë gjithnji n' ushtrim nji sond për nji (shbirim) minimum tetqind (800) metër.

Art. 7. — Në qoft se rezultatet e kërkimeve lejoheshin për me kërkuem konçesionin për shfrytzimin e gjismentëve, Shoqnija ka me pregaditë kërkesën e Konçesjonit definitiv edhe Qeverija detyrohet, që prej tashti me ja dhanë me konditat qi vijojnë :

a) Shoqnija ka me themelue nji kompanië për shfrytzimin transportin, përdorimin, punimin (trajtement) edhe tregtimin e prodhimeve ; kapitali minimun i të cillës ka me qenë nji miljon e pesqindmijë (1.500.000) fr. ari.

b) Kufit e tokavet për t' u dhanë s' kan me muëjtë me kapërcyëm ato të shënuëme n' artikullin 1.

c) Dy zona shfrytëzimi kan me mujtë me u zgjedhë, edhe të përshime në kufi këtu sypri.

d) Koha e konçesjonit ka me kenë 50 (pesdhet) vjet.

e) Çpronësimi i tokave ka m'u baëm si mbas ligjave shqiptare.

f) Për qera Shoqnija ka me paguë nji taksë të përvjetshëm fiks 1.50 qindar edhe më tepër nji t' ardhun për përpjestimtare tremdhetë e gjysë për qind (13.50%) të voj-gurit brut në kantierë o në të holla ose në natyrë, si edhe tremdhetë e gjysë

për qind (13.50 %) të vojnave qi kan me dalë nga distilacioni i landëve tjera, mbasi të zbritet sasija që ajo ka me pasë konsumuëm për punimet që i përkasin shfrytëzimit.

Landët e tjera që kan m' u eksportuëm brut do të paguëjn t' ardhun pjestimtarë si mbas ligjës minierave.

g) Për posë taksave e t' ardhunave të shënume në këtë konvencion, as ndonji tjetër taksë nuk ka m' u aplikuë mbi prodhimet e dhanuna në shfrytzim, ose që rrjedhin prej prodhimeve brut si edhe Shoqnija nuk ka m'u randuë as prej ndonji tjetër taksë të veçantë ose personale.

Art. 8. — Nënshkrimi i katërdhet për qind (40%) i kapitalit të kësaj Shoqnië ka m' u rizervuë për nënshtetas Shqyptar edhe ka m' u ba në nji afat gjasht mujsh, në qoft se aksionet nuk do të jenë nënshkruem ose nji pjesë, Shoqnija ka me ja vuem në dispozicion të Qeverisë mbrenda nji kohës së re tre muejshe. Këto aksione nuk kan me mujtë me u dhanë të hujve pa pëlqimin e grupit nënshkruësit Italjan.

Art. 9. — Mbrenda vazhdimit të Konçesjonit Shoqnija detyrohet me zbatuem, mesatarisht punimet e forazhit si vijon:

Në vjetin e parë	300 metra
„ „ „ dytë	400 „
„ „ „ tretë	500 „
„ „ „ katërt	500 „
„ „ „ pestë	500 „

për posë në rast ku voj-guri kishte m' u gjetë ndër thellsina ma të pakta.

Mbas fillimit të së gjashtës vjetë deri në mbarim të Konçesjonit Shoqnija detyrohet me rregulluë programin e vet të sondazhit në mëndyrë qi me mbajtë nji shbirim të mesëshëm 500 metra në vjetë. Në kjoft qi kishin me ndodhë shkaqe të nji natyre me penguem zbatimin e programit minimum të shenuëm këtu sypri, çashtja ka me ju deferuë komisionit teknik të shenuem n' artikullin 19 i cilli ka me mujtë me caktuë nji zbritje konvenabël të programit.

Art. 10. — Shoqnija ka me pasë të drejtë me instalue e me përmbajtë qynge (conduits) për transportimin e vojit, të hidrokarburëve të langshëm e gazoze mbas aprovimit të projektit qi ka me qenë e detyruëme me paraqitë.

Art. 11. — Shoqnija s' ka me mujtë me përdoruë tokën e dhanun të Shtetit, për me ba indushtri bujqësore ose pyllore ose

BKSH

të tjetër lloj qi nuk kishte me pasë për qëllim prodhimin e punimi i prodhimeve të dhanuna ose ato që rrjedhin prej tyne, por Qeverija ka me mujtë, pa i përkit të drejtat e Shoqniës dhanuna Shoqniës me këtë konvencion, me disponuë sypërfaqet si t' i pëlqejë ma mirë.

Art. 12. – Shoqnija ka me shpërblye si mbas ligjës personat e tretë nga damtimet e shkaktuëme mbrenda punimeve edhe për ç' do kohë ka me majtë Qeveriën të lirë prej ç' do farë përgjegjësijet e cilla (Qeveria) ka me pasë me ju përgjegj kundra personave të tret.

Art. 13. – Në qoftë se prodhimi vjetuër i voj-gurit kishte me mrrijtë 50.000 ton. me lejuëm kështu ndërtimin në vënd të nji ose ma tepër rafinerive, të gjith materjali edhe sendet e nevojshme për këto ndërtime kishin m' u importue në Shqipnië pa paguem as ndonji taksë.

Art. 14. – Në rasë ku nji ose ma tepër rafinerie, si mbas artikullit ma parshëm që kishin m' u vuem n' ushtrim, Shoqnija kishte me vuë në dispozicion të Qeveriës, me çmim korrent, sasina e voj-gurit shtërngimisht e të nevojshme për nevojat e vëndit; për nevojat e administracionit me nji zbritje dhetë për qind (10%) mbi këtë çmim qi ka me u ba.

Art. 15. – Shoqnija, mbrenda periudhës Konçesjonit ka me pasë të drejt me hjekë dorë në nji pjesë ç' do faret të tokës që ban fjalë ky Konçesjon. Ky lëshim ka me përjashtuem përpjestimisht në sypërfaqen, prej detyrimeve qi rezultojnë me këtë konvencion mbi sa i përket t' ardhunave mbi tokët e xanuna.

Art. 16. – Në mbarim të Konçesjonit, të gjitha maqinat, materjalet, uzinat e rafineriët kan m' u ba pranë Qeveriës të liruëme prej ç' do ngarkimi.

Art. 17. – Me 31 Kallnduer e me 31 Korrik të ç' do vjetit Shoqnija ka me paraqitë në Zyrën e minierave desenet, porfilet edhe krokit e punimeve të zbatuëme kështu edhe ajo ka me dhanë në rasë kërkimi, të gjitha informatat qi i përkasin punimeve.

Art. 18. – Në rasë ku punimet t' jenë mbetë vartas ose t' jenë ndalue, pengue prej ndollinave ç' do faret të forcës magjore qi të kenë ndollë në Shqipni edhe për ç' do farë shkakut; detyrimet e ndryshme nuk kan me pasë ndonji vleftë mbrenda të gjith kohës të rasave të forcës magjore, edhe kohët e parapame nuk kan me vazhduë.

Art. 19. — Nji komisjon teknik i përbamë prej 4 misve dy prej të cillve kan m'u emnue prej Shoqnies, edhe dy prej Qeveriës, kanë me vertetue konditat e tokës,edhe me veshtrue në qoftë se detyrimet janë zbatue normalisht prej anës Shoqëniës, komisjoni ka fuqi me zbritë këto detyrime në rasë ku kishin me ndodhë pengime në posibilitetin e zbatimit të detyrimeve të përmenduna.

Art. 20. — Në rasë të ç' do farë mos marrëveshtjet në mes të Qeveriës e të Shoqniës qi i përkasin interpretimit të së drejtave e detyrimeve të dy palve kontraktuese, çashtja ka me u deferue në tre arbitër njani prej të cilve ka m' u emnue prej Qeveriës i dyti prej Shoqniës edhe i treti ka me u zgjedhë në marrëveshtje të përbashkët prej dy arbitrave. Në rasë ku këto s' kishin me mujt me u marrë vesht mbi zgjedhjen e të tretit arbitër ky ka me u emnue prej Gjyqit Diktimit Shqyptar. Në pritjen e gjykimit të arbitrave vazhdimi i konçesjonit nuk mundet me qënë i penguem.

Art. — 21. — Shoqnija, nji muej mas notifikimit të lejës kërkimeve ka me dhanë për garanci, në „Banca Commerciale Italiane në Romë" shumën e 150.000 (njiqindëpesëdhetëmi) Lireta Italjane. Kurë ka me ju dhanë konçesjoni i shfrytzimit Shoqnija ka me e dhanë në nji afat 1 muej mbas kalimit të kësajë datë po n' at bankë e gjithnji për garanci, nji shumë të ré prej 150.000 (njiqindëpesëdhetëmi) Lireta Italiane.

Shuma e parë e 150.000 Lira Italjane e dhanun 1 muej mbas notifikimit të lejes kërkimeve ka me ju këthyëm po sa qi Shoqnija të kenë importue në Shqipnië materjal e maqina të nji vleftës 150.000 Lira Italjane.

Të tjerat 150.000 Lira Italjane kanë me mbetë në dispozicion të Qeveriës në titull garanciet, për zbatimin e këtij konvencioni deri në mbarimin e tij, kjo shumë gjithnji ka me ju këthyem Shoqniës në qoftë se të jen konstatue qi konsideracionet teknikë e bajnë të pa mundshëm vazhdimin e punimeve të shfrytzimit.

Art. 22. — Shoqnija ka me dhanë përpara, nji muej mbas notifikimit të lejes kërkimeve shumën e taksës fiks për dy vjet d. m. th. 6420 (gjashtëmiëkatërqindënjizet) Fr. ari.

Art. 23. — — Ky konvencion ka m'u redizhuem Shqip e përkthye Frengjisht. Në rast kontestacjoni mbi interpretimin e tij, përkthimit Frengjisht i vërtetuem e i nënshkruem prej Qeveriës ka me ju xanë besë.

BKSH

Art. 24. — Ky konvencion ka me qënë i vlefshëm për nji periudhë 20 (njizet) vjetësh mbas datës dekretit Kryesis në konformitet të artikullit 117 të Statutit Repubiikës Shqiptare edhe ky ka me ju paraqitë Parlamentit për m' u zgjatue për 33 (tridhetetri) vjet.

Shoqnija ka me mujt me kërkuem në ç' do çast këtë zgjatim.

Në rasë kur parlamenti nuk kishte me ratifikuem zgjatimin, Artikulli 16 nuk ka me pasë as ndonji vleftë.

Art. 25. — Mbassi qi në vendin e Drashovicës ndodhet materjal i lanun që prej kërkimeve të para të baëme në 1920, Qeverija detyrohet m' e dhanë këtë materjal edhe inventarin e tij, Shoqniës qi ka me pasë të drejtën me i përdorë tuej paguem nji t' ardhun fiks të përvjetëshme 500 (pesqind) Fr. ari.

Tiranë, me . . . .

Konvension ky i pranuem edhe prej mbledhjes me 28-III 925 të Këshillit Ministruer.

Ministri i Financavet
e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri Dreitësiës
P. POGA

Ministri i P. Botore e Buiqësiës
Zav. Ministri i P. të Mbrendshme
K. KOTTA

Pëlqej këtë konvension dhe urdhënoj zbatimin e tif.

2 Maj 1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 37.

DEKRET-LIGJË, 2 Maj 1925.

Mbi organizimin e gjykatave të Drejtësis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Maj 1925, Nr. 19)

KRYE E I

Formimi i Gjykatave

Neni 1. Gjyqet e Drejtësis ndahen.

a) Gjyqet e Shk. I.rë.

b) Gjyqet e Apelit.

Për veç këtyne në Kryeqytet ka dhe nji Gjyq Diktimit,

Pjesa e I.

Neni 2. Në qendrën e ç' do Prefekture e N-prefekture formohet nga nji Gjykatë e Shk. I. rë.

Neni 3. Gjykatat e Shk. I. rë, përbahen prej nji Gjyqtari nji Nd. Gjyqtari, dhe me sasin e sekretarve të nevojshëm si dhe ftuës e shërbëtor.

Pranë Gjykatave të Shk. I. rë ndodhet nji Noter-Përmbaruës me nji sekretar.

Pjesa e II.

Neni 4. Në qendrat e Prefekturave formohet nga nji gjykatë e Apelit.

Neni 5. Gjykatat e Apelit përbahen prej nji Kryetari, dy Antarve, nji Kryesek.-Nd. Antari, dhe me personelin e sekretarve të nevojshem si dhe mbas nevojës prej ftuësve e shërbëtorve.

Neni 6. Pranë Gjykatave t' Apelit ndodhet nji Prokuror me nji Sekretar nji Gjyqtar Hetuës me nji Sekretar.

Pjesa e III.

Neni 7. Gjykata e Diktimit ndahet në dy dega.

1) Dega e çështjeve Civile. 2) Dega e çështjeve Penale.

Ç' do degë ka nji Kryetar. 4 Antarë, 1. Nd. antar, 1 Kryesekretar, dhe sekretarët e nevojshëm e ftuëse shërbëtor.

Neni 8. Pranë Gjyqit Diktimit ndodhet nji Kryeprokuror, nji Nd. Kryeprokuror, nji sekretar, nji Protokolist arshivist, dhe nji shërbëtor.

Neni 9. Seicili prej Kryetarve të Diktimit kryeson degën e vet por në rastin e mbledhjes Përgjithshme detyra e Kryetarit i përket Kryetarit Degës Civile.

KRYE i II.

Pjesa e I.

Kompetenca e Gjykatave

Neni 10. Gjyqet e Shk. I. tue u mbështet në ligjat vepruse shikojn e zgjidhin fillimisht të gjitha çështjet Civile, Tregtare, dhe gjithë gabimet e deliktet.

Gjyqet e Shk. I. bajnë dhe hetimet të çështjeve kriminale në vende ku ka gjykata t' Apelit hetimet e çështjeve kriminale bahen nga Gjyqtari Hetuës.

Gjyqet e Shk. I. rë në vende ku nuk ka Noter-Përmbaruës janë të ngarkuëm të kryejnë dhe detyrat të përmbarimit e Noteris.

Neni 11. Gjykimet e Gjyqeve të Shk. I. rë për deri 50 fr. ari janë të preme. Gjykimet për dori 500 fr. ari ose n'atë vlefte janë të diktuëshme, gjykimet prej 501 fr. ari e ma tepër janë t' apeluëshme.

Pjesa e II.

Neni 12. Gjyqet e Apelit tue ju mbështet ligjave në veprim shikojnë e gjykojnë apelisht të gjitha çështjet civile e tregtare, të qendrës e të qarkut tyre qi kalojnë 500 fr. ari ose aqë vleftë, gjykojnë tue pasë dhe trupin e juris pranë gjithë çështjet kriminale qi ndodhen në qarkun e tyne.

Neni 13. Gjykimet e gjykatave t' Apelit janë të diktuëshme por, gjykimet mbi çështjet kriminale i shtrohen diktimit vetiut.

Pjesa e III.

Neni 14. Gjyqi i Diktimit studjon e shqyrton të gjitha gjykimet e dhanuna nga Gjyqet e Shk. I., të cilat nuk kalojnë 500 fr. ari ose n' atë vleftë, si dhe gjykimet e dhanuna nga gjykatat e Apelit.

Neni 15. Gjyqi i Diktimit ka kompetencën qi rezulton si mbas këtij ligji procedurave Civile e Penale.

Neni 16. Detyrat e Prokuroravet, Gjyqtar Hetuesve, Noter-Përmbaruësve janë gjithë ato të shenuëme ndër procedurat e ligjat e tjera në veprim.

Pjesa e IV.

Neni 17. Gjykatat fetare të ç' do komuniteti fetar shëkojnë e zgjidhin këto çështje :

a) Kunorëzim.

b) Çkunorëzim (separation).

c) Ushpim (nakafa) qi rjedh prej kunorës.

Neni 18. Vendimet e gjykatave fetare mbi çështjet e kallxuëme në nenin 17, eksekutohen prej zyrës përmbaruëse.

Pjesa e V.

Prokurorat

Neni 19. Prokurorat janë mbrojtësit e të drejtave të përgjithshme ; pra detyra themelore e tyne asht kujdesimi i plotë

mbi mirë-zbatimin e ligjave të Shtetit, e sigurimi i qetësis dhe i së drejtës botore. Këta korespondojnë me Ministriën e Drejtësiës e me autoritetet e tjera.

Neni 20. Në çashtjet ndëshkimore detyrat themelore të prokurorave janë të caktuëme në procedurën penale.

Neni 21. Prokurorat në çashtje gjyqësore i shtrohen rregullave hierarhike. Gjyqtarët e Shk. I. sa për detyrat qi ju përkasin si Prokurora, janë të lidhun me prokurorat e gjyqeve të Apelit.

Rregullat hierarhike respektohen dhe në çashtjet administrative të gjyqeve.

Në çashtje qi shifet nevoja e domosdoshme zyrat e sipërtreguëme munden të korispondojnë drejt për së drejti njena me tjetrën.

Neni 22. Kryeprokurori kuër të shofi se nji nëpunës i drejtësis meriton lavdi ose qortim, ose ndeshkim disipiinuer i drejtohet Ministris së Drejtësiës gjith ashtu ban veprimet e duhuna si mbas ligjës për tajet ligjore të nëpunsavet të Drejtësis.

Neni 23. Prokurorat e Apelit në qarqet e tyne po te shofin vepra të kundra ligjëshme ose të pa rregullshme, mbasi të bajnë hetimet e para ja lajmërojnë Ministrisë së Drejtësisë për veprim.

Neni 24. Kuër gjykimi i nji nëpunësi të Drejtësis i përket gjyqit të naltë të Shtetit, detyrën e Prokuroris e bën Kryeprokurori ose ndihmësi i tij.

Neni 25. Prokurorat kanë të drejtën e kontrollimit ndaj gjykatave e zyrave përkatëse qi i mvaren.

Detyrat e prekurorve të çashtjeve Civile

Neni 26. Prokurorat marin pjesë para gjyqit në çashtjte qi pasojnë :

1) Nër çashtjet qi i përkasin të drejtës Botore.

2) Nër padina qi i përkasin pasunisë Shtetit.

3) Kur nji padi i përket popullsis një katundi ose qytetit ase nji qarkut.

4) Kur padia i përket institutave të përgjithëshme.

5) Kur padia bahet ndaj nji testamentit bamirës.

6) Kur padia bahet ndaj nji personit moral tue përjashtuar gjithë shoqëritë tregtare e anonime.

7) Nër çashtje ku kërkohet refuzimi i gjyqtarvë.

8) Kur ndodhë ndonji ankim kundra gjyqtarve.

9) Nër çashtje qi i përkasin detyrës ose kompetencës të gjyqeve.

10) Nër padi qi ndodhin jetima, të marë, të sikvestruem (Mahxhur) si dhe nër çashtje qi ndodhet ndonjeri prej ndërgjegjësve nën kujdesim.

11) Ndër padina kur njeri prej ndërgjeqësve ndodhet i humbur d. m. th. nuk i dihet vdekja ose gjallnimi i tij.

Neni 27. Nër padinat e kallxueme në nenin e sipërmë, Kryetari i Gjyqit para se të fillojë shikimin të padisë, i komunikon aktet Prokurorit ose Ndihmësit të tij.

Neni 28. Prokurori nga data e komunikimit të akteve mbrenda 5 ditve asht i detyruem me ja kthye aktin gjyqit së bashkut me mendimin e tyne zyrtar mbi marrjen ose jo pjesë në padin e ngrehun.

Neni 29. Prokurorat edhe sikur të diftojnë mendimin mbi mos nevojën e të marrunit pjesë në padi, gjykata, para se nep gjykimin mund t' a vendosë ndëgjimin e mendimit të Prokurorit. Prokurorat në qoftë se marrin pjesë jashta kompetencës tyne me lypjen e ndërgjegjësve, gjyqi mund të vendos mos përzimjen e Prokurorit.

Neni 30. Mbasi në gjykatat e Shk. 1. nuk ndodhin Prokurora, çashtjet për të cilat asht nevoja e të marrunit pjesë të Prokurorave mund të Apelohen ose diktohen nga Prokurorat e Apelit, për të cilat gjykatësit e shkallës I, detyrohen të lajmërojnë. Afati i apelimit ose i diktimit i të tilla çashtjeve fillon që nga data e ditës së nesërme të komunikimit të çashtjes.

Neni 31. Në çashtjet qi asht nevojave të marrunit pjesë të Prokurorave edhe sikur të pajtohen t' interesumit nuk i vjen ndonji pengim veprimeve ligjore të Prokurorave.

Neni 32. Prokurorat në çashtje qi marrin pjesë për veç qi do të tregojnë mendimin e tyne faqe ndërgjyqeve janë të detyruem me i paraqit Gjyqit në fund të padiës me anë të nji parashtresës shkurtimin e kundërshtimeve e të argumentave të përmbledhuna.

Neni 33. Prokurorat tue ju shtruë kushtevet të treguem në Procedurën Civile mund të apelojnë ose të diktimojnë padinat në të cilat kanë marrë pjesë tue qenë të pa detyruem me plotsue dispozitat për dorzanie e sigurim të cilat janë nga kushtet e apelimit e të diktimit.

Nnei 34. Apelimi ose 'diktimi i bamun prej Prokuroravet mbi çashtjet e kallxuëme me nenin 26 të këtij ligji ka fuqi eksekutive kundra të interesuemve.

Neni 35. Prokurorat kontrollojnë eksekutimin e të gjithë akt gjykimeve të qendrës e të qarkut tyne, dhe gjith llogarit e veprimet e kujdesive bonjakëve.

KKYE III.

Pjesa e I.

Detyra e Nd. Antarve, Nd. Gjyqtarve, të Kryesekretarve dhe të sekretarve

Neni 36. Nd. Antarët, në mungesë të antarve, zavendësojnë ata në gjykime, përmbarojnë të gjitha detyrat ligjore, ndihmojnë edhe në të gjitha veprimet e kanceleris.

Neni 37. Në munges të Prokurorit, ose të Gjyqtarit Hetues i zavendëson nji nga antarët e gjyqit dhe detyrën e antarit e ban Nd. Antari.

Neni 38. Nd. Gjykatësit të gjyqeve Shk. I. zavendësojnë giyqtarin në mungesën e tij gjykojn ato çashtja qi urdhënon gjyqëtari, me urdhënin e giyqtarit bajnë të gjitha veprimet qi i kanë ngarkuar ligia gjyqtarit dhe rregullojnë veprimet e shkresinës tue punuar dhe si sekretar.

Neni 39. Kryesekretarët e Gjyqeve rregullojnë të gjitha veprimet e shkresinave, shkruajnë në kohën të caktueme akt-gjykimet, rregjistrojn e përmbledhin t' ardhunat e gjyqit, kujdesohen në të gjitha veprimet e sekretarve tue qenë drejt për së drejti përgjegjësa si Kryetar zyret, gjithë ashtu përmbarojnë urdhënat ligjore të Kryetarit.

Neni 40. Sekretarët redaktojnë procesverbalet e gjykimit, zbardhojnë të gjitha aktet në kohën e caktuëme, përmbarojnë urdhënat ligjore të Kryetarit e të Kryesekretarit.

Neni 41. Protokolist-kopistat protokolojnë të gjitha aktet dhe shenojnë në protokol të gjitha veprimet e zyrës, kujdesohen për rregullimin e mbi ruajtjen e arshivës, kopjojnë të gjitha aktet që ju epen, zavendësojnë sekretarët ne rasa të nevojshmo.

Neni 42. Nër ato giykata qi nuk ka protokolist-kopist detyrat e tyne i përmbarojnë sekretarët e gjyqeve.

Neni 43. Ftuesat përmbarojnë detyrat e komunikimit qi u

ngarkon ligja, bajnë shërbimet e caktueme prej gjyqit dhe shërbëtorët përmbarojnë urdhënat e superiorëve tyre.

KRYE IV.

Pjesa e I.

Cillësit e Gjyqtarve

Neni 44. Për t' u emëruar nëpunës me cillësi gjyqtëri ose Prokurori kandidati duhet të ketë këto cillësina:

1) Të jetë nënshtetas Shqiptar;

2) Të ketë mbushun të 25 vjetët;

3) Të shkruej e të këndoj gjuhën zyrtare;

4) Të ketë mbaruar nji shkollë Drejtësiet (Universitet) ase të jetë i praktikuem 10 vjet rresht si gjyqtar ose advukat. Ata qi kanë praktikë ma pakë se 10 vjet i shtrohen provimit.

5) Të mos jetë veshun me petka fetare.

6) Të ketë moral e sjellje të mira e të mos ketë famë të keqe.

7) Të mos jetë gjkykuem me krim ose me delikt.

8) Të mos ketë dhanë falimenton, e të mos ketë bjerrë të drejtat politike, dhe sikur ma vonë të drejtat në fjalë t' i jenë këthyë.

9) Të mos jetë pushuëm kryekëput nga puna disiplinisht.

Neni 45. Ata që kanë mbaruem nji shkollë drejtësie dhe dëshërojnë të emnohen nëpunësa rishtazi me cilësi gjyqtrrie për veç cilësinavet të tregueme në nenin 44 duhet të kenë nji praktit dy vjeç në degat të ndryshme të gjyqeve ase të kenë ushtruem avukaturën dy vjet rresht.

Neni 46. Ç' do nëpunës me cilësi gjyqtari para se të mbushi tri vjet shërbimi në rangun e vet nuk mund të gradohet.

Neni 47. Avukatat me dipllomë t' universitetit Juridik, si dhe ata avukata praktikant qi kanë cilësit e caktuëme në këtë ligjë mund të emnohet gjyqtarë tue u marrë para sysh vjetët e shërbimit në karierën, mirësjelljen dhe meritimin e tyne.

Avukatve të cilve u proponohet nëpunësia e nuk e pranojnë ndalohen nga ushtrimi avukatuer që nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

Neni 48. Kur nji gjyqtarie ndodhet vakant preferohen ata qi janë ma të vjetër në shërbim dhe qi kanë cilësit e caktuëme në këtë ligjë.

Neni 49. Nëpunësit qi kanë cilësi gjyqtarie, zgjidhen me anë të komisionit për zgjedhjen e nëpunsavet të drejtësis dhe me proponimin e Ministriës së Drejtësiës emnohen me dekret të Kryetarit të Republikës; nëpunsat tjerë të drejtësis zgjidhen dhe emnohen me dekret të Ministriës së Drejtësiës.

Neni 50. Noter Përmbaruesa do të kenë cilsit e tregueme në nenin 44 të kësaj ligje mbasi ata janë në gradë të Nd. Gjyqtarve të Shkallës I.

Pjesa e II.

Pa tundshmenija e Gjyqtarve

Neni 51. – Gjyqtarët e çdo rangut e Prokurorët janë të pa tundshme, këta me as nji mënyrë nuk mund të pushohen nga puna për veç me gjykimin e gjyqii kompetent për faje në detyrë e për faje ordinare.

Sa për fajet disiplonare ato që shkaktojnë pushimin e tyne nga detyra gjykohen nga Gjyqi i Diktimit, fajet disiplinore për veç pushimit vendosen nga komisija për zgjedhjen e gjyqtarve dhe eksekutohen me anë të Ministrit të Drejtësis.

Neni 52. Në rastin e gradimit të gjyqtarve në qoftë se ata nuk e pranojnë nëpunësin e re quhen dorëheqës.

Neni 53. Gjyqtarët nuk mund të marrin pjesë as përkohësisht, me rrogë ose pa rrogë në ndonji tjetër shërbim shtetnuër: vetëm mund të emnohen Profesora në shkolla drejtësie t' Universitetit.

Neni 54. Gjyqtarët nuk mund të bajnë tregti dhe nuk munden me marrë pjesë në administratën e ç' do shoqniës tregtare.

Neni 55. Gjyqtarët ekspcjonisht pushohen kur me ligjë të posaçme suprimohet gjyqi dhe ngushtohet qarku gjyqësuer.

Pjesa e III.

Transferimi i Gjyqtarve

Neni 56. Gjyqtarët e ç' do rangut sikuër u treguë në nenin 54 të kësaj ligje janë të pa tundëshme dhe nuk transferohen pa dëshirë por me vendimin e komisis për zgjedhjen e gjyqtarvet disiplinisht ose për arsye administrative të forta, mund të degradohen.

Transferohen gjyqtarët në rastin qi mblidhen me nji vend dy gjyqtarë të afërmë në gjak gjer në shkallë të katërtë, ose janë baxhanakë, dhandër, vjehër e kunat.

Pjesa e IV.

Lavderim e gradim i Gjyqtarve

Neni 57. Në mbarim të ç' do vjetit Ministrija e Drejtësis tue marrë para sysh statistikat e raportat e inspektorit dhe hetimet e tjera po të shohi se gjyqtarët i kan krye detyrat e tyne si mbas ligjave vepruëse, u dërgon nga nji letër lëvdat tue ju shënue këto dhe në jetëshkrimin e tyne.

Neni 58. Gradimi i gjyqtarve bahet si kur asht treguë në nenin 68 të kësaj ligje, tue ju marrë parasysh zotësija e mirësjellja e tyne.

Gradimi bahet tue ndjek radhën e rangut.

Pjesa e V.

Ndeshkimi disiplinuer i Gjyqtarve

Neni 59. Gjyqtarët janë të detyruëm të vazhdojnë rregullisht në detyrë e të mos cenojnë detyrën me asnji mëndyrë; gjithashtu janë të shtrënguëm të ruajnë e të mos cenojnë dinjitetin gjyqësuër mbrënda e jashta zyrës.

Neni 60. Dënimet disiplinore janë këto:

a) Qortim me shkrim.

b) Të premit e nji sasis së rrogës deri dy muej.

c) Të zbritunit e gradës.

d) Pushimi definitiv nga puna.

Neni 61. Dënimet disiplinisht të sipërtregum zbatohen si mbas randësis të veprave të gjyqtarve.

Neni 62. Pranimi i miqve në zyrë asht i ndaluëm. Ata gjyqtarë qi veprojnë kundra kësaj dispozite meritojnë ndeshkim disiplinuer.

Neni 63. Ndëshkimet disiplinore shenohen në jetshkrimin e të dënuëmve.

Neni 64. Ata qi degradohen disiplinisht s' kanë të drejtë të marrin shpenzime udhëtimi.

Neni 65. Prokurorat janë të detyruëm të lajmërojnë pa vonesë Ministrin e Drejtësis për fajet disiplinore të lemuna në qarkun e tyne; në qoftë se ata i mungojnë kësaj detyre, dënohen dhe ata si mbas randësis të fajit.

Neni 66. Gjyqtarët janë të detyruëm të mbajnë sekret veprimet e mbrendëshme të zyrës qi nuk rrjedhin botnisht.

Nani 67. Kur nji gjyqtari i prishen prej gjykatës ma të naltë ma tepër se gjysma e shumës absolute të gjykimeve të tija, ose shuma e të prishunave dhe e atyne qi s' kanë posibilitet për eksekutim kalojnë gjysën e shumës të gjykimev, Ministrija e Drejtësis merr masat disiplinore ndaj atij gjyqtari dhe e pushon nga detyra.

Pjesa e VI.

Hierarkia e Giyqtarve

Neni 68. Herarkia e gjyqtarve asht si tregohet ma poshtë :

1) Kryesekretar Nd. Gjyqtar e Gjyqeve Shk. I.;
2) Kryesekretar-Nd. Gjyqtar e Apelit;
3) Ndihmës antarët e Gjyqevet Apelit;
4) Gjyqtarët Hetuesa.
5) Gjyqtarët e Shk. I.;
6) Antarët e Apelit;
7) Prokurorat t' Apelit;
8) Nd. Antari i Diktimit;
9) Kryetarët e Apelit ;
10) Ndihmsi i Kryeprokurorit në kët gradë asht dhe Inspektori i Drejtësisë;
11) Antarët e gjyqit të Diktimit;
12) Kryeprokurori;
13) Kryetarët e gjyqit të Diktimit;

KRYE E V.

Pjesa e I.

Sekretarët

Neni 69. Për t' u emnue Protokolist-kopist në gjyqet e Drejtësis, kandidati me gjith qi duhet ketë cilësit e tregueme në § 1, 3, 5, 6, 7, 8 e 9 të Nenit 44 të kësaj ligje do të ketë mbarumun nji gjymnaz ose nji shkollë qytetse.

Neni 70. Rangu i sekretarëve shkon mbas rrogës së tyne tue dalë deri te Kryesekretari i Gjyqit të Diktimit.

Sekretarët mund të gradohen mbas dy vjet shërbimi.

Neni 71. Në rast t' emnimit e sekretarve preferohen vendasit qi kanë cilësit e caktueme në nenin 69 të kësaj ligje.

Gjithashtu kur nër kandidat të ketë njerës qi kanë mbarue Gjymnazin e të tjerët shkollën qytetse në rasë t' emnimit preferohen të parët.

Neni 72. — Për t' u emnue sekretar në zyrat e Drejtësis kandidati do t' i shtrohet provimit. Provimi do të bahet si mbas nji rregullores të posaçme të Miuistris Drejtësisë.

Pjesa e II.

Përgjegjësija e sekretarve të Zyreve të Drejtësië

Neni 73. Sekretarët si për faje ordinare ashtu dhe për fajet e lemuna nga detyra i shtrohen rregullave të përgjithshëm, kur se shifet nevoja për pushimin e tij nga detyra gjyqi kompetent mundet t' i drejtohet Ministris Drejtësiës për heqjen e tij nga puna.

Neni 74. — Sekretarët ndëshkohen disiplinisht për të gjitha ato shkaqe qi si mbas këtij ligji ndëshkohen dhe gjyqtarët.

Mos kujdesimi i sekretarëve në detyrat e veta shkakton ndëshkim disiplinuer.

Ndëshkimi disiplinuer i sekretarve caktohet nga Ministrija e Drejtësiës.

Nene të ndryshme

Neni 75. — Gjykatat fetare për çashtjet gjyqësore janë nën kontrollim të Ministris Drejtësiës.

Neni 76. — Nji nëpunës i Drejtësis kur jepë dorëhekjen nuk mund të lanë shërbimin me atë çast, por asht i detyruem të presi pranimin e dorëheqjes deri në nji muaj.

Nenet e posaçme

Neni 77. — Komisioni i posaçëm për zgjedhjen e nëpunsave të drejtësis i cili përbahet prej Ministrit Drejtësisë, Kryetarve të Diktimit Kryeprokurorit dhe sekretarit të Përgjithshëm të Ministris Drejtësis, asht i detyruar qi mbrenda 3 muejve mbas shpalljes të kësaj ligje me caktue të gjith ata gjyqtarë qi gëzojnë të drejtat e pa tundshme

Afati i përmendun zgjatet deri për gjasht muej për ata Gjyqtarë të cilët mbas kësaj ligje kan me ju shtrue provimit.

Neni 78. — Në rast të nevojës domosdoshme gjytarët munden me u emnue vendas.

Neni 79. — Në gjykatat e shkallës I. në të cilat nuk asht emnue ndihmës gjykatës deri sa t' emnohen në mungesë të gjykatësve zavendësohen prej sekretarit.

Neni 80. — Ligjat e Organizimit të gjyqeve të Drejtësis të shpalluna deri tash lehen pa fuqi.

Neni 81. — Kjo ligjë hyn në fuqi 15 dit mbas shpalljes në Fletoren zyrtare.

Neni 82. — Ministrija e Drejtesisë ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Tiranë, mè 2 Maj 1925. *Kryetari i Republikës*
A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Mnistri i P. Botore e Bulqësis
K. KOTTA

Min. i P. të Mbrëndëshme
CENO

Nr. 38.

DEKRET-LIGJË 9 Maj 1925.

Mbi kërkim merkuri (zhivë) në prefekturat Shkodër-Krumë e Peshkopi

(e botueue në Fletoren Zyrtare 11 Maj 1925, Nr. 19)

1) I epet afat (option) nji vjetë z. H. A. Gotlieb me kërkuë mërkur (zhivë) në Prefekturat, Shkodër, Krumë, Peshkopië.

2) Mbrenda këti afatit z. H. A. Gottlieb detyrohet me ba studimet e hetimet në Prefekturat e nalt-përmenduna mbi kët mineral dhe me paraqitë kërkesë të rregullëshme, për konçesjon në Ministri të P. Botore e Bulqësiës.

3) Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

4) Ministria e Punve Botore e Bulqësis ngarkohet me zbatimin e kti dekret ligji.

Tiranë, me 9-V-1925 *Kryetari i Republikës*
A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Dreitësis
P. POGA

Ministri i P. Botore B.
e Zav. M. i P. të Mbrendëshme
K. KOTTA

Nr. 39.

DEKRET-LIGJË, 9 Maj 1925.

Mbi ngritjen e Gjyqit Ushtarak të Shkodrës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Maj 1925, Nr. 19)

Mbasi u pa vendimi Nr. 223 datë 28-4-1925 i Këshillit Ministruër.

DEKRETOJMË:

1. Ngrihet Gjyqi Ushtarak i Shkodrës formuem në bazë të dekret-ligjës me d. 17-11-1925.
2. Kjo dekret-ligjë hyn në fuqi qysh nga data e dekretimit.
3. Ministria e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj dekret-ligje.

Kryetar' i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Mbrendëshme
CENA KRYEZIU

BKSH

Gjendja e parapame e shpenzimevet
të
MINISTRIS SË FINANCAVET
për ushtrimin financjar prej 1-IV-1925 — 31-III-1926

Kap.	EMERTIM		Kompetenca për ushtrimin financjar 1925-1926 Fr. ar
	Titull' i I. Shpenzime të rendëshme		
	Katheg. e I. Shpenzime efektive		
	Ngarkime të Shtetit		
1	Rrogë jetike.	*(a)*	39.860
			39 860
	Kryesi e Republikës		
2	Shpenz. të përgjith. të Kryesis së Republikës	*(b)*	246.800
			246 800
	Senati		
3	Shpenzime të përgjithshme të Senatit . . .	*(c)*	195.000
			195 000
	Këshilli i Kombit		
4	Shpenz. të përgjith. të Këshillit të Kombit .	*(ç)*	416.840
			416.840
	Kryesi e Këshillit Ministruer		
5	Personali — Rrogë		16.560
6	Shpenxime Zyrje	*(d)*	2.440
			19.000
	Ministri e Financavet		
7	Personali — Rrogë	*(a)*	114.360
8	Ministrija — Shpenzime Zyre		48.400
9	Qira		7.296
10	Udhtim e djete.		7.000
11	Kremtime		300
12	Shpenzime gjyqi		2.000
13	Shpenzime transporti (Instalacjon)		200
14	Të pa parapame		2.000
15	Veshë e mbathë shërbëtorësh		1.000
16	Fond reservë		2.720
			185.276

BKSH

Kap.	EMERTIM		Kompetenca për ushtrimin financjar 1925-1926 Fr. ar
	Administrimi qarkuer		
17	Personali administruer i Intendancave financjare – Rrogë.		596.640
18	Shpenzime Zyre	(b)	11.200
19	Qira.		11.300
20	Udhtim e djete.		4.000
21	Shpenzime gjyqi		17.840
22	Shpenzime për vërtetim të taksave	(c)	20.000
23	Mirëmbajtje e pasunis së Shtetit		12.000
24	Shpenzime për dërgesë të hollash		1.500
25	Shpenzime transporti (Instalacjon)		1.000
			675.480
	Administrimi doganuer		
26	Personali – Rrogë		224.640
27	Shpenzime Zyre	(a)	5.000
28	Qirà		9.550
29	Udhtim e djete		3.000
30	Dërgesa të hollash		1.000
			143.190
	Administrim i Monopoleve		
	Krypë, shkrepsa, letra cingaresh, letra loje.		
31	Personali – Rrogë		pro memoria
32	Shpenzime Zyre	(b)	1.490
33	Qirà		15.000
34	Udhtim e djete		600
35	Agio 5% mbi të shitunit e pullave		7.200
36	Shpenzime për nxjerrje e bartje krype. . .		494.000
			518.290

Titull' i II. Shpenzime të parendëshme

Katheg. e I. Shpenzime efektive

Administrimi qendruer

Kap.	EMERTIM	Fr. ar
37	Rrogë e Komisjonit Kontrollues	8.700
38	Dam arke.	5.000
39	Përkthim ligjesh e rregulloresh	1.000
		14.700

BKSH

Kap.	EMERTIM	Kompetenca për ushtrimin financjar 1925-1926 Fr. ar
	Administrimi qarkuer	
40	Dam arke	5.000
41	Rregjistrim ndërtesash	20.000
42	Kthim taksash	4.000
43	Blemje pasunije e ngrefje ndërtesash . . .	15.000
		44.000
	Administrimi doganuer	
44	Kthim tagresh	10.000
45	Dam arke	3.000
		13.000
	Administrimi i Monopoleve	
46	Rrogë për nëpunësa të përkohëshëm . . .	12.000
47	Shpenzime për pulla	pro memoria
		12.000
	Të shuemit e Kreditavet	
48	Pagesë e detyrave të ndryshme të vjetve të kaluem, të pa parapame	10.000
		10.000

PËRMBLEDHJE E TITUJVE

Titull' i I. Shpenzime të rendëshme

Kath. e I. Shpenzime efektive

Ngarkime të Shtetit — Detyrë e përjetëshme	39.860
Kryesi e Republikës.	246.800
Senati	195.000
Këshilli i Kombit	416.840
Kryesi e Këshillit Ministruer.	19.000
Ministri e Financave.	185.276
Administrimi qarkuer	675.480
Administrimi doganuer.	243.190
Administrimi i monopoleve	518.290
	2.539.736

Titull' i II. Shpenzime të parendëshme

Katheg. e I. Shpenzime efektive

Shpenzime për qendër	14.700
Administrimi qarkuer	44.000
për t' u bartun	58.700

Kap.	EMERTIM	Kompetenca për ushtrimin financjar 1925-1926 Fr. ar
	të bartuna	58.700
	Administrimi doganuer.	13.000
	Administrimi i monopoleve	12.000
	Të shuemit e kreditavet	10.000
	Shum' e përgjithshme e Kath. I. (pjesës së parend.)	93.700
	Shum' e përgjithshme e shpenzimeve reale (të rendëshme e të parendëshme)	2.633.436

PËRMBLEDHJA E KATEGORIVE

Kath. I. Shpenz. efek. (të rendshme e të paredshme)		2.633.436
	Shum' e përgjithëshme	2 633.436

Kap. I. Rrogë jetike

Art. 1.	Xhamija e Madhe e Korçës	Fr. ari	12.480
„ 2.	Familja e Alltunve.	Fr. ari	12.100
„ 3.	Xhidiqet	Fr. ari	15.280
		Fr. ari	39.860

Kap. 2. Kryesi e Republikës

Art. 1.	Rrogë e Kryetarit.	Fr. ari	120.000
„ 2.	Rrogë e indemnitet personali. . . .	Fr. ari	21.600
„ 3.	Shpenzime Pallati.	Fr. ari	36.000
„ 4.	Qira.	Fr. ari	7.200
„ 5.	Mobilje	Fr. ari	50 000
„ 6.	Automobil.	Fr. ari	12.000
		Fr. ari.	246.800

Kap. 3, Shpenz. të përgjith. të Senatit

Art. 1.	Parija e Trupi i Senatorve	Fr. ari	115.800
„ 2.	Personali – Rrogë.	Fr. ari	37.200
„ 3.	Shkresinë.	Fr. ari	1.000
„ 4.	Zjarm e dritë	Fr. ari	1.000
„ 5.	Mobilje	Fr. ari	10 000
„ 6.	Shtypshkrime	Fr. ari	15.000
„ 7.	Mirëmbajtje Zyre.	Fr. ari	1.000
„ 8.	Shpenzime udhtimi	Fr. ari	8.000
„ 9.	Qira.	Fr. ari	5.000
„ 10.	Petka sherbtorësh.	Fr. ari	1.000
		Fr. ari	195.000

BKSH

Kap. 4. Shpenz. të përgjith. të Këshillit të Kombit

Art.	1. Parija e Trupi Legjislativ.	Fr. ari	311.600
„	2. Personali – Rrogë.	Fr. ari	42.240
„	3. Shkresinë.	Fr. ari	15.000
„	4. Zjarm e dritë	Fr. ari	1.000
„	5. Të vogla	Fr. ari	1.000
„	6. Shtypshkrime	Fr. ari	15.000
„	7. Qira.	Fr. ari	9.000
„	8. Mirëmbajtje Zyre	Fr. ari	1.000
„	9. Bibliothekë	Fr. ari	5.000
„	10. Udhtim djetë.	Fr. ari	15.000
„	11. Petka policije e sherbtorësh. . . .	Fr. ari	1.000
		Fr. ari	416.840

Kap. 6. Shpenz. Zyre të Kryesis së K. Ministruer

Art.	1. Shkresinë	Fr. ari	400
„	2. Zjarm e dritë	Fr. ari	200
„	3. Mobilje	Fr. ari	400
„	4. Qira	Fr. ari	1.200
„	5. Veshë e mbathë shërbëtorësh . . .	Fr. ari	240
		Fr. ari	2.440

Kap. 8. Shpenz. Zyre të Min. së Financavet

Art.	1. Shkresinë	Fr. ari	2.000
„	2. Zjarm e dritë	Fr. ari	1.000
„	3. Mobilje	Fr. ari	1.000
„	4. Të vogla	Fr. ari	500
„	5. Blemje librash e të përkohshme. . .	Fr. ari	500
„	6. Shtypshkrime.	Fr. ari	43.400
		Fr. ari	48.400

Kap. 18. Shpenz. Zyre

Art.	1. Shkresinë.	Fr. ari	4.600
„	2. Zjarmë e dritë	Fr. ari	3.600
„	3. Mobilje	Fr. ari	2.000
„	4. Të vogla	Fr. ari	1.000
		Fr. ar	11.100

BKSH

Kap. 22. Shpenz. për vertetim të taksave

Art.	1. Të dheta	Fr. ari	10.000
„	2. Xhelep	Fr. ari	1.500
„	3. Taksë rruge	Fr. ari	500
„	4. Patentë	Fr. ari	500
„	5. Taksa tjera	Fr. ari	7.500
		Fr. ari	20.000

Kap. 27. Shpenz. Zyre

Art.	1. Shkresinë	Fr. ari	1.300
„	2. Zjarm e dritë	Fr. ari	2.500
„	3. Mobilje	Fr. ari	600
„	4. Të vogla	Fr. ari	600
		Fr. ari	5.000

Kap. 32. Shpenz. Zyre

Art.	1. Shkresinë	Fr. ari	180
„	2. Zjarm e dritë	Fr. ari	360
„	3. Mobilje	Fr. ari	800
„	4. Të vogla	Fr. ari	150
		Fr. ari	1.490

BKSH

Gjendja e parapame e shpenzimevet

të

MINISTRIS SË DREJTËSIS

për ushtrimin financjar 1925-1926

Kap.	EMERTIM		Kompetenca për ushtrimin financjar 1925-1926 Fr. ar
	Titull' i I. Shpenzime të rendëshme		
	Kath. e I. Shpenzime efektive		
	Shpenzime për administrimin qendruer		
1	Ministrija – Personali – Rrogë		33.480
2	Shpenzime Zyre (shkresori, zjarm e dritë mobilje, shtypshkrime, bibliothekë, të vogla, paparapame)	(a)	18.600
3	Qirà		2.000
4	Kremtime		100
5	Mirëmbajtje Zyre		2.000
6	Veshë e mbathë shërbëtorësh		300
7	Udhtim e djete		1.500
8	Fond reservë		29.900
			80.880
	Shpenzime për administrimin e Gjykatave		
9	Magistraturë Gjykatse – Personali – Rrogë	(b)	617.240
10	Shpenzime zyre (shkresinë, zjarm e dritë, mobilje, shtypshkrime, të vogla, bibliothekë, të pa-parapame	(c)	15.810
11	Qira		20.380
12	Mirë mbajtje zyrash		pro memoria
13	Udhtim e djete	(ç)	36.590
14	Shpërblim avoketënvet si gjyqtar		1.500
15	Instalacion		pro memoria
			691.520
	Titull' i II. Shpenzime të pa-rendëshme		
	Kath. e I. Shpenzime efektive		
	Shpenzime të përgjithëshme		
16	Rrogë për nëpunsa të pezulluem		pro memoria
17	Përkthim ligjesh e rregulloresh		1.000
		për t' u bartun	1.000

BKSH

Kap.	E M E R T I M	Kompetenca për ushtrimin financjar 1925-1926 Fr. ar
	të bartuna	1.000
18	Shpenzime për Organizatorë.	26 600
19	Ndihmë për Gjyqin e Sherjatit.	100.000
		127.600

PËRMBLEDJE E TITUJVE

Titull' i I. Shpenzime të rendëshme

Kath. e I. Shpenzime efektive

Shpenzime për administrimin qendruer. . .	80.880
Shpenzime për administrimin e gjykatës . .	691.520
Shum' e përgj. e Kat. I. (pjesës së rendshme)	772 400

Titull' i II. Shpenzime të pa-rendëshme

Kath. e I. Shpenzime efektive

Shpenzime të përgjithshme	127.600
Shum' e përgjith. e Kat. I. (pjesës së pa rend.)	127 600
Shum' e përgjithëshme e shpenzimeve reale (të rendëshme e të pa rendëshme)	900.000

PËRMBLEDHJE E KATEGORIVE

Katheg. e I. Shpenzime efektive

(të rendëshme e të pa rendëshme)	900.000
Shum' e përgjithëshme	900.000

a) Art.	1. Shkresinë	Fr. ari	800
„	2. Zjarm e dritë	Fr. ari	600
„	3. Mobilje	Fr. ari	7.000
„	4. Shtypshkrime	Fr. ari	8.000
„	5. Bibliothekë	Fr. ari	1.000
„	6. Të vogla	Fr. ari	200
„	7. Të pa parapame , ...	Fr. ari	1.000
		Fr. ari	18.600

BKSH

b) Art.	1. Rrogë	Fr. ari	614.940
„	2. Rrogë zëvendsije	Fr. ari	2.300
		Fr. ari	617.240
c) Art.	1. Shkresinë	Fr. ari	10.620
Me gjithë këtë, Qeveris italiane i u deshtë, mâ vonë, me konstatue se, artikulli i naltëpërmendun i kishte dhanë e mund t' i kishte dhanë shkak disa interpretimevet jo ekzakte ose artificjoze e të tilla sa me shnatyruëm plotësisht shpirtin e domethanjen e artikullit në fjalë.

Tue pamun, nga tjetra anë se, parimet të cilat artikulli vetë ishte nji konfermim i ri, janë mjaftësisht të garantuëme prej përgjithësis së tekstit të Traktatit të përmendun e prej disave të këtyne nyjevet, Qeverija italiane ka marrë vendimin me u shmangë, nga ana e sajë, t' aplikojë artikullin 10 të Traktatit të Tregtis dhe të Lundrimit italo shqyptarë e, tue marrun para syësh sa u tha ma parë, i proponon Qeveris shqyëtare qi, njisojit t' i shmanget nga ana e vetë.

Pëlqeni, Z. Ministrë, sigurimet e konsideracjonit t' em të naltë.

Ministri i Italis DURAZZO

Shkëlqesiës së Tij
MUFID BEY LIBOHOVA
Zav. Ministrë i P. të Jashtme

Tiranë

Ministrija e P. të Jashtme e Shqypënis
Nr.

TIRANË, me 6 Mars 1925.

Z. Ministrë,

Me notën e Juej të sotshme Nr. 282, keni pasun mirësinë me më lajmue se, Qeverija italiane kishte vendosun m' u shmangë prej aplikimit t' Art. 10 të Traktatit të Tregtis e të Lundrimit në mes t 'Italis dhe të Shqypënis, i parashtruëm në Romë me 20 Kallnduer 1924.

Tue më spjegue ersyënat e këtij vendimi, Ju keni tërhjekun vërrejtjen t' ime mbi ç' ka artikulli i naltëpërmendun, si ç' e ver-

tetojnë procces-verbalet e bisedimevet në mest të dy Dergatavet, kishte për qëllim, vetun të konfirmojë parimet e portës së hapun, si ndaj tratamentin e kombit ma të favorizuem e të konkurencës së lirë të gjytetasve italianë e shqyptarë në Shqypëni dhe n' Itali. Shkëlqesa e Juëj shtonte edhe se, për me larguëm ç' do vështirsi, qi mund të dalin prej interpretimeve artificjoze ose të padrejta të cilat mund t'i kishte a se do t'i kishte shkaktuëm nërkuptimi i këtij artikulli, e, tue konsideruëm, nga tjetra anë, se parimet e naltëpërmenduna janë mjaftësisht të garantuëme prej përgjithësis së tekstit të Traktatit si edhe nga disa dispozita të veçanta të tij, Qeverija Italjane i propononte Qeveris Shqiptare m' u shmangë edhe këjo, nga ana e sajë, nga aplikimi i artikullit në fjalë.

Kam nderin të Ju deklarojë se Qeverija Shqiptare, tue njoftun plotësisht bazën e mirë të këtyne konsideratavet, shpejtohet të pranojë proponimin e Qeveris Italiane dhe shmanget njisojit, nga ana e sajë, prej aplikimit të artikullit 10 të Traktatit të Tregtis e të Lundrimit në mest t' Italis dhe të Shqipnis, i përfunduëm në Romë me 20 Kallnduër 1924.

Pëlqeni, z. Ministrë, sigurimet e konsideracjonit t'em të naltë.

Zav. Ministri i P. të Jashtme
MUFID BEY LIBOHOVA

Shkëlqesës së Tij
MARKEZE CARLO DURAZZO
Ministrë i M. T. Mbretit t' Italis
Durrës

Traktat tregtije e lundrimi në mes të Shqipnis e t' Italis

Këshilli i Naltë i Regjencës së Shqipnis e Madhnija e Tij Mbreti i Italis t' amëshuëm prej nji dishiri të njinjishëm për të shtrënguëm lidhjet miqësore e për të shvilluëm marrëdhanëjet tregëtare e detare në mes të dy vendevet të tyne, kanë da me përbamë nji traktat tregëtije e lundrimi e, për këtë qëllim, kanë shenuëm për Fuqiplotë të tyne, për t' u dijtun.

Këshilli i Naltë i Regjencës së Shqipnis :

Shkëlqesën e Tij z. Kolë Thaçi, Ministri i Financavet, Shkëlqesën e Tij z. Fejzi Bey Alizoti, ish Ministër i Financavet.

Madhënija e Tij Mbreti i Italis :

Shkëlqesën e Tij Benito Mussolini Kryeministër, Ministër i Mbrendëshëm e zav. Ministër i P. të Jashtme, të cilët, mbas qi ndërruëne fuqitë e plota të tyne, të gjetuna në formën e pëlqyëme e të duhun, u morën vesht për artikujt qi vijojnë:

Art. 1. – Ka për të qenë liri tregtije e lundrimi krejtë e plotë në mes të shtetasve të Mbretnis s'Italis e t'atynevet të Shtetit të Shqipnis.

Shtetasit shqiptar n' Itali e shtetasit italian në Shqipni, t'jetë qi ato të vendosen nër limane, qytete ase në shfardo vendesh të tjerë të tokavet respektive, t' jetë qi ato të banojnë përkohësisht, kanë për të mujt me ushtrue tregëtin e industrin e tyne, pa qenë të detyruëm të paguëjnë të drejta, vergjina, taksë ase patenta, nënë shfardo titulla qi t' jenë, e të tjera as ma shumë se ato qi do t' i mirren bashkëkombëtarëvet ase shtetasvet të Kombit ma të favorizuëm, e të drejtat, privilegjet imunitetet e ç' do tjetër lehtësi t' jetë, qi kanë për të qenë të gëzuëm, për sa i përket tregëtis ase industris, nga shtetasit e njanës anë kontraktuëse, kanë për të qenë të njinjishme për shtetasit e të tjetrës anë.

Shtetasit e të njanës prej të dy palëvet kontraktuëse qi ushtrojnë nër vendet e tyne nji industri ose tregti, kanë me pasuu të drejtën personale ose me anë t' udhëtarëvet në shërbimin e tyne të blejnë mallna në vendin e së tjetrës anë kontraktuese, të bajnë porosina tregëtare, kështu edhe mbi mostrat, pa lanun për këto nji taksë të veçantë ma të naltë nga ajo e kombëtarëvet ose të shtetasvet të kombit ma të favorizuëm. N' ushtrimin e aktivitetit të tyne mbi vendet e të tjetrës anë kontraktuëse, kanë për të gzuëm, prej anës s' administratavet e të shërbimevet publike nji lloj tratamenti me kombëtarët ose të shtetasvet të Kombit ma të favorizuëm.

Art. 2. Anët kontraktuëse garantohen përshoqënisht (reciproquement), për sa i përket importimit eksportimit dhe transititit për të drejtat e tramentin e Kombit ma të favorizuëm.

Secila prej Anëvet kontraktuese pengohet, pra, m' e bamun të tjetrën që të përfitojë, gratis e përnjiherë mbi të gjitha privilegjet e favoret, të cilat, me kushtet e naltëpërmenduna, ajo i ka dhanë ose do t' i nepte nji së tretës Fuqi, pikërisht për sa i përket shumës, garancis dhe të marrunit e të drejtavet të caktuëme ose jo në këtë traktat, magazive të depove të doganavet (i përmbrendësuëm regjimi përkatës hymjen, daljen e rruëjtjen

e mallnavet nër skelet franke (ports francs), pikët franke (points francs) ose nër magazët e përgjithëshme), taksave të mbrendëshme, formaliteteve e tratamentit t' ekspedicjonevet në doganë dhe të drejtave të taksavet indirekte ose të prishunit (consommation) qi merren për llogari të Shtetit, të provincavet, të komunevet (corporations) ose të stabilimentavet.

Janë të përjashtuëm, njiherit favorët qi kanë tashë a se qi mund t' u nepen ma vonë Shteteve të tjerë kufinuës për të lehtësuëm trafikun e kufinit (trafic frontiere), kështu dhe ato qi rrjedhin prej nji bashkimit doganuër të përfunduëm ase qi mund të përfundohet në t' ardhmen prej njanës së Palëvet kontraktuëse.

Art. 3. — Të drejtat e të hymunit në Shqipni mbi produktet origjinere e qi vinë nga Italija, të shënuëme në anneksin (në bashkanjitësën(A të këtij traktati nukë kanë me muëjtë të sypër-kalojnë taksat e shenjuëme në të përmendunin anneksë.

Të drejtat e të hymunit n' Itali mbi produktet origjinere e qi vinë nga Shqipnija, të shenueme në anneksin B. të këtij traktati, nukë kanë me muëjtë të sypër kalojnë taksat e shenjuëme në të përmendunin anneksë.

Art. 4. — Në kjoftë se njanë prej Anëvet kontraktuëse merrë, mbi produktet e të nji vendit të tretë, të drejta ma të nalta nga ato qi aplikohen po mbi ato produkte origjinare e qi vinë prej Anës së tjetër. a se në kjoftë që ajo i nënvenë mallnat e nji vendit të tretë në ndalime ose shtërngime importimi qi nukë janë t' aplikuëshme po mbi ato mallna të së tjetrës Anë kontraktuëse, ajo ashtë e autorizuëme, në rastë që cirkonstancat do t'a dojshin, m' e bamun që, aplikimi i të drejtavet ma të ulta mbi produktet qi vinë prej së tjetrës Anë, a se pranimi i tyne për hyemjen, të mvaret në paraqitjen e certifikatavet t' origjinit.

Certifikatat në fjalë mund të lihen nga autoriteti lokalë i vendit t' eksportimit ose nga zyra doganore dërguëse, si për mbrenda ashtu edhe për kufi, ase nga dhoma e tregtis dhe e industris kompetente, ose nga nji agjent konsulluër.

Anët kontraktuese do të vërejns qi tregtija të mos jetë e penguëme as prej naltësis së taksavet qi merren për këto certifikata, as prej formalitetevet të pa-dobiëshme në kohën e librimit të tyne.

Art. 5. — Mallnat e të ç' do lloji, në transit, kanë për të qenë të lirshme prej ç' do të drejtë tranziti, qoftë qi këto transitojnë drejtë për së drejti, ashtu edhe kuër, në njajtën e tran-

sitit, duhet qi të shgarkohen, të depozitohen e të ringarkohen. Veç kësajë, Anet kontraktuëse pengohen me mos nënvuë transitin në formalitete a se në tjera masa qi tue mos qenë të nevojshme do t' i sjelleshin pengime.

Art. 6. – Me qëllim shdrivillimi të marrëdhanjevet tregtare në mjes të dy Shtetevet, Qeveriët e të dy Palëvet kontraktuëse pengohen, secila për ate qi ashtë në kompetencë të vetën, të napin përkrahjen e tyne për themelimin e dy magazave për depo mbi tokën shqypëtare, njana në Shkodrë, tjetra në Sarandë, në të cilat kanë m' u mujtë të depozitohen mallnat e dërgueme nga Italija në Shqipni, qoftë për konsumacjon për mbrenda Shtetit, qofë për rieksportim, ashtu edhe mallnat shqiptare qi janë për t' u dërguë n' Itali, si për konsumacjon mbrenda Mbretënis, si dhe për rieksportim.

Në rastin e duhur, Qeverit e të dy Palëvet kontraktuëse kanë për të studjuëm, me nji akord të përbashkët, rregullat e konditat mbas të cilavet themelimi i të përmendunavet magazëve për depo ka për të mujtë m' u konçeduë nji shoqënis italiane, ose italo shqiptare, a se nji dhomës tregtare italo-shqiptare ashtu edhe rregullat për t' u ndjekun, nër këto raste, për fonksjonimin po t' atyne magazave për depo.

Art. 7. – Anët kontraktuëse angazhohen qi të mos pengojnë tregtin përshoqënuëse (reciproque) e të dy Vendevet me ndalime ose shtërngime, cilat do qofshin, n' importim, n' eksportim e në transit.

Këjo dispozitë nuk u bjen faret ndonji pengim masavet të ndalimit qi secila prej Anëvet kontraktuëse ka për të qenë e shtërngueme të marrin në rasë të sigurimit të Shtetit ose për shkaqe shëndetësije e në rasë të mbrojtjes së shtazavet ose të drushnjavet të dobishme kundra smundjevet, mizavet (insektes) e parasitavet të damshme, a se kundra monopolëvet të Shtetit, e në rasë t'aplikimit, mbi mallnat e hueja, ndalime ose shtërngime të vendosuna kundrejt produksjonit të përmbrendëshëm të mallnavet me ato të përgjasuëme a se të shitjes ose të transportit përmbrenda të mallnavet qi u gjasojnë atyne të produksjonit kombëtarë.

Art. 8. – Asnji e drejtë e përmbrendëshme e marrun në llogari të Shtetit, t' autoritetevet lokale a se të trupnimevet qi randëson tashë ose në t' ardhmen produksjonin, fabrikacjonin ose konsumacjonin të nji malli, cilido ky qoftë, në tokën e të

njanës prej Anëvet kontraktuëse, nuk ka për të kjenë, për cilin do shkak qoftë, ma e naltë ose ma e randë për mallnat origjinare e qi vinë prej vendevet të së tjetrës Anë, nga e drejta qi merret për mallnat me ato të përgjasuëme e qi produktohen në vende.

Art. 9. – Shoqëniët tregtare e civile (të përmbrendësuëm Institutei private e publikës të sigurimit) qi e kanë ndejën nër vendet e të njanës prej Anëvet kontraktuëse ë qi aty janë vleftësisht të kontitësuëme si mas ligjevet respektive, kanë për të qenë të njoftuna, në konformitet me mënyrat e me kufizimet e caktuëme prej ligjëvèt në fuqi, si kur të kenë qenëje ligjore nër vendet e së tjetrës Anë, kanë për të muëjtë me ushtruë aty aktivitetin e tyne industriale ase tregtare e do të kenë të gjitha të drejtat e tyne, e përmbrendësuëme ajo e paraqitjes nër gjyqe, si për padi ashtu edhe për mbroje.

Gjithësesi, shoqëniët e përmenduna kanë për të gëzuem në vendet e së tjetrës Anë kontraktuëse po ato të drejta, të cilat janë ose kanë për t' i u dhanë shoqënivet, me ato të përgjasuëme, të nji cilit-do vend tjetër.

Shoqënit e Institutet e përmenduna s' kanë për të paguëm për ushtrimin e punëvet tregtare a se industriale në tokën e së tjetrës Anë, vergjina, të drejta ose takse, as të tjera as ma të nalta nga ato qi merren prej kombëtarëvet ose prej shtetasve të kombit ma të favorizuëm.

Art. 10. – Anët kontraktuëse pengohen përshoqënisht të mos konçedojnë monopole, privilegje a se konçesjone të cilët kishin me pasun si përfundim përjashtimin, në përfitim total të njanës ose ma të shumë të Fuqiëve të tretë, shtetasit e së të tjetrës Anë. në të gjithë ç' ka të bajë nji ose ma shumë dege tregtije e industrije.

Për sa u përket konçesjonavet të minavet, të bujqësis e të transportit, asht e akorduëme se konçesjonet qi kanë për t' u mujtë m' u dhanë prej njanës s' Anëvet kontraktuësvet shtetasve e të së tjetrës Anë, nuk kanë për të t'u nënëvuëm konditave ma të randa nga ato qi do t' u ishin vuëm, po për ato konçesione, kombëtarvet e se shtetasvet të Kombit ma të favorizuëm,

Art. 11. – Aniët e të njanës nga të dy Palët kontraktuëse për skelet e së të tjetrës Anë. kanë për të qenë të tratuëme, si në të hymit e në kohë-njatjen e qindrimit t' atyne në skele, ashtu edhe në të dalunit, nji lloji si aniet kombëtare ose aniët

e Kombit ma të favorizuëm, si për sa u përket të drejtavet e të taksavet, cilat do kjofshin natyra dhe emertimi, të nxjerruna në përfitim të Shtetit, të komunëvet, trupnimevet, të nëpunsavet publikë a se të stabilimentavet ashtë dhe për sa u përket vendqindrimit të këtyne aniëvet, ngarkimit e shkarkimit të tyne nër skelet, skelicët, basenët e docks-ët, e përgjithësisht, për të gjitha formalitetet e dispozitat, të cilat do qofshin, në të cilat mund të jenë të shtruëm aniët, ekipazhi (personeli) e ngarkimi i tyne.

Veç kësajë. kanë me kjenë t' aplikuëshme, aniëvet të njanës prej Anëvet kontraktuëse e ngarkimit të tyne, të gjitha favorët qi Ana tjetër kishte me i akorduë ose do t' i a akordonte në t' ardhmën nji Shtetit të tretë për sa u përket tratamentit e ngarkimit t' aniëvet.

Art. 12. – Asnji e drejtë lundrimi ose skelëje nukë do të merret, në skelet e Anëvet kontraktuëse, për aniët e së të tjetrës Anë qindrojnë nër ato, për shkak të nji aksidentit ase për fuqi madhore, por, njiherit, duhet me vërrejtun edhe qi anija të mos merret me asnji veprim tregtije, e qi ajo të mos e zgjasin kohë-qindrimin e sajë në skele përtej kohës së nevojshme.

Në rasë të mbytjes ase të prishjes të nji aniës qi ashtë e Qeveris ose shtetasve të njanës prej Anëvet kontraktuëse në brigjet ose në vëndet e së të tjetrës Anë, jo vetëm qi ka m' i u dhanë naufragëvet ç' do lloji ndihmë e lehtësi, por edhe aniët, pjesat, copat, ênët e të gjitha sendet qi u bajnë pjesë atyne, dokumentat e anis, të gjetuna në breg, ashtu dhe plaçkat e mallnat qi, të hudhuna në det, kanë me u rigjetë, ase çmimi i shitjes së tyne, kanë për të qenë krejt të ridhanuna pronarëvet, mbi kërkesën e tyne ose mbi atë të agjentit të tyne, i autorizuëm si duhet.

Proçedura qi ka për t' u ndjekë në rastet e naltëpërmenduna ashtë e rregulluëme në Konventën Konsullore në mes të dy shtetevet.

Art. 13. – Të gjitha mallnat, cilët-do kjofshin lloja e vendi nga ku ato vinë, të cilavet importimin, eksportimi, transiti e vuëmja në magaze për depo kanë me u bâ në Shtetet e të njanës prej të dy Palëvet kontraktuëse prej aniësh kombëtare, kanë me muëjtë njisojit t' jenë aty t' importuëme, të kalojnë në transit a të depozitohen prej aniëvet e së tjetrës Anë, tuëj gzuëm po ato privilegje, reduksione, favore e rikthime, e pa kjenë të nënvuëme as në të tjera as në mâ të forta të drejta doganore

a takse, as në të tjera a në ma të forta shtërngime nga ato qi janë në fuqi po për ato mallna n' importimin, eksportimin, eksportimin transitin a depozitimin e tyne, prej aniëvet tregtare ase nga aniët e Kombit mâ të favorizuëm.

Art. 14. – Konduktorët e aniëvet e të barkavet qi janë të së njanës nga anët kontraktuëse kanë për të kjenë të lirëshme me lundruë mbi të gjitha rrugët e komunikacionit ujnuër, tuëj gzuëm mbi vëndet e Anëvet kontraktuëse, po ato kondita e tuëj paguë po ato të drejta mbi aniët e mbi ngarkimin e këtyne, qi gëzojnë dhe konduktorët e aniëvet e të barkavet kombëtare ase ato të Kombit mâ të favorizuëm.

Art. 15. – Kombësija e aniëvet ka për të kjenë e konstatuëme si mbas ligjëvet të Shtetit të cilit anija në fjalë banë pjesë.

Çertifikatat e sasi-mbajtjes të lanuna prej njanës t' Anëvet kontraktuëse kanë për të kjenë të mjaftaëshme edhe për në vëndin e së të tjetrës Anë për caktimin e kapacitetit t' aniëvet pa mos kjenë e nevojshme nji kqyrje e dytë e tonazhit.

Tue përjashtuëm rastin e shitjes juridiciare, aniët e të njanës nga Anët kontraktuëse nukë kanë për të muejtë me u kombësuë në të tjetrën Anë pa mos kenun nji deklaratë mbrapamarrjeje të flamurit, e lanun prej autoritetevet të Shtetit të cilit anija banë pjesë.

Art. 16. – Shtetasit e të njanës prej Anevet kontraktuëse kanë për të kjenë të lirë për përdorimin, po mbi ato kondita, e tuëj paguë po ato takse qi janë të caktuëme për kombëtarët, e udhave të mbëdha e të rrugave të tjera, kanaleve, digëve, urë-lundrëve, urëve e urë-tërthurësve, skeleve e vendë-ngarkimeve, shenjave e zjareve shenuëse ujnat e lundryëshme pilotazhit, makarave, peshëve publike e instalacjonëve të tjera, magazave e stabilimentave për rruëjtjen dhe magazinazhin e ngarkimit, aniëve e sendëve të tjera; për sa qi këto stabilimenta a institucjone janë për përdorim publikë, kjofshin t' administruëme nga Shteti, kjofshin nga privatët.

Veç se rregullimeve të veçanta mbi farët e fanalët e mbi pilotazhin, nukë ka për t' u marrë ndonji taksë, për në kjoftë se verevërte nukë ashtë bamun përdorim i këtyne stabilimentavet e institucjonëvet.

Art. 17. – Aniët italiane lejahen me bamun, si tashë, transportin e udhëtarëvet e e të mallnavet prej njanës në të tjetrën skele shqypëtare.

Për sa i përket shgarkimit nër skelët shqypëtare të mallnávet aty të transportuëme nga aniët e shoqënivet të lundrimit ase nga armatorët italianë, dorëzimi i tyne ka për të mujtë me vazhduë të bahet si ashtë tashë, magazavet të doganës.

Art. 18. — Italianët kanë me muëjtë t' ushtrojnë peshkimin nër ujnat vendësore shqypëtare e të konkurrojnë në adjudikatat dhe për peshkimin nër ujnat e mbrendëshme, tuj u konformuë dispozitavet të ligjëvet e të rregullorëvet qi janë në fuqi në vendë.

Art. 19. — Të dy Palët kontraktuëse pengohen të bashkëveprojnë, me mjete konvenabls, për te ndaluëm e dënuëm kontrabandën në mjes të veëndeve të tyne, pikërisht për sa ka të bajë me monopolët e caktuëme ase qi kanë për t' u caktuë nër vëndet e të tjetrët Anë; mji njoftuëm përnjiherit përfaqësusvet konsulluër të së tjetrës Anë konstatimet e hollësinat relative me kontrabandat të cilat kanë me ardhë në dijeni të nëpunsave të tyne; për këtë, m' i u dhanun të gjithë ndihmën ligjore organëvet e së tjetrës Anë kontraktuëse, qi janë të ngarkuëm me vërrejtun : me i ndihmuë e me i u dhanun, me anën e organëvet të financës e të policis, si dhe me anën e autoritetevet lokalë përgjithësisht të gjitha ato informata nga të cilat do të kenë nevojë për ushtrimin e funksjonit të tyne.

Art. 20. — Ky traktat ka për t' u ratifikuëm e ratifikimet kanë m' u shkëmbye në Romë sa mâ shpejtë qi t' jetë e mundun.

Ka për të filluë me pasë fuqi pesëmbëdhjet ditë mbas shkëmbimit të ratifikimevet e ka për të mbetë i zbatuëshëm për njatjen e të tre vjetëve prej ditës së të hymjes në fuqi.

Me gjithë këtë, në kjoftë se nukë denonsohet gjashtë muëj përpara ekspiracjonit të kësaj kohe, ka për të kjenë i zgjatuëm, me përsëritje të prashme, për nji kohë-njatje të pacaktuëm e at-here ka me kjenë i denonsuëshëm në ç' do kohë, tuj mbetun i zbatuëshëm edhe gjashtë muej pas tuj filluëm prej ditës së denonsimit.

Me nji besim të tillë, Fuqiplotësit e kanë nënshkruë dhe i kanë vue timbret e tyne.

I bamun në Romë, në dy kopje, me 20 Kallnduër njimijenandqindenjizetekatër.

BENITO MUSSOLINI KOL THAÇI FEJZI ALIZOTI

Ministri i Punëvet të Jashtme të ngarkuemit me punë i Shqipnis

ROMË, 20 Kallnduër 1924.

Zotni i ngarkuem me Punë,

Për të kjaruemun deklarata e bame prej Delegatës italianë në rrjedhjen e bisedimevet për mbylljen e Traktatit të Tregtis e të Lundrimit në mes t' Italis dhe të Shqipnis, nënshkruem me datën e kësaj dite, për sa i përket rregjimit doganuer në të cilin janë të shkruem disa mallna Shqipëtare në t' importuemit e tyne n' Itali, kam nderin të deklarojë se, për mallnat e shenuëm në listën, këtu të bashkanjitun, Qeverija italiane nuk ka asnji qëllim që të përjashtohen nga pagesa (franchise).

Në rast por që, prej cirkonstancavet tash të pa-parapame, nji modifikim i regjimit të tashëm ka për t' u pa i nevojshëm, për sa u përket mallnavet të naltëpërmendun, Qeverija italiane ka për të marrë akorde me Qeverin shqipëtare me qëllim që edhe importimi n' Itali, po t' atyne mallnavet, qi vijnë nga Shqipënija të mos të damtohen.

Ju lutem qi të keni mirësin me më dhanë sigurimin se Qeverija shqipëtare asht i këti mendimi mbi këtë çashtje.

Pëlqeni, Z. i ngarkuem me punë, sigurimet e Konsideratës s' eme të naltë.

Numri i tarifës italiane	EMERTIMI I MALLNAVET
24	Voë fluturash shtëpiake.
ex 278	Të mbetuna hekri e çeliku: *a)* të ç'do lloje, në pjesë të ç' do dimendsioni, qi dërgohen nëpër fabrikat e shkriësis ose të çeliksis për m' u zi përsëri ose për m' u rishkri, nën vërejtjen e doganavet.
	b) Në copa, në peca fletësh çeliku të kallajisuna, kutina, vaze të vogla e ênë të tjera të përgjasueme me fleta çeliku të kallajisuna, të përdorueme ose të reja qi nuk mund të përdoren, qi dërgohen nëpër shkriësit (usine) për t' i u hjekun kallajin, nën vërrejtjen e doganavet.
	c) Copa të vogla qi dalin prej punimit të hekrit dhe

BKSH

Numuri i tarifës italiane	EMERTIMI I MALLNAVET
	të çelikut (lima, copa të vogla tournazhi, rrethina (écailles, kartë-prerëse (rognures) dhe copa të vogla të përgjasueme.
604 *a)* 1	Druë: komun: të pa-punuëme ose vetun të captuëme me sëpat.
606	Qymyr druni.
885 *a)*	Shqeme: të pa-bluëm.

Ministri i Punëvet të Jashtme të ngarkuemit me punë të Shqipnis

ROMË, 20 Kallnduer 1924.

Zotni I ngarkuem me Punë,

Me nji notë me datë të sotshme, Ju, tuej u mbështetun në deklaratat e bame nga Delegata shqiptare Delegatës italjane në rrjedhjen e bisedimevet për përfundimin e Traktatit të Tregtis e të Lundrimit në mest të Italis dhe të Shqipnis, i nënshkruem me datën e kësajë dite, për sa u përket ndryshimevet qi Qeverija shqiptare ka në mendje m' i sjellun të drejtavet doganore për disa mallna n' importimin e tyne në Shqipni e qi vinë prej Vendevet të pranuëm në tratamentin e kombit ma të favorizuëm, keni pasun mirësin me më komunikue pasqyrën përmbajtëse të mallnavet që kanë për t' i u modifikuem të drejtat si dhe shënimin e të drejtavet të reja respektiye.

Për njiherit, Ju patët mirësin me deklaruë se, të drejta të reja, të cilat kanë me qenë t' aplikuëme mallnavet italian prej datës së të vuëmit në fuqi të Traktatit të Tregtis e të Lundrimit, nuk kanë m' u shtuë në të gjithë kohën e qindrimit po të këtij Traktati.

Në gjegje të këtyne komunikatave kam nderin t' Ju njoftojë se Qeverija italiane mur njoftim.

Pëlqeni, Z. I ngarkuem me Punë, sigurimin e konsideratës s' eme të naltë.

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
43	Pastë ushqyëse të ç' do lloji	kuintal	60
50	Portogale, mandarina, qitra t' ambla	kuintal	30
53 *b)*	Fiqë të thata :		
	1. Për përdorim industrialë	kuintal	15
	2. Të të tjerë	kuintal	70
ex 62	Konservë molla t' artës	kuintal	50
ex 105 *b)*	Venë të tjera (komunë) :		
	1. Në botile (shishe)	kuintal	70
	2. Në fuçijë deri më 12 grade alkool	kuintal	50
	3. Në fuçijë, ma naltë se 12 gradë e deri më 14 gradë alkool	kuintal	80

I ngarkuemi me punë i Shqipnis Ministrit të P. të Jashtme

ROMË, me 20 Kallnduër 1924.

Zotni Minîstër,

Në rrjedhjen e bisedimevet për përfundimin e Traktatit të Tregtis e të Lundrimit në mest të Shqipnis e t' Italis, i nënshkruëm më datën e kësajë dite, delegata shqiptare ka pasun nderin m' i komunikue delegatës italiane se Qeverija Shqiptare ka mendim të ndrrojë të drejtat doganore për disa mallna n'importimin e tyne në Shqipni e qi vinë prej vendevet të pranuëm me tratament të kombit ma të favorizuëm.

Tash, kam nderin me i adresuëm Shkëlqesës s' Uej, këtu të bashkanjitun, në konformitet me instruksjonet e marruna prej Qeveris s' eme, pasqyrën përmbajtëse të mallnavet, të cilave kanë për t' i u ndryshuëm të drejtat doganore si dhe shenimi i të drejtave të reja rispektive.

Njikohësisht, instruksjonet e mija më vejnë në pozitë të deklarojë se, të drejtat e reja, qi kanë m' i u aplikuë mallnavet italiane prej datës së të vuëmit në fuqi të Traktatit të Tregtis e të Lundrimit, nuk kanë m' u shtuë në të gjithë kohën vazhdimin po të këtij Traktati.

Pëlqeni, z. Ministër, sigurimet e konsideracjonit t'em të naltë.

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
43	Pastë ushqyëse të ç'do lloje	Kuintal	60
50	Portogale, mandarina, qitra të ambëla	Kuintal	30
53	*b)* Fiqë të thata:		
	1. Për përdorim industrialë . .	Kuintal	15
	2. Të tjerë	Kuintal	70
ex. 62	Konservë molla t' artash . . .	Kuintal	60
ex. 105	*b)* Venë të tjerë (komunë):		
	1. Në botile (shishe)	Kuintal	70
	2. Në fuçijë deri në 12 gradë alkool.	Kuintal	50
	3. Në fuçijë ma naltë se 12 gradë e deri më 14 gratë alkool	Kuintal	80

I ngarkuemi me punë i Shqipnis Ministrit të P. të Jashtme

ROMË, me 20 Kallnduër 1924.

Zotni Ministër,

Për të kjaruëmun deklaratat e bame prej delegatës italiane në rrjedhjen e bisedimevet për përfundimin e Traktatit të Tregtis e të Lundrimit në mest të Shqipnis dhe t' Italis, i nënshkruëm me datën e kësajë dite, mbi çështjen e regjimit doganuër në të cilin janë të nënvuëme disa mallëna shqiptare n' importimin e tyne në Itali, Shkëlqesa e Juëj pata mirësin me më deklaruë, me nji notë të sotshme, se, për sa u përket mallnavet të shenuëm në listën e bashkanjitun, Qeverija italiane nuk ka mendim me suprimuëm pagesën (franchive).

Shkëlqesa e Juuej patë mirësin të shtojë se, në rast qi, prej rastavet tash të paparapame, do t' u shifte i nevojshëm nji ndrrim i regjimit të tashëm për sa u përket mallnavet të naltëpërmenduna, Qeverija italiane ka për të hyëm në marrëveshtje me Qeverin shqiptare me qëllim që importimi n' Itali po t' atyne mallnavet që vijnë prej Shqipnije të mos të damtohen.

Tue marrun njoftim prej këtyne deklaratavet, kam nderin me e sigurue Shkëlqesën e Juëj se, Qeverija shqiptare ashtë plotësisht n' akord mbi këtë çashtje.

Pëlqeni. z. Ministër, sigurimet e konsideracjonit t'em të naltë.

Numuri i tarifës italiane	EMERTIMI I MALLNAVET
24	Voë fluturakësh shtëpiake.
ex 278	Të mbetuna (copa) hekri e çeliku :
a)	Të ç' do lloje, në copa të ç' do dimensjoni, qi dërgohen nëpër shkriësit ose nëpër çeliksit për t' u zi përsëri ose për t' u rishkri, nënë vërrejtjen e doganavet.
b)	Në copa, në peca fletash të kallajisuna, kutiëna, vaze të vogla e ênë të tjera të përgjasuëme me fleta të kallajisuna, të përdoruëme ose të reja qi nuk përdoren, qi dërgohen nëpër shkriësit për m'i u hjek kallajin, nënë vërrejtjen e doganavet.
c)	Copa të vogla qi dalin prej punimit të hekrit e të çelikut (lima, copa të vogla turnaxhi, rrethina (écailles), kartëprerëse (rognures) e copa të tjera të gjasuëme).
604 *a)* 1	Druë : komunë : i pa-punuem ose vetëm i coptuem me sëpatë.
606	Qymyr druni.
785 *a)*	Shemik (sumac): i pa-bluëm.

PROTOKOLE

Na të nënshkruemit e sipërm të Traktatit të Tregtis e të Lundrimit në mest të Shqipnis e t' Italis, i nënshkruem me datën e kësaj dite, Fuqiplotasit e poshtëshenuem erdhnë në marrëveshtje për deklaratën qi vijon :

Qeverija shqiptare pengohet me hyëm në bisedim me Qeverin italiane për me caktuëm, në nji shumë fikse të përvjetshme, totalin e taksës qi do të paguhet nga aniet italiane, të cilat ndjekin në Shqipni udhëtime të rregullshme lundrimi të subvencjonuëme prej Qeveris italiane, cilido kjoftë numri i udhtimevet e i itinerarëvet, në vende të taksavet qi janë sot në fuqi në skelet shqiptare, d. m. th. të drejta shëndetësije, qindrimi në skel, fari ose të tjera taksa qi ndoshta mund të caktohen në t' ardhmen.

Me nji besim të tillë, kanë nënshkruem këtë protokolë.

I bamun në Romë, në kopje authentike të dyfishme me 20 Kallnduer njimijë e nandë qind e njizet e katër.

BKSH

Tarifa e të drejtave e të hyemit në Shqipni

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
34	Rriz	Kuintal	8
37	Semolinë.	Kuintal	15
ex 46	Peksimeta e biskota të tjera .	Kuintal	70
47	Biskota të sheqeruëme e produkte me këto të gjasëshme cilsije të parë.	Kuintal	100
51	Limona	Kuintal	6
ex 57	Bajama		
b)	Të thata	Kuintal	25
c)	Pa livoçkë	Kuintal	40
ex 75	Çokolat e kakao në pluhun . .	Kuintal	100
98	Birrë :		
a)	Në fuçijë.	Kuintal	20
b)	Në botile (shishe)	Kuintal	30
102	Fërnet	Kuintal	120
ex 103	Likuore, të sheqeruëme ase me erna (aromatiques) e pije të tjera alkoolike (i përjashtuem Maraskino-a)	Kuintal	160
ex 103	Maraskino (liqueur)	Kuintal	100
ex 105 *c)*	Vermuth, Marsalë e venë të tjerë italiane me këto të gjasëshme:		
	1. Në fuçijë	Kuintal	80
	2. Në botile	Kuintal	100
106	Venë kinkine (quinquina) e përmbrendësueme vena Serravallo	Kuintal	20
108	Ujna minerale të ç' do lloje . .	Kuintal	5
110	Akull e borrë	Kuintal	3
	Ad. 110. Akulli e borra t'importuëm me qëllim konservacjoni të peshkut janë të përjashtuëm		
118	Voj recini	Kuintal	5
ex 138	Lëkurë të tannuëme (tannées e të punueme :		
a)	Në sholla (a semelles)		
	1. të preme	Kuintal	20

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
	2. copa të vogla (déchets)	kuintal	30
	3. ordinare	kuintal	35
	4. sholla për kundra	kuintal	60
	b) viçi, vaketë	kuintal	80
153	Sende drunit trashësisht të punueme.	kuintal	25
155	Thuma drunit (Clous en bois)	kuintal	15
ex 157	Mobilje prej drunit semplë (ordinare		
	a) semple, prej druni ordinarë	kuintal	35
ex 106	Liege (fr. në tapë e në sholla	kuintal	40
170	Letre emballage-i (me mbështjellë pako, etj.)		
	a) e trashë	kuintal	3
	b) e hollë	kuintal	5
175	Letrë për me shkrue: . . .		
	a) ordinare.	kuintal	6
	b) prej cillsije t' epërme . . .	kuintal	10
181	Zarfe prej letret, të ç' do lloji		
	a) në kutiëna	kuintal	25
	b) pa kutiëna	kuintal	35
183	Zarfe, të tjerë.	kuintal	25
187	Letrë emballag-i, të bardhë	kuintal	5
201	Sende në letrë a se në kore (carton) jo të përmenduna:		
	a) në letre t' argjentit, të mundafshit, t' arit.	kuintal	200
	b) në letrë metali të pa vleftë	kuintal	150
	c) prej cilsinesh të tjerë. . .	kuintal	90
ex 204	Bambazhë e pambuk hydrofile.	kuintal	30
205	Pambuk në fije i pa-gërshetuëm:		
	a) natyrel	kuintal	30
	b) i bardhë	kuintal	35
	c) në gjyrë	kuintal	45
206	Pambuk në fije të gërshetueme:		
	a) pambuk i pa-punuëm (ecru):		
	1. prej Nr. 4 e deri më 24 . .	kuintal	40

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
	2. prej Nr. 26 e deri më 32	kuintal	50
	3. prej Nr. 34 e ma naltë	kuintal	60
	b) pambuk i bardhë :		
	1. prej Nr. 4 e deri më 24	kuintal	50
	2. prej Nr. 28 e deri më 32	kuintal	60
	3. prej Nr. 34 e deri më 42	kuintal	70
	4. prej Nr. 60 e ma naltë .	kutntal	90
207	Fije pambuku përgjithësisht (në rëkele, në çikrikë (pelotes). të mbështjelluna (echeveaux).	kuintal	40
	Ad. 207, Për fijet në rekele rrëxohen 10% nga e drejta		
ex 208	Shiritë, tentelë (soutaches, kordonë pambuku	kuintal	120
ex 208	Lidhësa kundërash	kuintal	60
210	Cohë pambuku i pa punuem, e peshueme me 100 m²		
	a) deri më 3 Klg.	kuintal	100
	b) prej 3 e deri më 4 Klg. . .	kuintal	90
	c) prej 4 e deri më 6 Kgl. . .	kuintal	85
	ç) prej 6 e deri më 7 Klg. . .	kuintal	75
	d) prej 7 e deri më 9 Klg. . .	kuintal	65
	dh) prej 9 e deri më 11 Klg. . .	kuintal	50
	e) prej 11 e deri më 13 Klg. . .	kuintal	40
	f) ma shumë se 13 Klg. . . .	kuintal	35
211	Cohë pambuku të bardhë, e peshuëme me 100 m²		
	a) deri më 3 Klg.	kuintal	325
	b) prej 3 e deri më 4 Klg. . .	kuintal	275
	c) prej 4 e deri më 6 Klg. . .	kvintal	200
	ç) prej 6 e deri më 7 Klg. . .	kuintal	180
	d) prej 7 e deri më 9 Klg. . .	kuintal	150
	dh) prej 9 e deri më 11 Klg. . .	kuintal	100
	e) prej 11 e deri më 13 Klg. . .	kuintal	80
	f) ma shumë se 13 Klg. . .	kuintal	65

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
212	Cohë pambuku me vizatime, e peshueme më 100 m^2		
a)	deri më 3 Klg.	kuintal	350
b)	prej 3 e deri më 4 klg.	kuintal	280
c)	prej 4 e deri më 6 klg. . . .	kuintal	230
ç)	prej 6 e deri më 7 klg. . . .	kuintal	200
d)	prej 7 e deri më 9 klg. . . .	kuintal	170
dh)	prej 9 e deri më 11 klg. . . .	kuintal	125
e)	prej 11 e deri më 13 klg. . . .	kuintal	105
f)	ma shumë se 13 klg.	kuintal	75
	Ad. 212. Cohët e pambuknt qi, në peshë kanë 3 e deri më 15% mëndafshë ase landë të tjerë të gjasëshme, kanë për të qenë të shtrueme në nji shthsë të drejtë 40% Cohët e pambukut të përziëm me fiie t' arit ose metalesh të tjerë në përpjestim ma shumë se 3% në peshë kanë për të qenë të shkrueme në nji shtesë të drejtë 50%.		
213	Facolete pambuku		
a)	Facolete të mbëdha prej cilsije t' epërme.	kuintal	300
b)	prej cilsijet tjetër	kuintal	180
214	Çarapë, dorëza, fanella, këmisha brekë	kuintal	400
ex 216	Kadife pambuku (të përjashtuem kadifet me anë a se me vije):		
a)	ordiner :		
	1. të bardha.	kuintal	170
	2. me vizatime	kuintal	200
	3. të shtypuna me ngjyrë. . . .	kuintal	250
b)	prej cilsijet t' epërme :		
	1. të bardha	kuintal	200
	2. Me vizatime	kuintal	250
	3. Të shtypuna me ngjyrë . .	kuintal	300

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
ex 216	Kadife pambuku me anë ose me vijë, të ç' do lloje, të shtypuna me ngjyrë ase jo	kuintal	125
ex 228	Thasë kanave (chanvre) ase jute (jute)	kuintal	15
ex 237	Cohna leshi:		
ex *a)*	Cohë (në llojë kazmiri), e peshueme me m²		
	3. ma shumë se 300 gr. e deri me 500 gr.	kuintal	360
b)	Cohë leshi të trashë, e peshueme me m²		
	1. deri me 400 gr.	kuintal	250
	2. ma shumë se 400 gr. . . .	kuintal	200
238	Cohë leshit e përzieme me pambuk, e peshueme me m²:		
a)	deri më 300 gr.	kuintal	180
b)	ma shumë se 300 gr.	kuintal	135
ex 244	Fanella, këmisha, brekë leshit:		
a)	në leshë të safë	kuintal	700
b)	në leshë të përziëm	kuintal	600
ex 254	Cohë mëndafshit e ngjyrosun ase jo:		
b)	e përzieme me landë të tjera .	kuintal	900
ex 265	Kapele, qeleshe (fes):		
e)	feltret (feutre), cohet, kadifet, leshit	kuintal	450
ex 270	Ombrelë për shië e për diellë:		
b)	leshit ase leshit me mëndafsh .	për copë	3
c)	pambukut, linit e kanavet . .	për copë	1.50
277	Breza (ceintures); mbuloje (couvertures), er-mbushëse (chambres a air), rrethana (bandages) të mbushuna për velespite, motociklete, automobila, e për karroca (voitures) të tjerë; llastikë për me prishë shkrimin:		
a)	në kauçuk	kuintal	20

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
	b) në kauçuk i përziëm me landë të tjera	kuintal	30
	c) burri (tuyaux) në kauçuk, e llastikë për të prishun shkrimin .	kuintal	40
281	Sende të tjera me kauçuk . .	kuintal	120
285	Barrut për të qitun.	kuintal	100
286	Barrut për mina	kuintal	30
202	Çement	kuintal	1
299	Squfrë:		
	a) në pluhun	kuintal	4
	b) në copa	kuintal	5
	c) i përziëm me landë të tjera .	kuintal	2
304	Enëra toket të pjekuna:		
	a) ordinere e të pa-verniçueme		
	b) të verniçueme	kuintal	5
ex 307	Mermerë		
	a) i pa-punuëm		përjashtuëm
	ex *b)* i pastër e i punuem:		
	1. mermer i mirë për pllaka vorresh, kamba shkallësh e për trueze	kuintal	2
337	Gozhda e gozhda të vogla		
	a) gozhda hekri e çeliku të mira		
	1. prej Nr. 13 e deri me Nr. 15 i përmbrendesuem	kuintal	10
	2. prej Nr. 16 e deri më Nr. 17 i përmbrendëshëm	kuintal	9
	3. prej Nr. 18 e deri me Nr. 20 i përmbrendësuem	kuintal	8
	4. prej Nr. 21 e ma naltë . .	kuintal	7
	b) gozhda hekrit, me kokë a me bisht të katrëkandshmë		
	1. të vogla	kuintal	10
	2. të mëdha	kuintal	8
	c) gozhda prej metalesh të tjerë .	kuintal	15
	ç) gozhda:		
	1. për kundëra	kuintal	10

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
	2. për kafase, me kokë	kuintal	20
	3. për të mbathunit e kafshëvet	kuintal	15
	a) gozhda nga llojet e naltëpërmenduna, me kokë prej metalesh të tjerë	kuintal	20
ex 342	Mobilje të hekrit të verniçusme ase me ngjyrë.	kuintal	15
ex 357	Sumbulla metali	kuintal	80
ex 361	Fishekë :		
	b) gjuetije :		
	1. të mbushuna	kuintal	75
	2. të bosha	kuintal	50
ex 376	Plumbë gjuetije	kuintal	10
389	Kazane për makina me avull .		përjashtë
390	Lokomobila e makina të tjera me avull.		përjashtë
392	Dinamos, akumulatore . . .		përjashtë
397	Makina e motore jo të përmenduna		përjashtë
398	Makina bulqësore e aksesuarët e tyne		përjashtë
ex 407	Automobile (të përmbrend. kamjonët)		
	a) qi nuk kalojnë peshën 400 . .	kuintal	100
	b) prej 400 e deri më 900 klg. .	kuintal	90
	c) prej 900 e deri me 1800 kgl. .	kuintal	70
	ç) prej 1600 e deri me 2500 . .	kuintal	60
	d) prej 2500 e deri me 4000 kgl. .	kuintal	50
	dh) prej 4000 kgl. e ma naltë . .	kuintal	30
ex 407	Aksesuare për automobilat (të përjashtuëm llastikat-pneus). .	kuintal	40
ex 409	Motocikleta :		
	a) me dy rrota	kuintal	40
	b) me tre rrota	kuintal	50
ex 408	Aksesuare për motocikletët (të përjashtuëm llastikët - p n e u s)		
	a) hekrit.	kuintal	50
	b) prej metalesh të tjerë.	kuintal	100
409	Velespite e aksesuarët e tyne (të përjashtume llastikët-pneus)	kuintal	50

DRAFT

Numuri i tarifës shqiptare	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta Fr. ar
435	Qirinjë	kuintal	30
436	Qirë-mbajtëse	kuintal	40
ex 438	Okrë (ocre-nji farë toket për të bamun ngjyse	kuintal	10
447	Ngjyrë e kremë për kundëra .	kuintal	40
448	Verniçë për kundra.	kuintal	50
ex 451	Ngjyrë e blueme (broyes) me me voje.	kuintal	50
470	Sodë e potasë kaustikë (caustic cue)	kuintal	2
472	Shapë.	kuintal	5
477	Sufatë bakrit		përjashtue
479	Naftalinë.	kuintal	5
ex 483	Barna (për farmaçië)	vleftë	20%
ex 483	Kininë e bashkëbaësat e sajë (composé)		përjashtue
437	Krahën, të stolisme (parures) pipe, e sende të përgjasueme në çelulojde, në gastare, e në lande si këto.	kuintal	400
499	Sende në fildish (nacre, madreperla) e të gjasëshme.	kuintal	100
ex 500	Sende rrashtit ose briësh; sumbëlla rrashtit, briësh korozo (corozo).	kuintal	80

Tarifa e të drejtavet në të hyemit n' Itali

Numuri i tarifës italiane	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta hyemjeje L. S. ar	Koeficentë sypër-vleftje
ex 1	Kuej:			
ex *a)*	kuej të plotë (entiers) qi tuej i matun deri te shpatullat, kanë nji naltësi 1.30 metra a se ma pakë.	për kok	100	0.5

BKSh

Numuri i tarifës italiane	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta hymjeje L. S. ar	Koeticentë sypër-vleftje
ex *b)*	të tjerë qi tuej i matun deri te shpatullat, kanë nji naltësi 1.30 a se ma pakë:			
	1. mashkuj të tredhun. . .	për kok	40	
	2. femna	për kok	80	
2	Mushka	për kok	25	
3	Gomarë	për kok	5	0.5
ex 4	Qej, qi kanë për kokë nji peshë 240 klg. ose ma pakë e qi janë për t' u therë në kasaphane nën kontrollin e doganës	për kok	10	
ex 5	Bullica.	për kok	20	0.5
ex 6	Lopa, kanë per kokë nji peshë 200 klg. ose ma pakë, e, qi janë për t' u therë në kasaphane nën kontrollin e doganës.	për kok	8	
ex 9	Qingjë me peshë 12 klg. e ma poshtë pesha gjalië	për kok	2	
ex 10	Kèce me peshë 12 klg. e ma poshtë (pesha e gjallë) . .	për kok	2	
33	Peshk të freskët si dhe t' akulluem (congelés)		Të përjashtuem	
ex 34 *a)*	Peshk të pregatituna të thatë, të krypuna ose tymosuna:			
ex 5	sardele të krypuna e shtypuna	për kuintal	4	
6	sardele e saraka (anchois) në krypë.	për kuintal	5	
ex 36	Putarkë (Bottargue). . . .	për kuintal	60	
ex 74	Groshë e bathë të thatë . .	për kuintal	1.50	
81 *c)*	Limona e qitra		Të përjashtuem	
ex 98 *a)*	Ullinjë në krypë (ose shlli) .	kuintal	25	
118	Ullinjë të freskta		Të përjashtuem	
123	Llumë ullinjësh		Të përjashtuem	
ex 211	Leshna:		Të përjashtuem	
a)	Natyrale a se të ngjyrosuna (suinté)		Të përjashtuem	

DRAFT

Numuri i tarifës italiane	EMERTIMI I MALLNAVET	Njisi	Të drejta hymjeje L. S. ar	Koeficentë sypër-vleftje
b)	Të laeme .		Të përjashtuem	
146	Shikë mëndafshit (cocons á soie)		Të përjashtuem	
605	Dru për të djegun		Të përjashtuem	
ex 627 *a)*	Xhengë : i pa-punuem		Të përjashtuem	
ex 639 *a)*	Bri e rrashtë pa-punuem		Të përjashtuem	
ex 353	Ziftë (poix navale)		Të përjashtuem	
ex 784 *a)*	Landë (glands) lisi të pa-blueme		Të përjashtuem	
805	Lëkurë të tjerë veç se për qurkësi (pelleterie) të pa-punueme të freskta (qofshin të krypuna ose të shlliëme), të thata ose të krypuna dhe të uthullneme (pickled)		Të përjashtuem	
806	Lëkurë për qurkësi, të pa-punueme, të freskta ose të thata		Të përjashtuem	
938 *a)*	*Zorrë* të freskta		Të përjashtuem	

Protokol i fundëshëm

Para se me e nënshkrue Traktatin e Tregtis e të Lundrimit, i përfunduem me datën e kësajë dite, në mes t' Italis e të Shqipënis, Fuqiplotësit e poshtëshënuem kanë ba deklaracjonat vijuese, të cilat kanë për të bamun pjesë integrante po të këtij Traktati :

Ad. art. 7. – Anët kontraktuese janë në marrëveshtje qi, me qëllim realizimi sa ma parë n' integritetin e tij të parimit i stabiluem n' Art. *7* al. I. të Traktatit të Tregtis i përfunduem në këtë ditë, nuk kanë me sjellun ndalime a se shtërngime n' importim a eksportim, veç se kur kjo masë ka me u pa me doemos (absolument) e nevojshme, e, në këtë rasë, kanë për të vazhdue aq kohë sa kanë për t' ekzistue rasat eksepsionale të cilat e shkaktuen.

Ad. Art. 11. – Përgjasimi (l' imitation) i aniëvet e i ngarkimit të tyne nër skelet e të dy palëvet kontraktuese, nuk ka për të pasun effekt :

a) Për aplikimin e ligjëvet të veçanta për mbrojtjen e marinës tregtare, për shkaqe konstruksjonesh të reja a se ushtrimi t' aniëvet me shpërblime (primes*)* nga ana e Shtetit e lehtësina të veçanta;

b) Për privilegje të konçedueme shoqënive për sport detuer;

c) Për ushtrimin e shërbimevet të skelës e të lundrimit t' afertë (cabotage, veç se për sa i përket dispozitës së parit alinea t' Art. 17.

d) për ushtrimin e peshkimit, tue u përjashtue dispozita e Art. 18.

Ky protokol, i cili ka për të qenë i konsideruëm si i aprovuem e i sanksionuem prej anvet kontraktuëse, pa ndonji tjetër ratifikim të veçantë, me të vetmin fakt të shkëmbimit të ratifikimevet të traktatit te i cili referohet, u kompilue në dy kopje, në Romë, me 20 Kallnduer njimijenantëqindenjizetekatër.

K. THAÇI BENITO MUSSOLINI FEIZI ALIZOTI

Marrëveshtje Konsullore ndërmjet Shtetit të Shqipnis dhe Mbretënis s' Italis

Këshilli i Naltë i Shqipnis dhe Madhnija e Tij Mbreti i Italis, tue dishruem me u siguruem Agjentavet Konsullore të dy Shtetevet imunitetet dhe privilegjet e duhuna për të kryemit e detyrës së tyne, kanë vendosun me mbyllun nji Marrëveshtje dhe për këtë qëllim, kanë emnuem për Fuqiplotë të tyne këta:

Këshilli i Naltë i Shqipnis:

Shkëlqesin e Tij zotin Fejzi Bey Alizottin, ish Ministër i Financavet;

Shkëlqesin e Tij Djafer Villa, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrin e Punëvet të Jashtme;

Madhnija e Tij Mbreti i Italis:

Shkëlqesin e Tij Benito Mussolini, Kryetar i Këshillit, Ministër i Punëvet të Mbrendshme dhe zavendës për Punët e Jashtme;

Të cillët, mbassi këmbyen fuqit e plota të tyne, të cillat u gjetën në formën e duhun e të mirë, vendosen si vijon:

Art. 1. – Secilla nga të dy palët Kontraktuese do të mundet me venduem Kryekonsullata, Konsullata, Nënkonsullata ose

Agjenta Konsullorë në skelet, qytetet dhe lokalitetet e tokës së tjetrës palë.

Por, Qeverit e dy palëvet kontraktuese e mbajnë të drejtën me caktue rezidencat ku u pëlqen qi të pranohen zyrtarë konsullorë; asht e dijtun se, në këtë pikpamje, ata nuk do të kundërshtojnë respektivisht në kurrnji ndalesë qi të mos jetë e përgjithshme për të gjitha kombet e tjera.

Agjentat e naltpërmendun do të jenë reciprokisht të pranuem dhe të njoftun tue paraqitun provizjonet e tyne si mbas rregullavet dhe formalitetevet të venduëme në vendet respektive. Exequatura e nevojshme për shërbimin e lirë të detyravet të tyne do t' u epet pa shpenzime e sa ma shpejt qi të jetë e mundun dhe mbi paraqitjen e Exequaturës së përmendun, autoriteti ma i naltë i vendit të rezidencës së tyne do të marri me nji herë masat e nevojshme qi të munden me e kryem barrën e detyrës së tyne e qi të pranohen në gëzimin e përjashtimevet, prerogativavet, imunitetevet, nderimevet dhe privilegjevet qi i mveshen cillsis së tyne.

Kryekonsujt dhe Konsujt do të mund t' emnojnë nënkonsuj ose agjenta konsullore në qytetet dhe lokalitetet e qarqevet të tyne konsullore respektive por me pëlqimin e Qeveris prej së cillës mvaren kryekonsujt dhe konsujt. Këta agjenta do të mund të zgjidhen pa ndërlikim ndërmjet qytetarvet të dy vendevet, si edhe ndërmjet të huejvet dhe do të kenë nji brevet të dhanun prej Konsullit qi do t' i ketë emnuem dhe nën urdhnat e të cillit do të jenë. Ata do të gëzojnë po ato privilegje dhe imunitete si agjentat e kathegorivet të kombit ma të favorizuëm. Ata nuk do të mund të fillojnë nga detyra pa qenë të njoftun prej Qeveris lokale.

Art. 2. — Zyrtarët konsullorë italjanë në Shtetin e Shqipnis dhe zyrtarët konsullorë të Shtetit të Shqipnis n' Itali do të gëzojnë, nën rezervën e nji reciprociteti të plotë, të gjitha privilegjet, përjashtimet dhe imunitetet qi gëzojnë ose do të gëzojnë në kohën e ardhshme zyrtarët konsullorë t' asaj shkalle të kombit ma të favorizuem. Zyrtarët konsullorë të karjerës të dy vendevet do të kenë të drejtë me i telegrafuem me shifrë Qeveris së vet dhe Legatës së vet.

Ata do të mund të venë mbi portën e përjashtme të konsullatës apo nënkonsullatës nji tabelë me armën e kombit të vet bashkë me këtë shkrim:

Konsullata ose Nënkonsullata e . . . .

. Gjithashtu ata do të mundin me e naltsuem flamurin e vendit të vet mbi shtëpin konsullore në ditët e solemnitetevet publike si edhe në rasat e tjera si mbas zakonit.

Mbetet e kuptueme se këto sheje të përjashtme nuk do të munden kurr me e nënkuptuem sikurse të konstituojshin të drejtën e nji Strehjeje (droit d' asile), por para çdo gjaje këto do të vlejnë me i diftuem kombtarvet banimin konsullor.

Kryekonsujt, konsujt dhe nënkonsujt ose agjentat konsullorë do të mundin gjithashtu me naltësuem flamurin kombëtar mbi barkën që do të kenë në skelen për zbatimin e detyrës së tyne.

Art. 3. – Kur drejtësija e njenit nga të dy Shtetet do të ketë për të marrë ndonji deklaratë juridike apo dishmin prej nji kryekonsulli, konsulli, nënkonsulli ose nji agjenti konsuiluer shtetas i Shtetit qi e ka emnuem dhe qi nuk merret me kurrnji tregëti, ajo do t' a grishi me shkrim me u paraqitun para sajë, dhe në rasë ndalimit të shkaktuem nga nevojat e shërbimit, ajo do t' i kërkojë dishmin e tij me shkrim, ose do të shkojë në banim të tij ose zyrë për t' a marrun dishmimin me zà.

Agjenti i përmendun do të plotësojë këtë kërkim në kohën ma të shkurtën qi të jetë e mundun.

Art. 4. – Arkivat konsullore do të jenë të pa dhunuëshme dhe autoritetet lokale nuk do të mundin, për kurrnji shkak, dhe n' asnji rasë, me vizituëm apo me vuëm dorë mbi letrat qi do t' ishin pjesë e tyne.

Këto letra do të jenë kurdoherë të ndame kryekput nga librat ose letrat qi i përkasin tregtis ose industris qi zyrtarët konsullorë respektiv mund të kenë.

Art. 5. – Kryekonsujt, Konsujt dhe Nënkonsujt e të dy Shtetevet, ose Kançeljerët e tyne, do të kenë të drejtë me praeuem në Kançelari dhe në banim t' interesuemvet, deklaratat qi mund të kenë me bam tregtarët dhe të gjith shtetasit tjerë të vendit të vet.

Ata dp të jenë gjithashth t' autorizuem me pranuem si noter dispozitat dhiatore të kombtarvet të tyne.

Veç kësaj; do të kenë të drejt me pranuem në Kançelari të tyne çdo akt marrëveshtje qi mund të bahet ndërmjet nji ose ma shum nga komtarët e tyne dhe tjera personavet të vendit në të cillin ndodhen, ashtu dhe të çdo akt marrëveshtjeje

qi i përket qytetarvet të këtij vendi vetëm, por me kusht qi këto akte të kenë të bajnë me pasunina qi ndodhen ose me çashtje qi do të rregullohen në tokën e kombit i të cillit asht Konsulli ose Agjenti Konsulluer përpara të cillit u paraqitën këto akte.

Kopjet ose nxjermnat e këtyne aktevet, të legalizueme rregullisht prej Agjentevet të përmendun, dhe vulosun me vulën zyrtare të Konsullatavet ose Agjentavet Konsullorë, do të kenë vleftë sa në drejtësi aq jashta drejtësis, qoft në Mbretnin e Italis, qoft në Shtetin e Shqipnis po m'ate titull se sa origjinalet dhe do t'a kenë po atë fuqi dhe vleftë sa sikur t'ishin paraqitun para nji notarit ose oficer publik të njanit dhe të tjetrit vend, mjaft qi këto akte të jenë kenë përpiluem në format e kërkueme prej ligjëvet të Shtetit prej të cillit mvaren Konsujt, Nënkonsujt ose Agjentat Konsullorë e t'i jenë mandej Shtrue pullës dhe rregjistrimit, si edhe të gjijha formalitetevet të tjera qi e rregullojnë çashtjen në vendin ku akti do të ketë zbatimin e tij.

Në rasë që nji dyshim do të delte mbi autentincitentin e të kryemit të nji aktit publik i rregjistruem në kançelarin e njenët nga Konsullatat respektive nuk mund t'i mohohet t' interesuemit qi e kërkon përballimi me origjinalin, e qi për ketë përballim mundet me ndodhë vetë pranë, po t'a gjykojë të nevojshme.

Kryekonsujt, Konsujt, Nënkonsujt dhe Agjentat Konsullorë respektif do të mundin me përkthye e legalizue çdo lloj dokumentash të dhanun nga autoritetet apo zyrtarët e Vendit të vet, dhe këto përkthime do të kenë, në Vendin e rezidencës së tyne, po atë fuqi dhe vleftë se siknr t'ishin bam prej përkthyesavet të betuem të vendit.

Art. 6. — Në rasë vdekjeje të nji Sekretarit të njenës nga Palët Kontraktuese në tokën e tjetrës autoritetet lokale do të lajmojnë me nji herë Kryekonsullin, Konsullin, Nënkonsullin ose Agjentin Konsullorë në qarkun e së cillit vdekja ka ndodhë· Këta, m'anë tjetër, do të lajmojnë autoritetet lokale, po qe se jane lajmërue ma të parit.

Kur nji italjan në Shtetin e Shqipnis ose nji nënshtetas i këtij Shteti n'Itali, do të ketë vdekë pa pasë bam dhiate dhe pa pasë emnuem zbatues të dhiatës, ose po të jetë se trashigimtarët, qofshin të natyrthëm, qofshin të shenuem me dhiaten, anë nën moshën ligjore, të pazotë ose nuk ndodhen aty, ose

po të jetë se zbatuesat e emnuem të dhiatës nuk ndodhen në vendin ku do të çelet trashigimi, Kayekonsujt, Konsujt dhe Nënkonsujt ase Agjentat Konsullorë të kombit të të vdekunit do të kenë të drejtë me u marrë njanën mbas tjetrës me operacjonet qi vijojnë :

1. Me i vumë dyllat, qoftë zyrtarisht, qoftë si mbas kërkesës së palevet t' interesueme, mbi të gjitha sendet, mobilat dhe letrat e të vdekunit, tue e lajmuem për këtë operacjon autoritetin lokal kompetent, i cili do të mundet me ndodhë aty dhe mi vuem dhe ay dyllet e veta.

As këtë dyllë, as ato t' agjentit Konsulluer nuk mund të hiqen pa qenë përanë operacjonit autoriteti lokal.

Por, po të jetë se mbas nji lajmit t' adresuem prej Konsullit ose Nënkosullit auioritetit lokal për të grishun me u ndodhë në heqjen e dyllevet të dyfishme, ky nuk paraqitet mbrenda nji afatit dyzet e tet orësd, tue filluem me marrjen e lajmimit, ky Agjent do të mund t' a kryejë vetë operacjonin e naltpërmendun.

2. Me e bam inventarin e të gjitha pasunivet e sendevet të të vdekunit ndër sy t' autoritetit lokal, po qe se, si mbas lajmimit të naltpërmendun, e ka pa me udhë me u ndodh në kët veprim.

Autoriteti lokal do të nënshkruejë proces-verbalet e bamë para tij, pa mujtun, për këtë ndërhyrje zyrtare në këto akte, me kërkuem tagre kurrnji fare.

3. Me urdhënuem shitjen n' ankandë publike e të gjitha sendevet mobiljere të trashigimit qi mund t' u priheshin e t' atyne qi nuk mund t' u mbahen, si dhe të korrunavet e sendevet, për shitjen e të cilavet do t' u paraqiteshin rasa të favorëshme.

4. Me depozituem në vend të sigurt sendet dhe vleftat e futuna n' inventar; me mbajtë shumat e t' ardhunavet qi mund t' arkëtohen, si dhe prodhimin e të hymevet qi do të merren, në shtëpin Konsullore ose me i a dorëzuem ndonji tregtarit qi paraqet garantina të mjafta. Këto depozitime do të bahen në njënën apo tjetrën rasë' në marrëveshtje me autoritetin lokal, i cilli do të ketë ndodhun n' operacjonet e përparshme, po qe se mbas konvokimit të përmendun në paragrafin para këtij, subjekta të vendevet, ose të nji Fuqije të tretë do t' u paraqitshin si t' interesuëm në trashigim si mbas dhiatës (ab intestato) ose si zbatuesa të dhiatës.

5. Me lajmuem vdekjen dhe me konvokuem, me mjetin e

BKSH

fletorevet të vendit e t' atyne të Vendit prej kah asht i vdekuni, po t' jetë nevoja, ata qi mund të kenë me marrë prej trashigimit si mbas dhjatës (ab intestato) ose si zbatuësa, me qëllim qi të mundin me paraqit titujt e vet respektiv për të drejtë marrjeje, dhe të justifikuem rregullisht mbrenda afatit të caktuem prej ligjëvet të secillit nga të dy Vendet.

Po t' u paraqitshin marrëse kondra trashigimit të dhiatës ose si trashëguësa (ab intestato), pagimi i të drejtavet të tyne duhet bam mbrenda nji afati pesmëdhet ditësh mbas mbylljes s' inventarit po t' ishin burime tjera qi mund t' a kryeshin këtë pagim, dhe në rasë të përkundërt, po sa qi fondet e duhuna të jenë mujtë me u mbledhë me mjetet ma të pëlqyëshme, ose ma në fund n' afatin e venduëm, nji mendimit, ndërmjet konsujvet dhe shumicën e t' interesuemvet.

6. Me administruem e liquiduëm ata vetë, ose me anën e nji personi qi do t' emnojnë nën përgjegjësi të veten, trashigimin e lanun me dhiatë ose ab intestato, pa muejt autoriteti lokal me ndërhyem në këto operacjone, por në qoft se subjekta të Vendit apo të tretë kanë të drejta qi duen t' i tregojnë në trashigim; përse, në kësi rase, po të shkaktoheshin pengime, qi rrjedhin sidomos nga ndonji reklamim qi i nep shkas nji kontestimit, Kryekonsujt, Konsujt, Nënkonsujt ose Agjentat Konsullorë tue mos pasë kurrnji kompetencë për t' i dhanë fund këtyne vështirsivet, gjykatavet të vendit u takon me i njoftun si mbas rasës në qoft se kanë me i krye apo me i gjykue.

Agjentat e nalpërmendun Konsullore do të veprojnë atëherë si përfaqësuës të gjas së lanun me dhiatë ase ab intestato, d. m. th. se tue e mbajtun administrimin dhe të drejtën me liquiduëm definitivisht gjan e lanun, sikurse edhe të drejtën me i bam shitjet e sendevet në mënyrat e përmenduna ma parë, ata do të kenë në kujdes interesat e trashigimtarëvet dhe do të mundin me shënuem avokatën qi do të ngarkohen me mprojtë të drejtat e tyne përpara gjykatavet. Asht e dijtun se do t' u dorëzojnë këtyne gjykatavet të gjitha letrat e dokumentat qi munden me e qiaruë çashtjen qi i u asht shtruem për gjykim.

Si të nepet gjykimi, Kryekonsujt, Konsujt e Nënkonsujt ose Agjentat Konsullorë do t' i shtrohen këtij po qe se nuk formojnë apel dhe do t' a vazhojnë atëherë me të drejtë të plotë liquidimin qi do të ketë mbet vartas deri në përfundim të moskuptimit.

7. Me organizuem, po qe nevoja kujdestarin (curatelle) ose vesajetësinë (tutelle) si mbas ligjëvet të vendevet respektive;

8. Me liquiduëm e me marrë pagesat e huanavet, të hymet ose shpërplimet qi u janë lidhë shtetasvet të vet me zbatimin e ligjëvet të sigurimit shoqnuër.

Art. 7. – Kur nji italjan në Shtetin e Shqipnis ose nji shtetas i këtij Shteti n' Itali të vdesi në nji lokalitet ku nuk ka agjent konsulluër të kombit të tij, autoriteti territorjal kompetent do të bajë, simbas legjislatës së vëndit, inventarin e sendevet qi ka lanë, dhe do t' a ketë për detyrë me i a lajmërue në kohën ma të shkurtë qi të jetë e mundun, përfundimin e këtij operacjoni Ambasadës apo Legatës qi i përket ose Konsullatës ose Nënkonsullatës ma t' afërme të vëndit ku do të çelet gjaja e lanun ab intestato ose me dhiatë (Testament).

Por në çasin qi Agjenti Konsulluër ma i afërm i lokalitetit ku do të çelej gjaja e lanun ab intestato ose më dhiatë do t' u paraqitte personalisht ose do të dërgonte nji delegat në vënd, autoriteti lokal qi do të ketë ndërhyem do të veprojë simbas përmbajtjes s' artikullit para këtij.

Art. 8. – Kryekonsujt, Konsujt dhe Nënkonsujt ose Agjenta Konsullorë të të dy Shtetevet, do të kenë dijeni ekskluzivisht mbi aktet e inventarvet dhe të tjera veprimevet të kryeme për ruejtjen e pasunivet dhe sendevet çfarëdo natyre të lanuna prej njerzish të detit dhe udhtarët e vëndevet të tyne, qoft n' udhtim e sipër qoft në skelen e mërritjes së tyne.

Art. 9. – Kryekonsujt, Konsujt dhe Nënkonsujt ose Agjentat Konsullorë do të mundin me shkuë persunalisht, ose me dërguem delegatën n' avulloret e kombit të tyne mbassi këta të jenë pranuë në praktikë të lirë; me pyetun kapitanat dhe detarët, me shqyrtuem letrat e avullores; me pranuem deklaratat mbi udhtimin e avullorevet, mbi vendin për të cillin udhtojnë dhe mbi ndodhjet e udhtimit; ma në fund me i përsjellun përpara gjykatavet dhe në zyrat e administratës së vendit, për t'u shërbyem si përkthyësa ose agjentë në çashtje qi do të kenë me ndjekë ose në kërkesat qi mund të kenë me bam.

Zyrtarët e rendit gjyqsuër si edhe rojtarët e nënpunsat e doganavet nuk do të mundin në kurrnji mënyrë me bam vizita ose kërkime mbi avulloret, pa e pasë lajmëruë paraondej autoritetin Konsulluër të kombit së cillit i përkasin avulloret, qi të mundet ky me ndodhun në vizitë.

Zyrtarët e naltëpërmendun të rendit gjyqsuër ose të doganavet do të lajmojnë gjithashtu me kohë autoritetet e naltëpërmenduna Konsullorë qi të ndodhin në deklaratat qi kapitanat dhe detarët do të mund të kenë me bam përpara gjykatavet dhe n' administratat lokale, me qëllim qi të mos shkaktohet as ndonji equivoque apo moskuptim qi do të mund të damtonte administrimin e mirë të drejtësis.

Art. 10. – Për gjitha sa i përket policis së skelëvet, ngarkimit apo shgarkimit t' avullorevet dhe sigurimit të mallnavet, pasuninavet apo teshavet, do të mbahen ligjët urdhnat e rregulloret e vëndit.

Kryekonsujt, Konsujt dhe Nënkonsujt ose Agjentat Konsullorë do të ngarkohen ekskluzivisht me mbajtjen e rendit të përmbrendshëm n' avulloret tregtare të kombit të tyne; ata do të rregullojnë vetë kundërshtimet të çfardo natyre qi mund të ngjajnë ndërmjet kapitanit, oficerët e avullores dhe detarët e sidomos ato qi i përkasin pagesës dhe të kryemit e kushtevet qi kanë lidhë reciprokisht.

Autoritetet lokalë nuk do të mundin me ndërhym veçse kur shrregullimet që ngjajnë n' avullore të kenë ngjyrat qi me e prishë qetsin dhe rëndin publik, në tokë ose në skele ose kur nji personë e vëndit, ose nji qi nuk asht e detarvet, do t' ishte e përziëme në këtë grindje.

Në të gjitha rasat tjera, autoritetet e naltpërmenduna do të kufizohen të ndihmuëm Konsujt e Nënkonsujt ose Agjentat Konsullorë, po qe se këta e kërkojnë ndihmën, për të rreshtuëm e dërguem në burg çdo njeri të nënshkruëm në rolin e detarvet sa herë qi, për nji arsyë çfarëdo, Agjentat e naltpërmendun do t' a shohin me udhë.

Art. 11. – Kryekonsujt, Konsujt dhe Nënkonsujt ose Agjentat Konsullorë do të mund të rreshtojnë dhe kthejnë, qoft n' avullore, qoft në vëndin e tyne, detarët ose çdo tjetër personë qi me çfarëdo titullit qoft, asht pjestarë i ekuipagjit t' avullorëvet të kombit të tyne, qi do të kishin dezertuëm.

Për kët qëllim duhet t' i sjellen me shkrim autoritetevet lokale kompetente, dhe me justifikuëm, me mjetin e paraqitjes së regjistravet t' avullores ose rolit t' equipagjit, ose, po të jetë se avullorja asht nisë, tue paraqitun nji kopje autentike të këtyne dokumentavet, me të cillat të tregohet se personat e reklamuëme ishin me të vërtetë pjestare t' equipagjit. Mbi këtë kërkesë

të justifikuëme në këtë mënyrë, dorëzimi i dezertorëvet nuk mund të mohohet. Veç kësaj do t' u epet agjentavet konsullorë të naltpërmendun çdo ndihmë dhe përkrahje për kërkimin e rreshtimin e këtyne dezertorëvet të cillët do të dërgohen në burgjet e vëndit dhe do mbahen aty si mbas kërkimit dhe me shpenzime të konsullit ose nënkonsullit deri sa ky të gjejë rasën për me i nisë.

Ky burgim nuk mundet me qënë ma i gjatë se tre muaj, mbas të cillvet, dhe si mbas nji lajmit të dhanun konsullit tri ditë përpara, i burgosuni të lirohet, dhe nuk do të mund të rreshtohet prap po për atë çashtje.

Por po qe se dezertori ka kryëm ndonji delikt në tokë, autoriteti lokal mundet me e shtyëm të nxjerrmen (extradition) deri sa gjykata të ketë dhanun vendimin dhe qi ky vendim të jetë zbatuem plotsisht.

Palët Kontraktuese vendosin qi detarët ose të tjerë njerës t' ekuipazhit, subjekt të vendit ku ngjan dezertimi, janë të përjashtuëm nga përmbajtja e këtij artikulli.

Art. 12. – Sa herë qi të mos ketë marreveshtje të përkundërta ndërmjet armatorvet, ngarkuesavet dhe siguruesavet, damet qi avulloret e të dy vendevet do të kenë pasë në det, qoft se hynë në skelët respektive vullnetisht qoft edhe pse të shtrënguem, do të rregullohen prej Kryekonsujvet, Konsujvet, Nënkonsujvet ose Agjentavet Konsullore të kombit të tyne, pos në qoft se subjekta të nji Fuqije të tretë, janë t' interesuem n'ato dame; në kësi rase, dhe në mungesë të nji marreveshtjes miqsore ndërmjet të gjitha palevet t' interesueme, ato do të rregullohen prej autoritetit lokal.

Art. 13. – Kur nji avullore qi i përket Qeveris ose shtetasvet të njënës nga Palet Kontraktuese do të mbytet ose të ndalet në viset e tjetrës, autoritetet lokale do t' i a lajmojnë ngjarjet Kryekonsullit, Konsullit, Nënkonsullit ose Agjentit Konsullor të qarkut, dhe në mungesë të tij do t' i a njoftojnë Kryekonsullit, Konsullit, Nënkosullit ose Agjentit Konsullorë ma t' afërm nga vendi ngjarjes.

Të gjitha operacjonet qi i përkasin shpëtimit t' avulloreve t shqiptare qi mund të mbyten ose të damtohen n' ujnat teritorjale t' Italis, do të dirizhohen prej Kryekonsujvet, Konsujvet, Nënkonsujvet ose Agjentavet Konsullorë të Shtetit të Shqipnis; reciprokisht të gjitha operacjonet qi i përkasin shpëtimit t' avullo-

revet italjane qi mund të mbyten ose të damtohen n' ujnat teritorjale të Shtetit të Shqipnis do të dirizhohen prej Kryekonsujvet, Konsujvet, Nënkosujvet ose Agjentavet Konsullorë t' Italis.

Ndyrhyrja e autoritetevet lokale s'do të ngjajë në të dy vendet veç se për me u ndihmuë Agjentavet Konsullorë, për me mbajtë rendin, me garantuem interesat e shpëtuesvet të huej n' equipagj dhe për me siguruem zbatimin e dispozitavet qi duhen mbajtë për të hymen e daljen e mallnavet të shpëtueme.

Në mugesë e deri në mërritje të Kryekonsujvet, Konsujvet, Nënkonsujvet ose Agjentavet Konsullore, ose të personës qi do të delegojnë për kët qëllim, autoritetet lokale do të marrin të gjitha masat e duhuna për mprojtjen e njerzvet dhe ruejtjen e sendevet qi do të jenë shpëtuem nga mbytja.

Ndërhyrja e autoritetevet lokale, në këto rasa të ndryshme, nuk do t' i napi shkas marrjes se kurrnji shpenzimi, përveç atyne qi mund të nevojitin operacjonet e shpëtimit e të ruejtjes së sendevet të shpëtueme, si edhe ato të cillavet do t' i shtroheshin në rasa të këtilla, avulloret komtare.

Në rasë dyshimi mbi kombësin e avullorevet të mbytuna dispozitat e përmenduna në këtë artikull do të jenë në kompetencë ekskluzive t' autoritetit lokal.

Palët Kontraktuese vendosin, veç kësaj, qi mallnat e sendet e shpetueme nuk do t' i shtrohen asnji tagrit doganuer, pos në qoft se janë shenuem për konsumimin e mbrendshëm.

Art. 14. — Me qëllim qi me lehtësuem udhtimin e emigrantevet shqiptarë ose në tranzit ndër tokën e Shqipnis, kah skelet italjanë, dhe t' emigrantavet qi kthehen në vendin e vet po ndëpër këto skele, do t' u epet shoqnivet të lundrimit italjanë e drejta me venduem tue i u bindun legjislatës së vendit, agjencina shitjeje në Shtetin Shqiptar dhe me zhvilluem aktivitetin e tyne për bartjet direkte prej skelevet italiane në skelet kah të të cilat dirizhohet emigracjoni.

Po kjo mprojtje qi i nepet prej Italis emigrantevet italjanë do t' i sigurohet, prej Qeveris Italjane, emigrantevet shqiptarë, aq në Shtet se sa mbi avullore.

Art. 15. — Dy palët Kontraktuese lidhen me filluem, sa ma shpejt qi të jetë e mundun, bisedimet për të mbyllun nji ose ma shum marrëveshtje të veçanta për t' u siguruem puntorvet të njenit nga të dy vendet në tokën e tjetrit dhe aty qi kanë të drejtë, barasin në trajtimin me komtarët për gjith sa i përket

zbatimit të ligjëvet përkatëse për mprojtjen e punës, ndihmës mjekësore dhe miqsis, sigurimevet shoqnore kondra rreziqevet të ndryshëm, arsimit dhe lirimit të shoqnimit dhe t' organizimit profesjonel, dhe për të rregulluem komunikimin e akteve gjyqsore dhe nxjerrjes së kriminelevet.

Art. 16. – Kto marrëveshtje do të ratifikohet dhe ratifikimet do të këmbehen në Romë sa ma shpejt qi mund të bahet.

Kjo do të hyjë në fuqi në datën e këmbimit të ratifikimevet dhe do të ketë vleftë për 10 vjet tue filluem po me këtë datë. Në rasë qi njana nga të dy Palët kontraktuese nuk do të ketë njoftue, gjasht muej përpara perjudhës së përmendun, qëllimi me i a ndaluem efektet, do të mbetet e detyrshme deri në mbarimin e gjasht muejvet tue filluem në ditën qi njana ose tjera Palë kontraktuese t' a ketë njoftue prishjen.

Për vërtetim të sa u tha Fuqidlotët kanë nënshkruem këtë Marrëveshtje dhe e kanë vulos me vulat e veta.

Bamë në dy copë origjinale në Romë me njizet e nandë Fruer njimij e nandqind e njizet e katër.

Marrëveshtje Vendimi ndërmjet Shtetit të Shqipënis dhe Mbretnis s' Italis

Këshilli i Naltë i Shqipnis dhe Madhnija e Tij Mbreti i Italis tue dishruem me rregulluem vendimin e nënshtetasvet të dy Shtetevet me dispozita liberale e të nji ma të plotës shkallë reciprociteti, kanë vendosun me mbyllun nji Marrëveshtje, e për këtë qëllim, kanë emnuem për Fuqiplotës të tyne, këta:

Këshilli i Naltë i Shqipënis:

Shkëlqesin e Tij Zotin Fejzi bej Alizotti, ish-Ministër i Financavet;

Shkëlqesin e Tij Xhafer Villa, Sekretar' i përgjithshëm në Ministrin e Punëve të Jashtme;

Madhënija E Tij Mbreti i Italis:

Shkëlqesin e Tij Benito Mussolini, Kryetar i Këshillit, Ministër i Mbrendshëm dhe zavendës i Punëve të Jashtme;

Të cilat, mbassi kanë këmbyem fuqit e tyne të plotë, të gjetuna në formën e duhun, kanë vendosun sa vijon:

Art. 1. Do të ketë ndërmjet të Shtetit të Shqipënisë dhe të

Mbretnisë s' Italis miqsi të gjithnjishme dhe liri reciprcke për t' u venduem e për tregti.

Italjanët do të pranohen e do të tratohen në Shtetin e Shqipënisë për sa i përket personavet e pasunivet të tyne po në nji kambë e po n' atë mënyrë se sa janë, do të munden me qenë në kohë t' ardhshme, komtarët, ose shtetasit e kombit ma të favorizuem.

Reciprokisht Shqipëtarët do të pranohen e do tratohen n'Itali, për sa u përket personavet pasunivet të tyne, po në nji kambë e po n' atë mënyrë se sa janë, ose do të munden me qenë në kohë t' ardhshme, kombtarët, ose shtetasit e kombit ma të favorizuem.

Prandaj shtetasit e secilës nga dy Palët kontraktuese si edhe familjet e tyne, mjaft qi t' i binden ligjevet të vendit, do të munden lirisht me hyem, udhëtuem, banuem, e me u venduem në secilën pjesë të tokës së tjetrës Palë, pa i u shtruem, për sa i përket lejevet të banimit e autorizimit me e punuem zejen e tyne, asndonji takse, barre ose kondite, tjetër veçse atyne së cilavet i shtrohen komentarët dhe shtetasit e kombit ma të favorizuem. Ata do të mundin me ba tregti si me shumicë ashtu edhe me pakicë, me punuem zejen ose industrin e tyne, me marrë me qira e me okupuem shtëpijat, magazet, dyqanet ndërtesat, qi do t' u duhen, me bam transporte malli dhe të hollash e me pranuem dorëzime aq prej së mbrendi se sa prej Vendevet të huaja, pa i u shtruem për të gjitha ose ndonjenën nga këto operacjone, shtetasit e përmendun, asndonji detyre ose barre ma të forta e ma të kushtueshme se sa atyne qi i janë shtruëm ose do të mund t' i shtrohen komtarët, me përjashtim të kujdesimevet të policis dhe dispozitavet të ligjës që janë e mund të shpallen për të rregulluem punimin e zejevet liberale të shtetasvet të kombit ma të favorizuem.

Ata do të jenë si njana palë sa tjetra dhe po në nji shkallë barasie në të gjitha blerjet e tyne të lirë me venduëm çmimin e sendevet, mallit apo sende çfaredoje si ato t' importuëme si ata kombëtare, qoft se i shesin mbrenda ose i kanë për eksportim por me kusht qi t' u shtrohen pikërisht ligjevet dhe regullorevet të vendit. Ata do të gëzojnë po atë liri për t' i kryëm punët e veta vetë, për të paraqit në doganë deklaratat e tyne, ose për të përdorë për këtë qëllim cilindo qi t' u pëlqejë, i ngarkuëm me fuqi (përfaqësuës) faktora, postjerë agjen-

ta dhe dorëzuësa ose përkëthyësa, në blerjen apo në shitjen e pasunivet të tyne, sende ose mallë. Ata do të kenë gjithashtu të drejtën me mbush të gjitha detyrat qi u janë besuëm prej bashkëatdhetarëvet të tyne ose prej të huajsh ose prej kombtarësh me cilsin e ngarkuëmvet me fuqi, faktora, agjenta, dorëzuësa ose përkëthyësa.

Qeverit e dy vëndevet do të përdorin të gjitha mjetet qi në dispozicjon me qëllim qi kontratat qi interesojnë punëtorët italjanë qi ndodhen n' Itali, në shërbim t' administratavet publike ose të ndënmarrjevet private, industriale, bulqësore ose të ç' do tjetër natyre, të respektohen si duhet prej dy palëvet t' interesuëm.

Personat qi do kenë bam shpërdorime ndaj punëtorëvet të naltpërmëndun ose do t' i kenë gënjyë me e bamun vëndin e vet prej premtimesh të rejshme, do të dënohen si mbas përmbajtjes së ligjavet në fuqi.

Për sa u përket pasaportavet shtetasit e sëcilës nga palët kontraktuësa do të gëzojnë, në tokat e tjetrit, po ato privilegje, immunitete, favore ose kondita të cilat i gëzojnë ose do t' i gëzojnë mbas këndej shtetasit e kombit ma të favorizuëm.

Ma në fund, nuk do të paguajnë, për arsyë të tregtis së tyne ose t' industrisë së tyne në qytetet apo vëndet e të dy Shtetevet, qoftë se vendosen në to, qoftë se banojnë në to përkohësisht, tagre tjera taksa apo vergjina në çfardo emën qi të jenë, ma të nalta se ato qi do t' u merren kombtarëvet ose shtetasvet të kombit ma të favorizuëm; dhe privilegjet immunitetet ose tjerat favore çfarëdoje, të cilat i gëzojnë ose do t' i gëzojnë mbas këndej, në lamën e tregtis e t'industris, qytetarët e njanit nga të dy shtetet, do të jenë të komunikue dhe qytetarët e shtetit tjatër.

Shtetasvet secilës nga palët kontraktuëse, nuk do të mund t' u merren në tokën e tjetrit pasunit veçse për nji shkak ligjuër i njofton me vleftë publike dhe këjo me nji dam-shpërblim të drejtë.

Art. 2. – Shtetasit e njanës nga palët kontraktuëse qi banojnë ose janë venduëm në tokën e tjetrës, dhe qi do të dishrojnë me u këthyëm në vendin e vet, ose qi do të dëboheshin me vendim gjyqësuër apo me masë policijet ligjërisht e pranuëme dhe e zbatuëme, ose si mbas ligjavet mbi lypsin apo zakonet, do të pranohen ato vetë dhe familjet e tyne, në ç' do

kohë dhe në ç' do rasë, në vendin prej kahit janë dhe ku do t' i kenë mbajtun të drejtat e veta si mbas ligjavet.

Shtetasit e secilës nga palët kontraktuëse do të gëzojnë në tokën e tjetrës palë nji mprojtje të plotë dhe të përgjithët për sigurimin e personavet të tyne, të pasuninavet dhe t' interesavet të tyne. Ata do të gëzojnë, për këtë qëllim, po ato të drejta dhe privilegje të njinjishme, qi u janë dhanë apo do t' u epen kombtarëvet, dhe shtetasvet të kombit ma të favorizuëm.

Gjithashtu, ata do të kenë, hyrjen e lirë dhe të lehtë pranë gjykatavet të ç' do shkalle dhe të ç' do juridiksjoni për t' i bam të vlefshme të drejtat e veta e për t' i mprojt këto, tue i u shtruëm ligjevet të vendit.

Për këtë qëllim ata do të mund të përdorin avoketën, notarë ose agjenta qi do të gjykojnë të zotët me i mprojtë interesat e tyne, dhe do të gëzojnë, përgjithsisht për sa u përket përpjekjevet drejtësore, po ato të drejta dhe ato privilegje qi do t' u jenë akorduëm në kohët e ardhshme kombtarëvet ose dhe shtetasvet të kombit ma të favorizuëm.

Art. 4. – Shoqniët tregtare dhe civile (bashkë me Institutet publike dhe private sigurimi) qi banojnë në tokat e njanës nga palët kontraktuëse e tuë pamë se qenë të ngrehuna si mbas ligjavet respektive, do të njifen, si mbas mënyravet dhe kufizimevet të caktuëme prej ligjavet në fuqi, sikurse kanë qenëjen legale në tokat e tjatrës, dhe do të munden aty me i zbatuëm të gjitha tagrat e veta, bashkë me atë qi me ngrehë padi përpara gjykatavet qoftë për të paditë, qoftë për të mprojtë.

Në ç' do rasë shoqënit e përmenduna do të gëzojnë në tokat e tjatrës palë kontraktuëse po ato taksa qi u janë akorduëm ose do t' u akordohen shoqënivet kësodore të nji vendit tjetër çfarëdo.

Shoqnit dhe Institutet e përmenduna nuk do të kenë me paguëm për zbatimin e punëravet të tyne tregtare ose industrore në tokën e tjetrës palë, vergjina, të drejta apo taksa, as të tjera ma të nalta, se sa ato qi u merren kombtarëvet ose shtetasvet të kombit ma të favorizuëm.

Art. 5. – Mbasi tagri i përfitimit (droit d' aubaine) nuk asht në veprim as n' Itali as në Shqipëri, shtetasit e dy palëvet kontraktuëse do të munden me vuëm dorë dhe me dispozuë mbi trashigimin qi mund t' u bijë, në virtyt te nji ligje apo dhjate, në nji tokë çfarëdo të tjetrës palë, n' egalitet me komb-

BKSH

tarët, pa iu shtruëm tjera konditavet apo konditavet ma të randa se këta. Do të kenë liri të plotë dhe të përgjithtë me blem, me pronuëm me blerje, shitje ose dhurate, këmbim, martese opo dhjatë ose trashigim *ab intestato* ose në çdo mënyrë tjatër, çfarëdo pasunije të tundëshme ose të patundshme pronimi i të cilavet u lejohet kombtarëvet, dhe me dispozuëm mbi to. Trashigimtarët dhe përfaqësuësit e tyne do të munden me u zanë vendin dhe me vuëm dorë mbi këtë pasuni vet ose me të ngarkuëm me fuqi qi do të veprojnë n' emën të tyne dhe si mbas formavet të zakonshme të ligjës, sikurse komtarët. Në mungesë të trashigimtarëvet ose përfaqësuësavet, pasunija do të përdoret po n' atë mënyrë sikurse do të përdorej në të tilla rasa ajo e nji shtetasit të vendit. Në të gjitha këto pikëpamje ata nuk do të paguëjnë, mbi vleftën e nji pasunije asnji vergji, kontributë apo barë tjatër ose ma e randë se ato të cilavet i shtrohen kombëtarët. Në të gjitha rasat, do t' u ipet leja shtetasvet të dy palëve kontraktuëse me eksportuëm pasunit e veta, d. m. th. italjanët prej tokës së Shtetit Shqipëtar dhe shqipëtarëvet prej tokës italjane, lirisht dhe pa u detyruëm në rasën e eksportimit, me paguëm një tagër çfardo, përse janë të huaj, dhe pa u detyruëm me paguem tagra të tjera ose ma të randa se sa ato qi i u shtrohen kombtarët.

Art. 6. – Në rasë rekuizicjonesh në njenin të dy Shtetet, interesat e shtetasvet të tjetrit, nën reservë të dispozitavet t'artikullit qi vazhdon për sa u përket rekuizicjonever ushtarake, do të gëzojnë nji mprojtje të plotë për sa i përket caktimit të çmimevet të rekuizicjonit, të cilat do të caktohen në nji masë të drejtë tue marrë para sysh rasat qi munden me influencuëm mbi vleftën e pasunivet qi do të rekuizicjonohen. Kuptohet vetiut se në ç' do rasë shtetasit e njenit nga të dy Shtetet nuk do të tratohen në Shtetin tjetër, në këtë të përpjekun, në nji mënyrë ma pakë të favorshme se sa shtetasit e nji fuqis së tretë çfarëdo.

Art. 7. – Shtetasit e së cilës nga të dy palët kontraktuëse, do të përjashtohen në tokën e tjetrës prej ç'do shërbimi ushtarak, qoftë në tokë qoftë në detë, n' ushtrin e rregullshme ose miliciën kombtare. Gjithashtu do të jenë të përjashtuëm nga çdo shërbim zyrtar i detyrshëm, drejtësor, administrativ ose i bashkis, nga ç'do rekuzicjon ose shërbim ushtarak, si edhe nga huat e detyrshme e tjera barrë qi mund të vehen për nevoja lufte ose prej rrjedhjes së tjera rasash të jashtzakonshme.

Por me gjith këtë bahet përjashtim për barrët qi janë të lidhuna me marrjen me qira të nji pasunije, si edhe për shërbimet e rekuizicjonet ushtarake të cilavet mund të grishen me i u shtruëm kombtarët si pronarë, zot tokësh apo qiramarrës ndërtesash.

Art. 8. – Në kurrnji rasë, nuk do të mund t' i ngarkohet ase kërkohet, për pasunit e nji shtetasit të njenit nga të dy Shtetet në tokën e tjetrit, taksa, tagra, kontributa ose barrë, tjera ose ma të nalta se sa ato qi do të mund t' i vehej apo ngarkohej po për atë pasuni, po t' ishte këjo e nji shtetasit të vendit. Veç kësaj mbetet e kuptuëme se shtetasit e njanës nga të dy palët kontraktuëse nuk do të munden, për sa i përket pasunivet të tyne të tundshme dhe të patundshme ose t' ardhunavet të tyne, me u detyruëm, në tokën e tjetrës palë, në tjera detyra, ndalime, taksa ose vergjina veçse n' ato së cilavet do t' i shtrohen kombëtarët apo shtetasit e kombit ma të favorizuëm.

Art. 9. – Ç'do përfitim qi njana nga të dy palët kontraktuëse do t' i ketë lëshuëm apo do të mund t' i lëshojë në kohën e ardhshme, në nji mënyrë çfarëdoje, nji fuqis tjetër për sa i përket vendimit apo zbatimit të zejevet, do të jetë i zbatuëshëm po n' atë mënyrë dhe n' ato kondita e n' atë kohë tjetrës palë.

Art. 10. – Qeverija italjane dhe Qeverija Shqiptare, tue dishruëm me siguruëm komunikimin e aktevet qi interesojnë shtetin civil të shtetasvet të Shtetit të tyne respektiv, zotohen me i kryëm reciprokisht dërgesat regullisht të legalizuëme t'akteve të lindjes, martesës ose vdekjes qi u përkasin dhe kryëm gjithashtu leçitjet e martesës.

Ky komunikim do të kryhet me udhën diplomatike, pa shpenzime në mënyrën e përdorun në secilin vend.

Aktet e naltpërmendun do të përcjelljen me nji përkëthim në gjuhë të vendit qi i dërgohen, ose në frengjisht.

Art. 11. – Këjo marrëveshtje do të ratifikohet dhe ratifikimet do të këmbehen në Romë sa ma shpejt qi të jetë e mundun.

Këjo do të hyjë në fuqi në datën e këmbimit të ratifikimevet dhe do të ketë vleftë për 10 vjetë tuë filluëm me atë datë. Në qoftë se njana nga të dy palët kontraktuëse nuk do t'a ketë njoftuë, gjasht muëj përpara mbarimit të perjudhës së naltpërmendun, qëllimin qi ka qi të marrin fund efektet e saja, këjo mbetet e detyrshme deri në mbarim të gjasht muëjvet tuë

filluëm me ditën në të cilën njana ose tjetra palë do t'a ketë lajmuë prishjen e saj.

Për këtë vërtetim të sa u tha fuqiplotët kanë nëshkruëm këtë marrëveshtje dhe e kanë vulos me vulat e veta.

Bamë në dy copë origjinale në Romë me njizetenand Fruër njimijë e nandëqind e njizetekatër.

Protokol i fundit

Në çasin e nënshkrimit të marrëveshtjes së vendimit të lidhun me datën e sodshme ndërmjet t' Italis e të Shqipënis, fuqiplotët e nënshkruëm kanë bamë deklaratën qi vijon dhe e cila do të bajë pjesë të pa ndame, po të kësaj marrëveshtje.

Ad. Art. 5. – Mbetet e kuptuëme se, për sa i përket të drejtës me marrun me blerje pasunina të patundshme fushtare, janë të zbatuëshme në tokët e secilës nga palët kontraktuëse ndaj shtetasvet të palës tjatër dispozitat e venduëm prej legjislatës respektive ndaj shtetasvet të çdo vendi tjetër ma të favorizuëm mbi këtë subjekt.

Po të jetë se njena nga palët kontraktuëse do të zbatonte kufizime ndaj shtetasvet të palës tjatër, këjo do të zbatojë po ato kufizime ndaj shtetasvet të palës qi do t' i ketë venduëm me legjislatën e vet.

Ky protokol, i cili do të konsiderohet si i pëlqyëm e i sanksionuëm prej palëvet kontraktuëse, pa tjatër ratifikim, vetëm me faktin e këmbimit të ratifikimevet të marrëveshjes së cilës i përket, u ba në dy copë, në Romë, me njizetenandë Fruër njimij e nandëqind e njizetekatër.

Nr. 46.

DEKRET LIGJË, 29 Majë 1925.

Mbi ndalimin e transitos

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Qershuer 1925, Nr. 24)

Mbassi n pa vëndimi i Këshillit Ministruër me 22-V-1925.

DEKRETOJMË:

1. Transita për tokë përgjithësisht asht e ndaluëme.
2. Ky dekret ligjë hyn në fuqi qysh nga data e shpalljes.
3. Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Tiranë, me 29-V-925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Nr. 47.

LIGJË, 21 Qershuer 1925.

Mbi rivumjen në zbatim t' organizimit të gjykatave

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Qershuer 1925 Nr. 32)

1. – Deri sa t' aprovohet Dekret-Ligja mbi organizimin e Gjykatave me datë 2 Maj 925, mbetet në fuqi organizimi i përparshëm.

2. – Kjo Ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes.

Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Unë, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqej ligjën e naltpërmendun e pranueme prej të dy dhomave legjislative dhe urdhëroj zbatimin e saj.

Tiranë, me 21 Qershuer 1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 48.

LIGJË, 12 Korrik 1925.

Mbi pranimin e Konventës për Bankën Kombëtare, të Konvencionit për huan prej 50.000.000 fr. ari për punë Botore, të Ligjit Organik të Bankës Kombëtare, të ligjit mbi regullimin e monedhave

(e botueue në Fletoren Zyrtare 31 Korrik 1925, Nr. 40)

Unë, Kryetari i Repubikës Shqiptare urdhënoj eksekutimin e

a) Konvencjonit të Bankës Kombtare të shtipilluem midis Qeveris Shqiptare dhe Grupit Financjar Italjan me datë 15 Mars 1925 e i ratifikuem me dekretin me datë 15 Mars 1925 dhe i shpallun në Fletoren Zyrtare me 18 Prillë 1925.

b) Konvencjonit mbi Huan për punërat Botore të Shqipnis prej 50.000.000 (pesëdhjetëmiljon) Fr. ari.

c) Ligjit organik të Bankës Kombtare të përbamun prej 60 artikujsh e të përmbledhun në 8 kaptina.

ç) Ligjit mbi rregullimin e Monedhës, me gjithë ndryshimet e bâmuna prej të dy Dhomave legjislative në konvencjonet e në ligjin organik të sipërpërmendun.

Kryetari i Repupblikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
e Zav. Ministri i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

KONVENTION

Unë Ahmet Mufid Libohova Ministri i Financavet e zëvëndës Ministri i Punvet të Jashtëme në përfaqësim të Shtetit Shqyptar nga njena ânë e Gr. Uff. Mario Alberti nga tjetra ânë, si përfaqësonjës i grupit financjar i rekomanduar nga Qeverija Italiane, kemi stipiluë, si vijon:

1. Grupi italjan i qërfaqësuëm nga Gr. Uff. Mario Alberti, ka për të formuëm mbrënda nandëdhjetë ditvet prej ratifikimit të kësajë kontrate „Banka Nacionale Shqypëtare" me nji kapital nominal prej fr. ari 12.500.000 (dymëdhjetë miljon e gjysmë) i ndam në katërqind e nandëdhjetë e pesë mijë akcjoneve ordinare me vleftje se e cila 25 fr. ari e në 100.000 akcjone themeltare me vleftje se e cila Fr. ari 1.25. Prej nji kapitalli të tillë nominal 2.500.000 Fr. ari kanë për të qënë të nënshkruara me nji herë e Banka ka për të të mund me filluëm aktivitetin e sajë porsa të ketë dhanë prova Qeveris Shqypëtare se ka effektivisht versun pranë nji Bandkës mâ në zâ në Svicër shumën në 2 500.000 Fr. ari ose ekuivalentin e saj.

2. Shtetasit Shqypëtar kanë për të pasun të drejtë me marrun pjesë në sottoscritionin e kapitalit deri në masën e 49$^0/_0$ të kapitalit akcjonar.

3. Drejtorija qendrore e Bankës ka për të pasur ndejtjen e sajë në Kryeqytetin e Shqypnis.

4. Kjo konventë ka për të pasun nji afat prej 50 vjeç me fakultet zgjatimi si mbas nji marrëveshtjes ndërmjet të së dy ralvet.

5. Banka ka për të qënë e përbame n' armoni me ligjët e Shteti e ka për të mundun me çelun dega si në Shqypëni ashtu edhe jashtë.

6. Banka ka për të pasun, ashtu si me me këtë konventë lejohet, këto të drejta e fuqina qi vazhdojnë:

a) me marrë mbi vehte (intrepredence) ç' do llojë operate bankare e financiare;

b) privilegjin eksklusiv me qitë kart-monedha, qi ka për të pasun nji kurs ligjuër e nji fuqi të patundëshme për pagesat në Shqypni;

c) me pregatitë të gjitha „coniazionet" e emisionet e monedhës praj metali, fitesat e të cilëvet kanë për të qënë të ndame në pjesët e njinjishme midis të Shtetit e të Bankës;

KONVENZIONE

Io Ahmet Mufid Bej Libohova, Ministro delle Finanze e Ministro ad interim degli affari Esteri, in rappresentanza dello stato albanese da una parte ed il Gr. Uff. Mario Alberti dall' altra, come rappresentante del gruppo finanziario raecomandato dal governo italiano abbiamo stipulato quanto segue:

1. Il gruppo italiano rappresentato dal Gr. Uff. Mario Alberti formera entro novanta giorni dalla ratifica der presente contrato «la Banca Nazionale d' Albania» con un capitale nominale di frs. oro 12.500.000 (dodici milioni e mezzo di franchi oro) diviso in 495.000 azioni ordinarie del valore ciascuna di frs. oro 25 ed in 100.000 azioni fondatrici del valore ciascuna di frs. oro 1.25. Di tale capitale nominale 2.500.000 frs. oro saranno sottoseritti subito e la Banca potra cominciare la sua attivita non appena avrà data la dimostrazione al Governo albanese di avere effettivamente versato presso una primaria Banca in Isvizzera l' importo di 2.500.000 frs. oro o il suo equivalente.

2. I cittadini albanesi avranno diritto di partecipare alla sottoscrizione del capitale sino al limito del 49 % del capitale azionario.

3. La direzione centrale della Banca avrá sede nella capitale dell' Albania.

4. La presente convenzione avra la durata di 50 anni, con facolta di proroga, previo accordo fra le due parti.

5. La Banca sara costituita in armonia colle leggi dello Stato e potra aprile filiali cosi in Albania che all' Estero.

6. La Banca avra, e le sono colla presente convenzione concessi, i seguenti diritti e poteri:

a) intraprendere qualsiasi operazione bancaria e finanziaria;

b) il privilegio esclusivo di emettere carta moneta, che avra corso legale e potere liberatorio pei pagamenti in Albania;

c) provvedere a tutte la coniazioni ed emissioni di moneta metallica, i cui profitti saranno divisi in parti eguali fra lo Stato e la Banca;

d) me marrun depozitë fondet e Shtetit e me pasun shërbimin e thesarit (tesoreria);

e) me pasaritë (negociare) huan qeveritare e të Bashkivet.

7. Gjithë shka nevojitet për ndërtesën, instalimin e të shtruarit e ndërtesavet të Bankës ka për të qënë i përjashtuëm nga të drejtat doganore. Me të marrun fund konçesjoni, ndërtesat e Bankës kanë për të qënun të zotnuëme nga Shteti Shqypëtar me nji vleftje siç kanë për të qënë e çmuëme. Çmimi ka për të qënë i caktuëm nga nji çmuës i zgjedhun mbas nji marrëveshtjes mjedis të Shtetit e të Bankës.

8. Të gjitha kapitalet e vleftjet (valori) private qi kanë për t' i-u mbështetun Bankës kanë për të qënë të lira prej ç' do konfiskimit qoftë direkte ose indirekte, prej ç' do sukuestrimit e kontrollimit nga ana e Shtetit, përveç në rastin e nji vendimit formale ligjor të gjykatorëvet ordinare, me qenë se Banka i shtrohet plotësisht ligjvet të Shtetit.

9. Drejtorija qendrore e Bankës, me ndejtjen në kryeqytetin e Shqypënis, ka për t' u përba prej dy misavet italjan e dy shqypëtar, kryësija ka për të qënë e ngarkuëme njënit prej dy misavet italjan qi ka për të pasun votin përfunduës. Dy misat Shqypëtar kanë për të qënë t' emnuëm nga Qeveria.

Deri sa Banka nuk ka për të pasun zhvillimin e nevojëshëm misat e Drejtoris qendrore të naltpërmendun mund të jenë të zbritun ndër dy misa, njeni italjan me votë përfunduës, tjetri shqiptar.

10. Në Këshillin e administratës të Bankës nji mis e nji komiser (sindaco) kanë për të qenë të shenjuëm prej Ministris së Financavet të Shqypnis.

11. Banka do të gatojë nji reservë metalike (ar ose serm në shufra a monedhë) me nji vleftje të nji të tretës të Bankanotëvet të lëshuëme. Për mbulimin e kusurit ka për të caktuë vëndim të patundëshëm, Statuti i Bankës i cili ka për të qënë i inspiruëm nga parimet qi ka për të caktuëm seksjoni financjar i Lidhjes së Kombevet për krijimin e Bankëvet qi presin të holla të ngrehuna në hijen e sajë në këto vjetët e fundit.

12. Qeverija ka për të pregatitë shpalljen e të gjitha ligjavet të nevojëshme për funksjonimin e rregullshëm e për nji qëndresë nacionale të monedhës, si dhe ligjat qi dishiplinojnë kurset bankare, obligacjonet, vleftjet, etj.

d) ricevere in deposito i fondi dello Stato e averne il servizio di tezoria:

e) negoziare prestiti governativi e municipali.

7. Tutto il necessario per la costruzione, le installazioni e l'arredamento degli edifici della Banca sarà esentato dai diritti doganali. Allo scadere della concessione gli edifici della Banca saranno riscattati dello Stato albanese al loro valore di stima, stabilito da un perito scelto di comune accordo fra lo Stato e la Banca.

8. Tutti i capitali e valori privati affidati alla Banca saranno sempre liberi da qualsiasi diretta od indiretta confisca, sequestro o controllo da parte dello Stato, eccetto il caso di sentenza formale e legale dei tribunali ordinari, dato che la Banca si sottomette senza restrizioni alle leggi dello Stato.

9. La direzione centrale della Banca, con sede nella capitale dell' Albania, sarà formata di due membri italiani e due albanesi, la presidenza sarà sempre attribuita a uno dei membri italiani, che avrà voto dirimente. I due membri albanesi saranno nominati dal Governo.

Finchè però la Banca non abbia preso il necessario sviluppo i membri della detta Direzione centrale potranno essere ridotti a due, uno italiano, con voto dirimente, ed uno albanese.

10. Nel Consiglio di ammistrazione della Banca un membro ed un commissario (sindaco) saranno designati dal Ministro albanese delle Finanze.

11. La Banca dovra costituirsi una riserva metallica (oro ed argento in verghe o monetati) del valore di un terzo delle banconote emesse. Per la rimanente coperture stabilirà precise norme lo Statuto della Banca, che si ispirerà ai principi stabiliti dalla sezione finanziaria della Lega delle Nazioni per la creazione della Banche di emissione sorte sotto i suoi auspici negli ultimi anni.

12. Il Governo provvederà alla emanazione di tutte le Leggi necessarie per ii regolare funzionamento della Banca e per un raziouale assetto monetario, come pure le leggi disciplinanti la materia cambiaria, le obligazioni, le ipoteche, ecc.

13. — Ky koncesjon ka karaktere të nji eksklusivitetit absolut e të pa tundëshëm.

14. — Banka përveç të marrunit pjesë të 10% qi i ruhet Shtetit Shqiptar në fitimet netto të përndame, nuk ka për të qenë e detyrueme të paguejnë asnji vergji ose taksë përveç të drejtës të patentës (vergji mbi t' ardhunat) në masën e ligjëvet që ndodhen tash në fuqi.

15. — Banka ka për të qenë e administrueme për sa të jet e mundun në konformitet me praktikën e zakonet e Bankavet italjane, në mbledhjet e përvjetëshme në të cilat se i cili akcjon ka për të pasun të drejtë vote kanë për t' u mbajtur n' armoni me dispozitat e legjislaturës italjane për sa i përket shoqënis për akcjone (in materia di societa për azioni).

16. — Të përndamit e fitimevet e shenimet e reservës kanë për të qenë të vendosuna në konformitet të Statutevet nga Këshilli administratuer, i cili do të mund të mblidhet në Shqipni ose n' Itali e të paraqiti mandej pëlqimin e mbledhjes t' akcjonistavet. Shteti Shqiptar ka për të marrun 10% të dobis netto të përvjetëshme.

17. — Se i cilli akcjonist asht përgjegjës deri në konkurencën e shumës t' akcjonevet të nënshkrueme.

18. — Banka asht detyrueme me përbam mbrenda nji muji që prej fillesës s' aktivitetii të sajë, shoqënin për zhvillimin ekonomik të Shqipnis n' Itali e në Shqipni ose gjetkë, me nji kapital prej 15.000.000 L. Italjane i ndamë 150.000 akcjone ordinare prej L. italjane 100 se e cila ose vleftjen e sajë. Nr. 10.000 të këtyne akcjonevet kan për të qenë të dorëzueme fal (gratuitamente) Qeveris Shiptare.

19. — Shoqënija, duhet t' i gjej Qeveris Shqiptare nji hua prej 50.000.000 fr. ari prej të cilave fr. ari 7.500.000 (shtatëmiljon e gjysmë) kanë për të qenë të dorëzueme në të parin vjetë; Fr. ari 7.500.000 (shtatëmiljon e gjysmë) në të dytin vjetë; Fr. ari 10.000.000 (dhjetë miljon) në të tretin vjetë; Fr.ari 12.500 000 (dymëdhjetë miljon e gjysmë) në të katërtin vjetë: Fr. ari 12.500.000 dymëdhjetë miljon e gjysmë) në të pestin vjetë.

20. — Interesat nuk kanë për të kapërcye të 7.50% përveç se kur në kohën e emisjonevet përqindja e ditës në pazar për të tilla operacjone të jet ma e naltë. Shpenzimet për emisjone, ndër të cilat hynë provigjonet, senserinat e të tjera për se cilën hua, nuk

13. La presente concessione ha carattere di esclusivita assoluta ed irrevoqabile.

14. La Banca, oltre alla partecipazione del 10% riservata allo Stato albanese sugli utili netti distribuiti, non sottostera ad alcuna imposta o tassa, eccetuato il diritto di patente (imposta sul reditto) della misura della legge attualmente in vigore.

15. La Banca sara amministrata per quanto possibile, in conformità con la pratica e le consuetudini bancarie italiane. Le assemble annuali in cui ogni azione avra diritto ad un voto, saranno tenuto in armonia colle dispozicioni della legislazione italiana in materia di societa per azioni.

16. La ripartazione dei profiti e le assegnazioni alle riserve verranno in conformita agli statuti deliberate dal Consiglio di amministrazione che potra riuniasi in Albania o in Italia e sotto posti poi alla approvazione della Assemblea degli azionisti.

Lo Stato albanese ricevera il 10% degli utili netti anuali.

17. Ogni azionista è responsabile sino alla concorrenza dell' ammontare delle azioni sottoscritte.

18. La Banca e tenuta a costituire entro un mese dall' inizio della sua attivita „La Societa per lo sviluppo economico dell' Albania" in Italia o in Albania o altrove, con un capitale di 15.000.000 di L. it. (quindici milioni di lire italiane) divisi in 150.000 acioni ordinarie di L. 100 ciascuna o equivalente. Nr. 10.000 di tali azioni saranno consegnate gratuitamente al Governo albanese.

19. La Societa dovra procurare al Governo albanese un prestito di 50.000.000 (cinquanta milioni) di frs. oro di cui frs. oro 7.500.000 (sette milioni e mezzo di frs. oro) saranno forniti nel primo anno; Frs. oro 7.500.000 (sette milioni e mezzo di frs. oro) nel secondo; frs. oro 10.000.000 (dieci milioni di frs. oro) nel terzo; frs. oro nel 12.500.000 (dodici milioni e mezzo di frs. oro) nel quarto; frs. oro 12.500.000 (dodici milioni e mezzo di frs. oro) nel quinto.

20. Gli interessi non eccederanno il 7.50% a meno che al momento delle emissioni il tasso corrente sul mercato per operazioni analoghe sia piu alto. Le spese per l' emissione, ivi incluse le provvigioni, senserie ecc. per ciascun prestito non potranno eccedre i limiti generalmente aplicati dai principali enti finanziari italiani in simili circonstanze.

21. La scadenza di tali prestiti non potra eccedere i 40 anni.

kanë për të kaluem kufinin e përgjithshëm t' aplikuem nga ma të parët trupe financiare italjane në të tilla raste.

21. – Kalimi i afatit për të tilla huana nuk do të kalojnë 40 vjet.

22. – Huaja ka për të qenun e përdorun ekslusivisht për këta vepra publike qi vazhdojnë :

a) rruga ;

b) të thame balangje e knetash ;

c) zhvillim' i bujqësis ;

d) ndërtesa urash.

23. – Shoqnija mund të formojë kompanina të nevojëshme që marrin mbi vehte të tilla punë o mnnd t' i marrë mbi vehte ajo vetë, ose mund t' i a mbështesin Shoqëninavet qi kanë qenë edhe ma parë. Secila prej këtyne vepravet ka për të qenë e mbarueme me nji pjesë të mjaftueshme të huas.

24. – Shoqënija, mbrenda tre muejvet të themelimit të sajë, do të marri mbi vehte ose do të vejë të tjera Shoqënina të lidhuna me tê me marrë për barrë të parat veprat botore edhe ashtu siç ka për të qenë prozhetue me një marrëveshtje me Qeverin ose do t'apin nji të katërtën e huas të vjetit të parë Por në qoftë se huaja nuk do të jepet, banka asht e detyrueme me i paradhanë për këtë vjetë qeveris, kundra bonavet thesare, me skadencë t' afërme, Fr. ari 2.500.000 (dy miljon e gjysmë) me mbarimin e vjetës. Në qoftë se në fundin e vjetit të parë shuma e naltpërmendun në Fr. ari 7.500 000 (shtatë miljon e gjysmë) nuk ka për të qenë e dorëzueme, Shtetit Shqiptar ka për të qenë i lirë me bam huana me të tjerë e nuk ka për të pasun asnji pengim ndaj Shoqnin.

25. – Të ngrehunit (rimborso) të kapitalit, e pagimi i pagesavet relative, i përdornin në përfundimin e vepravet botore të naltëpërmenduna ka për të qenë i garantuem nga Shteti Shqiptar me anë të burimevet qi vazhdojnë :

Të hyeme doganore (gadi) Fr. ari 6.000.000 (gjasht miljon)

Monopolet e Shtetit mbi krypë, kartë-cingaresh, shkrepsa (gati) Fr. ari 2.500.000 (dy miljon e gjysmë) për ç' do vjetë në të tanë Fr. ari 8.500.000 (tetë miljon e gjysmë). Në rastë që mbas nji paksimit t' ardhunat nga taksat e vergjivet në fjalë, shuma e parapame 8.500.000 Fr. ari do mund të ketë nji paksim sensible, Shteti Shqiptar asht i detyruem me përmbushnn deficitin tue e shenjuem t' ardhunat e vergjinavet të tjera ose

22. Il prestito sara esclusimente utilizzato per leseguenti opere publiche:

a) strade

b) prosciugamento di stagni a paludi

c) sviluppo agricolo

d) costruzione di porti

23. La Societa potra formare opportune compagnie che si assumano tali lavori o li assumera essa stessa, oppure li affidera a Societa gia essistenti Ciassuna di tale opere sara compiuta mediante una congrua parte del prestito.

24. La Societa dovra, entro tre mesi dalla sua fondazione, assumersi o far assumere dalle sue societa affiliate le prime opere pubbliche come saranno progettate d'accordo col Governo o fornire un quarto del prestito del primo anno. Se il prestito venisse a mancare, la Banea sarebbe tenuta ad anticipare a tale uopo al Governo, contro Buoni del Tesoro e breve scadenza, Frs. oro 2.500.000 (due milioni e mezzo di Frs. oro) o l'equivalente. La seconda rata di Frs. oro 2.500.000 (due milioni e mezzo di Frs. oro) sarebbe fornita alla scadenza di nove mesi ed i rimanenti Frs. oro 2.500.000 (due milioni e mezzo di Frs. oro) alla fine dell'anno. Se alla fine del primo anno il detto ammontare di Frs. oro 7.500.000 (sette milioni e mezzo di Frs. oro) non sara stato fornito, lo Stato albanese sara libero di contra prestiti con altri e non avra alcun obbligo verso la Societa.

25. Il rimborso del capitale, ed il pagamento dei relativi interessi, impiegato nel compimento di dette opere pubbliche, sara garantito dallo Stato albanese per mezzo dei seguenti cespiti;

Entrate doganali:

(circa) Frs. oro 6.000.000 (sei milioni Frs. oro).

Monopoli dello Stato sul sale, carta da sigarrette, fiammiferi:

(circa) Frs. oro 2.500.000 (due milioni e mezzo di Frs. oro) annualmente in totale Frs. oro 8.500.000 (otto milioni e mezzo di Frs. oro).

Nel caso che in seguito ad una diminuzione del gettito delle tasse ed imposte in questione la somma prevista di frs. oro 8.500.000 (otto milioni e mezzo di frs. oro) subisse una sensibile riduzione, lo Stato albanese sarebbe obbligato a colmare il deficit con l'assegnazione di proventi di altre imposte o con altre attivita,

me të tjera aktivitete. Të përmendunat Fr. ari 8.500.000 kanë për të qenë të shenjueme n' amortamenton e në pagimin e interesavet proporcjonalisht me sominishtrimin e huasë.

26. Kur ka për t' u pam nevoja me filluëm ekzekutimin e veprave botore Shteti ka për t' i-u mbështetun Bankës për me eksekutuë e për me marrë ofertat e nevojëshme. Qeverija ka për t' emnuem nji komisjon i cilli, bashkas me Bankën, ka për t' u kujdesuëm për shqyrtimin e ofertavet të tyne. Shoqënina e kompaninat me këto të lidhuna kanë për të pasun të drejtën me paraqitë ofertat për ekzekutimin e këtyne veprave botore e me kondita të njinjishme ata kanë për të pasun të drejtën e preferencës.

27. Veprat botore për të cilat Shoqënija ka për të pasun të drejtën e preferencës janë këto pika :

a) udhat e hekurta e tramvajet :

b) ndërtime limanesh, udhash, urash ;

c) bonifike e të thamje ;

28. Qeverija Shqyptare ka për të pasun të drejtën me emnuem dy administrator në Këshillin e Shoqënis.

29. Banka, shoqëninat e kompaninat me këtë, të lidhuna kan për të përdorun qytetas shqiptar deri 50% në të dytën e në të tretën kathegori të të naltpërmenduravet. Ekspertet teknikë janë të përjashtuëm. Proporcjoni caktuëm në favor të qytetasvet shqiptar mundet me u modifikuëm në rastin e nji imposibilitetit me gjetur në Shqipëni nji numër të mjaftuëshëm njerzish qi të jenë të zotët për shërbimin në fjalë.

30. Çdo konflikt qi të ngjanë n' aplikimin e kësaj konvente ka për t' u mbështetun ndreqja e sajë nji trupit të përbërë prej tre pleqësh, njeni i emnuem nga Banka e nji tjetër nga Qeverija, I treti mis ka për të qënë i zgjedhun në marrëveshtje me dy të parvet. Në rastë qi të mungojnë akordi në mjedis të dy të naltëpërmendunvet për të zgjedhunit e të tretit mis, ky ka për të qënë i zgjedhun nga kryetari i kortës juridike supreme të konfederatës Helvetike.

I nënshkruëm, i vulosun e i liqensuem nga të dy të naltpërmendunit, në kopjet e duplikuëme njena në gjuhën italisht e tjetra në gjuhën shqip. Në rasë kundërshtimi ka për të pasë besim teksti në gjuhën italisht me që asht i njoftun prej dy firmatarvet.

Tiranë, me 15-3-1925

Nënshkrue

MUFID LIBOHOVA MARJO ALBERTI

I detti frs. oro 8.500.000 (otto milioni e mezzo di frs. oro) saranno destinati all' amortamento ed al pagamento degli interessi proporzionalmente alla somministrazione del prestito.

26. Quando sembrera necessario di precedere alla esecuzione di opere publiche lo Stato si affidera alla Banca per provocare e ricevere le offerte necessarie. Il Governo nominera una commissione la quale, insieme con la Banca, procedera all' esame di tali offerte.

La Societa e le compagnie ad essa affiliate avranno il diritto di presentare offerte per l' esecuzione di dette opere pubbliche e a parità di condizioni, esse avranno diritto alle preferenza.

27. Le opere pubbliche per le quali la Societa avra il diritto di preferenza sono le seguenti:

a) ferrovie, tramvaie

b) costruzione di porti, strade, ponti

Për kundërshtimet qi mund të ngjasin mjedis të Bankës ose mjedis të degavet të sajë dhe nënshtetasvet Shqypëtar akcjonista ose privat, mbetë, natyrisht, pa mos u ndryshue kompetenca e zakonëshme e Gjyqevet të Shqypënis për juridicjonet e ndryshme, në të cilat do t' instalohen degat e Bankës.

Lutem Shkëlqesi të pranoni nderimet e mija ma të naltat.

Tiranë, me 4-VII-1925 Av. A. GAMBINO

Ligjë mbi rregullimin e monedhës
aprovue prej Dhomës së Deputetve me 23 Qershuer 1925
e prej Dhomës së Senatit me 5 Korrik 1925

Art. 1. – Monedha ligjore në tokën shqiptare asht franga ar.

Art. 2. – Kanka Kombtare e Shqipnis ka me u kujdesuë për të premit e këtyne monedhavet:

A R	Diametri në milimetër	Pesha gram	Lejimi kalimit peshës për copë tepër o mangut në miligram
Copa frang ar 100	25	32.258.06	32.26
Copa frang ar 20	21	6.451.61	12.90
Copa frang ar 10	19	3.225.80	6.45
ARGJENT			
Copa frangash 5	37	25.000.00	75.00
Copa frangash 2	27	10.000.00	50.00
Copa frangash 1	23	5.000.00	25.00
Copa frangnsh 0.50	18	2.500.00	17.50
NIKEL			

Monedhë me emrin «Lekë»

1.– Lekë ekuivalent (e barasuëshme) me 0.20 fr. ari.

0.50 Lekë ekuivalent (e barasuëshme) me 0.10 fr. ari.

A. S. E. Il Miuistro delle Finanze della Republica Albanese

TIRANA

Con riferimento alle domande rivoltemi dagli Onorevoli Senatori nella riuinione che ha avuto luogo il 1 Luglio 1925, in merito a gli articoli 2 e 14 della ,,Legge Organica për la Banca Nazionala d' Albania" e dello Statuto della Banca stessa ho l'onore di chiarire àll' Ecceleza Vostra che detti articoli si rifesiscono soltanto alle eventuali contro-versie fra gli azionisti da una parte e gli amministratori, i sindaci, i liqudatori o fra alcuni di essi dall' altra parte.

Per le eventuali controvsrsie fra la Banca o le diverse sue Sedi e i cittadini Albanesi, azionisti o privati resta naturalmente invariata la normals compntenza dei Tribunali Albanesi per le diverse giuridizioni delle quali saranno stabilite le Sedi della Banca.

Prego l' Ecellenza Vostra di voler gradtre l' espressione del mio miglior ossequio.

Tirana, 4 Luglio 1925. f-to Av. GAMBINO

Legge sull' ordinamento monetario approvata dalla Camera dei Deputati il 23 Giugno 1925 e dal Senato il 5 Luglio 1925

Art. I. – La moneta legale nel territorio della Stato Albanese e il franco oro.

Art. II. – La Banca Nazionale d' Albania provederà a coniare le seguenti monete:

ORO		Diametro milligrami	Peso grammi	Tolleranca di peso per pezzo in piu o in meno mgr.
Pezzo di franchi	100	25	32 258.06	32.26
Pezzo di franchi	20	21	6.451 61	12.90
Pezzo di franchi	10	19	3.225.80	6.45
ARGENTO				
Pezzo di franchi	5	37	25.000.00	75.00
Pezzo di franchi	2	27	10.000.00	50.00
Pezzo di franchi	1	23	5.000.00	29.00
Pezzo di franchi	0.50	18	2.500.00	17.50

NICHELIO

Monete denominare «Lekë»

Pezzo di 1.– Lekë equivalente a franchi 0.20.

Pezzo di 0.50 Lekë equivalente a franchi 0.10.

BKSh

TUNÇ

Subdivisionet e Lekës (nëndarje e Lekës)

0.25 Lekë ekuivalent (e barasuëme) më 0.05 fr. ari.

0.05 Lekë ekuivalent (e barasuëme) me 0.01 fr. ari.

Art. 3 – Monedhat arit dhe copat e argjentit prej fr. 5 të përbame prej 900 të mijta në lejimin e kalimit të dy të mijavet ma tepër o mangut.

Art. 4. – Copat e njizet e dhetë qindarësh të nikelit kanë qenë të përbamë prej nikelit me 1000 të mijta e lejimi i kalimit të 25 të mijtavet më tepër o mangut.

Art. 5. – Copat e nji e dy frangash e ata të pesëdhjetë qindarësh janë të përbame prej 835 të mijtavet në lejimin e kalimit të tri të mijtavet më tepër o mangut për se të cilin nga këto dy metale.

Art. 6. – Pjestimi i monedhavet të tunçit caktohen në 960 të mijta bakër e 40 të mijta kallajit me lejimin e 5 të mijtavet tepër o mangut për se cilin nga këto të dy metalet.

Art. 7. – Askush nuk asht i detyruem të pranojë në pagesë nji shumë ma të madhe se Fr. ar 50 në monedha argjent; Arkat e Shtetit dhe Banka Kombëtare e Shqipnis. janë të detyrueme të pranojnë monedha argjenti në masa të pakufizueme.

Monedhat prej nikelit e prej tunçit mund të përdoren në pagesë vetëm n' at sasi deri sa të jetë nevoja e përmbushjes së pjesvet të frangut.

Art. 8. – Monedhat qi janë të mbeta veç sasis së lejueme edhe të caktueme me ligjë si edhe monedhat e cungueme (të vderuna, të birueme të prishuna) sa mos me ju dukë shkrimet e ftyra të fërkueme në mënyrë qi mos të jenë e mundun pamja e shtypja në të dyjat anët ose nga njena vetëm, janë të përjashtueme nga përdorimi e mbledhen vetëm në Zyrën e shkembimevet të Bankës Kombëtare të Shqipënis si landë me vleftje.

Art. 9. – Ndër kontrata e akte, ndër rregjistra të llogarivet t' administratavet si edhe në ç' do rregjistër ose dokument qi i përket interesavet të popullit vleftjet do të njehsohen dhe të tregohen në Frang e qindar të monedhës Shqipëtare.

Po, kjo detyrë për me tregue vleftjet në frang e qinder të monedhës Shqipëtare i ngarkohet të gjithë shkrimevet qi i përkasin llogarivet të privatve tue fillue që prej 1 Kallnduer 925.

Kundravajtësit do t' i shtrohen gjobës prej Frangave 5 deri në 50.

BRONZO

Suddivisioni del Lek

Pezzo di 0.25 Lek equivalente a franchi 0.05

Pezzo di 0.05 Lek equivalente a franchi 0.01

Art. III. – Le monete d' oro e il pezzo d' argento di franchi 5 sono al titolo di millesimi 900, con la tolleranza di due millesimi in piu od in meno.

Art. IV. – I pezzi da venti e dieci centesimi di nichelio consisteranno nichelio al titolo di 1000 millesimi, con la tolleranza di 25 millesimi in piu o in meno.

Art. V. – I p zzi di uno e due franchi, e cinquanta centesimi sono al titolo di 835 millesimi con la tolleranza di tre millesimi in piu od in meno.

Art. VI. – La lega delle moneta di bronzo e fissata nella proporzione di 960 millesimi di rame e di 40 millesimi di stagno col la tolleranza di 5 millesimi in piu od in meno per ciascuno dei due metalli.

Art. VII. – Niuno e obbligato a ricevere nei pagamenti una somma magiore di franchi cinquanta in monete divisionarie d'argento, le quali sono invece senza alcun limite ricevute nell casse della Banca Nazionale d' Albania e in queli dello Stato.

Le monete di nichelio e di bronzo possono essere impiegate nei pagamenti soltanto a compimento delle frazioni di franco.

Art. VIII. – Le monete calanti oltre la tolleranza determinata dalla legge e tutte quelle tosate, bucate, sfigurate e logore per modo che non ne sia pin riconsiciblite l' impronta da entrambi i lati da uno solo sono escluse dal corso e ricevute solamente come pasta negli uffici di cambio della Banca Nazionale d' Albania.

Art. IX. – Nei contratti e negli atti publici, nei registri di contabilita delle publiche amministrazioni, e in ogni altro libro o documento che riguardi gli interessi del publico i valori devono essere calcolati ed espressi in franchi e centesimi della moneta Albanese.

Il medesimo obbligo di esprimere i valori in franchi e centesimi della moneta albanese e esteso a tutte le scriture private a datare dal primo Gennaio 926.

I contravventori sarano soggeti a multa da franchi 5 a franchi cinquanta.

Art. 10. — Dënohen me burgim prej tri deri në dymëdhet vjet:

1) cilido qi ban monedha të përgjashme, atyne të Shtetit;

2) cilido qi me çëfarë do mënyrë ndrron monedhat e verteta tuë i dhanë këtyne dukën e nji vleftjes ma të madhe;

3) cilido qi në marrëveshtje me ndokend i cili ka ba ose asht tue ba pergjasim ose ndryshim në monedha, shtjen këto në Shtet ose i shpenzon ose në mënyrë tjetër i ven në përdorim ose ja ep të tjervet me qëllim qi t'i shpenzojnë ose t'i venë në përdorim në ndonji mënyrë tjetër.

Art. 11. — Cilido qi ndryshon cilësin e monedhavet kombtare tue i paksue në ç' do mënyrë vleftjen ose në marrëveshtjeje me atë i cili ka bam ndryshimin kryen ndonji nga veprat e përmenduna me pikën 3 t' art. 10, dënohet me burgim prej nji deri në pesë vjetë.

Art. 12. — Cilido qi ka qenë në marrëveshtje me ate i cilli ka ba ose ndihmue për përgiasim ose ndryshimin e monedhavet i shpenzon këto ose i ven në përdorim asht i dënuem, në qoftë se janë modhedha të përmenduna n' art 10. me burgim prej nji deri në shtatë vjetë e me burgim prej nji vjete deri në dhetë në qoftë se monedhat janë të rasës së përmendun në pikën e I. t' art. në fjalë. Në qoftë se asht rasa e monedhavet të përmenduna n' art. 11 dënimi asht me burgim prej tre e deri në tridhjetë muej. Në qoftë se fajtori monedhat në fjalë i ka pranue besueshëm dënim i burgimit asht deri në gjasht muej burg ose me gjobë deri më 2000 (dymij franga)

Art. 13. — Cilido qi ban ose mban vegla të nevojëshme vetëm e vetëm për gjasimin ose ndryshimin e monedhavet dënohet me burgtm prej nji deri në pesë vjetë.

Art. 14. — Kur për deliktet e parapame n' artikujt e kaluem zbatohet dënimi i burgimit duhet qi këtij t' i shtohet edhe gjoba si edhe të nenvuemt e fajtorit nën roje të vecantë t' autoritetevet të qetsis botore.

Art. 15. — Lirohet nga dënimi ay fajtuer i cili kryen ndonji delikt nga ato të parapam n' artikujt e naltshenjuem po kje se ky para se autorizet të kenë dijeni, mrrinë me ndalue përgjasimet, ndrrimet e qitunit në përdorim të monedhavet të përgjasueme e të ndryshueme.

Art. 16. — Ka ç'do fuqi nga ato të parapame ma nalt, kartëmonedha e cila në themel të lejimit të veçant do të qitet nga

Art. X. — E punito con la reclusione da tre a dodici anni:

1) chiunque contraffara le monete nazionali;

2) chiunque alteri in qualsiasi mondo menele genuine. col dare ad esse l' apparenza d' un valore superiore;

3) chinque di concerto con colui che abbia eseguito o sia concorso ad eseguire la contraffazione o alterazioni di menete, le introduca nello Stato o le spenda o le metta altrimenti in circolazione, ovvero, le procuri ad altri fine di spenderle o di metterle altrimenti in circolazione.

Art. XI. — Chiunque altera la qualita delle monete nazionali scemandone in qualsiasi modo il valore, ovvero di concerto con chi abbia cosi alterato la moneta, commetta alcuni dei fatti indicati nel numero tre del precedente articolo e punito con la reclusione da uno a cinque anni.

Art. XII. -- Chiunque, senza concerto con chi abbia esseguito o sia concorso ad eseguire la contraffazione o l' alterazione, spende o mette altrimenti in circolazione monete conffratte o alterate e punito, se traltasi di quelle indicate all'articolo decimo, con la reclusione da uno a sette anni, e da tre a dieci, nel caso preveduto dal primo capoverso; e se trat tasi di quelle indicate nell' articolo undicesimo, con la reclusione da tre a trenta mesi.

Se il colpevole abbia ricevuto in buona fede le monete la pena e della detenzione sino sei mesi o della multa sino a franchi due mila.

Art. XIII. — Chiunque fabbrica o detiene strumenti destinati esclusivisamente alla contraffazione o alterazione di monte e punito con la reclusione da uno a cinque anni.

Art. XIV. — Quando per i delitti preveduti negli articoli precedenti si applica la pena della reelusione sono sempre aggiunte la multa e la sottoposizione alla vigilanza speciale dell' autorita di publica sicurezza.

Art. XV. — Va esente da pena il colpevole di alcuni dei delitti preveduti dagli articoli precedenti se riesca, prima che l' autorita ne abbia notizia, a impedire la contraffazione, l' alterazione o la circolazione delle monete contraffatte o alterate.

Art. XVI. — A tutti gli effetti sopra previsti, la carta mo-

BKSH

Banka Kombtare e Shqipnis edhe asht e barasueme me monedhën e metalit.

Dhe ata qi përgjasojnë akcjonet e Bankës Kombtare të Shqipnis marrin po ato dënime të cilat janë parapa për pëgjasuesit, ndryshuësit edhe ato qi përhapin monedha të përgjasuëme (false).

Art. 17. – Banka detyrohet të nxjerrë e të vënë në çirkulacjon edhe multiplikatat e Lekës në kartëmonedhë.

Art. 18. – Banka Kombtare Shqiptare detyrohet me vuë në cirkulacjon ma parë Lekët me subdivizjonet (nerdarjet e tij) metalike dhe multiplat e tij në kartmonedhë.

Për kohën e vuëme në çirkulacjon të frangut argjent ekuivalent (e barasuëshme) me frangat ar. Shoqërija e Bankës detyrohet me ra d' acordo ma parë me Qeverinë Shqiptare. Këjo kohë nuk do të jetë ma shum se dy vjet.

Art. 19. Bjen nga fuqija ç'do dispozitë në veprim e cilla asht në kundërshtim me artikuj e sipërthanun.

BKSH

neta, che su base di esclusivo privileggio emettera la Banca nazionale d' Albania e parificata alla moneta metalica.

Anche i falsificatori della azioni della Banca Nazionale d' Albania incorrono nelle stesse pene previste per i falsificatori, controfatori e spacciatori di moneta falsa.

Art. 17. – La Banca Nazionale d' Albania dovra mettere in circolozione multipi di „Lekë" in carta moneta.

Art. 18. – La Banca dovra in un primo periodo mettere in circolazione monete divizionali in „Lekë" in monete metaliche e i snòi multipli carta moneta.

Prima di mettere in circolzione delle monete d' argento di un franco oro la Banca dovra prendere accordi con il Governo Albanese.

Questo periodo non puo durare piu di due anni.

E abrogato qualunque disposizione vigente in opposizione ai precedenti articoli.

BKSH

Nr. 49.

LIGJË, 14 Korrik 1925.

Ligji mbi ngritjen e moratoriumit të Korçës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 31 Korrik 1925 Nr. 40)

Art. I. — Ngrihet Moratoriumi në e rethinat e saja pa asnji përjeshtim (eksepsion) qysh nga shpallja e këshaj Ligje.

Art. II. — Populls:a e Korçës e të rrethinavet të saja asht e lirë të mprojë të drejtat e veta që patën qënë ndaluë nga shkaku i Moratoriumit tue u bindur Ligjëvet në veprim të Republikës.

Art. III. — Dispozitat e ligjës me datë 14 II-1922, vazhdojnë gjithnjë për pagimin e huas qi përshinë Moratoriumi. Kamatë e këtyne borxhevet rregullohen si mbas ligjës së moratoriumit.

Art. IV. — Në rast qi huadhanësit të refuzojnë për të mar të hollat në bazë të kësaj Ligje huamarsi ka të drejtë të depozitojë shumën e huas në zyrën e përmbarimit dhe lajmëron huadhansin me nji lajmesë për depozitimin qi ka bërë. Në mbarim të dhjet ditve të këtij afati zyra përmbaruëse lajmëron zyrën Kadastriale për të ngritun rehem ose Vefan e pasunis të huamarsit.

Art. V. — Në shpalljen e kësajë ligje dispozitat e gjith ligjëvet qi janë në kundërshtim me këtë mbeten pa fuqië.

Art. VI. — Kjo Ligjë hynë në fuqië qysh prej ditës sdpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. VII. — Ministria e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Tiranë me, 14 Korrik 1925

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Unë Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqej ligjën e naltpërmendun pranuë prej të dy Dhomavet legjislative dhe urdhënoj zbatimin e sajë.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 50.

LIGJË, 27 Korrik 1925.

Për përjashtimin nga tagri doganuër të 30 tonellatave çimento për vorezat Serbe

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Gusht 1925, Nr. 42)

1. Përjashtohen nga tagri Doganuër 30 (tridhjet) tonelata

çimento qi Legata Jugosllave do t' importojë për ndreqjen e vorrevet Serbe të mbetun në Tiranë.

2. Kjo Ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

3. Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Financavet
MUFID LIBOHOVA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë ligjë, të pranuëme prej të Dhomave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 51.

LIGJË, 21 Korrik 1925.

Mbi ndrimin e § I. të nenit 5 dhe të nenit 10 të ligjës s' organizimit të gjyqeve me datë 28 I-1923

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Gusht 1925, Nr. 42)

Paragrafi i I. i Nenit 5.

Gjyqi i Diktimit ndahet në dy dega:

1. Dega e çështjevet Civile.
2. Dega e çështjevet Penale.

Ç' do degë ka nji Kryetar, katër antar, nji Nd. Antari, nji Kryesekretar, dy Sekretar e nji Protokolist-Archivist.

Se e cilla degë e Diktimit ashtu dhe Kryeprokurorija kanë nga nji Shërbëtuër.

Kryetarët e këtij Gjyqi kryesojnë degat e tyne, por në rasë të mbledhjes së përgjithëshme, detyra e Kryesis, i përket Kryetarit të degës Civile.

Neni 10. — Gjyqi i Diktimit veprimet e shqyrtimet do t'i bazoj në dispozitat e procedurave Civile e Penale.

Paragraf i Përkohëshëm.

Dispozitat e këtij neni nuk përfshijnë aktet e padinavet qi asht dhanë për to, vëndim për plotësim.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Unë, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqej ligjin e sipërme pranuë prej dy Dhomave legjislative dhe urdhënoj zbatimin e tij.

Tiranë, më 21 Korrik 1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 52.

LIGJË, 21 Korrik 1925.

Mbi regullimin e pasunis së Shtetit në Sarandë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Gusht 1925, Nr. 42)

1. Për rregullimin e pasunis së Shtetit qi ndodhet në Sarandë dhe për të shiquëm të drejtat e Shtetit mbi këtë pasuni, formohet nji komisi arbitrale e përbëme prej pesë personave t' emnuëm nji prej Ministris së Financavet, nji prej Ministris së P. Botore e Bulqës's dhe dy me unanimitet ose shumicë votash prej tregtarvet dhe banorvet në Sarandë qi kanë të bajnë me pasunin e Shtetit dhe prej Kretarit, ose nji antarit të Diktimit, të zgjedhun prej Këshillit të këtij Gjyqi.

Komisija e kryesuëme prej Kryetarit ose antarit të Diktimit, fillon detyrën në Sarandë. Vendimet e kësaj komisije merren me unanimitet ose shumicë votash.

T' interesnëmit në qoftë se mbrenda 15 ditve prej datës së komunikimit të kësaj ligje, në Bashkin e Sarandës nuk emnojn arbitrat qi u përkasin si mbas këtij artikulli, humbasin të drejtën e marrjes pjesë në këtë komisi.

2. Detyrat e kësaj komisije jan:

a) Do të rregjistrojë në nji rregjistër të posaçëm gjith ndërtesat qi janë ose do të provohen pasuni e Shtetit.

b) Do të shqyrtojë dokumentat e t' interesuëmvet qi pretendojmë zotnimin mbi ndërtesat; do të marrë parasyësh gjith arësyët e provat ligjore, kur shef nevojë, sa për spiegime, thërret dhe ndëgjon t' interesuëmit mbi këtë çashtje. Nuk përfshihen nga këjo ligjë ndërtesat për të cillat asht filluë gjyqi përpara datës së kësaj ligje.

c) Do të vendojë shumat e qiranavet të mbetuna deri ditën e vëndimit të komisis, vieftat e tokave të pushtuëme prej ndërtesavet e do të caktojë nji të drejtë tokë të përvitshme që prej vitit të pushtimit të tokës deri ditën e pagimit të vleftës së sajë.

ç) Tokat e ndërtesavet, qi me vendim të komisis do të quhen e pranohen private, i mbeten të zotëve të ndërtesave kundrejt nji shpërblimit ligjuër të paguëm prej të zotvet.

d) Të zotët e ndërtesavet tue paraqitun vendimin e komisis dhe dishmit e pagesavet qi u ngarkohen, kanë të drejtë të marrin dokumentat Kadastriale nga Zyra kompetente.

dh) Kushtet e kontratavet të bamuna në kohën e ndreqjes së ndërtesavet e në vazhdim të regjimevet të ndryshme, janë të vleftëshme.

3. Vendimet e komisis, qi i notifikohen Ministris Financavet dhe t'interesuëmvet, janë të preme dhe eksekutohen prej Zyrës së Përmbarimit si mbas ligjës së posatshme, të drejtavet të Shtetit (tahsili emval nizamnamesi).

T'interesuëmit mund t'i drejtohen Gjyqit kundra vendimit të komisis mbrenda 15 ditve prej ditës së notifikimit të vendimit; për ndryshe vendimet e komisis marrin formen e preme; gjith këto veprime nuk ndalojnë përmbarimin e vendimit.

4. Komisija e parë e formuëme si mbas dekret-ligjës me datë 29 III-1925 pushohet dhe vendime e saj jan të pa fuqiëshme.

5. Ndërtesat e ngrehuna prej ushtrivet të huaja në kohë të pushtimit ushtrijak të Sarandës e të rrethinavet të saj ipso-jure janë të Shtetit Shqiptar; gjith ashtu ç'do akt-shitblerjeje mbi këto ndërtesa midis cilido personi, asht ipso-jure i pa vleftëshëm.

6. Ministrija e Financavet autorizohet t'instalojë refugjatët Shqiptarë në pasunin Shtetnore të Sarandës, me konditë qi të mos kenë të drejtë shitjeje për 25 vjet.

7. Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

8. Ministrija i Financavet, e Botore-Bulqësis, dhe ajo e Drejtësis detyrohet me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Financavet — *Ministri i Drejtësis*
MUFID LIBOHOVA — P. POGA

Minis. P. Botore e Bul.
K. KOTTA

Unë, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqej ligjën e sipërme dhe urdhënoj ekzekutimin e saj.

Kryetari i Rebublikës
A. ZOGU

Nr. 53.

SHTOJCË, 18 Korrik 1925.

E Statutit Themeltar mbi ndryshimin e nenit 2

(e botueue në Fletoren Zyrtare 12 Gusht 1925, Nr. 42)

Asamblea Legjislative në mbledhjen e sajë me 18-VII 925 e

voţojë shtojcën e artikullit 2. të Statutit Themeltar të Republikës Shqipëtare si ç' vijonë:

Shtojcë Art. 2. të Statutit

I. As nji ndryshim kufini nuk mund të bahet veç se me nji vendim të marrun pas dispozitave të parapame n' artikullin 141 të këtij Statuti.

II. Këjo shtojcë Statuti hyn në fuqi çë sot.

18. VII 925

Kryetari Asambles Legjisllative
Kryetari i Senatit
ESHREF FRASHERI

Nr. 54.

KONVENCJON, 25 Korrik 1925.

Me Hekurudhat e Shtetit Mbretnor t' Italis për kërkim e shfrytzim vaj guri e j.

(i botuem në Fletoren Zyrtare, 14 Gusht 1925, Nr. 43)

Ndërmjet t' Exelencës së Tij Ministrit të P. Botore e Bulqësiës vepruës n' emën e për njehsi të Shtetit Shqiptar, për t' u shenjue tash e mrapa si „Shteti" në njënen anë:

E të hekur-udhave të Shtetit Mbretnor t' Italiës të përfaqësueme prej Z. Ugo Pioli i emnuem posaçisht dhe fuqiplotës, për t' u shejue tash e mbrapa si „Konçesjonari" (term qi shenon Hekur udhat e Shtetit Mbretnor t' Italis si edhe Shoqniët t' organizueme prej tyne si kur flitet n' artikullin 9 të këtij konvencion) në tjetrën anë:

Asht konvenue e vendue çka vazhdon:

Art. 1. Shteti i akordon Konçesionarit të drejtën eksklusive për kërkim dhe shfrutzim të vojgurit, gaz natural, bitum e shkame asfaltike të cillat prodhojnë vojguri tuej i distilue ndër tokat e me konditat e përmbajtuna në kët konvencion.

Periudha e Kërkimeve

Art. 2. Konçesionari detyrohet me tregue në nji afat dy muejsh tuej nisë që nga data e nënshkrimit të këtij konvencion kufiët e tokavet (përimetres) që i konsideron për me ba kërkimet dhe me këto kondita;

a) Sasia e përgjithshme e perimetrave të mbajtun nuk ka me muejt me përshie nji sipërfaqe ma të madhe se 50.000 (pesdhetmi) hektar.

b) Nga caktimi i perimetravet kanë me u përjashtue vendet (localités) e ndalueme prej ligjës, si edhe tokat mbi të cillat, partie të treta kan fitue të drejtën për eksploration dhe për shfrytzim të substancave të tregueme në art. 1 përpara nënshkrimit të këtij konvencion.

c) Numri i perimetrave nuk ka me muejt me kenë ma tepër se katër.

Art. 3. Konçesjonari ka me pasë të drejtën eksklusive, mbrenda tri vjetvet tuj nisë që nga data e shpalljes të ratifikimit të këtij konvencion në gazetën zyrtare, me ba nër perimetrat e tregueme n' artikullin e ma parëshëm, të gjitha punimet e kërkimit, si në sypërfaqe ashtu në thellësi, me qëllim që me zbulue substancat e tregueme n' art. 1. Kjo perjudhë tri vjetëshe qi tash e mbrapa ka m' u shenjue „Perjudha e Kërkimit" në marrëveshtje të përbashktë ka me muejt me u zgjatue rishtas për nji afat t' arsyeshëm, në kjoftë se ka nevojë nga rrethana (circostances) të posaçme.

Art. 4. Për veç punimeve sypërfaqore e të kërkimeve me pusa e galeriena, Konçesjonari detyrohet me shbirue (forer) mbrenda perjudhës së kërkimeve, të paktën shtat pusa prej të cilleve tre do të kaptojnë nji thellësi 1000 (njimi) metrash, për veç rasës kuër gjindet vojguri në nji thellësi ma të pakët

Art. 5 Konçesjonari nuk ka me muejt me disponue mbi mineralet e nxjerruna mbrenda përjudhës së kërkimit veç se për analiza e prova industriale e këtë në nji masë pa kapërcye 100 njiqind) tonelate për gjith e cillin substance të tregueme n' art. 1. Por gjithnji ky ka me muejt me i përdorue lirisht n' ato sasie sa janë të nevojshme për punimet e kërkimit.

Në rasë që produkcioni, mbrenda kësaj perjudhe do të jet ma i madh se sasienat e sipërpërmenduna, Shteti ka me akordue nji leje përdorimit të lirë me të drejt eksportimit, mbasi të paguhet përpara nji redevance 13.5 (trembëdhet e gjysë) përqind të sasienave të tregueme në leje.

Art. 6. Konçesjonari ka me i qaraqitë Shtetit krye gjasht muejsh nji raportë që të përmbajë studimet e punimet e bame për kërkim dhe përparimin e tyne mbrenda gjasht mujorit të para – kaluem. Kësaj raporte kanë me u bashkanjit planet e har-

tat e nevojshme dhe Konçesjonari do të japi të gjitha informatat suplementare që Shteti mund të kërkojë.

Perjudha e shfrytzimit

Art. 7. – Në çë farë do kohet perjudhës së kërkimit ose në mbarim të kësaj perjudhe, në kjoftë se Konçesjonari e gjykon se eksiston vojguri nër sasiena të shfrytëzueshme tregtarisht, ka me pas të drejtë me zgjedhë në perimetrat e treguem n' art. 2. sypërfaqet nër të cilat aj ka me pas të drejt eksklusive për kërkime të ma-pastajshme e për shfrytzim të substancave të treguëme n' art. 1 deri më 31 Dhetuër 1985, dhe me konditat e treguëme në artikujt qi vazhdojnë. Periudha e përfshiëme mbrenda të zgjedhunit të sypërfaqeve të sypër-përmenduna dhe data 31 Dhetuer 1985 ka m' u shenjuë si «Periudha e Shfrytzimit».

Art. 8. – Të zgjedhunit e sypërfaqeve që konçesionari ka me muëjtë për me ba nër to punimet që i përkasin periudhës së shfrytzimit i nënvehet konditavet që vazhdojnë:

a) Sypërfaqet e zgjedhuna, krejtësisht nuk do të kalojnë 30.000 (tridhet mijë) hektarët.

b) Këto sypërfaqe nuk do të kapërcejnë caqet e perimetravet të treguëme n' art. 2.

Art. 9. – Me qëllim që me i dhanë nënshtetasvet shqiptar posibilitetin me marrë pjesë në sipërmarrjen qi ban objekt të këtij konvencjonit, Konçesjonari detyrohet me formuë, nër katër mujët e parë të perjudhës së shfrytzimit nji ose ma shumë shoqëniëna anonime qi të kenë për qëllim zbatimin e programit të shfrytzimit dhe ma të madhin zhvillim (developpement) të dobinavet (benefices) që rrjedhin prej këtij konçesjoni. Konçesjonari do t' i lëshojnë (ceder) shoqniëvet të sypër përmënduna të gjitha të drejtat qi i janë akorduëm me kët konvencion. Kapitali i këtyne shoqëninave nuk ka me kenë ma i vogël se 10.000.000 (dhet miljon) frank ar dhe ka me mujt me u shtuë (augmenter) si mbas nevojave të sipërmarrjes.

Ky (kapitali) ka me u nda nër akcione i vleftës nominale jo ma të naltë se 50 (pesdhetë) frank ar, prej të cillit 40% ka me u rezervuë, për tre muëj rresht, nënshkruësvet nënshtetas shqiptar. Në kjoftë se në fund të kësaj perjudhe tremujshe të gjitha ose nji pjesë e akcionavet të rezervuëm për nënshkrim kombëtar nuk ka me kenë e nënshkruëme, kan me u lanë këto të gjitha ose kjo pjesë e pa nënshkruëme në dispozicion të Qe-

veriës Shqiptare për dy muëj që të mund të bahet nënshkrimi prej Thesariës së Shtetit. Në fund të këtyne dy muëjve akcjonet e rezervuëme që nuk janë nënshkruë prej Shtetit ose prej nënshtetasve shqiptar, kan me u liruë nga ç' do të drejtë optioni dhe Konçesjonari ka me muëjt me disponuë mbas dëshirit të vet.

Shteti ka të drejtën me emnuë nji antar në Këshillin t' administratës të Shoqniënavet të sypër përmenduna. Nji kopje e bilanceve vjetore të shoqniënavet ka me ju komunikuë Shtetit.

Art. 10. – Konçesjonari detyrohet me i paguë Shtetit, mbrenda të gjith periudhës të vleftës (validié) së këtij konvencjoni nji taks fiks dhe nji redevancë përpjestimore. Takka fikse ka me u paguë nji frank e gjysë ar (1.50) për nji vjet e për nji hek'ar toket të dhanun Konçesjonarit. Kjo taksë ka me u paguë të parën herë për dy vjet paradhanje, mbrenda muëjit që vjen mbas ratifikimit të këtij konvencioni.

Redevenca përpjestimore ka me u paguë kryë tre muëjsh në përpjestim të trembëdhet e gjysë (13.5) për qind të prodhimit të vojgurit të pa punuëm (brut) që asht bajtë prej pusave nër reservuare, tuë zbritë sasiënat që janë konsumuë për punimet e shfrytzimit. Shteti ka me pasë të drejtë me kërkuë (pretendre) kët redevancë në natyrë ose në të holla. Në fund të ç' do tremujorit të perjudhës së shfrytëzimit, Konçesjonari do t' i paraqesin Ministriës së P. Botore e Bulqësis, nji raportë mbi sasinat e voj-gurit të pa punuëm të prodhuëm dhe mbi mëndyrën që asht disponuë. Redevanca ka me u njehsuë (calculée) mbi sasinat e treguëme ndër këto raporta.

Art. 11. – Mbrenda periudhës së shfrytzimit Konçesjonari detyrohet me vuë në zbatim programin e thellimit (forage) qi vazhdon.

Në vjetën e parë 1000 metra
Në vjetën e dytë tjera 2000 metra
Në vjetën e tretë të tjera 3000 metra
Në vjetën e katërt të tjera 4000 metra
Në vjetën e pestë të tjera 4000 metra.

Në kjoftë se nji vjetë numri i metrave të thellimit kapërcen minimun të nalt-treguëme, sasia e ma tepërt ka me u zbritë prej minimun-it të metrave që do të shbirohen (forer) nër vjetët vashduëse. Programi minimum i thellimit ka me muëjt me e ndaluë (suspendre) në rasë të nji prodhimit të jashtëza-

konshëm i cili kishte me penguë zaptimin (capture) të nji pjesës së vojgurit që del nga sondat. Kështu vjen edhe kur prodhimi i voj-gurit të kaptojë (atteindre) 150.000 (njiqindepesdhetmijë) tonelatë në vjetë dhe për aq kohë deri sa prodhimi nuk ka me zbritë nën kët sasië. Në rasë kur zorime serioze pengojnë zbatimin e programit minimum të thellimit çashtja do t'i parashtrohet komisjonit mixtë t'ekspertave (Art. 21) i cilli ka me pasë fakultetin me akordue nji zbritje të arsyëshme të programit.

Mbas pes vjetve të para periudhës së shfrytzimit, Konçesjonari detyrohet me vazhdue dhe me zhvillue në ma të naltën gradë që asht mundun shfrytzimin e gisementave vojguror tuej ba të gjitha mundimet e mujshme e t' arsyeshme, dhe ka me rregullue mbi këto parime programin e thëllimit, mbas konsultimit me komisjonin mixt.

Art. 12. – Konçesjonari ka me pasë të drejtën me e lshue (abandoner) çdo pjesë toket të përfshieme nër sypërfaqet e majtuna për shfrytzim. Ky lshim e liron nga të gjitha detyrimet e caktueme prej këtij konvencjoni, për sa i përket tokave të lshueme.

Art. 13. – Konçesjonari detyrohet me ngref (installer) në Shqipnie nji rafinerie në rasë që të konstatohet se kapaciteti vjetor i prodhimit të pusave n' ushtrim (exercice) t' arrinë 50.000 tonelate vojgurit të nji kapitalitetit qi i nep dorë industriallsht për rafinim.

Art. 14. – Në fund të periudhës së shfrytzimit (d. m. th. mbas 31 Dhetuer 1985) të gjitha sondat, pusat, gelerinat, instalacionet e konstrucionet qi eksistojnë në Shqipnie dhe janë të Konçesjonarit, kan me ju lëshue gratis Shtetit pa kurr far detyre.

Instalacione e ndertime

Art. 15. – Konçesjonari ka me pasë të drejtën me ndertue, (exercer) e me majtë : Rruga ordinare, dekovile, tramvaj, hekur udha, teleferike, linje qyngash për voj guri (conduites) për uj o për gaz, ura rreshtime (quais) limane, rezervuare, depote, stacione pompash, rafinerina, uzina e banime, telegrafa pa tel, linje telefonike ; përfund të gjitha instalacionet e ndertimet qi kan me qenë të nevojshme për drejtimin e mirë të sipërmarrjes qi ban objekt të këtij konvencioni, në qoft nevoja dhe jasht sy-

përfaqevë të dhanuna për shfrytzim. Shteti detyrohet me i akordue gratis nër tokat e ujnat shtetnore qi nuk i janë dhanë personave të treta, kalim të lirë, dhe tokat të nevojshme për instalacionet e ndertimet e sypër përmenduna si edhe me ba ekspropracionin në konformitet me ligjet në fuqi, në rasë kur instalacionet e ndertimet do xanë tokat ose ujnat private ose të dhanuna përpara të tretve për të tjera qellime.

Të gjitha shpenzimet e nevojshme si edhe shperblimet e ekspropriaciocenarit, kan me kenë për barrë të konçesjonarit. Këto shperblime kan me u njesue pa mvarësisht nga çdo konsideratë që rrjedhë nga kenja (existencë) e konçesjonit qi përban objektin e këtij konvencjoni.

Kondität e përgjithshme

Art. 16. — Konçesjonari detyrohet me shpërblye në nji mënyrë të drejtë personat e treta qi mund të jenë të damtueme prej punimevet të cilat lejohen prej këtij konvencioni. Shpërblimi ka për t' u caktue në mëndyrë miqësore ndërmjet të dy palëvet, e në rasë nji mos marrëveshtje çashtja ka me u caktue me arbitrage. Në qoft se arbitragi nuk ka me u ba çashtja ka me ju parashtrue gjykatorëvet të vendit.

Art. 17. — Nëpunësit e punëtorët e marrun (engagés) prej konçesjonarit në tokë shqiptare, kan me qenë nënshtetësiet shqiptare përveç drejtorave, teknikve, specjalistave. Me gjith kët në rasë që punimet do të pengoheshin seriozisht nga shkaku i mos mjaftimit të puntoris lokale, ka me ju dhanë leje Konçesjonarit me prue puntorë të huej në numër të mjaftueshëm si mbas mendimit të favorshmë Komisjonit mixte.

Art. 18. — Në rasë qi punimet pengohen ose priten nga shkaqe forcës majore (force majeure) detyrimet e Konçesjonarit kan me u ndalue për sa të ngjasin rasat e forcës majore, e ky afat nuk ka me u njehsue nër periudhat e kohës së parapame si maximum në këtë konvencion. Në qoftë se ngjanë mosmarrëveshtje mbi vleftën e rasave të forcës majore, çashtja ka me ju parashtrue kolegjit t' arbitragit të parapam n' artikullin 24.

Art. 19. — Konçesjonari ka me pasë të drejt me importue në Shqipnië, të lirë nga çë do taksë doganore a tjetër, makinat prodhimet e materialet qi ka me pasë nevojë për ushtrimin e të drejtave që i janë njoftë me këtë konvencjon.

Art. 20. – Koncesjonari ka me u përjashtue prej të gjitha taksave e tagrave të tashme e t' ardhshme mbi kapitalin e angazhuem, t' interesavet dhe të fitimeve që rrjedhin, të tokave në konçesjon, mbi prodhimin e exportimin e prodhimeve përveç atyneve që janë parapamë në kët konvention.

Art. 21. – Nji komisjon mixt ekspertash ka me u formue i përbamë prej gjasht antarësh, prej të cillëve tre kan me u emnue prej Shtetit, e tre prej Konçesjonarit. Ky komisjon ka me vertetue konditat e tokavet e ka me vështruem përmbushjen e detyrimevet të Konçesjonarit. Komisjoni ka me pasë fuqi me zbritë programin minimum të themelimit si mbrenda periudhës së kërkimit ashtu edhe n' at të shfrytzimit në rasë kur rrethana të veçanta kishin me justifikue kët zbritje. Komisjoni ka me pasë edhe fuqi me vendue (deliberer) mi të gjitha çashtjet teknike e legale qi kan për me u ba mbi nji interpretim të dyshimtë të konditave të këtij konvencioni ose qi kishin me mujtë me lindë prej nji rasës të parapame ose të pa-parapashme e cila mund të zgjidhet miqësisht. Vendimet e Komisjonit kan me u ba me shumicë votash, e në qoftë se kjo shumicë nuk ka me mujt me u formue çashtja ka me ju parashtrue arbitragit të parapam n' artikullin 24.

Art. 22. – Në qoft se Konçesjonari nuk përmbushë detyrimet e veta që rrjedhin nga ky konvencion. Shteti ka me pasë të drejtën me i drejtue nji vrejtje (intimation) tuej i ba me dijt që mbrenda nji afatit tremuejsh të përmbushin detyrimet e marruna.

Në qoftë se në mbarim të këtij afati, Konçesjonari nuk ka plotësue detyrimet, Shteti ka me i u sjellë menjiherë arbitragit si mbas art. 24. Në qoftë se mbas arbitragit Konçesjonari vazhdon në mos përmbushjen e detyrimeve të veta, Shteti ka me pasë të drejt me prishë konvencjonin.

Art. 23. – Në kjoftë, në konformitet me artikullin 13, Konçesionari instalon nji rafinerië në Shqipnië ka me kenë i detyruem me i dhanë prodhimet e veta Qeveriës Shqiptare, me çmimet e ditës tue ba hji zbritje 10% (dhet për qind).

Sasiënat që Konçesjonari do t' japin me konditat e sypërthanun nuk do të kalojnë asnjiherë 20% (njizet për qind) prodhimit të përgjithshëm të rafineriës.

Art. 24. – Në rasë të nji mosmarrëveshtje çfarëdo ndërmjet të Shtetit e Konçesjonarit, mbi të drejtat e detyrimet e të dy palëve kontraktuëse, që rrjedhin nga dispozitat e këtij kon-

vencjoni, çashtja ka me ju parashtruë nji kolegjit arbitragit i përbaëm prej tre antarësh, prej të cilve njeni ka me u emnuë prej Shtetit, e tjetri prej Konçesjonarit e i treti ka me u zgjedhë në marrëveshtje prej dy arbitrave të parë. Në qoftë se dy arbitrat e parë nuk bjen në godi për me emnuë arbitrin e tretë ka me u formuë nji kolegjë arbitragi i ri i përbamë prej pesë antarësh, prej të cilëve dy kan me u emnuë prej Shtetit e dy të tjerët prej Konçesjonarit e i pesti ka me u zgjedhë me shumicë votash prej katër arbitrave të parë. Në qoftë se edhe në zgjedhjen e arbitrit të pestë nuk do të jetë e mundun me j' a arritë nji marrëveshtjes, emnimi ka me ju parashtruë Gjyqit të Diktimit Shqiptar. Vendimet e kolegjit t' arbitragit do të jepen me shumicë votash. Pritja e gjykimit t' arbitravet nuk ka me mujtë me shkaktuë ndalimin e ushtrimit të konçesjonit.

Art. 25. – Për me garantuë zbatimin e mirë të detyrimeve që rrjedhin nga ky konvencjon, Konçesjonari ka me i paguë në kasë të Ministrisë së Financave Shqiptare, nër tridhet dit mbassi të nënshkruhet ky konvencjon, shumën e 150.000 (njiqindepesdhetmijë) frang ar e cila ka me u ba pronsi e Shtetit në rasë të prishjes së këtij konvencioni për shkak mos përmbushjet nga ana e Konçesjonarit.

Kjo shumë ka me ju kthyë konçesjonarit:

a) Në qoftë se ky koncesjon nuk ka me e ratifikuë.

b) Në qoftë se konçesjonari lëshon në ç' farë do kohet konçesjonin edhe të drejtat e përkatëshme por me konditë qi të ketë përmbushë të gjitha detyrimet e parapaëme prej këtij konvencjoni; përfund ka me u kthyë në mbarim të konçesjonit.

Art. 26. – Për zbatimin e këtij konvensjoni i cili ka me j'u shtruë jurisdikcionit tè Ministriës P. Botore e Bujqësiës, Konçesjonari zgjedhë për banim Kryeqytetin e Shqipniës dhe ka me ju nënvuë ligjavet të vëndit deri sa mos të kundërshtojnë me çka asht kontraktuë në këtë konvencjon.

Art. 27. – Ky konvencjon asht ba shqip e frengjisht dhe në katër exemplarë të nënshkruëme prei dy palëve kontraktuëse. Dy exemplarë (nji tekst shqip e nji frengjisht) ka me u rujt nër arkivat e Shtetit, e dy të tjerat, (nji tekst shqip e nji tekst frengjisht) kan me ju dhanë Konçesjonarit. Parashifet e konvenohet posaçisht se në rasë dyshimit ose mos marrëveshtjesh të shkaktuëme prej ndryshimeve të interpretimit ose redaktimit, vetëm tekstit frengjisht i zihet besë.

Art. 28. — Ky konvencion asht i vlefshëm për nji perjudhë 20 (njizet) vjetësh tuëj nisë që nga data e nënshkrimit të tij.

Me gjith këtë Qeverija detyrohet me ja paraqitë Parlamentit për ratifikim nji Dekret-Ligjë e cila zgjaton ngjatjen e vjetër të këtij konvencjoni deri me 31 Dhetuër 1985.

Në tekstin e këtij konvencjoni për ratifikim, kuptohet ratifikimi i Dekret-Ligjës së sypër-përmendun mbi zgjatimin e konçesjonit deri me 31 Dhetuër 1985.

Ba në Tiranë me 12 Mars 1925.

Për Hekurudhat e Shtetit Mbretnor t' Italis:
UGO PIOLTI

Për Qeveriën Shqiptare:
Ministr' i P. Botore e Bulqësis
KOTTA

Kjo kontratë asht nji me kontratën e aprovuëme me dekretet e Këshillit Ministrial e të Kryësiës së Republikës së Shqipniës me datë 9 Mars 1925.

UGO PIOLTI K. KOTTA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë konvesion të pranuëm prej të dy Dhomave legjislative urdhënojmë zbatimin e tij.

Tiranë, me 25-VII-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 55.

KONVENCION, 22 Korrik 1925.

Me shoqrin Italiane të Minierave të Selenicës për Konçesion vaj-guri etj.

(i botnem në Fletoren Zyrtare, 14 Gusht 1925, Nr. 43)

Në mes të Qeveris Shqiptare e pëfaqësuëme prej Shkëlqesiës së Tij Ministrit P. Botore e Bujqësiës, qi ka m' u shenuem në vijim si „Qeveri" e z. Ing. Giovanni Nobili Drejtuër e fuqiplotë i Shoqënis Italiane të Miniereve të Selenicës qi banon në Romë, Piazza S. S. Apostol 18; iqi ka m' u shenuem në vijim si „Shoqni" asht venduem sa vijon:

Art. 1. — Qeveria i nep Shoqëniës nji Leje Kërkimi qi i nep të drejtë Konçesjonit, transportimit, përdorimi, punimi (traitement) edhe për tregtim të prodhimeve, si që e pranon tekstí

i Konvencjonit për voj-guri, hydrokarbure të forta, të langta e gazoze, schist e bituminoze, argjile e ranë bituminoze, mbi nji sipërfaqe prej 2140 hektar e ma sigurisht te përshiem në zonën e kufizueme me poligonalin *a*, *b*, *c*, *d*, *e*, *f*, *g*, të shenuem në planin topografik këtu bashkalidhun ku *a*, *b*, *c*, *d*, korrespondojnë drejtësisht ndër qendrat e katundeve të Risilis, Libonjës Penkoves, Peshkopis. E në të djathtë të kreut t' urës eë Drashovicës edhe *f* në qendrën e katundit Kishbardhë ku kryqzohen tri rrugat me majën 204.

Konçesjonari ka të drejtën eksklusive për me bamë në këtë zonë të gjitha punimet e kërkimeve, me përdor ujnat për instalime eventuel hydroelektrike tuej ju përmbajtë gjithnji ligjeve Shqiptare, edhe në masë vetëm për nevojët e kësaj sypërmarrje.

Art. 2. — Leja e kërkimeve ka me pas nji afat tri vjetesh që prej datës ratifikimit këti konvencioni vetëm në rasë ku Shoqnia kishte me gjykuem ma oportune për me e kërkuem konçesjonin definitiv para mbarimit të kësajë kohe.

Art. 3. Shoqnia ka me pasë të drejtë me importue në Shqipnië të gjitha maqinat të gjith materjalet e nevojshme për punimin të përjashtuem prej ç' do far taksit doganuër, edhe kjo, si mrenda periudhës së kërkimeve ashtu edhe mrenda periudhës së Konçesjonit.

Art. 4. — Shoqnia ka me pasë të drejtë me eksportue për provim industrial e përjashtuem prej ç' do far taksesh, prodhimet e nxjerruna në sasi qi të mos kapërcejnë maksimum 100 tone në qoftë se ka me qenë nevoja, ajo ka me muejt me disponuë sasina ma të mdhaja me lejen ma par të Qeveriës e tuj paguem nji taks përpjestimtare.

Art. 5. — Puntorët e përdoruem ndër punime kan me qenë nënshtetësijet Shqiptare për pos specialistëve, teknisienve edhe ekspertave. Ata kan për t' u siguruem si duhet kundra rreziqeve në punë.

Art. 6. — Mbrenda kërkimeve, për posë vjetës së par të caktuëme për instalacione, Shoqnia detyrohet me mbajtë gjithnji n' ushtrim nji sond për nji shbirim minimum tetqind (800) metër.

Art. 7. — Në qoft se rezultatet e kërkimeve lejoshin për

me kërkuem konçesjonin për shfrytzimin e gjismentave, Shoqnija ka me pregaditë kërkesën e Konçesjonit definitiv edhe Qeveria detyrohet, që prej tashit me ja dhanë me kondita qi vijojnë :

a) Shoqnija ka me themelue nji kompani për sfrytzimin transportimin, përdorimin, punimin (traitement) edhe tregtimin e prodhimeve ; kapitali minimum i të cillës ka me qenë nji miljon e pesqindmi (1.500.000) fr. ari.

b) Kufit e tokvet për t' u dhanë s' kan me muejt me kapërcyem ato të shenuem n' arttkullin I.

c) Dy zona shfrytzimi kan me mujtë me u zgjedhë edhe të përshime në kufi si këtu sypri.

d) Koha e konçesjonit ka me qenë 50 (pesdhetë) vjet.

e) Çpronsimi i tokave ka m' u bam si mbas ligjëve Shqiptare.

f) Për qera shoqnija ka me pague nji taksë të përvjetëshme fiks 1.50 fr. ari edhe ma tepër nji t'ardhun përpjestimtare tremdhetë e gjysë për qind (13.50$^0/_0$) të vojgurit brut në kantjere, a në të holla ose në natyrë, si edhe tremdhetë e gjysë për qind (13.50$^0/_0$) të vojnave qi kan me dalë nga distilacioni i landëve tjera, mbasi të zbritet sasija që ajo ka me pasë konsumuem për punimet që i përkasin shfrytzimit.

Landët tjera që kan m' u eksportuem brut do të paguejn nji t' ardhun përpjestimtare mbas ligjës miniereve.

g) Për pos taksave e t' ardhuna të shenueme në këtë konvencion, as ndonji tjetër taksë nuk ka m' u aplikue mbi prodhimet e dhanuna në shfrytzim ose që rrjedhin prej prodhimeve brut si edhe Shoqnija nuk ka m' u randue as prej ndonji tjetër taksë të veçantë ose personale.

Art. 8. – Nënshkrimi i katërdhet për qind (40$^0/_0$) i kapitalit të kësaj Shoqnie ka m' u rizervue për nënshtetas Shqiptar edhe ka m' u ba në nji afat gjasht muejsh, në qoft se aksionet nuk do të jenë nënshkruem ose vetëm nji pjesë, Shoqnija ka me i vuem në dispozicion të Qeveriës mbrenda nji kohës së re tre muejshe. Këto aksjone nuk kan me muejtë me u dhanë të huejve pa pëlqimin e grupit nenshkrues Italjan.

Art. 9. – Mbrenda vazhdimit të Konçesjonit Shoqnija detyrohet me zbatuem, mesatarisht punimet e forazhit si vijon :

Në vjetin e parë . . . . 300 metra
Në vjetin e dytë . . . . 400 metra

Në vjetin e tretë . . . 500 metra
Në vjetin e katërtë . . 500 metra
Në vjetin e pestë . . . 500 metra

për posë në rast ku voj-gurit kishte m' u gjetë ndër thellësina ma të hapta.

Mbas fillimit gjashtës vjetë deri në mbarim të konçesjonit Shoqnija detyrohet me rregullue programin e vet të sondazhit në mënyrë qi me mbajtë nji shbirim të mbrendshëm 500 metra në vjetë. Në qoftë qi kishin me ndodhë shkaqe të nji natyre me penguem zbatimin e programit minimum të shenuem këtu sipri, çashtja ka me ju deferue komisjonit teknik të shenuem n' artikullin 19 i cili ka me muejtë me caktue nji zbritje konvenable të programit.

Art. 10. — Shoqënija ka me pasë të drejtë me instalue e me përmbajtë qynge (conduits) për transportimin e vojit, të hidrocarbureve të langshëm e gazoze mbas aprovimit të projektit qi ka me qenë e detyrueme me paraqitë.

Art. 11. — Shoqnija s' ka me mujtë me përdorue tokën e dhanun të Shtetit, për me ba industri bujqësore ose pyllore ose të tjetër lloj qi nuk kishte me pasë për qëllim prodhimin e punimit të prodhimeve të dhanuna ose ato që rrjedhin prej tyne, por Qeverija ka me mujtë, pa i përkit të drejtat e dhanuna Shonisë me këtë konvencjon, me disponue sypërfaqet si t' i pëlqejnë ma mirë.

Art. 12. — Shoqnija ka me shpërblye si mbas ligjës personat e treta nga damtimet e shkaktueme mbrenda punimeve edhe për ç' do kohë ka me majtë Qeverin të lirë prej ç' do farë përgjegjsijet e cilla (Qeveria) ka me pasë me u përgjegj kundrejt personave të tretë.

Art. 13. — Në qoft se prodhimi vjetuer i voj-gurit kishte me mrrijtë 50.000 ton. me lejuem kështu ndërtimin në vend të nji ose ma tepër rafinerive, të gjith materjali edhe sendet e nevojshme për këto ndertime kishin m' u importue ne Shqipni pa paguem as ndonji taksë.

Art. 14. — Në rasë ku nji ose ma tepër rafinerie, mbas artikullit ma parshëm qi kishin m' u vuem n' ushtrim, Shoqnia kishte me vue në dispozicion të Qeveris, me çmim korrent sasinat e voj-gurit shterngimisht të nevojshme për nevojët e vendit, për nevojët e administrationit me nji zbritje dhjetë qind (10%) mbi kët çmim qi ka m' u ba.

Art. 15. — Shoqnija, mbrenda perjudhës së konçesjonit ka me pasë të drejtë me hjekë dorë në nji pjesë ç' do faret të tokës që ban fjalë ky Konçesjon. Ky lshim ka me e përjashtuem përpjestimisht me sypërfaqen, prej detyrimeve qi rezultojnë me këtë konvencion mbi sa i përket t' ardhunave mbi tokët e xanuna.

Art. 16. — Në mbarim të Konçesjonit, të gjitha maqinat, materjalet, uzinat e rafineriët kan m' u ba pron' e Qeveriës të liruëme prej çdo ngarkimi.

Art. 17. — Me 31 Kallnduër e me 31 Korrik të ç' do vjetit Shoqnija ka me paraqitë në Zyrën e minierave desenet, profilet edhe krokit e punimeve të zbatuëme kështu edhe ka me dhanë në rasë kërkimi, të gjitha informatat qi i përkasin punimeve.

Në rasë ku punimet t' jenë mbetë vartas ose t' jenë ndaluë, penguë prej ndollinave ç' do faret të forcës magjore qi të kenë ndollë në Shqipni edhe për ç' do farë shkakut, detyrimet e ndryshme nuk kan me pasë ndonji vleftë mbrenda të gjith kohës të rasave të forcës magjore, edhe kohët e parapame nuk kan me 'vazhduë.

Art. 19. — Nji komisjon teknik i përbaëm prej 4 misve dy prej të cillve kan m' u emnuë prej Shoqniës, edhe dy prej Qeveriës, për me vërtetuë konditat e tokës, edhe me vështruë në qoftë se detyrimet janë zbatuë normalisht prej anës së Shoqniës ; komisjoni ka fuqi me zbritë këto detyrime me rasë ku kishin me ndollë pengime në posibilitetin e zbatimit të detyrimeve të përmenduna.

Art. 20. — Në rasë të çdo farë mos-marrëveshtjet në mes të Qeveriës e të Shoqniës që i përkasin interpretimit të së drejtave e detyrimeve të dy palve kontraktuëse, çashtja ka me u deferuë në tre arbitër njani prej të cillve ka m'u emnuë prej Qeveriës i dyti prej Shoqniës edhe i treti ka me u zgjedhë në marrëveshtje të përbashkët prej dy arbitrave.

Në rasë ku kto s' kishin me muëjt me u marrë vesht mbi zgjedhjen e të tretit arbitër ky ka me u emnuë prej Gjyqit të Diktimit Shqiptar.

Në pritjen e gjykimit të arbitrave vazhdimi i konçesjonit nuk mundet me qenë i penguëm.

Art. 21. — Shoqnija, nji muëj mbas notifikimit të lejës së kërkimevet ka me dhanë për garanci, në „Banca Commerciale Italjana„ në Romë shumën e 150.000 (njiqindepesdhetmijë) Lire-

ta Italjane Kurë ka me ju dhanë konçesjoni i shfrytzimit Shoqnija ka me dhanë në nji afat 1 muëj mbas kalimit të kësajë date po n'at banke e gjithnji për garanci, nji shumë të re prej 150.000 (njiqindepesdhetmijë) Lireta italjane.

Shuma e parë e 150.000 Lireta italjane e dhanun 1 muëj mbaj notifikimit të lejes së kërkimeve ka me ju kthyëm po sa qi Shoqnia të ketë importuë në Shqipni materjal e maqina të nji vleftës 150.000 Lira italjane.

Të tjerat 150.000 Lira italjane kan me mbetë në dispozicjon të Qeveriës në titull garanciet, për zbatimin e këtij konvencioni deri në mbarimin e tij, kjo shumë gjithnji ka me iu këthyëm Shoqniës në qoftë se të jenë konstatuë qi konsideracionet teknike e bajnë të pa mundëshme vazhdimin e punimeve të shfrytëzimit.

Art. 22. – Shoqnia ka me dhanë përpara, nji muëj mbas notifikimit të lejes kërkimeve shumën e taksës fikse për dy vjet d. m. th. 6.420 (gjashtë mijë e katër qind e njizet) fr. ari.

Art. 23. – Ky konvencion ka m' u redizhuem Shqip e përkthye Frengjisht. Në rast konstetacioni mbi interprimin e tij, përkthimit Frengjisht i vertetuem e i nënshkruem prej Qeveris ka me ju zanë besë.

Art. 24. – Ky konvencion ka me qenë i vlefshëm për nji perjudhë 20 (njizet) vjetësh mbas datës dekretit Kryesis në konformitet të artikullit 117 të Statutit të Republikës Shqiptare edhe ky ka me ju paraqitë Parlamentit për m' u zgjatue për 33 (tridhetetri) vjet.

Shoqnia ka me muejtë me kërkuem në ç'do çast këtë zgjatim.

Në rasë kur Parlamenti nuk kishte me ratifikuëm zgjatimin, artikulli 16 nuk ka me pasë as ndonji vleftë.

Mbasi qi në vëndin e Drashovicës ndodhet materjali i lanun që prej kërkimeve të para të baëme në 1920, Qeveria detyrohet m'e dhanë këtë materjal edhe invëntarin e tij, Shoqniës qi ka me pasë të drejtën me e përdorë tuëj paguëm, nji t'ardhun fikse të përvjetëshme 500 (pesqin) fr. ari.

Tiranë, me 2 Maj 1925.

Soc. Ital. delle Miniere di Seleniza	*Ministr' i P. Botore e Bujqësis*
GIOVANNI NOBILI	K. KOTTA

Pëlqejmë këtë konvension të pranuëm prej të dy Dhomave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e tij.

Tiranë, me 22-VII-1925. *Kryetari i Republikës*
A. ZOGU

Letër-ngjitun konvencionit petrolifer të Shoqnis të Minierave të Selenicës i nënshkruem me 2 Maj 1925, në mest të Ministrit të P. Botore e Bujqësis e të Z. Giovani Nobili përfaqësues i Shoqnis mbi shpjegimin e konvencionit në fjalë.

Ka me korrespondue n' Art. 7. në fund të ç'do trimestrit të perjudhës së shfrytzimit Shoqnija do të parashtrojë në Ministrin e P. Botore e Bujqësis nji rraportë mbi sasinat e voj-gurit brut të prodhuem dhe mbi mënyrën qi asht disponue.

Redevanca ka me u llogaritë mbi sasinat e treguëme në këto raporta.

Ka me korrespondue n' Art. 8. Qeveria ka me pasë të drejtë m' emnue nji antar në Këshillin e Administratës të Shoqniës.

Nji kopje e bilançavet vjetore të Shoqniës ka me ju komunikue Qeveriës.

Për zbatimin e këtij konvensioni i cili ka me qënë nën juridiksionin e Ministris së P. Botore e Bujqësiës, Shoqnia e zgjedh për banim Kryeqytetin e Shqipniës e kjo ka me ju shtrue ligjave të vendit deri sa këto të mos të kundërshtojnë në sa asht vendue me këtë konvension.

Ing. G. NOBILI K. KOTTA

Nr. 56.

KONVENCJON, 26 Korrik 1925.

Me Shoqërinë Standard Oil Company për konçesjon vaj-guri

(i botuem në Fletoren Zyrtare, 14 Gusht 1925, Nr. 43)

Bamun në Tiranë. . . . . 1925 midis Shkëlqesis së Tij Ministrit Punve Botore e Bujqësisë, e në emën të Qeverisë Shqiptare (që në sa vazhdon ka me u emnue Qeveria) me njanën anë: edhe Zotnisë Eugene S. Sheffeid, i ngarkuem me fuqin prej Standard Oil Company of New-York City, Shtetet e Bashkueme të Amerikës Broedway N. 26 (që në sa vazhdon ka m' u emnue

Kompania emën ky që shënon Kompaninë në fjalë si edhe ata që përfaqësojnë të drejtat e saja (ses ayants droit) sa herë qi teksti i këtij konvencioni e lyp ose e pranon), më tjatër anë;

U caktue edhe u lith ç' ka vijon:

Neni 1. – *a*) Tue fillue qysh më 12 Maj 1925 Qeveria i njef Kompanisë të drejtën për me zgjeth mbi krejt sypërfaqen e Shtetit Shqiptar, pa kur farë restrikcioni posë atyneve të paragrafit „*b*" të këtij neni, sypërfaqe qi tansisht nuk kalojnë një maximum prej tet-dhetë mijë hektarë me qëllim me ba mbi këto studime gjeollogjike e me kërkuë petroll, bitum, gaz natural, argjile bituminoze edhe schiste që kanë aftësi me dhanë petroll me anë të dlirimit (destillation).

Tue fillue qrej ditës të nënshkrimit të këtij konvencioni, Qeveria angazhohet mos me konçedue as një misi të tretë (a aucune tierce partie) as në një të drejtë petrolli e cila të munt të zbatohet para datës 12 Maj 1925.

b) Se kompania nuk ka me pas të drejtën me zgjeth, mbas paragrafit „*a*" të këtij neni, as një sypërfaqe që misa të tretë do të kenë zgjedhë, për me ba kërkime ose shfrytzime të landave të përmëndura, si mbas (conformement) të drejtave të konçedueme këtyneve prej Qeverisë para datës të nënshkrimit të këtij konvensioni.

c) Të zgjedhunit e sypërfaqes prej tetëdhetë mijë hektarësh duhet t' i komunikohet Qeverisë mbrenda dy muëjve prej datës së nënshkrimit.

d) Këto tetëdhetë mijë hektarë nuk mund të përbâjnë ma tepër se katër zona të veçuëme.

Neni 2. – *a)* Mbasi të ketë caktuë sypërfaqen ose sypërfaqet që përbajnë të tetëdhetë mijët hektarë të nalt-përmëndun, Kompania angazhohet me proçedue në këto veprime si mbas konditave që vijojnë:

b) Se Kompania ka me pasë të drejtën absolute me bâ studime gjeollogjike edhe sondazhe kërkimesh në këto sypërfaqe, për të cilat bahet fjalë në nenin 1.

c) Se Kompania angazhohet me kërkuë, mbrenda Periudhës kërkimeve të parapame këtu poshtë, të paktën një pus per ç'do shtatëmijë hektarë nga sypërfaqet të rezervuëme prej saj si mbas nenit 1.

Gjysma e numrit të këtyne puseve, por jo një numur ma i math se tri, kanë me u çpuè deri më një thellësië prej një mi-

jë metra të paktën, përveç rastit ku petrolli do të gjendet më një thellësië ma të vogël.

d) Se Qeveria angazhohet me i dhanë Kompanisë tanë lehtësinat, tue e larguë ç' farë do kundërshtime ose ndalime të përparimit të veprimeve.

e) Në mbarim të ç' do trimestri Kompania detyrohet me i dhanë Qeverisë raportë të imtuëme (deailes) gjithfarësh tue bashkëngjitun kopje pllanesh të pregatituna e të dorëzuëme Kompanisë nga ana e agjentëve të saj, si edhe gjith mostra e landave të gjetuna.

Neni 3. – Kompania ka me pas të drejtë me importuë e me exportuë, si mostrë (a titre d' echantillons), sasie të arësyeshme landash nga gjith llojnat që janë treguë ma nalt, e që janë gjet prej saj (Kompanisë) në kohë të studimeve. Kompania ka me pasë edhe obligatën, sapo të jetë e mundun (convenable), me mbush ç' do gropë që asht ba edhe me e rafshuë sypërfaqen, sa të jetë e mundun, e me e pruë në gjëndjen të ma parëshme.

Neni 4. – *a)* Ç' do i tretë, që t'i damtohet prona prej Kompanisë në vazhdim të veprimeve që Shoqnia ka të drejtë me ba, do të çpaguhet me një herë prej Kompanisë, me një shpërblim të drejtë (equitable).

b) Gjith kështu Qeveria do të çpaguhet për ç' do lloj obligate që do t' i ngarkohet prej ç' do personi të tretë nga shkaku i veprimeve të sipërmarruna prej Kompanisë.

c) Shuma e çpagimit, që do të paguhet ndër kondita të naltpërmenduna, në rast mosmarrëveshtjeje në mes të dy palëve, do të caktohet prej arbitrash që do të emnohen nga pronari i tokës e nga Kompania. Numuri i arbitravet do të caktohet me një akord të përbashkëtë midis të dy palëve. Në rast të një mos-marrëveshtjeje në mes të arbitrave, këta do të zgjedhin një sypër-arbitër. Vendimi i sypër-arbitrit do të jetë definitif. Në qoftë se arbitrat nuk bien në godi mbi personin e sypër-arbitrit, puna do t' i referohet gjykatores Shqiptare kompetente.

d) Për sa i përket pagesës të çpagimit të vendosun, duhet marrë parasysh vlefta ordinare e tokës, pamvarësisht (independent) prej ç' do konsiderate të implikueme në këtë konvencion.

e) Pagimi i çpagimit do të bâhet mbrenë muaji qysh prej datës vendimit t' arbitrëve ose të sypër-arbitrit.

f) Në rast, ku, në kohë të veprimeve të përmenduna në këtë konvencion, tokët do të damtohen më një shkallë që t' i bâjë të përdoruëshme për levrim (culture) ose kur do të jenë të zanuna për një periundhë q' e kalon vitin, pronari i një të tillë toke ka me pas të drejtë me lyp exproprijimin si mbas ligjit në fuqië.

Neni 5. — *a)* Qysh prej datës të notifikimit të premë (formelle) per të zgjedhunit të sypërfaqeve ashtu si asht caktuë tek neni I. do t' i jepet Kompanisë një periudhë tre vjeç, mbrenda së cilës periudhë Kompania ka me pas të drejtë me caktuë sypërfaqet për kërkime të imtuëme e për sondazhe shfrytzimesh.

Kjo periudhë tre vjeç, që në sa vazhdon do të emnohet. Periudha e Kërkimeve," në akord të bashkëtë, munt të zgjatet me një tjatër periudhë të arësyëshme, në qaftë se rethina të veçanta e lypin, (le rendaient desiberable) edhe në rastin për të cilin flitet në paragrafin që vazhdon.

b) Puriudha e kërkimeve nuk mundet të dekllaret e kaluëme, pa lejen e Kompanisë, veç se një muaji mbasi të marrë funt periudha e kërkimeve e ç' do misi të tretë (tierce partie), që do të ketë fitue të drejta analloge prej Qeverisë para se të nënshkruhet ky konvencion.

c) Mbas datës nënshkrimit të këtij konvencioni as një e drejtë expluatimi ose forazhi nuk munt t' i jepet as një misí (partie) mbi as një pikë të tokave të rezervuëme prej Kompanisë si mbas nenit I. deri sa Komponia të ketë ushtruë (exerce) të zgjedhunit e saj prej pesëdhetë mijë hektarëve për t' i expluatue ajo vehtë, ashtu si asht caktuë tek ky nen.

d) Këto të drejta për zgjedhjen në fjalë kan me ju shtrue (seront soumis) konditave që vazhojnë:

e) Tue filluë qysh prej datës 12 Maj 1925 deri në mbarim të Periudhës, Kërkimeve, Kompania ka me pasë të drejtën exklusive për me zgjeth sypërfaqe për kërkime të imtuëme e për sondazhe shfrytzimesh ndër sypërfaqet që kan me u lanë, me u lëshuë ose me u kthyë prej cilit do misi të tretë qi të jetë, e të cilat sypërfaqe do të kenë marrë, nga shkaku, i të drejtave petrolli edhe të tjerave landa të përmenduna tek neni I. të drejta të fitueme prej Qeverisë para datës të nënshkrimit të konvencioni.

f) Se sypërfaqet e caktuëme si mbas kushtit të këtij neni nuk duhet të kapërcejnë shumën prej pesëdhetë mijë hektarë,

të cilat nuk kan me u zgjedh përveç se mbi sypërfaqet të konçeduëme Kompanisë si mbas kushtit nenit 1 edhe si mbas kushtit të paragrafit „e" të këtij nenit. Kompania i njef ç' do sipërmarrje të misave tretë të drejtën e kalimit mbi të pesdhetë mijët hektarë të zgjedhuna prej saj, me buria (avec conduits) ose të tjera mjete transporti.

g) Se Kompania ka me i paraqit Qeverisë një raport ç' do gjashtë muaj mbi përparimet e bame në këto forazhe bashkë me një kopje të gjith pllaneve edhe hartave të nevojshme, edhe se Kompania gjith kështu ka me paraqit të gjith informatat shtimtare (supplementaires) që Qeveria do t' i shohë të nevojshme.

h) Se një Komisiōn Teknik do të formohet, i përbamun prej gjashtë anëtarësh, tre nga këta do të emnohen nga Qeveria e tre nga Kompania. Ky Komisjon do t' i vërtetojë konditat e tokave e do të vrejtojë (surveiller) të kryemit të detyrave nga ana e Kompanisë.

Në rast ku kanë me u çfaq vështirsinat të cilat do t' i pengojshin seriozisht të kryemit të programit, Komisjoni ka me muejt me venduë një rrëzim të arësyëshme të këtij programi.

Komisioni ka me pas edhe fuqië për me bâ një zdrypje nëpër të gjitha obligat që u përkasin gërmimeve, si për punë të kërkimeve si edhe për punë të shfrytzimit, në rast ku rrethanat e veçanta kan për t' a bâ të dëshërueme një masë këso doret.

i) Se ç' do kohë të periudhës Kërkimeve Kompania ka me pas të drejtën me zgjeth, e lirë nga çdo barrë posë atyne të parapame (prèvue) në kët konvencion të tanë ose një pjesë të sypërfaqeve, që do të ketë zgjedhun si mbas kushtit të këtij neni, mbi sypërfaqet për të cilat bahet fjalë tek neni I. i kësaj marrëveshtjeje, me qëllim me i zhdrivillue e me bâ ndër këto kërkime të masandajshme (ulteriers) për të nxjerrun (obtenir) petroll ose ç' do landë prej atyneve të naltpërmenduna.

j) Se në ç' do kohë të Perjudhës Kërkimeve, mbas datës 12 Maj 1925, Kompania ka me pasë të drejtë të zgjedhë, me mënyrën të shenuema në paragrafin e ma parëshmë të tana ose një pjese të sypërfaqeve që ajo do t' i ketë zgjeth simbas kushtit të paragrafit „e" të ktij neni, me qëllim me i zhvilluë e me i shfrytzuë si mbas mënyrës të parapame (prèvue) në paragrafin e ma parëshmë.

Neni 6. – Kompania ka me pasë të drejtën exklusive të

shfrytzimit e të kërkimeve mbi sypërfaqet që do të ketë zgjeth si mbas nenit 5 për petroll ose për krejt ose një pjesë të landave sipërtreguëme, deri me 31 Mars 1985.

Këto të drejta do t' u shtrohen (seront soumis) konditave që vazhdojnë:

a) Se ka për t' u formuë një kompanië Amerikane nën titullin, „Americano-Albanian Oil Company" që në sa vazhdon ka m' u emnuë, „Kompania e Veprimevet".

b) Se kapitali i autorizuëm i Kompanisë nuk do të jetë ma i vogël se dy milion e pesë qint mijë dollarë, në akcione prej pesë dollarë si cila e do të munt të shtohet, në qoftë se Kompania e gjen punën të nevojshme.

Pesë muaj para emisionit të ç' do kapitali në akcjone, Kompania do të detyrohet me informuë Qeverinë mbi qëllimin që ka për t' a ba emisionin respektif e në tre muajt e para të kësaj kohe prej pesë muajsh, nënshtetasit shqiptarë do të munden të nënshkruajnë dyzet për qint të këtij kapitali n' akcione, me çmimin e emisionit, e në rast kur këto akcione ose një pjesë e tyne nuk do të jetë e nënshkruëme (souscrire) prej nënshtetasve shqiptarë, Qeveria në dy muajt që mbesin do të ketë të drejtë me nënshkruë të gjitha ose një pjesë prej akcioneve në fjalë, tue pas parasysh gjithmonë që shuma e akcioneve të nënshkruëme nuk do të mundet me e ndaluë kufinin të dyzetve për qint.

c) Se një kopje e bilancave të përmotëshme të Kompanisë Veprimeve do t' i komunikohet Qeverisë.

d) Se Qeveria do të ketë të drejtë me emnuë një anëtar në Këshillën e Administratës Kompanis Veprimeve.

e) Se Kompania do të detyrohet me ja lëshuë Kompanisë Veprimeve konçesionin që do t' i jetë dhanun asaj me gjithë të drejtat edhe privilegjet të përkatëshme me qëllim që veprimet e expluatimit, shdrivillimit ose të explorimit të tokave që përbajnë objektin e këtij konvencioni të jenë sipërmarrës e të vazhduëme prej Kompanisë së Veprimeve.

f) Se Kompania e Veprimeve do të detyrohet me paguë një redevancë prej trembëdhetë e gjymës për qint mbi prodhimin e petrollit brut, që do t' jetë sjellë prej pusave në rezervuarët të venduëme, më parë (en éspehe) ose me lanë (en nature). Pëlqimi i njanës prej këtyneve të dyja i lihet Qeverisë.

Kompania e Veprimit do të ketë të drejtë të rrëxojë nga

shuma e petrollit të prodhuëm me mënyrën të diftuëme në paragrafin e përparëshmë, çdo sasië që ajo ka për t' a prishë për të gjithë punët që janë në lidhje me shfrytzimin; kështu që redevanca do të llogaritet mbi bazë të sasiës që mbetet mbas rrëximit për të cilin flitet këtu.

Në mbarim të ç' do trimestri Kompania asht e obliguëme me ja parashtruë Ministri i Punve Botore një raport tue treguëm sasiën të petrollit të prodhuëm si edhe tue çfaq mënyrën qysh ka me u disponuë kjo sasië. Redevanca do të llogaritet në bazë të sasiëve që figurojnë në këto raporte.

g) Se Kompania e Veprimit do të detyrohet me paguë një qira të përmotëshme prej një e gjysmë franga ari për hektar, për ato sypërfaqe që do t' i jenë lëshuë në konformitet me nenin 5.

Kompania do t' i paguajë Qeverisë qiranë për dy vjetët e para në muajin që pason ratifikimin e këtij konvencioni.

h) Se pas formimit, Kompania e Veprimit angazhohet me vuë në zbatim programin e forazhit që vazhdon:

Brenda vitit të parë 1.500 metra;

Brenda vitit të dytë 3.000 metra ma tepër;

Brenda vitit të tretë 4.000 metra ma tepër;

Brenda vitit të katërtë 4.000 metra ma tepër;

Brenda vitit të pestë 4.000 metra ma tepër;

Teprica, në qoftë se do të ketë, prej ktyne numurave metrash në ç' do vit do të llogaritet për të plotsuë numurin e metrave të vitit që pason.

Me gjith këto, në qoftë se brenda pesë vjetëve të sypërshënuëme, pusat e gërmuëme mbrijnë në prodhim të tre-muajshëm prej njizetepesë mijë tonellata, Kompania do të ketë të drejtë me i kadaluë (relantir) punët e gërmimit, por do të shtrëngohet t' i fillojë përsëri gjithmonë brenda pesë vjetëve të para që pas programit në krye deri sa përsëri të mbrinjë më njëzet e pesë mijë tonellata.

Komisioni Teknik do të jetë kompetente me venduë një zdrypje të arësyëshme të këtij programi, në qoftë se kjo duket e dëshëruëshme në konsiderim të veprimeve të përgjithëshme të Kampanisë e të natyrës si edhe të konditave të tokave petrollifere.

Mbas pesë vjetëve të para Kompania e Veprimit ngarkohet me ba të gjitha përpjekjet e arësyeshme për me zhdrivillue

BKSH

gradën ma të naltë, që asht e mundun, për shfrytzimin e dujvë (gisements) petrollifere në sypërfaqet e konçeduëme e do të rregullojë prcgramin e gërmimit në konformitet me ato që u tha ma nalt mbas një këshille me Komisionin Teknik.

i) Se Kompania e Veprimit do të ketë të drejtë me lanë (abandonner) ç' do pjesë të tokave që do t' i jenë dhanë asaj; kjo e lanë e tokave do të tërheqë liberimin e Kompanisë prej të gjitha obligatat që rezulitojnë prej këtij konvencioni për ç'ka u përket tokave të lana.

j) Se dyqind mijë franga ari do të depozitohen në kohën e nënshkrimit të këtij konvencioni në një Bankë të New-Yorkut me urdhër të Qeverisë si një dorzanië (garantie) për exekutimin e mirë të neneve të këtij konvencioni.

Shuma e nalt-përmendun e garantisë do të jetë e pengueme për gjith periudhën e kërkimeve edhe do të bahet pronë (propriété) e Qeverisë në qoftë se Kompania nuk do të kishte mbushun detyrat që merr me këtë konvencjon kundrejt Qeverisë.

Por me të marrë fund periudha e kërkimeve, ose në qoftë se Komisioni Teknik do të ketë konstatue një përfundim negatif në ç' ka u përket kërkimeve, apo në qoftë se Parllamenti nuk do t' a ketë vërtetue konvencionin, Qeveria Shqiptare angazhohet me e lajmue Bankën e sipërthanme që të kthehet shuma në fjalë në dispozicion të Kompanisë.

k) Se në mbarim të periudhës së konçesionit, d. m. th. më 31 të Marsit 1925, krejt materiali që gjëndet në Shqipnië: instalacione, ndërtesa, depoja, pusa, rethina (quais), rruga e urra që i përkasin Kompanisë Veprimeve do t' i jepet në dorë Qeverisë gratis.

l) Se kur Kompania e Veprimit do të ketë nevojë për rruga, ku munt të kalojnë karrocat, e për tramway të nevojshme për shfrytzim, Qeveria do t' i japë kalim të lirë pa farë shpërblim mbi rrugët.

(m) Qeveria do t' i japë Kompanisë të drejtën e ndërtimit e te përmbajtunit për nevojat e saja, të buriave (conduits), vija telefonike. telegrafa pa tel, telegrafa, ropë-ways ajrit, rruga të hekurta e tramways për aq sa do të jenë exklusivisht të përdorueme për shërbimin e industrisë petrolifere, rruga e rrethinë (quais) e ura që tue u nis nga tokat që përfshin konçesjoni i veht do të mbrinj në ç'do pikë të bregut-detit, që Kompania ka

për t' a gjet të pëlqyeshme (convenable.) Ajo ka për të pas edhe të drejtën e ndërtimit të bijave për punëtorët e vet, të uzinave edhe të rafinerive.

Për këtë qëllim ajo do të ketë drejtë që t' i lëshohen toka që u përkasin njerësve privatë me mënyrën e expropriјimit në konformitet me ligjet në fuqi. Të çmuemit e tokave për t' u expropriju do të bahet pa-mvarësisht prej ç' do konsiderate të simplikueme prej konçesjonit për të cilën bahet fjalë në këtë konvencion.

Për sa u përket tokave botore jo të zanme, këto do t'i lëshohen gratis nga Qeveria.

(n) Se Kompania edhe Kompania e Veprimit ka të drejtë me importue në Shqipnië, të lirueme prej ç' do takse doganore; krejt materialin edhe vegla që do t' i duhen asaj.

(o) Se Kompania do të ketë të drejtë me exportue petrolin brut; asfaltin; seran e prodhimet sekondare pa pague as nji taksë exportimi.

(p) Se Kompania e Veprimit do të jenë të përjashtueme prej ç' do takse speciale, reale ose personale.

(q) Se nëpunësat edhe punëtorët merren në shërbim prej Kompanisë Veprimit do të jenë nga nënshtetësia Shqiptare, posë drejtorëve teknіçianëve, expertëve dhe specialistëve.

(r) Se në rast kur një rafinerië do të installohet eventualisht në Shqipnië prej Kompanisë Veprimit, Kompania merr mbi vedi barrën t' u përgjegjet kërkeseve për voj-guri e për prodhime sekondare që janë fare të domosdoshme për nevojat e Qeveris, me çmimin e pazarit, tue bamun një zbritje prej dhetë për qint; me gjith këto kërkimet e Qeverisë nuk do të mundin të kapërxejnë të njëzetat për qint të prodhimit neto, mbasi të jetë zdryp sasia e vojit të gurit të konsumuem për punërat e Kompanisë.

Ç' do kërkesë e Qeveris Shqiptare që kapërzen të njëzetën për qint ashtu edhe gjith kërkesat për tregëti ose për qëllime të tjera në Shqipnië, do të pranohen para se të exportohet voji i gurit me çmimin e pazarit.

Kur prodhimi trimestrial i vojit të gurit brut do të jetë prej dhetë mijë tonellata e nalt, dhe në Shqipni edhe nuk do të jetë ngrehun rafineria që u përmend ma sipër, Kompania detyrohet t' i japë (fournir) Qeveris Shqiptare ç' do trimestri gjashtë qint e njëzet e pesë tonellatë voj-guri shndritës (lampant) dhe shta-

tëdhet e pesë tonelata benzinë me dhetë për qint ma pak sê çmimet e pazarit.

Neni 7. *a)* Në rast kur punërat e Kompanisë ose të Kompanisë Veprimit do të jenë pre, ose ndalue (interrompus) ose pengue, nga ngjarje të forcave majore të majore të ngjame prej cilit do shkak, periudhat kohve të parapame si maximum në këtë konvencjon do të pushojnë së vazhduari për gjith kohën e ngjarjeve të forcës majore.

(b) Personali dhe materiali i Kompanisë dhe i Kompanisë Veprimit në ç' do kohë do të gëzojë mprojtjen e Qeveris Shqiptare.

(c) Në qoftë se Qeveria Shqiptare vendos mos pranimin e shkakut që Kompania ose Kompania e Veprimit e deklaron si të forcës majore, kjo mosmarrëveshtje do të vihet nën arbitrazh si mbas rregullave të nenit 10.

Neni 8. Anët Kontraktuese detyrohen njera kondrejt tjatrës të lehtësojnë zbatimin e konditave të parapame në këtë konvencion.

Neni 9. Në qoftë se Kompania nuk do të plotësojë angazhamentet e saja që rrjedhin prej këtij konvencjoni, Shteti do të ketë të drejtë t' i tërheq vërejtjen tue e ftue t' u konformohet brenda tre muajve angazhamentenve të sipërmarruna. Në qoftë se në mbarim të këtij afati Kompania nuk do të jetë konformue, Shteti, do të ja referojë punën për nji herë arbitrazhit si mbas nenit 10. Në qoftë se mbas arbitrazhit, Kompania ngul kambë për mos plotësimin e agamenteve, Shteti do të ketë të drejtë të anulojë (resiller) kët konvencjon.

Neni 10. Në rast të ç' do mos-marrëveshtje midis Qeverisë edhe Kompaniës Veprimit që i përket interpretimit të drejtave dhe obligatave të dy anëve kontraktuese që rjedhin nga dispozitat e këtij konvencioni, çashtja do t' u referohet tre arbitrëve nga të cilët njeni do t' emnohet prej Qeverisë, një tjatër prej Kompanisë dhe i treti do të zgjidhet prej të dy arbitërve në fjalë në marrëveshtje të përbashkët.

Në qoftë se arbitrët nuk merren dot vesht për personin e arbitrit të tretë, ky do të zgjidhet me mënyrën që pason :

Një komitet do të formohet prej pesë anëtarësh, dy prej të cilëve do të zgjidhen prej Qeverisë, dy prej Kompanisë dhe i pesti do të emnohet me shumicën të katër anëtarëve të parë. Ky komitet do të emnojë me shumicë votash arbitrın e tretë,

Në rast kur për ç' farë do arësye që të jetë, zgjedhja e arbitrit të tretë nuk do do të munt të bahet prej Komitetit, emnimi i tij do t' i referohet Gjyqit Diktimit Shqiptar.

Neni 11. Për sa u përket veprimeve Kompanisë të bamuna në Shqipni, ç' do konflikt i lindur prej tyne do t' u parashtrohet gjykatoreve të vendit, posë kur asht parapa ndryshe në këtë konvencion.

Neni 11. Ç' do informatë e parapame në këtë konvencjon, që Qeveria do të kërkojë nga Kompania e Operacionit, kjo informatë do t' i dërgohet kësaj me letër ose me kablogram, drejtuar Ministrisë Punve Botore. Ç' do informatë e dhanme me letrë do të quhet e marrun tri dit mbas ditës të mbritjes në destinacionin ordinar mbas dorëzimit saj në zyrën e ekspedicionit.

Neni 13. Ky konvencion asht ba Shqip edhe Frengjisht në katër copë (exemplaires) të nënshkruëme prej të dy anëve kontraktuëse. Por në rast mosmarrëveshtjeje mbi interpretimin e tij, teksti frengjisht duhet t' a zerë vendin e parë (doit prevaloir).

Për Qeverinë Shqiptare

Për Standard Oil Company of New-York

Na, Kryetar' i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë konvencion të pranuëm prej të dy Dhomave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e tij.

Kryetari i Republikës

A. ZOGU

Nr. 57.

KONVENCION, 27 Korrik 925

Për tokë petrofiliere lidhun me Z. Herbert Rushton nënshtetas Englez

(i botuem në Fletoren Zyrtare, 22 Gusht 1925, Nr. 45)

Në mes të Z. Ministrit të Punve Botore e Bujqësiës, n' emën e për hesap të Shtetit Shqiptar (qi shenohet këtu e pastaj si „Qeveri") me një anë Z. Herbert Henry Rushton me banim në 19 Basinghali Str. London E. C. 2, për vehten e tij dhe për Shoqërin kur do formohet m' anë tjatër; asht lidhë e caktue ç' ka vazhdon :

Art. 1. – Qeveria i njef Kompaniës të drejtën për të zgjedhë mbi krejt tokët e Shtetit Shqiptar, pa kurrfarë restrikcionit për pos këtyne të shenueme në kët artikull, sypërfaqet qi përgjithsisht nuk kalojnë maximum prej 20.000 Hektarësh me qëllim për të ba studime gjeologjiks e për të kërkue petrol. bitum gaz të natyrshëm argjile. bituminoze e kiste që kan aftësi, me dhanë petrolin nëpër distilacion.

Zoti H. H. Rushton ase Shoqria që do të themelohet prej tij, nuk kan me pasë asnji të drejtë me ba zgjedhjen mbi sypërfaqe që kanë zgjedhë partiet e treta për me bâ kërkime e shfrytzime të landëve të naltpërmenduna, në konformitet me të drejtat që u janë konceduem prej Qeveriës para datës së nënshkrimit të këtij konvecion. Z. H. H. Rushton ase Shoqria nuk kan me muëjt edhe me zgjedhë sypërfaqet e nalt-përmenduna para se të kenë ba zgjedhjen e sypërfaqeve të veta Shoqnia Standard Oil C.

Kjo zgjedhje e sypërfaqes prej 20.000 Hektarësh duhet t' i komunikohet Qeveriës 20 ditë mbassi Standard Oil Company të ketë zgjedhë sipërfaqet e veta. Këto 20.000 Hektar nuk do të munden as me nji mënyr të përbajnë ma tepër se 2 zona të veçanta. Përjashtohet nga zdhedhja zona e Panajis si tregohet në planin e bashkanjitun.

Art. 2. *a)* Mbasi të shenjohet sypërfaqia ose sypërfaqet që bajnë 20.000 Hektarë për studime gjeologjike. Kompania merr mbi vedi me proçedue në këto veprime me konditat qi pasojnë :

b) Qeveria merr mbi vedi me ba Kompaniës të gjith lehtësiënat tuej parandalue ç' do lloj ndalim punë (obstrukcion) e pengime në dam të përparimit të veprimeve.

c) Se as nji të drejtë shfrytzimi e germimi nuk duhet t' i konferohet asnji të treti mbi as nji pikë të këtyne 20.000 Hektarve, deri me sa Kompania të ketë zgjedhun 10.000 Hektarë qi kjo Kompanië do t' i shfrytzoj si asht thanë n' Art. 5. E nëpër të gjitha germimet, Kompania merr mbi vedi të mos baj dame pa pëlqimin e proprietarve (ose pronarve) të tokave në fjalë me nji distancë (largësie) prej 50 metrash nga çdo ndërtesë së banueshme e do të bajnë shka mundet për me ju largue çdo damit qi kishte me muejtë me rrjedhë në korrat, vneshtat ose pemët të frytëshme.

d) Se kërkimet nuk do të bahen me nji largësi ma pak se 64 metër prej pusevet me ujë të përdoruëshme.

e) Se ujnat minerale nuk duhen të damtohen pa lejen e Qeveriës.

f) Se kërkimet nuk kan për t' u ba në qytete e katunde ashtu edhe nëpër vende botore si treg. kopsht e shesha qi i përkasin nji ose shumë katundeve ose qyteteve të vogjël, vorresa, rruga, udhë-hekurit ose rruga botore.

g) Në mbarim të ç' do trimestrit Kompania detyrohet t' japë Qeveriës raporta mbi të gjith hollsinat mbi ç' do lloj studimesh, tue bashkalidhun në ta kopjet hartash e planesh të pregatituna e të dorëzueme Kompaniës nga ana e Agjencive të sajë, ashtu edhe për mostrat e landve të gjetuna.

Art. 3. — Kompania ka me pasë të drejtë me çue (emporter) e me exportue si (echantillon) moster sasien t' arsyëshme landësh prej të gjitha llojnave qi janë tregue ma nalt e qi janë gjetë prej asaj (Kompaniës) nëpërmjet të gërmimeve (fouille) Kompania ka me pasë edhe obligatin por sa duhet (convenable) me mbushë ç' do gropë qi asht ba edhe me rafshue sypërfaqen e sa të jetë e mundun me e pruë në gjendjen e përparëshme.

Art. 4. — *a)* Ç' do të tretë, në vazhdim të punimeve qi Shoqnia ka të drejtë me ba, që t' i jetë damtue proni prej Shoqniës, do t' i jetë shpërblye me nji herë nga Shoqnia në nji shpërblim të nji vleftës së vërtetë (equitable).

b) Gjith-ashtu Qeveria do të shpërblehet për ç'do lloj obligate qi t' i ngarkohet kundrejt ç' do personi të tretë nga shkaku i punimeve të sipërmarruna prej Kompaniës.

c) Shuma e shpërblimit, qi do të paguhet ndër konditat e sipërpërmenduna në rasë mos marrëveshtje në mes të dy anve, do të caktohet prej arbitrash qi do t' emnohen nga pronari i tokës e nga Kompania. Numri i arbitrave do të caktohet me nji akord të përbashkët prej të dy palvet. Në rasë të nji mos-marrëveshtje në mes t' arbitrave, këta do të zgjedhin nji syperarbitër.

Vendimi i syper-arbitrit do të jetë definitiv. Në qoftë se arbitrat nuk bien në godi për personin e sypër-arbitrit, puna do t' i referohet gjykatorevet kompetente shqiptare.

d) Për sa i përket pagimit të shpërblimit të vendosun duhet marrë parasyshë vleftën ordinare të tokës pa mvarsisht (independent) prej ç' do konsideratë t' implikuëme nga ky konvencion.

e) Pagimi i shpërblimit do të bahet mbrenda nji muajit qysh prej datës së vendimit t' arbitrave ose të sypri-arbitrit.

f) Në rasë ku, në kohë t' operatave të përmenduna në kët konvencion, tokat do të damtohen më nji shkallë të pa përdoruëshme për cultivacion, ose kuer do të jen të nxanuna për nji perjudhë qi e kalon motin, pronari i nji të tillë tokë ka me pasë të drejtë me kërkue exproprijimin si mbas ligjës në fuqi.

Art. 5. — *a)* Që prej ditës të notifikimit të premë për zgjedhjen e 20.000 hektarve për t'u explorue ashtu si asht thanë në nenin, do t' i epet Kompaniës nji perjudhë deri tre muej, në të cillën ajo ka me pasë të drejtë me i caktue sypërfaqet për kërkime në hollësiëna e për sondage, edhe se Kompania ka me pas të drejtë me baëm sondazhë ndër sypërfaqet e akorduëme si pas konditave qi pasojnë:

b) Se sypërfaqet e caktueme kështu nuk duhet të kalojnë nji shumë të 10.000 hektarve, të cilët nuk do të zgjedhen veç se mbi 20.000 hektarë qi i janë konçedue Kompaniës për t' u explorue si pas termavet të nenit 1. Kompania i njef çë do sypërmarrjes së tretë të drejtën e shkruarjes mbi 10.000 hektarët zgjedhun prej sajë me qynga (borija) (avec conduits) ose me tjatër mjet transporti.

Faculteti i zgjedhjes në fjalë do të jetë absolut e do të jetë i liruem prej ç' do llojë reservash, përveç atyne të parapame n' art. 1.

c) E drejta e të zgjedhunit e sypërfaqes në fjalë qi i nepet Kompaniës ka me pasë prijoritet absolut mbi ç' do cillë partië të tretë.

d) Se nuk munden m' u shenjue më shum se 2 zona të veçanta.

e) Se për me i çue kah mbarimi i tyne kërkimet të holluëme (detailles) nji perjudhë prej 3 vjetësh, do t'i nepet ma së shumit, kjo perjudhë do të shenohet pastaj si perjudhë kërkimeve të hollueme (detailles) e gërmimesh (forage).

f) Se Kompania duhet t' ja parashtrojë Qeveriës nji raportë në ç' do gjasht muaj mbi përparime qi bahen nëpër kërkime e gërmime me nga nji kopje të gjith planeve e hartave të nevojshme, ose Kompania duhet prap me i dhanë të gjitha informatat suplementare qi Qeveria beson se janë të nevojshme.

g) Se Kompania merr mbi vedi në kohë të perjudhës së gërmimit me gërmue së pakti dy pusa në 10.000 hektarë të sypërfaqes së rizervuëme prej sajë për m' u shfrytzue.

Prej këtyne 2 pusave 1 do të gërmohet deri në nji thellë-

siē prej 1000 (njimijë) metrash posë me nji rasë ku petroli do të gjindet në nji thellësië ma të vogël.

h) Se nji komisjon teknik do të formohet, i përbaëm prej 6 antarësh, tre nga këta do të jenë t' emnuëm nga Qeverija e tre nga Kompania. Ky komisjon do t' i vërtetojë konditat e tokavet e do t' a vrejtojnë (surveiller) të kryemit e detyrave nga ana e Kompaniës, në rasë qi do të parashtroheshin vështirsiëna të cillat do t' i pengojshin serjozisht, të kryemit e programit minimum, Komisjoni ka me muejtë me vendue nji rrëzim t' arsyeshëm prej këtij programi. Komisjoni ka për të pasë edhe fuqië për të ba nji zbritje nëpër të gjitha obligatat qi i përkasin gërmimevet, si për punë të gërmimevet si edhe për punë të shfrytzimit, në rasë ku cirkonstancat kryesore kan për t'a ba të dishruëshme nji masë kso doret.

i) Se në çë doças mbas datës së shenimit të kuptuem të sipërfaqes të sipërtreguëme, para mbarimit, ose në mbarim të perjudhës së gërmimit, Kompania ka me muejtë me shkrim me informuë Qeverinë, a e konsideron apo jo, qi ka petrol n' at sasië sa ka me muejtë m' u shfrytzue tregtarisht, me kët rasë Kompania do të ketë të drejtë me zgjedhë, e lirë prej ç'do barrë posë atyne që janë parapa në kët konvencion, sypërfaqet krejtësisht ose vetëm nga një pjesë prej ç' do sypërfaqe për t'a zhvillue këtë e për të ba në të kërkime të pastajshme (ulterieur) për me nxjerrë petrol ose ç' do landë nga ato të treguemit nalt.

Art. 6. — Kompania do t' a ketë të drejtën eksklusive të shfrytzimit e të kërkimeve mbi çka marrin sypërfaqet (etandue) 10.000 hektarësh qi ajo do t' i këtë zgjedhë si mbas nenit 5, për petrol ose për krejtë apo nji pjesë landvet sypërtregueme deri me 31 Dhetuer 1985.

Këto të drejta ju shtrohen (soumis) konditavet qi pasojnë:

a) Se ka për t' u formue nji Kompanie Inglize nen titullin „The Valona Oilfields Limited, qi ka për t' u shenjue këtu e poshtë si Kompania e Veprimit.

b) Se kapitali i autorizuem i Kompanisë, nuk do të jetë ma pak se 150.000 L. Sterlinë n' acion nga nji lirë sterlini e do të mundet me u shtue në qoft se Kompania e gjykon të nevojshme.

Pesë (5) muej para emisjonit të çë do kapitalit n' akcion Kompania do të detyrohet me informue Qeverin mbi qëllimin

BKSH

qi ka për t' a ba komisjonin respektiv e në tre muejt e para të kësaj kohe prej 5 muejsh, nenshtetasit Shqiptarë do të munden të nënshkruejnë 40°/₀ të këtij kapitalit n' akcione me çmim t' emisjonit e në rasë ku kto akcione ose nji pjesë e tyne nuk do të jetë e shkrueme (souscrire) prej nënshtetasve Shqiptar, Qeveria në dy muejt qi jesin do të ketë të drejtë me shkrue (souscrire) të gjitha ose nji pjesë prej akcjonesh në fjalë, tue pasë para syshë gjithnji qi shuma e akcioneve të shkrueme nuk do të mundet me e kalue kufin e 40°/₀.

c) Se nji kopje e bilançavet të përmotëshme të Kompaniës Veprimeve do t' i komunikohet Qeveris.

d) Se Qeveria do të ketë të drejtë me emnue nji antar në Këshillë t' Administratës të Kompaniës së Veprimeve.

e) Se kompania do të detyrohet me ja lshue Komdanis së Veprimeve krejt Konçesjoset qi do të jenë dhanun asajë me të gjitha të drejtat e privilegje të përkatëshëm me qellim qi veprimet e explorimit ose zhvillimin e shfrytzimin e tokvet qi përbajnë objektin e këtij konvencionit, të jenë sypërmarrë e të vazhdueme prej Kompanis së Veprimeve.

f) Se Kompania e Veprimevet do të detyrohet me pague nji redevance prej 13.50 për qint (tremdhet e gjysë) mbi prodhimin e petrolit brutto qi do të ketë qenë sjellë prej pusavet në reservoar (reservoire) të themelueme për kët qëllim më parë (en expese) ose në landë (en nature). Pëlqimi i njenës prej këtyne të dyjave i lehet Qeverisë. Kompania e Veprimit do të ketë të drejtë të rrxojë nga shuma e petrolit të prodhuem me mënyrë të diftueme në paragrafin e përparëshëm çë do sasie qi ajo ka për të prishë për të gjitha punët qi janë në lidhje me shfrytzimin ; në mënyrë qi redevenca do të llogaritet mbi bazë të sasiës qi mbetet mbas rrzimit qi flitet këtu.

Në mbarim të çë do trimestrit Kompania asht e shterngueme me ja parashtrue Ministriës së Punvet Botore e Bujqësiës nji raportë qi i përket sasiës së petrolit të prodhuem si edhe mënyrën qi ajo se si ka me disponue kët sasië. Redevenca do të llogaritet në bazë të sasiënave qi figurojnë në këto raporta.

g) Se Kompanija e Veprimit do të detyrohet me pague nji t' ardhun të përmotëshëm nga 1.50 fr. ari për hektar, për ato sypërfaqe qi do të jenë lëshue në konformitet të nenit 5 *a) b*) Kompania do t' i paguej Qeveris redevencën për dy vjet e përpara në muej qi pason ratifikimi i konvencjonit.

h) Se pas formimit Kompania e Veprimit lidhë me vue në zbatim programin e foragit si pason:

Mbrenda vjetit të parë 1000 m
Mbrenda vjetit të dytë 1.500 m. e ma tepër
Mbrenda vjetit të tretë 2000 m. e ma tepër
Mbrenda vjetit të katërt 2000 m. e ma tepër
Mbrenda vjetit të pestë 2000 m. e ma tepër.

Teprica në kjoftë se do të ketë prej këtyne numrave metrash në ç'do vjetë do të llogaritet për të plotësuë numrin e metravet të vjetit qi pason.

Me gjitë këtë në kjoftë se mbrenda 5 vjetëve sypërshenjuëme, pusat e gërmuem arrijnë nji prodhim tremuejshëm prej 10.000 ton. Kompania do të kishte të drejtë me i ndaluë (relatir) punët e gërmimit, por do të shtërngohet t'i fillojë përsërij gjithnji mbrenda 5 vjetëve të para qi pas programit në krye deri sa përsëri t' arrijë deri 10.000 ton. Komisjoni teknik do të jetë kompetent me vendue nji zbritje t' arsyeshme të këtij programi, në qoftë se kjo duhet e dishrueshme në konsiderim të veprimeve të përgjithshme të Kompaniës e të natyrës si edhe të konditës së tokave petrolifere.

Mbas 5 vjetësh të para Kompania e veprimimit ngarkohet të bajë të gjitha mundimet e arsyëshme për me zhvillue gradën ma të naltë qi asht e mundun për shfrytzimin e dejvet (gisement) petroliferi në sypërfaqet e konceduëme e do të rregullojë programin e gërmimit në konformitet me atë qi u tha ma nalt mbas këshillimit të komisjonit teknik (d. m. th. me i ba të gjitha mundimet e arsyeshme për shfrytzimet e dejve petrolifere në nji shkallë ma të naltë qi mund të jetë).

Se Kompania e Veprimit do të ketë të drejtë me i lanë të gjitha pjesët e tokavet qi do t'i jenë dhanë asajë ky ndryshim i tokavet do të tërheqë librimin e Kompaniës prej të gjitha obligatave qi rezultojnë prej këtij konvencioni për çka u përket tokave të lëshuëme.

i) Se 40.000 fr. ari (1.600) L. St. do të depozitohen nji muaj mbas nënshkrimit të këtij konvencioni, në Arkën e Përgjithshme të Ministris së Financavet këtu, si nji dorzanië (garantië) për exsekutimin e mirë të neneve të këtij konvencioni.

Shuma e sipër-përmendur e garantiës do të jet e pengume për gjith periudhën e konçesjonit, dhe do të lehet pasunië (propriete) e Qeveriës në qoftë se Kompania nuk do të kishte mbushun detyrat që merr me kët konçesjon kundrejt Qeveriës.

Por me të marrmen fund perjudha e konçesjonit ose në kjoftë se Komisjoni teknik do t' i ketë konstatue nji përfundim negativ në çka i përket kërkimeve apo në kjoftë se Parlamenti nuk do t' a ketë vertetue konvencjonin, Qeveria Shqiptare detyrohet me i kthye Kompaniës shumën në fjalë.

k) Se në mbarim të perjudhës të konçesjonit prej 60 vjetve krejt materjali qi gjindet në Shqipni, instalacionet, ndërtesat debojat, pusat, rrehtime (Quai) rruga e urat qi i përkasin Kompanis së Veprimeve do t' i nepen në dorë gratis Qeveriës Shqiptare.

l) Se kuer Kompania e Veprimit do të ketë nevojë për rruga qi mund të kalojnë karrocat e për tramvay të nevojshme për shfrytzim, Qeveria do të japë kalim të lirë pa farë barret mbi rrugat.

m) Qeveria do t' japë Kompaniës të drejtën e ndërtimit e të përmbajtunit me kambë për nevojat e asajë të ullukave (buria-conduit). Vija telefonike, telegrafa pa tel, telegrafa robau ajrit, rrugat e hekurit e tramvay për aq sa do t'jenë exklusivisht të përdorueme për shërbimin e industriës, petrolifere rruga e rehtina e ura, qi tuej u nisë nga tokët që përshien konçesjonin e vet do t' arrijnë çdo pikë bregut qi Kompania ka për t' a gjetë të pëlqyeshme.

Ajo ka për të pasë edhe të drejtën e ndërtimit të banimeve për puntorët e vet, reservuarvet, t' amplasamentave, të debojavet, të zyrevet, të uzinëve e të rafinerjeve, për kët ajo do të ketë të drejt qi t' i lshohen tokë qi i përkasin njerëzve private me mënyrën t' ekspropriates në konformitet me ligjët në fuqi.

Të çmuemit e tokve për t' u expropriu, do të bahet pa mvarësisht prej çë do konsiderimit t' implikuem prej konçesjonit qi flitet në kët konvencion.

Për sa i përket tokvet botore jo të xanme, këto do t' lëshohen gratis nga Qeveria.

n) Se Kompania dhe Kompania e veprimit do të kenë të drejtë me importue në Shqipni të lirueme prej çë do takset doganore, krejt materjalin e veglat qi asai do t' i duhen.

o) Se Kompania do të ketë të drejtë me nxjerrë jashtë petrollin bruto, asfaltin, serën e prodhimit sekondarë pa pague as nji taksë exportimit.

p) Se Kompania edhe Kompania e Veprimit do të jenë të përjashtueme prej ç' do taksë specjale reale ose personale.

q) Se nëpunsat dhe puntorët qi merren në shërbim prej Kompaniës së Veprimit do të jenë nga nënshtetësija shqiptare, posë teknicienëve, ekspertave, dhe specjalistave.

r) Se në rasë që një rafinerie do të mundet m' u instalue në Shqipni prej Kompanis së Veprimit, Kampania ngarkohet t'i përgjegjet kërkesave për vaj-guri e për prodhime sekondare qi janë fare të domosdoshme për nevojat e Qeveriës, me vleftën e pazarit, tuej e bamun një redukcion prej 10% me gjith këtë kërkesat e Qeveriës nuk do të munden të kapërcejnë të 20% të prodhimit neto mbasi të jetë zbritë sasia e vojit të gurit të konsumuem për punrat e Kompaniës.

Përpara se t' exportohet voji i gurit, ç' do kërkesë e Qeveriës shqiptare qi kapërcen 20% ashtu edhe gjith kërkesat për tregtin ose për qëllime të tjera në Shqipnië, do të pranohen me çmimin e pazarit.

Kuer prodhimi i tremuejshëm i vojit gurii brutto do të jetë 5.000 tonelatë e lartë, dhe në Shqipnië edhe nuk do të ketë rafinerië qi u përmend sypri, Kompania detyrohet t' i napë (fournir) Qeveriës Shqiptare për tre muëj 150 tonelatë voj-guri shndritës (lampant) dhe 15 tonelatë benzinë me vleftë 10% ma pak se çmimet e pazarit.

Art. 7. — *a)* Në rasë ku punrat e Kompaniës ose të Kompaniës së Veprimit do të jenë të preme, ose të (interrompus) ndaluese ose të pengueme, nga ngjarja prej forcave majore të ngjame prej ç' do cilit shkak, perjudhat e kohve të parashikuëm si maximum në këtë konçesjon, do të pushojnë prej vazhdimit për gjith kohën e ngjarjeve të forcës majore.

b) Personali dhe materjali i Kompanis dhe i Kompaniës së Veprimit në ç' do kohë do të gëzojnë mprojtjen e Qeveriës Shqiptare.

c) Në kjoftë se Qeveria Shqiptare vendos mos pranimin e shkakut të cilve Kompania ose Kompania e Operationit e deklaronte si prej forcës majore, kjo mos-marrveshtje do të vehet nën arbitrazhe si mbas rregullavet të nenit 10.

Art. 8. — Anët kontraktuëse detyrohen njena prej tjetrës të lehtësojnë zbatimin e konditave të parapame ng ky konçesjon.

Art. 9. — Po të provohet se kompania nuk asht e konformuëme me obligatat e ngarkuëme me kët konvencion Qeveria ka të drejtë t' a anulojë kët konvencjon.

Art. 10. — Në rasë të ç'do mosmarrëveshtje midis Qeveris e Kompanis veprimit qi i përket interpretimit e të drejtave dhe obligatave të dy anëve kontraktusse të rrjedhun (derivant) nga dispozitat e këtij konvencjonit, çashtja do të riferohet tre arbitrave, nga të cilët njëri do t' emnohet nga Qeveria nj tjetër nga Kompania dhe i treti do të zgjidhet nga të dy arbitrat në marrëveshtje të përbashkët.

Në kjoftë se arbitrat nuk merren dot vesh për personin e arbitrit tretë, ky do të zgjedhet në mëndyrën si pason:

Nji komitet do të formohet prej 5 antarësh, 2 prej të cillve do të zgjidhen prej Qeveriës, 2 prej Kompaniëë dhe i pesti do t' emnohet me shumicën e arbitrave, të parë.

Ky komitet do t' emnojë me shumicë votash arbitrin e tretë.

Në rasë kur, për çdo farë arsyjet, zgjedhja e arbitrit të tretë nuk do të mund të bahet prej Komitetit emnimi i tij do t' i referohet Gjyqit Diktimit Shqiptar.

Art. 11. — Për sa i përket veprimeve të Kompaniës të bamuna në Shqipni çdo konflikt i lindur prej tyre do t'i parashtrohet gjyqeve të vëndit përveç se n' asht parapa ndryshe në kët konvencion.

Art. 12. — Ç' do informatë e parashikuëme në kët konvencion, që Qeveria Shqiptare, do të kërkojë nga Kompania e Operationit, kjo informatë do t' i nepet kësaj me letër ose me kablogram, drejtuar Ministrisë Punvet Botore e Bujqësis.

Ç' do informatë e dhanme me letër, do të quhet e marrë 3 dit mbas arritjes së postës në distinationin e rregullshëm, dhe po t' jetë dërguar me kablogram, 48 orë mbas dhanjës në Zyrën e expedicionit.

Art. 13. — Ndalimi i të lëshuarit (interdiction de ceder) asht e ditun qi Kompania do t' i lshojë të drejtat dhe obligatat e sajë Kompaniës Veprimit por kjo e fundit' as me nji pretekst nuk do të mundet të lëshojë tjerve, (a des tiers) të gjithë ose nji pjesë e kësaj kontrate, pa pëlqimin e Qeverisë se ndryshe Qeveria ka të drejtë me e prishë për nji herë kët kontratë.

Art. 14. — Ky konvencion u ba në dy (2) origjinale, Shqip e Fregjisht, por në rasë të nji mos-marrëveshtje (divergence) për interpretimin e tij, teksti frengjisht do t' jetë ma i vlefshëm.

Art. 15. – Sendet t' arteve dhe antikave të zbuluëme në kohën e kërkimit dhe të punrave do t' i parashtrohen rregullave qi rregullonin këto landë.

Ba në Tiranë, me . . . . . .

Konçesjonari:

Për Qeverin Shqiptare
M. i P. B. Bulqësiës

Pëlqejmë këtë konvension të pranuëm prej të dy Dhomave legjislative dhe urdhnojmë zbatimin e tij.

Tiranë, me 25 Korrik 1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 58.

DEKRET-LIGJË, 29 Maj 1925.

Mbi ndalimin e transitos për tokë

Mbassi u pa vendimi i Këshillit Ministruer me d. 22-V-925.

DEKRETOJMË:

I. – Transita për tokë përgjithësisht asht e ndalueme.

II. – Ky dekret-ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes.

III. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Tiranë, me 29-V-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Nr. 59.

LIGJË, 1 Gusht 1925.

Mbi krijimin e Kryekonsullatës në Kopenhagë

I. – Krijohet nji Kryekonsullatë nderi në Kopenhagë me të drejtat e përkatëshme.

II. – Kjo ligjë hyn në fuqi çë nga dita e shpalljesh.

III. – Ministrija e Punve të Jashtme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Financavet
e Zav. Min. i P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

AQSh

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej të dy Dhomave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 1-VIII-1925. *Kryetari i Republikës*
A. ZOGU

Nr. 60.

LIGJË, 21 Gusht 1925.

Mbi përjashtimin nga tagri doganor të mobiljeve t' organizatorve të gjindarmëriës

I. – Përjashtohen nga tagri doganuer mobiljet qi do t' importojnë Organizatorët e Gjindarmeriës për nevojat shtëpiake të tyre.

II. – Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

III. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Financavet
MUFID LIBOHOVA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej të dy Dhomave legjislative dhe urdhnojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 21-VIII-1925. *Kryetari i Rebublikës*
A. ZOGU

Nr. 61.

RREGULLORE, 23 Gusht 1925.

Për instalimin e imigrantve dhe të bujqve në tokat shtetnore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 26 Gusht 1925, Nr. 46)

1. Komisia e formuëme si mbas nenit 7 të ligjës, për të vendosunit e imigrantave dhe të bulqëve, ka për detyrë të sigurojë përkohësisht ushqimin e imigranteve, t' u dajë sasinë e tokës si mbas nenit 2 e 5 të ligjit, të grefunit e ndërtesavet ku ta lypi nevoja, mirë përdorimin e kredinave të destinuëme për këto qëllime, të kërkojë e të gjejë tokët e nevojshëme të cillat duhet të jenë të favorëshme për instalim dhe kështu të vendoj mbi tanë mënyrat qi kan të bajnë me instalimin e tyne e të buj-

qëve. Të gjith shpenzimet qi do të bahen ndër Prefektura e Nënprefektura kan për t' u ush'ruë me vëndim të Komisieve të naltë-përmënduna.

2. Të kryëmit e veprimeve shkrimore e të njehsinavet të emigrantsve do i ngarkohen njenit prej misave të Komisiës.

3. Shpenzimet qi kanë me u bamë nga kredija e emigrantëve do të paguhen prej Arkës së Financavet në bazë të akteve justifikuëse të vërtetuëme nga Komisia. Në fund të ç' do muejit do t' i dërgohet Ministris së Financavet e të Mbrendëshme nji listë e shpenzimëve këso dore.

4. Komisiët tue pas gjithmonë parasyesh frymët e nji familjes edhe fuqin produktive të tokës si mbas nenit 4 paragraf i fundit mund të caktojnë nji sasië tokë në nji shkallë të mjaftme në qoftë se kjo kërkohet prej emigrantit a bulkut dhe këte ja dorëzojnë Kryetarit të families si të bajnë hetimet e imta i cili për tokën ma tepër se 2 hektar e gjysmë asht i detyruar ti shtrohet gjith taksavet Shtetnore pa as nji përjashtim.

5. Emigrantat dhe gjith bujqit të treguem në art. 2. të ligjit qi do të instalohen me anë të Komisievet, në tokat shtetnore shtëpiet e tyne do t'i ngrefin në vendin e caktuem e sį mbas planit të pregatitun prej Komisjonit si për kët ashtu edhe për të blemit të veglave bujqësore e të pendave dhe për farë, mund të ndihmohen me nji sasië të hollash qi komisiët do të shofin të arsyeshme. Por sasija e ndihmës këso dore do t' ju jepet me konditë qi tu ritirohet mbrenda 10 vjetve e me 10 kistet e njinjishme prandej Finannca e vendit ka me pregatit nji diftesë detyre me anë të cillës Kryetari i familjes do të çfaq se merr për sipër të paguemit e këtij borxhit rregullisht e tue fillue pagesën e kistit të parë në mbarim të vjetit të tretë të instalimit.

Diftesa do të vertetohet edhe në Noteri.

6. Po sa të mërrinë emigrantat nër vise ku do t' instalohen Komisjoni ma parë merr shenim nga ç' vend erdhën e mbi klimën e vendeve ku banojnë: mbi profesionet do të kenë në kujdes për instalimin e tyne pranë njerzve të vet e afër njeni tjetrit'

7. Për emigrantat qi vinë nji herësh e me shumicë do të sigurohet të instaluemit e tyne në nji vend tue krijue katunde me konditat shëndetsore, e në tokën qi do të caktohet për këta do të siellet doktor e ingjinier të cilët do të zgjedhin e të cak-

tojnë vendet për nevojat publike si për faltore, Shkollë, krue, varresë, treg e tj.

8. Për ngrehje të ndërtesave ase për blerje të sendeve për konstruksione të këtyne, Komisionet do të japin vendim e do të kërkojnë kredi të nevojshme nga Ministrija e P. të Mbrendshme dhe krediet, do ti shpenzojnë pa dyshim, në bazë të autorizimit të autoriteteve kompetente e si mbas rregullave.

9. Me të kryemit e veprimeve të transferimit në shtëpit qi do të ngrefin e të damit e të dorëzuemit të tokve emigranteve dhe bujqeve me nji herë u vehen shtëpive Nr. renduer e merret notë mbi sasiën të frymeve të familjeve qi në to banojnë e emnat e mbi emnat e vjeçët e tyne e mbi sasië të dynymve të tokve qi u asht caktue, dhe nji liste qi të përshin këto cilsina do t' i paraqitet Ministris së P. të Mbrendëshme.

10. Katundeve qi do të krijohen ndër vende ku instalohen emigrantat do tu vehen emnat qi të shifen të pëlqyëshme e do tu caktohen pyje e kullotë për nevojat e tyne komune e do t' u emnohen pleqsina e mësuesa. Për të tilla katunde do të formulohet edhe nji hartë në katër kopje nga të cilat njana i dërgohet Ministris së P. të Mbrendshme njana i jepet zyrës së Kadastrës në vend e tjetra i paraqitet Ministris së Financavet dhe e katërta i lehet pleqësis së katundit me anë të cillës do të zgjidhen çashtjet e grindjet qi mund të ngjajnë ndërmjet tyne.

11. Ato familje emigrantash e Bujqish që nuk i drejtohen Qeveris për installimin e tyne mbrenda nji vjetës qysh nga data e shpalljes së ligjës relative, nuk mund të përfitojnë nga dispozitat e asaj ligje dhe të kësaj rregullores.

12. Ndër vende ku janë instalue emigrantat dhe bujqit Kryetari i Komisionit ose nëpunësi i Bujqësis apo ingjineri i Botores kanë me shetit e me raportue Prefekturën e Nënprefekturën mbi gjendjen shëndetësore e të shtimit të frymve dhe mbi hapat qi qeverija duhet të bajë për lehtësimin e nevojave e mbi modifikimin e pozitës damtuese të banorve ndër ato vise.

13. Tue marrë parasyshë vendet ku banojshin përpara emigrantat e atmosferën e atyne me të cillën janë qenë të klimatisuem, Komisionet duhet të instalojnë emigrantat ndër vise qi t' i përshtaten klimës së vendeve të tyne.

Ministri i Financavet	*Ministri i Drejtësis*
e Zav. Min. P. të Jashtme	*e Zav. M. i P. të Mbrendëshme*
MUFID LIBOHOVA	P. POGGA

Minis. P. Botore e Bul.
K. KOTTA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë rregullore të pranueme prej Këshillit Ministruer dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 23-VIII-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 62.

DEKRET-LIGJI, ... 1925.

Mbi taksin $1\,^0/_0$ mbi gjanat q'importohen dhe eksportohen në favor të Bashkis së Durrësit

(i botuem në Fletoren Zyrtare, 26 Gusht 1925, Nr. 46)

Na, Kryetar i Republikës Shqiptare tue pam vendimin e Këshillit Ministruer me d. 18-VIII-1925

DEKRETOJMË:

a) Tue marrë parasyesh nevojën e domosdoshme të Bashkiës së Durrësit për me sigurue shpejtimin e punimeve për ndërtesat etj. për zbukurimin e atij qyteti, Bashkija në fjalë do të marri edhe nji taks $1\,^0/_0$ (nji përqind) ma tepër mbi gjanat qi importohen n' at qytet si edhe mbi ato qi eksportohen prej asaj Porte.

b) Përjashtohen nga ky taks gjanat e Trupit Diplomatik, të Kryqit të Kuq e t' Ushtriës.

c) Ç' do dispozitë ligjore asht e pa fuqieshme, në qoftë se i kundërshton këtij dekret ligji.

d) Zbatimi i këtij dekret-ligji i ngarkohet Ministriës së P. të Mbrendëshme.

e) Ky dekret-ligj hyn në fuqi prej ditës së shpalljes dhe mbetet pa fuqi në krye të mot motit.

Ky dekret-ligj asht shtojca e nenit 107 të ligjit të Bashkive.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Financavet
MUFID LIBOHOVA

Zav. Min. i P. të Mbrendshme
P. POGA

Nr. 63.

LIGJI, 21 Gusht 1925.

Mbi përjashtimin nga tagri doganuer të materjalit që do të dërgojë Italia për varret e italianve të mbetun në Shqipni

(i botuem në Fletoren Zyrtare, 26 Gusht 1925, Nr. 46)

1. Përjashtohen nga taksa doganore dhe nga taksa e Magazinës materjali qi do të dërgohet nga Qeverija Italjane për ndreqjen e vorreve t' italjanëve të vrarë dhe të vdekur në Shqipëri. Materjali asht ky:

5.000 (pesëmijë) arqivole të vogjël prej druri të bardhë (petites bieres renforcées en bois blanc).

500 (pesëqind) arqivole të mëdhaja prej druri të bardhë (grandes bieres renforcées en bois blanc).

1.000 (njimijë) arqivole prej druri të bardhë për transport gratis (bieres en bois blanc pour transport gratis).

18.000 bloke çementoje të gropuar (blocs de ciment creux).

3.000 gjysma blokesh çementoje të gropuar (demi blocs de ciment creux).

100 bloka me xhunga çementoje të gropuar (blocs bossés de ciment creux).

150 gjysmën-blokesh me xhunga çementoje të gropuar (demi-blocs bossés de ciment creux).

750 meter linear veshjeje në çimento (mètres lineaires de revetement en ciment).

250 kapitale çimentoje të përbëra prej bazës dhe prej majes (chapitant en ciment constitué de la base e de sommet).

5.000 lastra të hekurta me shkronja në reliev (plaques en métal de fer avec lettres en relief).

950 Kilo parmak hekurit (grilles en fer).

5.000 shtylla guri (steles en pierres).

200 Tonelatë cimento Porsland e dorës së parë (tonnes de ciments porsland de première qualité).

2. Kjo Ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

3. Ministrija e Financavet dhe ajo e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Financavet
e Zav. Min. P. të Jashtme
MUFID LIBOHOVA

Ministri i Drejtësiës
e Zav. Ministri P. të Mbrendshme
P. POGA

BQSH

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej të dy Dhomave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 21-VIII-1925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Nr. 64.

LIGJ, ... 1925

Mbi transferimin e një krediti prej 542.580

(e botueue në Fletoren Zyrtare 26 Gusht 1925, Nr. 46)

Kredit i arkës përgjithshme

Kap. 7.	– të parapame në dispo. të Ministris	fr. ari . .	2000
„ „	– të mëshefta në dispo. të Ministris	fr. ari . .	100.00
	për nji automobil rogë shoferi etj.	fr. ari . .	12.000
			114.000

Për t' u mbajt kredit në dispozition

Kap. 20.	– Rrogë e ant. të këshillit adm. të Malsive.	fr. ari .	35.000
„ 23.	– Kler.	fr. ari .	23.000
„ 24.	– Emigrand	fr. rri .	20.000
„ –	– Instalim të refygjatve Shqiptar .	fr. ari .	300.000
			380.000

Për t' u komunikuc qarqeve

Kap. 16.	– Rrogë Poliçie Financës Tiranë . 1) shtesë rroge kryekomiserit të Policis.	fr. ari . .	600
	2) shtes për rrogë të 10 Policve të Qendrës *a)* 140 për ç' do polic për 9 muej.	fr. ari . .	12.600
			13.200

Financës Durrsit

Kap. 10.	– Shtes rrogë për N. Prefektin e Shijakut për 9 muej (veç kredis krahinarias qi asht për me plotësue shumën e duhun për rrogë të 9 muejve të N. Prefektit	fr. ari . .	900

Kap. 10. —	Shtes roge për sekretarët e N. Prefekturës *a)* 160 për 9 Muej .	fr. ari . .	1.440
	Shtes rroge për sekretarët e Shte. Civil N. Prefekt. *a)* 150 për 9 muj	fr. ari . .	1.350
			3.690

Financës Peqin

Kap. 1. —	Shtes rroge për N. Prefakturën e Peqinit *a)* 900 për 9 muej (bashk me kredin e rogës së Krah. të Peqinit q' asht për me plotsue shumën e duhun për rrogën e N. Prefek. për 9 muej)	fr. ari . .	900
„ „ —	Shtes roge për sekretarët e N. Prefekt. *a)* 160 për 9 muej . .	fr. ari . .	1.440
„ „ —	Shtes rroge për sekretarët e Shte. Civil *a)* 150 për 9 muej. . . .	fr. ari . .	1.350
			3.690

Kredit në dispozicjon të Drejtoris të P. Shëndetsis

Kap. 13. —	art. 16. Shpenzime Specializimi f.a.		8000
	Shpenzime Kininisationi	fr. ari . .	20.000
			28.000
		Gjithsejt Fr. ari	542.580

Nr. 65.

RREGULLORE, 28 Gusht 1925.

E Arsimit filluer e të mesëm

1.

Rregullore mbi këshillin administrativ qendruer

Art. 1. — Këshilli administrativ qendruer përbahet prej drejtorit të përgjithëshëm edhe prej shefavet të seksjonevet. Sekretari i I. i sekjonit *b)* asht i ngarkuem me detyrën e sekretaris së këshillit.

Art. 2. — Këshilli mblidhet rregullisht nji herë në javë nën kryesin e drejtorit të përgjithëshëm e, kur mungon ky, nën kryesin e zav. të tij; në rast nevoje mund të mblidhet edhe ma shpesh.

Art. 3. — Vendimet e këshillit epen me shumicë zanash e në rast të barasimit të votavet, fiton ajo anë me të cilën voton kryetari.

Art. 4. – Vendimet e marruna mbahen në nji regjistër të posaçëm edhe hyjnë në fuqi, mbassi nënshkruhen prej kryetarit e prej anëtarvet.

Art. 5. – Drejtori i përgjithëshëm detyrohet me i vum në zbatim vendimet e këshillit mbrenda në 15 ditë. Në qoftë se çfaqen arsye rishikimi të vendimit të marrun, drejtori i përgjithëshëm ka të drejtë t' i a referojë vendimin këshillit për ribisedim.

Art. 6. – Detyrat e këshillit:

a) vendos mbi çeljen ase mbi mbylljen e shkollavet si edhe mbi transferimin e qendrës shkollore;

b) vendos mbi ndamjen administrative të qarqevet shkollore;

c) bisedon edhe vendos mbi proponimet e inspektorëvet për sa u përket emnimevet, pushimevet, transferimevet e dënimevet t' arsimtarvet;

ç) studjon buxhetin e arsimit edhe vendos mbi shtimet a pakësimet e nevojshme;

d) studjon vendimet me randësi të këshillavet shkollore të qarqevet;

dh) bisedon edhe vendos mbi ankimet e arsimtarvet;

e) ep vendimin mbi çfardo projekti që i paraqitet;

ë) ndan' sasin e bursavet që u epen qarqevet;

f) ep vendimin definitiv mbi pranimin e bursistëvet në bazë të ligjës përkatëse;

g) cakton degët e ndryshme që do të ndjekin bursistët në shkollat e nalta, tue u bazuem mbi raportet e drejtorve të shkollavet;

gj) ep vendimin mbi ndëshkime e të preme të bursavet, tue u bazuëm mbi raportet e inspektorive të studentëvet ase mbi ato të legatavet;

h) merr vendimin mbi çmimin që do t' i epet auktorvet të libravet të pranuëm prej komisjonit teknik;

i) cakton çëmimin që do t' u epet auktorit në rast të ribotimit të libravet të tij;

j) bisedon e vendos mbi reformat administrative t' arsimit;

k) studjon rregulloret e qarkoret e vendos ndryshimin e përmirësimin e tyne;

l) ep vendime mbi leje të jashtëzakonshme t' arsimtarvet.

II.

Regullore e komisjonit teknik

Art. 7. — Njeni nga antarët e komisjonit teknik shënohet prej drejtoris së përgjithëshme si drejtuës i komisjonit përpara drejtoris së përgjithshme edhe rregullon veprimet e përgjithëshme të tij.

Art. 8. — Komisjoni gjindet nën kontrollim të drejtorit të përgjithëshëm, i cili e mbledh nji a ma shumë herë në javë për të mbikqyrë punët e kryëme.

Art. 9. — Drejtuësi i komisjonit detyrohet me i shikuëm punët e kryëme çdo ditë, tue vum nënshkrimin e vet e me ja paraqitë drejtoris në krye të çdo jave.

Art. 10. — Kur çfaqet ndonji nevojë për bisedim çashtjesh teknike, me të cilat asht tuë u marrun veçanërisht se-cili antar, komisjoni ka të drejtë të disponojë për këtë punë të shumtën nji orë në ditë.

Art. 11. — Komisjoni detyrohet të veprojë rregullisht mbas orarit të caktuëm prej drejtoris së përgjithëshme e nuk mund të mirret me ndonji punë tjetër përveç se me ato që shënohen në këto rregullore.

Art. 12. — Për antarët që do t'i shmangen detyrës vihen në veprim masat disiplinore si pas dispozitavet të ligjëvet në fuqi.

Art. 13. — Komisjoni teknik mirret me këto çashtje :

a) harton programe shkollore ;

b) plotëson e përmirëson ligjët e rregulloret arsimore të hartuem në këshillin qendruër ;

c) harton dhe përkthen tekstet shkollore e ç'do tekst tjetër me vleftë arsimore dhe shqyrton dorëshkrimet e paraqituna prej auktorësh me anën e drejtoris së përgjithshme edhe çfaq mendime mbi pranimin a mospranimin e dorëshkrimevet;

ç) ep mendim mbi çdo pyetje teknike arsimore të parashtrueme prej drejtoris së përgjithëshme ;

d) ka nën drejtimin e vet „Rivistën pedagogjike" dhe përkujdeset për botimin e saj.

Art. 14. — Komisjoni teknik e këshilli administrativ qendruër mblidhen së bashku rregullisht nji herë në muaj nën kryesin e drejtorit të përgjithëshëm për të biseduëm çashtje teknike me randësi, që mund të paraqiten nga drejtoria e përgji-

thëshme. Në rasë nevoje, mund të bahen edhe mbledhje të jashtëzakonëshme.

Art. 15. — Komisjoni teknik, përveç pikavet të caktuëme n' art. 13, me nisjativën e vet, mund të çfaq mendimin edhe mbi ndonji reformë tjetër arsimore.

III.

Rregullore mbi inspektorët e përgjithëshëm

Art. 16. — Inspektorët e përgjithëshëm detyrohen të dalin n' inspektimet 100 deri 120 ditë në mot.

Art. 17. — Inspektorët e përgjithëshëm do t' inspektojnë kryesisht normalet, që gjinden në zonen e tyne; përveç këtyneve, do t' inspektojnë edhe shkollat plotore të qendravet të prefekturavet e të nënprefekturavet e mbas nevojës edhe ndonji shkollë katundi. Ky inspektim i fundit ka për qëllim ma fort që të kontrollojnë këta veprimet e inspektorvet të qarqevet e të kenë dije mbi gjendjen arsimore si edhe mbi çashtjet për të cilat kanë raportuem inspektorët.

Art. 18. — Veçanërisht detyrohen me i kontrolluem zyrat e inspektorivet për me vërtetuem rregullimin e mirë të veprimevet teknike administrative si edhe të mbajtunit me rregull të regjistravet. U apin këshillë inspektorvet për të përmirsuem arsimin filluer e kontrollojnë në janë vum këto në veprim.

Art. 19. — Çdo herë që kthehen prej inspektimit, do t' i parashtojnë drejtoris së përgjithëshme raportin relativ.

Art. 20. — Inspektorët e përgjithëshëm mbledhin nji herë në mot të gjithë inspektorët e qarqevet, që gjinden në zonën e tyne, edhe mbajnë konferenca të veçanta, në të cilat bisedohen të metat që kenë pamë në kohë t' inspektimit edhe studjojnë mjetet e duhuna për përmirsimin e këtyne të metavet.

Vendimet e marruna në këto konferenca regjistrohen në nji regjistër të veçantë edhe kopja e tyne i paraqitet drejtoris së përgjithëshme.

Në fund të vitit shkolluer i paraqesin drejtoris së përgjithëshme nji raport të veçantë mbi veprimet e inspektorvet.

Art. 21. — Bajnë hetime mbi ankime, që mund të çfaqen kundër inspektorvet të qarqevet vetvetiu ase me urdhën të drejtoris së përgjithëshme.

Art. 22. — Inspektorët e përgjithëshëm detyrohen të mbaj-

në nji regjistër të veçantë për të shenuem vrejtjet mbi personalin e normalevet, t' inspektorvet e t' atij personali, të shkollavet fillore, që kanë inspektuem.

Art. 23. – Detyrohen të kenë nji regjistër të gjitha shkollavet, që gjinden në zonën e tyne.

IV.

Rregullore mbi inspektorit e arsimit filluer të qarqevet

Art. 24. — Inspektori i qarkut ka këto detyra;

a) t' u komunikojë drejtorivet të shkollavet fillore të qarkut të tij çdo ligjë, rregullore, urdhën e qarkore të drejtoris së përgjithshme t' arsimit, si edhe qarkoret e veta që kanë lidhje me administratimin dhe me teknikën e shkollavet;

b) t' inspektojë së paku tri herë në mot shkollat fillore të qarkat të vet, tuë dalë për inspektim 120 deri 160 ditë në vit.

Art. 25. – Inspektori n' inspektimet e veta:

a) vëzhgon me kujdes veprimet e drejtorvet të shkollavet, tuë kqyrun a i kan përmbushë pikërisht detyrat qi u janë ngarkuëm;

b) kontrollon personalin e shkollavet private, a i ka dokumentat shkollore dhe cillsít e ligjëshme;

c) mbikqyr cillsít shpirtnore të mësuësvet, zellin, ndërgjegjen dhe zotsín pedagogjike e methudhike në mësimet; gjithashtu mbikqyr a vijnë në detyrë me rregull; a regjistrojnë me kujdes landën e mësuëme; a u-mësuë me të vërtetë landa e shënuëme e a asht në përpjestim me kohën; a e pregatisin landën qi do të mësojnë dhe a e paraqesin mësimin methudhikisht; a i përdorin si duhet, veglat mësimore; a përkuidesen për librat e për mjetet e nevojshme të nxansvet; a i kontrollojnë me kujdesin e duhun detyrët e nxansvet; a i mbajnë me rregull regjistrat e përditëshëm; a i vejnë notat me drejtësí dhe a sillen me nji mënyrë të pëlqyëshme si me nxansit, ashtu dhe me kolegët e vet e para popullit;

ç) ban konferenca bashkë me arsimtarët; në këto konferenca ep mësime e udhëzime mbi të mbetat qi ka vum' re n' inspektimin e vet: u tregon për shëmbëll si të mbajnë me rregull regjistrat dhe aktet e ndryshme, si t' i ndreqin të metat e tyne pedhagogjike e methudhike, tuë u bamë vetë mësime shëmbëllore e tuë u diftuëm libra pedhagogjike të posaçëm; për t' a shtuëm kulturën e tyne pedhagogjike etj. Këto udhëzi-

me e përmirsime, mbasi t' ua zhvillojë gojarisht, i shënon në nji libër të veçantë („Libër i konferencavet t' inspektorit e të mësuësit“) e në kohën e duhun kontrollon pale a u-vunë këto në zbatim. Konferencat e sipërpërmenduna do të bahen vetëm me autorizimin e drejtoris së përgjithëshme, së cillës i asht kallzuëm nevoja e këtyneve me nji raport të posaçëm nga ana e inspektorit;

d) përkujdeset qi mos të mirren arsimtarët me punë, të cilat nuk kanë lidhje me detyrën e tyne e të cilat mund t' i sjellin pengime në të kryëmit e detyrës.

Art. 26. — Mbas çdo inspektimi do t' i paraqisë drejtoris së përgjithëshme nji raport, në të cilin parashtron gjendjen e shkollave t' inspektueme dhe shënon masat, qi duhen marrë për ndreqjen e të metavet qi vuni re. Kopjen e këtyneve raportevet ja paraqet inspektorit të përgjithëshëm, në juristikcjonin e të cilit gjindet qarku i tij.

Art. 27. — Ç' do inspektori të qarkut i ngarkohen 40 deri 60 shkolla për inspektim.

Art. 28. — Si qendër, inspektori do të ketë a qendrën e prefekturës ase qendrën e asaj nënprefekturë, e cila ka nji numër ma të madh shkollash.

Art. 29. — Përpara çdo inspektimi, inspektori duhet të paraqitet para autoritetit administrativ të vëndit; mbas inspektimit, do t' i vërtetojë dokumentat e shpenzimevet t' udhëtimit nga autoriteti i vendit e nga inspektori i përgjithëshëm i zonës e, bashkë me raportin e inspektimit, do t' ia paraqesë drejtoris së përgjithëshme.

Art. 30. — Ep mendim përmbi ndërtesat shkollore qi marrin me qirá bashkitë, tuë u përkujdesun qi këto t' i përmbushin sa të jetë e mundun, kërkimet e shëndetsis e të pedhagogjis.

Art. 31. — Sa herë qi kërkon leje ndonji nga arsimtarët e qarkut të 'tij për nji kohë të gjatë, ja paraqet lutjen e tij drejtoris së përgjithëshme tuë çfaqë mendimin e vet mbi pranimin ase jo të lutjes. Në qoftë se leja e kërkuëme nuk kapërcen 5 ditë, atëherë ka të drejtë t' a apë pa autorizim të drejtoris së përgjithëshme, por duhet t' a lajmojë këtë tuë treguëm arsyet. Këtë leje ma tepër se dy herë në vit nuk mund t' a apë për nji person.

Art. 32. — Vërteton diftesat edhe bordërot e arsimtarëvet

ase ai vetë ase tuë autorizuëm për këtë veprim drejtorin a kryemësuësin e shkollavet të qendravet ku ka zyrë financjare.

Art. 33. — Inspektori përkujdeset të këndojnë mësuësit „Revistën pedhagogjike" e çdo libër tjetër, qi asht për interesë t' arsimit filluër.

Art. 34. — Çdo inspektor detyrohet të mbajë me rregull këta regjistra:

a) nji protokol t' aktevet për zyrë e veçanërisht nji protokol dore, qi do të përdoret në rasë inspektimi;

b) nji katalog të shkollavet, qi ndodhen në qarkun e tij bashkë me emnat e mësuësvet:

c) nji katalog t' arsimtarëvet, ku do të shënohen mot për mot emnin e mbiemnin e vëndi i shërbimit të secilit. Në këtë katalog do të shënohen me rradhë arsimtarët në fillim të çdo viti shkolluër;

ç) nji regjistër të cilsivet t'arsimtarëvet; në këtë do të shënohen: 1) vëndi e data e lindjes; 2) vëndi ku asht regjistruem; 3) studimet e bame; 4) dokumentat shkollore; 5) shërbimi i deritashëm; 6) emnimet, gradimet e shpërnguljet e secilit;

d) nji rradhuër inspektimesh; në këtë do të shënojë, inspektori vrejtjet e gjykimet e veta mbi zotsín pedhagogjike e dhidhaktike, mbi zellin e çdo mësuësi si edhe mbi sjelljen e tij mbrenda e jashta shkollës; gjithashtu mbi vijimin e fëmivet, mbi pajisjen e tyne me mjete shkollore e mbi gjëndjen e ndërtesavet e t' orendivet të shkollës;

dh) nji katalog mbi masat dishiplinore;

e) nji dosar të veçantë, ku do të përmblidhen vendimet e këshillit shkolluër të vëndit.

Art. 35. — Inspektori detyrohet me i drejtumun inspektorit të nji qarkut tjatër informata të plota mbi ndonji msuës, i cili shpërngulet n' at qark. Kto informata do të epen në bazë të shënimevet të marruna në regjistrat e ndryshëm.

Art. 36. — Merr pjesë në këshillat shkollore të vëndit e bashkë me këto merr masat e duhuna për zbatimin e ligjës mbi detyrimin e të ndjekunit të shkollës.

Art. 37. — Inspektori, kur inspekton nji shkollë, duhet të shënojë me nënshkrimin e vet, në regjistrin e përditshëm e të përjavëshëm datën e inspektimit, si edhe vrejtjet e shënimet në nji radhuër të posaçëm „Radhuër inspektimi", i cili duhet të gjindet n' arkivin e çdo shkolle.

Art. 38. – Inspektori nuk duhet n' asnji mënyrë t' i bajë vrejtje ase t' i apë instrukcjone mësuësit përpara nxansve, por të bajë shënimet e duhuna në radhorin e inspektimit të shkollës e t' ia tregojë këto gojarisht vetëm për vetëm, ase përpara kolegëvet të tij.

V.

Rregullore për shkollat e mesme
Nënshkrimet, vijimi e koha e mësimit

Art. 39. – Viti shkolluër fillon me 1 Shtatuër edhe mbaron me 30 Qershuër; nënshkrimet bahen mbrenda 15 ditëve të para të Shtatorit; mësimet fillojnë me 16 Shtatuër e mbarojnë me 15 Qershuër.

Art. 40. – Për shkaqe të forta, me autorizimin e drejtoris së përgjithëshme t' arsimit, mund të zgjaten nënshkrimet deri në fund të Shtatorit. Mbasi të mbarojnë nënshkrimet, drejtoria e gjymnazit i njofton drejtoris së përgjithëshme t' arsimit numrin e nxansvet të nënshkruëm.

Art. 41. – Në klasën e parë të gjymnazit pranohen nxansit, qi kanë mbaruëm të 5-in vit shkolluër me provim në gjuhë e në arithmetikë; nxansit qi mbarojnë klasën e V. ose të VI-tën mund të hyjnë në të II-tën ose në të III tën klasë të gjimnazit mbas nji provimit në gjuhë n' arithmetikë; ashtu edhe ata qi kanë vërtetesën e lirimit të shkollës fillore të plotë, por pa ndonji provim. Nxansit qi vijnë nga shkolla fillore, të cilat kanë për gjuhë mësimi nji gjuhë të huëj, edhe ata provohen me provim në gjuhën shqipe e n' arithmetikë.

Art. 42. – Nxansi qi vjen prej nji gjymnazi shtetnuër ase të njoftun, me gjuhë mësimi të huëj, mund të pranohet në gjymnaz në bazë të diftesës shkollore t' atij gjymnazi; por me kusht qi të bajë provimin e gjuhës e të tregohet kështu se mund të ndjekë mësimet e rendit përkatës.

Art. 43. – Nxanësi qi ikë prej nji gjymnazi e nënshkruhet në nji tjetër gjymnaz të Shtetit, pranohet vetëm në bazë të diftesës së shkollës qi len.

Art. 44. – Nji nxanës mund të shpërngulet prej nji Gjymnazi në nji tjetër per këto arsye:

a) kur ndrron banim familja e tij, e kjo gja duhet të vërtetohet prej inspektoris s' arsimit të qarkut;

b) për arsyë shëndetsie në bazë të dishmis së mjekut të njoftun zyrtazisht;

c) kur dëbohet nxansi nga shkolla, ku vijonte ma parë;

ç) në rasë të mbylljes së shkollës.

Art. 45. – Në fund të çdo tremestri, drejtoria e gjymnazit asht e detyruëme me paraqitë listën e nxanësvet të nënshkruëme tue treguëm dhe numrin e amzës së të cillit.

Art. 46. – Nxanësit janë të detyruëm të vijojnë regullisht mësimet. Në qoftë se, për shkak sëmundjeje nji nxanës ka ma shumë se 150 mungesa orësh mësimi, duhet t' i shtrohet provimit në shtatuër të vitit shkolluër vijuës; n' asht se pa ndonji arsyë mungesat e tij kapërcejnë numrin 50, atëherë përjashtohet nga shkolla për at vit me të drejtën e provimit në fund të vitit ase në fillim të vitit të rí shkolluër.

Art. 47. – Ora e fillimit të mësimevet të përditëshme rregullisht asht në 8 para dreke; por kjo mund të ndryshohet si mbas gjendjes klimatike të vëndit e pas stinëvet tue filluem a ma herët a ma vonë; ashtu edhe mbas dreke mësimet rregullisht fillojnë në orën 2, por për arsyet e sipërpërmënduna, mund të nisin dhe ma vonë.

Mbi degët e gjymnazevet

Art. 38. – Gjymnazet do të kenë 2 degë, degën klasike dhe atë reale. Nxanësit deri në klasën e tretë kanë mësime të përbashkëta, prej kësaj klase mësimet ndahen në dy degë: në degën klasike, në të cilën do të vijojnë ata nxanës, qi dishirojnë të ndjekin n' universitet filosofin, letërsin, drejtësin e mjeksin; në degën reale në të cilën do të vijojnë ata, që do të ndjekin n' universitet degën e shkencës fizike-mathematike dhe barnatorin, ashtu edhe ata që do të hyjnë nëpër shkollat teknike ma të nalta. Të dyja degët do të jenë nën drejtimin e nji drejtori dhe shumë nga mësimet do të mësohen së bashku. Në degën klasike, përveç gjuhëvet klasike, të latinishtes e të greqishtes, do të mësohet edhe frangjishtja. Në degën reale në vënd të gjuhëvet klasike do të mësohen këto dy gjuhë të gjalla: frangjishtja e gjermanishtja.

Përveç këtyne degëve, atje ku t'a shohë të nevojshme drejtoria e përgjithëshme e arsimit, mund të krijohet edhe nji degë e normales. Kjo degë fillon prej klasës së V-të e mbaron në klasën e VII-të inkluzive. Shumicën e mësimevet do t' i digjoj-

në në degën klasike e në vënd të gjuhëvet klasike do të kenë pedhagogji. Për kët degë gjermanishtja do të jetë e detyrshme.

Mbi provimet në gjymnazet

Art. 49. – Provimet në gjymnazet janë të përditëshme e tremujore. Provimet e përditëshme bahen në gojë, e profesorët detyrohep me i provuëm nxansit të gjithë me çdo mësim. Në qoftë se numri i nxansavet asht ma i math, se i cili nxanës do të provohet së paku nji herë në muaj në çdo mësim. Përgjithësisht nxanësit mund të provohen ma shpesh ase ma rallë, si pas numrit që mund të ketë çdo klasë.

Provimet tremujore bahen çdo tre muëj me shkrim në të gjitha mësimet, përveç në mësimet teknike, si në gjymnastikë, vizatim, muzikë e kaligrafi. Këto provime i ban profesori mbrenda në klasë, pa lajmuëm aspak nxanësit, a në mësimin e ditës, ase në nji nga mësimet e pjesës së mësuëme në kto tre muej, por me kusht që kto pjesë të jenë përsëritun në shkollë.

Art. 50. – Në kategorin e provimevet hyjnë edhe: *a*) hartimet që bahen rregullisht dy herë në muej e *b)* ushtrimet me shkrim që bahen në çdo muëj në gjuhët e huëja që mësohen në shkollë.

Art. 51. – Të gjitha këto punë me shkrim profesori i kontrollon në shtëpi, përveç ushtrimeve të përmuëjshme, që profesori i kontrollon e i qorton në shtëpi ma parë, e pastaj u a thotë nxanësvet gabimet e tuë i shënuëm me ngjyrë të kuqe ma në fund ven edhe notën e përkatshme.

Art. 52. – Notat që rrjedhin nga provimet e përditshëme si edhe ato që dalin nga ushtrimet e përmuëjshme e nga provimet tremujore shënohen prej profesorit në regjistrin e përditëshëm. Nota e mesme që del nga të gjitha këto, në fund të çdo tremuëjshi asht nota e tremuëjshit të parë e shënohet në shtyllën e posaçme të diftesës shkollore. Diftesat, të nënshkruëme prej drejtorit e të vulosuna me vulën e shkollës, u dorzohen nxanësvet për t' u paraqitë prindëvet a kujdestarëvet të tyne. Si të nënshkruhen prej këtyneve, do t' i kthehen drejtoris së shkollës në nji ditë të caktuëme.

Mbi klasifikimin e nxanësvet të gjymnazit

Art. 53. — Sjellja, zelli dhe përparimi i çdo nxanësi klasifikohen në kët mënyrë:

a) Sjellja :

1. e shembëlltyrëshme ;
2. e urtë ;
3. e pëlqyeshme ;
4. e keqe.

b) Zelli :

1. i lavdueshëm ;
2. i mirë ;
3. i keq.

c) Përparimi :

1. shkëlqyeshëm ;
2. shumë i mirë ;
3. i mirë ;
4. i dobët.

Art. 54. — Për kalimin ase jo të nji nxanësi, do të mirret parasysh nota e tij e përgjithëshme që del nga notat, që janë shenuem për çdo mësim në fund të çdo tremuejshi. Në qojtë se nxanësi në dy landë merr notën 4, riprovohet në vjeshtë ; në kët provim, né mos fitoftë, ngel në klasë.

Nxanësi që merr notën 4 në tri landë, ngel në klasë.

Art. 55. — Vijimi i nxanësvet klasifikohet mbas numrit të mungesavet që ban nxanësi në çdo mësim.

Në qoftë se numuri i mungesavet kapërcen 150 orë mësimi për të gjithë vitin shkolluer, nxanësi nuk mund të kapërcejë klasën. Mungesat shënohen rregullisht në regjistër të përditshëm e në fund të çdo tremuejshi do të mblidhen e do të shënohen në diftesat shkollore, që do t' u përdahen nxanësvet në fund të çdo tremuejshi.

Art. 56. — Në fund të çdo tremuejshi profesori do të formojë nji gjykim të plotë mbi përparimin e nxanësve në bazë të notavet të shenueme për çdo mësim në regjistër, e notën e përgjithëshme të nxjerrun nga këto e shënon në shtyllën e posaçme të rregjistrit. Në fund të vitit shkolluer notat e përgjithëshme të fundit shenohen në regjistrat e n' amzë.

Art. 57. — Nota e sjelljes për çdo nxanës do të caktohet në konferencën e trupit të profesoravet e nota e zellit në bazë të notavet të fituemé përgjithësisht në mësime.

Art. 58. — Lajmet shkollore ndahen tri herë në mot në nji ditë të caktueme prej konferencës së profesorëve ; këto lajme do t' u ndahen nxanësve prej profesorit të klasës e do t' i kë-

thehen prapë këtij të nënshkrueme prej prindëvet a kujdestarëvet të tyne. Lajmet mbeten në drejtori të shkollës.

Në fillim të vitit shkolluer nxanësit i paraqesin lajmet e veta shkollore drejtoris e në bazë t' atyne nënshkruhen në klasë.

Art. 59. — Nji nxanës që nuk kapërcen klasën mund t' a përsërisë vetëm nji herë, edhe në qoftë se nuk e kapërcen as në të dytin vjet, lëshohet nga shkolla.

Detyrat e nxanësvet të gjymnazevet

Art. 60. – Nxanësi qi hyn në nji gjymnaz, detyrohet t' u shtrohet ligjevet dhe rregullorevet të shkollës.

Art. 61. – Nxanësi duhet të tregojë kundrejt profesorëvet të tij dashuni, nderim, binduni.

Art. 62. – Nxanësit duhet të shkojnë mirë me shoqi shoqin e të diftojnë nji sjellje të pëlqyeshme si mbrenda, ashtu edhe jashta shkollës.

Art. 63. – Kur mungon ndonji nxanës nga shkolla për shkak sëmundjeje, duhet të lajmojnë drejtorin ase profesorin e klasës së tij e, si të shkojë sëmundja të paraqesë raportin e doktorit, në qoftë se e kërkon këtë drejtori i shkollës ase profesori i klasës së tij.

Art. 64. – Nxansi duhet të vejë rregullisht në shkollë e të ndjekë mësimet e klasës së vet.

Art. 65. – Për çdo mungesë që mund të bajë për ndonji shkak tjetër përveç sëmundjes, duhet të marri lejen e drejtorit.

Art. 66. – Nxanësit që mungojnë në mësimet ndëshkohen pas nji pasqyre të vecantë, që do të caktohet ma poshtë.

Art. 67. – Çdo nxanës duhet të jetë i pastër nga trupi e i mveshun në nji mënyrë të pëlqyeshme.

Art. 68. – Asht e ndalueme të sjellë nxanësi me vehte në shkollë libra ase gjana të tjera, qi nuk janë të nevojshme për mësimet e ditës.

Art. 69. – Të gjithë nxansit detyrohen të gjinden në klasën e vet pesë minuta para se të fillojë mësimi. Nxansvet që hyjnë në klasë, mbassi të këndohen emnat e tyne, nuk u falet mungesa, përveç se në i gjetë profesori t' arsyshme shkaqet e vonesës.

Art. 70. – Në mësim e sipër asnji nxanës nuk mund të dalë jashta klasës; në pastë kush nevojë të madhe, duhet të dalë me leje të profesorit e të këthehet në mësimin sa ma shpejt.

Art. 71. — Nxansi duhet të mbajë nji qetsi të madhe si mbrenda në klasë veçanish, ashtu edhe në shkollë përgjithësisht. Vetëm aji që provohet ase pytet prej profesorit duhet të përgjigjet e të flasë;
të tjerët nuk bajnë za fare, por vrejnë me kujdes mësimin që bahet.

Art. 72. — Nxansit janë të ndaluem rreptësisht që të çfaqin pëlqimin ase mospëlqimin e vet si për mësimet ashtu edhe për profesorët.

Art. 73. — Çdo nxanës duhet të vijë në shkollë i bamun gati mirë për mësimet e ditës e duhet t' i ketë në rregull e të pastër rradhojt e detyrët e veta me shkrim.

Art. 74. — U ndalohet nxansvet të njij klase të hyjnë në kohë të mësimevet në nji klasë tjetër pa leje të drejtorit.

Art. 75. — Gjithashtu u ndalohet nxansvet të qindrojnë nëpër dyert e dhomavet të mësimit.

Art. 76. — Asnji i huëj nuk mund të hyëj në shkollë pa lejen e drejtorit.

Art. 77. — Kur hyn në klasë profesori ase nji i huëj, nxansit duhet të ngrihen me qetësi e t' ulen prap mbas urdhnit të profesorit të klasës.

Art. 78. — Nxansit duhet t'a mbajnë pastër dhomën shkollore; ata që shkarravisin ase prishin muret, shtretën, bankat e orendit e tjera, përveç që do të dënohen, por do të detyrohen të paguajnë edhe shpenzimet për ndreqjen e damit.

Art. 79. — Nxansit duhet të sillen mirë jo vetëm në shkollë, por edhe jashtë; duhet të tregojnë nderimin e dubun para profesorvet e auktoritetevet të tjera të vëndit, kur piqen me këto rrugës ase nëpër shetitje; nuk duhet të shkojnë nëpër kafet e nëpër vëndet e tjera argëtimi pa leje. Çdo profesor që sheh ase merr vesht se ndonji nxanës shkon nëpër të tilla vënde, duhet të lajmojë drejtorin e shkollës, i cili përkujdeset për dënimin e merituëshëm të nxansit.

Art. 80. — Kur sillet ligsht ndonji nxanës me bashkë-nxansit e vet, atëherë do të dënohet si pas fajit të bamun; ankuësi nuk duhet të marrë shpërblim vetë, por t' i drejtohet profesorit që ka kujdesin e klasës.

Art. 81. — Kjo rregullore në fillim të çdo viti shkolluër do t' u këndohet nxansvet dhe nji kopje do të mvaret në nji vënd të dukshëm të shkollës.

Masat diciplinore kundrejt nxansvet

Art. 82. – Nxansvet që nuk u shtrohen urdhënavet të profssorvet dhe rregullorevet të shkollës, u vihen këto ndëshkime:

a) qortim prej profesorit;

b) qortim prej drejtorit;

c) mbajtja në shkollë mbas mbarimit të mësimevet prej nji deri 3 orë; në kët kohë nzansi detyrohet të shkruajë dishka si pas urdhnit të profesorit;

ç) kumtimi i ndëshkimit të nji nxansi para gjithë nxansvet të shkollës, tuë shënuëm emnin e të ndeshkuëmit në nji vënd të posaçëm;

d) largimi nga shkolla për nji mot;

dh) nxjerrja nga shkolla për gjithnji;

e) nxjerrja prej të gjitha shkollavet të Shtetit.

Art. 83. – Ndëshkimet e shënuëme n' art. 82, *dh*, *e*, vihen me vendim të konferencës së profesorvet e me pëlqim të drejtoris së përgjithshme t' arsimit.

Art. 84. – Mënyra e zbatimit dhe e rregullimit të këtyne ndëshkimevet caktohet ma poshtë.

Ndeshkimet e nxansvet në shkollat e mesme

Art. 85. – Auktoritetet që vejnë ndëshkimet e nxansvet janë:

a) profesori mbikqyrës i rendit;

b) drejtori i shkollës;

c) këshilli mësimuër i shkollës;

Art. 86. – Profesori mbikqyrës i rendit ndëshkon me këto dënime: *a)* qortim i cili do të shënohet në rregjistrin e përditshëm; *b)* mbajtje nji orë në shkollë pas mësimevet. Drejtori dënon me: *c)* qortim të nxansit fajtuër përpara nxansvet të klasës; *ç)* mbajtje në shkollë për dy orë pas mësimevet; *d)* qortim të nxansit përpara gjithë profesorvet të shkollës. Këshilli mësimuër dënon me: *dh)* qortim të nxansit e ky do të shënohet n' amzë; *e)* kumtim të qortimit përpara gjithë profesorvet dhe nxansvet; ky ndëshkim do të shënohet n'amzë; *ë)* mbajtje 3 orë në shkollë pas mësimevet; edhe ky ndëshkim shënohet n' amzë dhe vihet i shkruëm në nji vënd të dukshëm të shkollës; *f)* përjashtim të nxansit nga shkolla për nji mot si pas art. 81, të rregullores mbi masat disiplinore.

Art. 87. – Sjellja në fund të vitit shkolluër do të shëno-

het në bazë të ndëshkimevet që nxansi ka pasun rrotull vitit në kët mënyrë: ndëshkimet e shënuëme në ndamjet *a*, *b*, dhe *c*, nuk mirren para syshë; për ndëshkimet e shënuëme në ndamjet *ç*, dhe *d*, ase për të dyja së bashku, i zbritet nji pikë; për ndëshkimet e ndamjes *dh*, i zbritet edhe nji pikë; për ato të ndamjes *e*, dhe *ë*, i zbritet edhe nji pikë tjetër.

Art. 88. – Mungesat e pa-arsyëshme mund të rradhiten si dënimet në këtë mënyrë:

Për 1 – 5	zbatohet ndëshkimi nën	. .	*a)*
Për 6 – 10	„ „ „	. .	*b)*
Për 11 – 15	„ „ „	. .	*c)*
Për 16 – 20	„ „ „	. .	*ç)*
Për 21 – 25	„ „ „	. .	*d)*
Për 26 – 30	„ „ „	. .	*dh)*
Për 31 – 40	„ „ „	. .	*e)*
Për 41 – 50	„ „ „	. .	*ë)*

Detyrat e të drejtat e trupit mësimuer të shkollavet të mesme

Art. 89. – Drejtori mban administratën dhe rregullën në shkollë, ven në zbatim ligjët e rregulloret shkollore, u njohton profesorvet urdhnat dhe qarkoret e auktoritetit ma të naltë e përkujdeset që të vihen këto në zbatim.

Art. 90. – Drejtori përfaqësou shkollën dhe mban rregullisht korrespondencën e duhun; në kët punë mund t'i ndihmojë edhe nji nga profesorët më të rij.

Art. 91. – Drejtori asht i përgjegjshëm për çdo shrregullim, që mund të ngjajë në shkollë.

Art. 92. – Drejtori përkujdeset për t'u mbajtun pastër shkolla, orendit dhe veglat mësimore. Për nevojët landore të shkollës i drejtohet auktoritetit ma të naltë.

Art. 93. – Drejtori ka për detyrë të mbajë inventarin e të gjitha orendivet dhe veglavet mësimore, tue ja ngarkuëm kujdesimin e tyne njenit nga profesorët e shkollës.

Art. 94. – Drejtori përpiqet për formimin e bibliothekës së shkollës, tue përmbledhun të gjithë librat që interesojnë si profesorët, ashtu edhe nxansit.

Art. 95. – Drejtori përkujdeset të mbajë në rregull këto rregjistra:

a) nji amzë;

BKSH

b) nga nji katalog për çdo klasë për të shënuëm mungesat edhe notat e mësimevet;

c) nga nji katalog për çdo landë e për çdo profesor për të shënuëm landën e zhvilluëme;

ç) nji rregjistër inventar orendinash edhe veglash shkollore;

d) nji libër prezentimi të profesorvet;

dh) nji radhue të posaçëm për të shënuëm mungesat e profesorvet;

e) nji katalog të libravet të bibliotekës;

ë) nji protokol të aktevet;

f) nji libër ndëshkimesh të nxansvet;

g) nji libër kronikash, ku do të shënohen shkurtazi ngjarjet ma me randësi të shkollës si edhe historia e saj;

gj) nji radhuer të veçantë për të shënuëm shpenzimet e bamuna.

Art. 96. — Në fund të çdo tremestri lajmon auktoritetin ma të naltë, kur mungon ndonji nga profesorët për sëmundje a për ndonji shkak tjetër fort të arsyëshëm. Në rast të tillë drejtori nuk mund t'apë leje ma tepër se 3 ditë rradhazi; për nji leje ma të gjatë kërkon pëlqimin e auktoritetit ma të naltë.

Art. 97. — Si drejtorët, ashtu edhe profesorët ndodhen në marrveshtje të shpeshë me prindët ase me kujdestarët e nxanësvet, tue i ndriçuëm ata mbi vijimin edhe sjelljen e djelmëvet mbrenda edhe jashtë shkollës.

Art. 98. — Drejiori asht i detyruëm të qiedrojë në shkollë deri në mbarim të gjitha mësimevet.

Art. 99. — Kur i dorzohet shkolla nji drejtori t'emnuëm rishtas bahet nji akt dorzimi me dy kopje, nga të cilat njena ruhet në arshivën e shkollës e tjetra i paraqitet auktoritetit ma të naltë.

Art. 100. — Drejtori ka të drejtë kontrollimi mbi trupin mësimuër:

a) a hyjnë e dalin profesorët prej klasës n'orën e caktuëme;

b) a e zbatojnë profesorët landën e caktuëme në program në bazë të katalogut të landës;

c) a i kontrollojnë e i shqyrtojnë me kujdes detyrët me shkrim të nxanësvet;

ç) a i shënojnë profesorët landët e mësuëme në çdo orë;

d) a mos përdorin tekste të tjera përveç atyneve, qi janë pëlqyëm prej auktoritetit e qi janë në lidhje me mësimin;

dh) a i mbajnë me rregull katalogët e klasës.

Art. 101. – Drejtori thërret trupin mësimuër në konferencë rregullisht nji herë në muaj; në rast nevoje mund t'a mbledhij edhe ma shpesh.

Art. 102. – Mënyra e të mbajtunit të konferencave caktohet në nji krye të veçantë.

Art. 103. – Drejtori ka të drejtë t' emnojë e të pushojë personalin shërbtuër, tue lajmuëm auktoritetin e vet.

Art. 104. – Profesori duhet të përdori mirë kohën e parashkruëme të mësimit, tue u gjetun në shkollë të pakën 5 minuta para fillimit të tij.

Art. 105. – Profesorët duhet të bajnë gati mirë landën për mësimet që do t'u apin nxanësvet.

Art. 106. – Profesorët detyrohen t' i mbajnë në rregull regjistrat, tue shënuëm notat e nxanësvet dhe mungesat e tyne ashtu edhe landën e zhvilluëme.

Art. 107. – Profesori n' asnji mënyrë nuk duhet të përdori nxanësit për shërbime private ase për punë, që nuk kanë lidhje me qëllimin e nxanësvet; dhe ndalohet rreptësisht familjariteti me tá.

Art. 108. – Profesori asht i ndaluëm të mbledhi të holla, përveç se kur mbledhja e këtyneve bahet me qëllim bamirsije; edhe në këtë rast duhet të ketë pëlqimin e auktoritetit ma të naltë.

Art. 109. – Profesori asht i ndaluëm të pranojë çdo send, që i epet nga nxanësi në formë dhuratë.

Art. 110. – Profesori si në shkollë, ashtu edhe përjashta duhet të diftojë nji sjellje të ndershmë e të mos përzihet me njerëz, qi dihet se kanë vehtija të papëlqyeshme e të përpiqet në çdo mënyrë me fituem besimin edhe nderimin e popullit. Gjithashtu proferët duhet t' i reshten çdo sjelljes, që prish prestigjin e mjeshtris së vet.

Art. 111. – Profesori nuk mund të largohet prej detyrës së vet pa mos lajmuëm drejtorin e shkollës.

Art. 112. – Trupi mësimuer mund të marrë leje tue paraqitun arsyet jerarhisht vetëm në këto raste:

a) për shkak sëmundjeje mbas nji raporti të mjekut;

b) për çashtje familjare me randësi, si për nji sëmundje të gjinis së tij, për nji vdekje a për nji ngjarje të jashtëzakonëshme.

Art. 113. — Në ditët e pushimevet trupi mësimuer mund të largohet prej vendit pa ndonji auktorizim.

Art. 114. — Profesorët duhet t' u shtrohen ligjevet dhe urdhnavet t' auktoritetevet.

Art. 115. — Profesorët janë të ndaluem t' u japin nxanësvet të shkollës së vet mësime private.

Art. 116. — Profesorët janë të ndaluem rreptësisht të mirren me tregëti ase me ndonji punë administrative.

Mbi masat disiplinore të trupit mësimuer të shkollavet të mesme e fillore

Art. 117. — Ndeshkimet disiplinore që u vihen arsimtarëvet për të shmangunit e tyne nga detyra janë:

a) vrejtje me gojë e me shkrim prej auktoritetit ma të naltë;

b) të premunit e rrogës;

c) shpërngulja;

ç) e nxjerrmja nga puna.

Art. 118. — Vrejtja bahet për nji faj të vogël të bamë për herë të parë, faj qi shkakton prishjen e rregullimit, si me thanë për nji vonim të vogël në të kryemunit e detyrës a për nji mungesë të rregullores së mbrendshme të shkollës. Vrejtja me gojë e me shkrim bahet prej drejtorit të shkollës. (Për mësuesit e shkollavet fillore vrejta me shkrim bahet prej inspektorit të qarkut).

Art. 119. — Të premunit e rrogës rrjedh, kur e përsërit arsimtari fajin e parë, d. m. th. kur, me gjithë vrejtjet e bame, nuk shkon me rregull në krye të detyrës, a kur vepron prap kondra rregullorevet, qarkorevet e urdhënavet t' auktoritetit epruer. Ky ndeshkim, si pas randësis së fajit ndahet në:

a) të premunit e rrogës së njij dite;

b) të premunit e rrogës së 5 ditëve;

c) të premunit e rrogës së nji të 4-tërtës së rrogës mujore;

ç) të premunit e nji gjymse të rrogës mujore.

Art. 120. — I pritet vetëm nji ditë rrogë, kur përsërit nji faj të vogël, për të cilin i asht hjekun vrejtja, ase kur nuk shkon në detyrë pa nji shkak t' arsyeshëm vetëm nji ditë e për herë të parë.

Art. 121. — I pritet rroga e pesë ditëve: 1) kur mungon për herë të dytë prap nji ditë, ase për herë të parë për dy ditë rresht; 2) kur u shmanget për herë të parë detyrave të caktu-

eme në rregulloren e veçantë; e sidomos kur u shmanget atyne detyrave, që kanë të bajnë me sjellje të mirë e me moral të pëlqyeshëm përpara nxanësvet e popullit.

Art. 122. – I pritet nji e katërta e rrogës, kur mungimi i tij nga detyra njiherë të vetme ngjat tri ase katër ditë rresht për herë të parë ase me përsëritje dy ditësh.

Art. 123. – I pritet gjymsa e rrogës, kur e len detyrën katër deri shtatë ditë rresht, ase kur e përsërit mungesën e tri ase katër ditëve. Ndeshkohet po me këtë dënim për herë të parë, kur shkakton arsimtari, me sjelljen e tij të pa pëlqyeshme, rrëximin e prestigjit morale e të randësis së detyrës.

Art. 124. – Të premunit e rrogës së njij dite e të 5 ditëve asht në kompetencë të drejtoris së përgjithëshme t'arsimit. (Për mësuesit e shkollavet fillore ky denim epet nga inspektoria e qarkut); të premunit e të së katërtës e të gjymsës së rrogës mujore, bahet me vendim të këshillit qendruer të drejtoris së përgjithëshme.

Art. 125. – Shpërngulja e nji profesori bahet:

a) kur nuk shkon aspak mirë me shokët e vet e kur vertetohet se fajin e ka aji vetë;

b) kur sjellja e tij e pa pëlqyeshme ka shkaktuem ndeshkimin e tij mbas art. 121.

Art. 126. – E nxjerrmja nga puna mund të bahet si pas art. 48, të ligjës së nëpunësvet:

a) përkohësisht për nji kohë të caktueme prej katër deri në nji mot;

b) prej nji e deri në 3 vjet.

Art. 127. – Në qoftë se ndeshkohet nji arsimtar, si pas art. 121, për sjellje të keqe e shifet se kjo punë nuk e ka bamun efektin e duhun, atëherë ky, si pas randësis së fajit e me vendim të këshillit qendruer të drejtoris përgjithëshme t' arsimit e me formalitetet e lypuna prej ligjës, nxirret përkohësisht nga puna pas pikës *a)* t' art. 126.

Art. 128. – Në qoftë se nji arsimtar, në rregullimin e punës, me të cilën asht i ngarkuem, vepron kundra rregulloreve administrative të vendueme e kështu i ep shkak shrregullimit e prishjes së disiplinës së shkollës a t' institutit, atëhere ky me vendimin e këshillit qendruer të drejtoris së përgjithëshme e me formalitetet e lypuna prej ligjës, nxirret përkohësisht nga puna tue u mbajtun dispozitavet të § *c)* të nenit 48 të ligjës së nëpunësvet.

Art. 129. – Arsimtari nxirret krejt nga puna:

a) kur e len detyrën ma tepër se 10 ditë rradhazi pa lejen e auktoritetit e pa ndonji shkak t' arsyëshëm mbas nenit 47 të ligjës së nëpunësvet;

b) kur shpërngulet e në 20 ditë e sipër nuk gjindet në vëndin e shënuëm;

c) kur dënohet nga gjykatorja për ndonji delikt;

ç) kur diftohet i pa zoti të kryej detyrën;

d) kur sjellja e tij morale nuk përmirësohet me masa disiplinore që u përmendën ma sipër;

dh) kur vërtetohet se ka ndonji sëmundje ngjitëse e cila mund të rrezikojë shëndetin e nxanësvet;

Art. 130. – Për fajet që shkaktojnë përgjegjësin ligjore, arsimtari dërgohet në gjyq mbas ligjës së nëpunësvet të Shtetit.

Semimatura dhe Matura

Provimi i Semimaturës

Art. 131. – Ky provim bahet në dy periudha: në Qershuër e në Shtatuër të çdo vjeti.

Art. 132. – Në këtë provim pranohen vetëm ata nxanës qi e kanë kryë, pa asnji notë të keqe, rendin e IV. të Gjymnazit Shtetnuër.

Art. 133. – Përveç diftesës së rendit IV. të Gjymnazit, nxanësit, qi i shtrohen këtij provimi, do t' i epet edhe diftesa e semimaturës në qoftë se e kalon këtë provim.

Art. 134. Vetëm diftesa e Semimaturës do të ketë vleftje për vijimin e mësimeve si në giymnas ashtu në ndonji tjetër shkollë, për të cilën kërkohen së paku katër klasë të gjymnazit.

Art. 135. – Komisjoni provuës përbahet prej drejtorit të gjymnazit si kryetar e prej kryetarit të rendit e mësuësve të landëve, të detyruëm e për provim, si antarë.

Art. 136. – Landët prej të cilave bahet provimi janë këto: gjuha shqipe, mathematika e historia.

Art. 137. – Provimi do të bahet dy mënyrësh: me shkrim e me gojë.

Art. 138. – Provimi me shkrim do të bahet vetëm në gjuhë shqipe; aj me gojë: në shqipen, mathematikën e historin.

Art. 139. – Vjeti shkolluër për nxansit e rendit IV. mbaron me 5 Qershuër. Provimi i semimaturës fillon me 16 Qershuër.

Art. 140. — Provimi i semimaturës fillon me provimin me shkrim në gjuhën shqipe, për të cilin mund të përdorën të shumtën 3 orë.

Art. 141. — Provimet me gojë prej shqipes e prej landëve të tjera mbahen në nji ditë të caktuëme, por së paku dy ditë mbas provimit me shkrim në shqipen.

Art. 142. — Provimi me shkrim në shqipen përbahet në zhvillimin e nji theme të zgjedhun prej komisjonit provuës ndër 10 thema të paraqituna prej profesorit të shqipes.

Art. 143. — Për shqipen e mathematikën provimet me gojë e përfshijnë landën e shvilluëme në katër vjetët e mësimit; për historín landën e shvilluëme në të III e IV klasë.

Art. 144. — Në provimin me gojë për çdo landë nxanësit mund t'i apin 3 pyetje. Shvillimi i provimit për ç' do landë e për çdo nxanës mund të durojë të shumtën 15 minuta.

Art. 145. — Të gjith antarët e komisjonit provuës janë të detyruëm të jenë në provim e të shënojnë për çdo nxanës e landë notën qi besojnë se ka merituëm.

Art. 146. — Mbasi provimet të marrin fund, komisjoni mblidhet në kryesin e drejtorit të gjymnazit dhe vendos mbi përfundimin e provimeve. Nota definitive për çdo landë shenjohet ajo për të cilën asht shumica e antarve të komisjonit, në rast qi nuk mund të bahet shumica, do të merret nota për të cillën asht mësuësi i landës.

Art. 147. — Diftesa e semimaturës do të ketë për shqipen, mathematikën e historin notat qi nxanësi i ka fituëm në provim të semimaturës, deri sa për landët e tjera do t'i vehen notat e fituëme rrokull vjetit shkolluër.

Art. 148. -- Diftesa e semimaturës nëshkruhet vetëm prej drejtorit të gjymnazit e kryetarit të klasës.

Art. 149. — Diftesa e semimaturës i epet nxanësit vetëm në qoftë se e kalon provimin, për ndryshe i shkruhet në diftesën e klasës IV se provimin e semimaturës nuk e ka kaluëm.

Art. 150. — Nxanësi, qi në provimin e semimaturës në Qershuër merr nji notë të keqe, e ka të drejtën të paraqitet prap në Shtatuër vetëm n' atë landë.

Aj qi në provimin e Qershorit merr dy nota të këqija ase në atë të Shtatorit nji notë të keqe mund të paraqitet për nji provim të rí — në të gjitha landët e caktuëme për semimaturën — vetëm në Qershuër të vjetit qi vjen.

Art. 151. — Gjith ata qi i përkasin këtij provimi si edhe nxanësve, do të shenjohet me radhë në nji protokol të veçantë, i cili nënshkruhet prej të gjith antarve të komisjonit provuës dhe ruhen n' arshivën e gjymnazit.

Provimi i maturës

Art. 152. — Ky provim bahet në dy periudha : në Qershuer — Korrik e në Shtatuer — Tetuer të ç' do vjeti.

Art. 153. — Në këtë provim pranohen vetëm ata nxanës qi e kanë kryem, pa asnji notë të keqe, të VIII klasë të gjymnazit Shtetnuer.

Art. 154. — Përveç diftesës të klasës VIII të Gjymnazit, nxanësit, qi i shtrohen këtij provimi e qi e kalon, do ti epet nji diftesë e veçantë (diftesa e maturës).

Art. 155. — Vetëm diftesa e maturës do të ketë vleftë për nënshkrimin n' universitete ase shkolla të nalta të hueja.

Art. 156. — Nxanësi qi nuk e kalon provimin e maturës nuk i epet asnji diftesë e vçeantë, por i shenjohet në diftesën e 8lasës së VIII se provimin nuk e ka kaluem.

Art. 157. — Vjeti shkolluer për nxansit e klasës së VIII mbaron me 10 Qershuer. Provimet fillojnë me 26 Qershuer.

Art. 158. — Landët në të cilat bahet provimi janë këto :

a) Të përbashta për të dy degët :

1) gjuhë shqipe ;

2) nji gjuhë e gjallë ;

3) histori ;

b) vetëm për degën klasike :

4) mathematikë ;

5) latinisht a se greqisht ;

c) vetëm për degën reale :

6) mathematikë ;

7) fizikë — kimi.

Art. 159. — Provimi asht dy mënyrësh : me shkrim e me gojë.

Provimi me shkrim do të bahet në : gjuhën shqipe, gjuhën e gjallë, mathematikën e latinishten ase greqishten.

Provimi me gojë në të gjitha landët e shenjneme në nenin 158.

Art. 160. — Komisjoni provues përbahet prej nji përfaqsuesi të drejtoris së përgjijhëshme t' arsimit si kryetar, prej drej-

torit të gjymnazit si nënkryetar e prej mësuesve të landëve, të detyrueme për provim si antarë,

Art. 161. – Provimet me shkrim bahen për ç' do landë në ditët e ndryshme ma së paku nji ditë pushim ndërmjet të tyne, Ato me gojë bahen së bashku në ditën a se ditët e caktueme; por së paku 5 ditë mbas provimit të mbram me shkrim,

Art. 162. – Themat për provimin me shkrim për shqipen, gjuhën e gjallë, mathematikën, latinishten a se grėqishten, çohen nga drejtoria e përgjithëshme e arsimit ts vulosuna. Këto thema çilen prej përfaqësuesit të ministris përpara gjith komisjonit provues vetëm 1/2 ore përpara se të fillojë provimí me shkrim në nji landë të caktueme.

Art. 163. – Për punimin e një lande mund të përdoren të shumtën katër orë. Përdorimi i mjeteve ndihmëse asht i ndaluem, posë fjalorve e logarithmave.

Art. 164. – Në kohë të provimeve me shkrim në dhomë të provimit duhet të jetë së paku 1/3 e komisjonit.

Art. 165. – Provimi me gojë bahet në këtë mënyrë: çdo mësuës do të përgatisi një copë të veçantë letre 25 pyetje nga landa e vet. Në provim çdo nxanës nxier dy nga këto pyetje dhe flet mbi njenën qi e zgjeth aj vet. Në qoftë se nxansi nuk përgjegjet as në njenën prej këtyne pyetjeve, mund të marri edhe nji tjetër pyetje.

Art. 166. – Çdo antar i komisjonit merr notat veçanërisht për çdo nxanës e për çdo landë, si në provim me shkrim, ashtu në atë me gojë.

Art. 167. – Nxansi, qi e ka notën e mesme të klasës VIII, 1 deri 1 1/2, pa asnji notë 3, e në të gjitha provimet me shkrim të maturës e merr notën 1, lirohet nga të gjitha provimet me gojë.

Art. 168. – Provimi me shkrim themelohet mbi thema e problema të nxjerruna prej programit të zhvilluem në gjymnaz për çdo landë. Provimi me shkrim në latinishten ase në greqishten përbahet prej nji përkthimi nga këto gjuhë në shqipen. Copa e tekstit do zgidhet ndër autorët qi nuk janë këndue në gjymnaz e s' mund të jet ma e gjatë se nji krye i mesëm (caput) i veprave t' autorve klasikë.

Art. 169. – Provimi me gojë për çdo landë e përfshin programin e shvilluem në gjymnas.

Art. 170. – Gjith antarët e komisjonit provuës janë të de-

tyruëm të jenë në dhomën në të cilën bahen provimet me gojë e të shenjojnë për çdo nxanës e landë notën qi besojnë se ka meritue.

Art. 171. — Mbasi të marrin fund provimet komisjoni mblidhet nën kryesin e përfaqsuesit të drejtoris së përgjithsme t'arsimit, dhe vendos mbi përfundimin e provimeve. Nota definitive për çdo landë shenjohet ajo për të cilën asht shumica e antarve të komisjonit, në rast qi nuk mund të bahet shumica, do të merret nota për të cilën asht përfaqsuesi i drejtoris së përgjithëshme t' arsimit.

Art. 172. — Diftesa e maturës do t'i ketë të gjitha landët qi mësohen në 7 e 8 klasë. Për ato lanë në të cilat provohet nxanësi do të shënjohen notat e fitueme në provimin e maturës; për landët e tjera do të merren notat e fitueme rrotull vjetit shkolluer në 7 ase në 8 klasë.

Art. 173. — Nxanësi qi merr notën e keqe në nji landë (përveç shqipes) në provimin e maturës në Qershuer-Korrik, mund të paraqitet për riprovimin po n' atë landë në vjeshtë. Nxanësi qi në provimin e maturës në Qershuer-Korrik merr dy nota të këqija ase notën e keqe vetëm në shqipen, si edhe aj qi merr nji notë të keqe prej çdo lande në provimin e maturës në vjeshtë, nuk mund të paraqitet për riprovimin e maturës para Qershorit-Korrikut të vjetit qi vjen, kur detyrohet t' i shtrohet provimit në të gjitha landët e caktueme për maturë. Nxanësi qi në provimin me shkrim të shqipes merr notën e keqe s' ka të drejtë të paraqitet në provime të tjera n' at sesjon.

Art. 174. — Në diftesën e maturës shenjohen : emni e mbiemni i nxansit e i prindit, ditët e provimeve, landët e provimit dhe ato mbas nenit 173 të kësaj rregullore me notat e fitueme.

Këjo diftesë nënshkruhet prej gjith komisjonit provues, vuloset me vulën e gjymnazit dhe vërtetohet, me regjistrim në nji protokoll të veçantë, prej drejtoris së përgjithëshme t' arsimit

Art. 175. — Gjith ata, qi i përket këtij provimi si edhe nxanësve, do të shenjohet me rradhë në nji protokol të veçantë, i cili nënshkruhet prej gjith antarve të komisjonit provues dhe ruhet n' arshivën e gjymnasit.

Rregullore për shkollat fillore

Detyrat e të drejtat e dreitorvet

Art. 176 — Drejtori i shkollës, kryemësuesi ase mësuesi që drejton nji shkollë, mban administratën e saj; ven në zbatim

ligjët dhe rregulloret shkollore; u njohton mësuesve qarkoret, urdhënat dhe udhëzimet e ardhuna prej auktoriteteve ma të nal-të e përkujdeset për t' i vumë këto në zbatim.

Art. 177. — Përfaqëson shkollën dhe mban rregullisht korrespondencën e duhun.

Art. 178. — Asht përgjegjës për çdo shrregullim që mund të ngjajë në shkollë.

Art. 179. — Përkujdeset për çdo nevojë të shkollës; për pastrimin, për hygjienën, për të mbajtunit mirë t'orendivet e të veglavet shkollore, dhe për plotësimin e këtyneve i drejtohet komisjonit shkolluer të vendit si edhe inspektorit të qarkut.

Art. 180. — Ka për detyrë të mbajë inventarin e të gjitha orendive e të veglave të shkollës, tue ja ngarkuem kujdesimin e këtyneve njenit nga mësuësit e shkollës.

Art. 181. — Përpiqet për formimin e bibliotekës së shkollës, tue përmbledhun gjithë librat që mund t'interesojnë si mësuësit ashtu edhe nxanësit.

Art. 182. — Përpiqet në bashkëpunim me nxanësit për të formuëm nji muze shkolluer, tue mbledhun sendet e prodhimet e vendit që janë tepër të nevojshme për mësimin e shikimit.

Art. 183. — Mban në rregull këto rregjistra:

a) nji regjistër amze;

b) nji regjistër të përditshëm;

c) nji regjistër të landës së mësuesve;

ç) nji inventar orendish e veglash shkollore;

d) nji katalog të bibliotekës shkollore;

dh) nji protokol konferencash;

e) nji protokol t' aktevet;

ë) nji libër prezentimi të mësuesvet;

f) nji libër të ndeshkimevet të nxanësvet;

g) nji libër të vërtetesavet të lirimit;

gj) nji libër kronikash, ku do të shënohet shkurtazi çdo punë ma me randësi të shkollës si edhe historia e saj;

h) nji radhuer të posaçëm për shpenzimet e ndryshme.

Art. 184. — Më të mbajtunit e këtyne regjistrave e të librave, drejtorit i ndihmon nji nga mësuesit që cakton ai vetë.

Art. 185. — Lajmon inspektorin e qarkut, kur mungon ndonji nga mësuësit për sëmundje a për ndonji shkak tjetër.

Art. 186. — Dërgon n' inspektori të qarkut shkresat që i drejtojnë mësuësit tue çfaqë edhe mendimin e vet.

Art. 187. — Lajmon komisjonin shkolluer për mosvijimin e rregullshëm të nxanësvet të shkruem, tue i paraqitun muej për muej listën e mungesavet të tyne.

Art. 188. — Duhet të jetë në të përpjekun të dendun me prindët ase në kujdestarët e nxanësvet, tue i ndriçuem ata mbi vijimin në shkollë të fëmijvet të tyne, mbi përparimin e tyne në mësimet e mbi sjellën e tyne si mbrenda ashtu edhe jashtë shkollës.

Art. 189. — Në fund të vitit shkolluer i paraqet inspektorit të qarkut nji raport të shkurtën përmbi ngjarjet me randësi të shkollës dhe përmbi zellin, zotësin e sjellën e trupit mësimuer të shkollës.

Art. 190. — Asht i detyruem të qindrojë në shkollë deri në mbarimin e të gjitha mësimevet të ditës.

Art. 191. — Kur i dorëzohet nji pasardhësit drejtimi i shkollës bahet nji akt dorëzimi në dy kopje, nga të cilat njana lihet n' arkivin e shkollës e tjetra i dërgohet inspektoris së qarkut.

Art. 192. — Ka të drejtë të zgjedhë klasën që ka ma pak orë mësimi, tue ja ngarkuem ndonji mësuesi tjetër gjymnastikën e kangën.

Art. 193. — Ka të drejtë kontrollimi mbi personalin e shkollës, tue vrejtë këto pika:

a) a hyjnë e dalin mësuesit prej klasës n' orën e caktueme si pas horarit, dhe a vijnë në shkollë në kohën e caktueme ;

b) a e zbatojnë landën e caktueme në program ;

c) a i kontrollojnë e i shqyrtojnë me kujdes detyrat me shkrim të nxanësvet ;

ç) a e shënojnë me kujdes në regjistër landën e mësueme të ditës ;

d) a mos përdorin tekste të tjera në mësimet përveç atyneve të pëlqyeme prej drejtoris së përgjithëshme t' arsimit ;

dh) a i mbajnë në rregull regjistrat e përditëshëm ;

e) a kujdesohen për pastrimin e shëndetin e nxanësvet.

Art. 194. — Ka të drejtë me hym në klasë në kohë të mësimit dhe t' i bajë vrejtje mësuesvet tue iu dhanë urdhënimet e këshillat e duhuna mbi të metat që vuni rë.

Art. 196. — Nuk ka të drejtë me asnji mënyrë t' i bajë vrejtje mësuesit përpara nxanësvet.

Art. 197. — Thërret trupin mësimuer në konferenca rregullisht nji herë në muej, në rast nevoje mund t' i mbledhë edhe

ma shpesh. Mënyra e të mbajtunit të konferencavet rregullohet në nji krye të veçantë.

Art. 198. — Ka të drejtë t'i apë leje mësuësit deri në tri dijë, por tue u pshtetë n'arsye të forta e tue lajmuem inspektorin e qarkut. Këtë leje nuk mund tja apë ma tepër se dy herë në mot nji personi.

Art. 199. — I proponon inspektorit emnimin e pushimin e ndonji shërbëtori të shkollës.

Detyrat e të drejtat e mësuesvet

Art. 200. — Mësuesi duhet t'a përdorë mirë kohën e parashkruëme të mësimit, tue u gjetun në shkollë rregullisht të pakën 10 minuta para mësimit.

Art. 201. Mësuësi detyrohet të paraqitet në mësim, i bamun gati në mënyrë që të kuptohet lehtasi prej nxanësvet.

Art. 202. — Do të kujdeset që t'a mbarojë landën e mësimevet sikurse asht caktuëm në program.

Art. 203. — Mësuësi detyrohet t' i mbajë në rregullë regjistrat, tue shënuem notat e nxanësvet, mungesat e tyne dhe landën e zhvilluëme.

Art. 204. — Do të kujdeset që si nxanësit ashtu edhe librat e mjetet e tjera të mësimit të kenë pastrin e duhun, e nxanësvet, si pas rasës, t'u apë këshillë shëndetësije.

Art. 205. — Kur duket se ndonji nga nxanësit ka symtomë sëmundjeje ngjitëse, duhet t'a dërgojë nxanësin në shtëpi tue lajmuem prindët e tij me anë të drejtorit të shkollës.

Art. 206. — Mësuësi n'asnji mënyrë nuk duhet t'i përdorë nxanësit për shërbime private ase për punë që nuk kanë lidhje me qëllim e mësimit.

Art. 207. — Mësuësi asht i ndaluëm që t'u shesë nxanësvet libra e tefterë e sende të tjera shkollore. Këtë punë mund t'a baj me autorizimin e auktoritetit shkolluër. Gjithashtu ndalohet që t'i shtyjë nxanësit të blejnë sende të tjera mësimore për fitim të ndonjij shkrimtari ase editori. Përgjithësisht asht i ndaluëm të ketë marëdhanje ekonomike me nxanësit.

Art. 208. — Aasht i ndaluëm të pranojë nga nxanësit ase nga familjet e tyne dhurata a shpërblime në çdo formë që t'epen këto; gjith' ashtu ndalohet që të mbledhë të holla nga nxanësit për t'i bamë dhurata drejtorit ase ndonjij mësuësi për çfarëdo arsyeje e shkaku. Të tjera mbledhje të hollash mund të

bajë ndër nxanësit, në qoftë se këto kanë nji qëllim bamirësije, por edhe atëherë pa përdorun forma shtërngimi e gjithëmonë me auktorizimin e auktoritetit shkolluër.

Art. 209. — Mësuësit detyrohen të gjinden në marrëdhanje të shpeshta me prindët ase me kujdestarët e nxanësvet, tue i lajmuem ata mbi të ndjekunit, përparimin dhe sjelljen e tyne.

Art. 210. — Mësuësit, si në shkollë ashtu dhe përjashta, duhet të diftojnë nji sjellje të ndershme e të mos përzihen me njerëz që dihet se kanë vetija të papëlqyëshme.

Art. 211. — Mësuesi nuk mund të largohet prej detyrës së vet pa lejen e inspektoris ; në qoftë se mungon titullari i inspektoris mund t' a kërkojë lejen prej drejtorit të shkollës ma të madha të qarkut. Në çdo rast lejen ka për t'a kërkuem me shkrim tue treguem edhe shkaqet që e shtrëngojnë të kërkojë leje.

Art. 212. — Mësuesit mund t'i epet leje vetëm për këto arsye:

a) Për shkak shëndetsie mbas nji raporti të mjekut;

b) Për nji çashtje famijare me randësi, si për nji sëmundje të familjes së tij, për nji vdekje a për ndonji ngjarje të jashtëzakonëshme.

Art. 213. — Në qoftë se mësuesi, për ndonji shkak të ranndë e të papritun, asht i penguem të mos apë mësim ndonji ditë, atëherë pa vonesë do t' ja kumtojë këtë gja drejtorit të shkollës tue diftue shkakun e pengimit e po qe e mundun, kohën e të ngjatunit të këtij pengimi.

Art. 214. — Në kohë të pushimevet, të gjysmaditëve ase në mbarim të mësimit të përditëshëm, mësuesi mund të largohet nga vendi i shkollës, në qoftë se nuk pengohet prej ndonjij tjetër punë zyrtare.

Art. 215. — Mësuësit duhet t' i shtrohen ligjavet e urdhnavet të auktoritetevet arsimore si edhe urdhnimevet të drejtorit.

Art. 216. — Asht e ndalueme që mësuësit t'u japin nxanësvet të shkollës së vet mësime private.

Art. 217. — Mësusit janë të ndalum rreptësisht me u marrë me tregti a me ndonji tjetër punë administratore.

Art. 218. — Mësuesit e katundevet mund ta marrin detyrën e sekretaris së pleqsis, por vetëm me leje t' inspektoris; porse kjo detyrë do të kryhet jashta orëvet të mësimit.

Klasifikimi dhe diftesat shkollave fillore

Art. 219. — Në rregjistrat e përditshëm, n' amzë, në lajmet shkollore e në diftesat e lirimit do të përdoren notat sipas art.

95, të klasifikimit të nxansvet të shkollavet të mesme. Për sa i përket trajtës së punvet me shkrim, përdoren këto nota:

1) fort e hijëshme;

2) e hijëshme;

3) e bukur;

4) e keqe.

Art. 220. – Këto nota do të përdoren për secilën landë mësimi, mësimet që janë dyfishe (si arithmetikë e gjeometri, histori natyre e dituni natyre) do të klasifikohen vetëm me nji notë. Për këndim e për shkrim do të vihet nji notë e veçantë për secilin.

Në qoftë se nota e përgjithëshme e njij nxansi asht „e mirë", por nota e tij në gjuhë e në arithmetikë asht e dobët (4), atëherë ky nxanës nuk mund të kalojë klasën as nuk mund të lirohet nga shkolla.

Nji nxanës mund të kalojë klasën e mund të lirohet nga shkolla në qoftë se nota e përgjithëshme e tij e nxjerun prej notavet të përditëshme, asht të pakën po thuaj „e mirë".

Art. 221. – Vijimi i nxansvet klasifikohet mbas numrit të mungesavet, që banë nxansi në çdo mësim. Në qoftë se numri i mungesavet kapërcen 200 orë mësimi të vitit shkolluer, nxansi nuk mund të kapërcejë klasën. Mësuesi mungesat do t' i shenojë rregullisht në nji radhurë të veçantë, e në fun të çdo pjese të vitit shkolluer, do t' i përmbledhë e do t' i shtjerë në lajmet shkollore të cilat do t' u përndahen nxansvet në fund të çdo tre muejshi.

Art. 222. – Në fund të çdo pjese të vitit shkolluer mësuesi do të formojë nji gjykim të plotë mbi përparimin e nxansvet e do të shënojë notën përkatse në regjistrin e klasës.

Art. 223. – Përparimi i fëmijvet të klasës së parë në çdo pjesë të vitit shkolluer për të gjitha landët klasifikohet me nji notë të vetme.

Art. 224. – Caktimi i notës së sjellës për shkolla me dy a me ma shumë klasë i përket konferencës së mësuesvet.

Art. 225. – Nota e zellit në mbarim të çdo tremuejshi vendohet prej atyne mësuesvet që apin mësime n' atë klasë; gjithashtu edhe nota për trajtën e jashtme për punët me shkrim, por me këtë ndryshim që këtë notë e caktojnë vetëm mësuesit, që e mësojnë këtë landë.

Art 226. – Po nuk u bashkuen mësuesit në caktimin e njaj note, atëhere këtë gja e vendon konferenca e mësuesvet.

Art. 227. – Lajmet shkollore ndahen 4 herë në vitin shkolluer në ditë të caktueme, të cilat i ndan mësuesi klasës n'orën e fundit të mësimit.

Art. 228. – Fëmijt e shkollës do t' u a paraqesin këto lajme për shikim prindvet e kujdestarvet të vet. Këta janë të detyruem me i vertetuem me nënshkrimin e vet, dhe me anën e fëmijvet me ja kthyem mësuesit të klasës.

Art. 229. – Në qoftë se mësuesi ka dyshim me u paraqitë këto me anën e fëmijvet të shkollës, atëhere u a dërgon zyrtarisht.

Art. 230. – Në mbarim të vitit shkolluer lajmet shkollore u lihen prindvet apo kujdestarvet dhe këta u a kthejnë të nënshkrueme mësuesvet në fillim të vitit shkolluer.

Art. 231. – Lajmet shkollore do të mbajnë:

a) emnin e qarkut (prefekturë, nënprefekturë, etj); të shkollës e të klasës që ndjek nxansi;

b) emnin e mbiemnin, moshën e besimin e nxansit;

c) kohën e nënshkrimit të fëmijs në shkollë;

ç) gjykimin mbi zellin, përparimin në landët e mësimit, ashtu edhe trajtën e përjashtme në punët me shkrim të çdo tremuejshi;

d) numrin e orëvet të mësimit që ka mhnguem, tue shenuem t' arsyshmet e të pa arsyshmet;

dh) vendin e datën e dhanjes së lajmevet shkollore, nënshkrimin e drejtorit edhe të mësuesit të klasës, si edhe vulën zyrtare të shkollës.

Art. 232. — Në mbarim të vitit shkolluer në këto lajme do të shenohet a asht nxansi i aftë të kalojë në klesën ma të naltë apo jo. Kalimin a mos kalimin në klasë ma të naltë e vendos konferenca e mësuesvet.

Mbi provimet e nxansvet

Art. 233. – Provimet e shkollavet fillore janë dy farësh: provime të përditëshme dhe provime për të marrë diftesat e lirimit.

Art. 234. – Mësuesi asht i detyruem të provojë nxansit sa asht e mundun ma shpesh tue mbajtun shënime të veçanta mbi përparimin e tyne. Në bazë të këtyne shënimevet mësuesi do të formojë nji gjykim mbi përparimin e njaj nxansi edhe do të shenojë notën e përkatëshme në regjistrin e përditëshëm në fund të çdo viti shkolluer.

Art. 235. – Provimet për të marrë diftesën e lirimit bahen me gojë e me shkrim; në gjuhë e n' arithmetikë bahen si me gojë ashtu edhe me shkrim; në landët e tjera me gojë.

Art. 336. – Notat e këtyne provimeve, tue u bashkuem me notat e përgjithëshme, apin notat për diftesën e lirimit.

Mbi konferencat e mësuesvet

I. Farët e konferencavet

Art. 237. – Në çdo shkollë fillore dy a ma shumë klasësh, si edhe në çdo shkollë të mesme, do të mbahen rregullisht konferenca mësuësish. Konferenca do t' u apë shkak mësuësvet të gjinden gjithnji në të përpjekun me njeni tjetrin e të shkëmbejnë mendimet e tyne mbi çdo çashtje të shkollës, në mënyrë që t' ja mbrrijnë njij marrëveshtje të përbashkët e njij harmonije mendimesh në veprim të tyne.

Art. 238. – Për çdo konferencë mësuësish, drejtori i shkollës do të thëresë trupin mësimuër me shkrim tue ja kallzuem rendin e ditës. Në qoftë se në konferencë do të përfliten pika mbi hygjenën, do të thirret edhe mjeku i bashkis, i cili do të marrë pjesë me vota konsultative.

Art. 239. – Në çdo vit shkolluër do të bahen dhetë konferenca: 1) ajo e fillimit; 2) ajo e çdo moji; 3) ajo e çdo pjese të vitit shkolluër; 4) ajo e mbylljes së vitit.

II. Konferenca e fillimit

Art. 240. – Në konferencën që mbahet në fillim të vitit shkolluër, trupi mësimuër zgjedh së pari sekretarin e bibliothekarin, pastaj do të mirret me këto gjana:

a) me të paraqitunit e listës së plotë të nxanësvet në moshën e detyrshme; do të vështrohet edhe cilët nga këta nuk kanë qenë lajmuem;

b) me të vëzhguemit e nxansvet që mungojnë nga lista e të vërtetësis së shënimevet që i përkasin moshës, sëmundjes, aftësis për shkollën etj;

c) me të përpiluemit e listavet të nxanësvet për çdo klasë e të ndamunit e tyne në paralele;

ç) me të shënuemit e mësuësvet nëpër klasët e të përpiluemit e orarit; mbi këto dy pika do të kërkohet pastaj pëlqimi i inspektoris;

d) me të kumtuemit mësuesvet të tij të çdo gjaje që ka të bajë me shkollën;

dh) me proponime që mund t'i bahen inspektoris, si p. sh. për punë të lokalit.

Art. 241. – Konferenca e fillimit mund të bahet n'atë ditë kur fillojnë nënshkrimet e të mbarojë para se të fillojnë këto.

III. Konferencat në mes të vitit

Art. 242. – Konferencat që do të bahen për çdo muëj e ato të çdo pjese të vitit shkolluër do të mbahen sipas këtyne rregullave:

1) do të këndohen verbalet e mbledhjes së përparshme;

2) do të lajmohen shkresat e ardhuna;

3) do të paraqitet ndonji lajm a ndonji raport i ndonjij mësuësi për klasën e tij, p. sh. mbi gjendjen e dhomës shkollore, mbi gjendjen shëndetësore të nxanësvet, mbi disiplinën e mbrendëshme e të jashtme të tyne, mbi sjellën morale të tyne mbrenda e jashta shkollës, mbi përparimin e mbi zellin e tyne;

4) do të bisedohet mbi masat disiplinore të ndonjij nxansi;

5) do të bisedohet mbi vrejtjet që mund të bajë drejtori në rast vizitimesh nëpër klasë, në qoftë se këto vrejtje përmbajnë nji çashtje për konferenca;

6) do të flitet mbi landën e shtjellueme a të mbaruëme e mbi çdo gja që i përket programës e orarit të mësimevet;

7) do të caktohen notat e përparimit, të sjellës e të zellit të nxadësvet në fund të çdo pjese të vitit shkolluër;

8) do të bisedohet mbi çdo proponim që mund të bëjë ndonji nga antarët e konferencës.

IV. Konferenca e mbylljes

Art. 243. – Në konferencë të mbylljes do të mirren parasyshë:

1) puna e nxanësvet që mund të kapërcejnë klasën a jo, ase që duhet të provohen në vjeshtë;

2) informatat e nevojshme për raportin që duhet me i paraqitë inspektoris mbi veprimet rrotull vitit shkolluër;

3) proponime për përmbushjen e nevojavet shkollore në kohë të pushimevet, si për të blemë vegla e mjete të reja mësimi e për të futë mënyrë të reja mësimi në shkollë.

V. Dispozita të përgjithëshme

Art. 244. – Kryetari i konferencës asht drejtori i shkollës; në mungoftë ky, zavendësi i tij. Antarë të konferencës janë të gjithë mësuesit që punojnë në shkollë.

Art. 245. – Kryetari çel e rregullon konferencën; ai asht i përgjegjshëm si për të mbajtunit rregullisht të konferencës, ashtu edhe për vijimin e rregullshëm të bisedimevet. Po vuni re kryetari se ndonji çashtje e parashtrume në konferencë e kapërcen qarkun e veprimit të saj, atëherë ai mund t'i presë të përfolunat mbi ate. Po u pa e nevojshme që të marrë pjesë në konferencë edhe ndonji antar që mungon, atëherë ajo çashtje do të shtyhet për në konferencë tjetër.

Art. 246. – Kryetari ka të drejtë edhe detyrë të ndalojë të vumit në veprim të çdo vendimi, i cili pas mendjes së tij u kundërshton parashkresavet apo rrezikon interesin e shkollës.

Art. 247. – I gjithë trupi mësimuër asht i detyruem me marrë pjesë rregullisht në konferencë të mësuësvet; në mos mundtë kush me u ndodhë aty, duhet të lajmojë drejtorin e shkollës apo zavendësin e tij; tue diftuëm edhe shkakun e të mos ardhunit.

Art. 248. – Kryetari do të shikojë qi koha e të mbajtunit të konferencës të caktohet në mënyrë qi mund të marrin pjesë pa u penguëm të gjithë antarët e trupit mësimuer.

Art. 249. – Konferenca mblidhet në nji kohë jashtë orëvet të mësimit, por jo në ditë pushimi.

Art. 250. – Konferenca rregullisht nuk do të zgjatet ma tepër se tri orë; po qe se urdhëni i ditës nuk mund të mbarohet në këtë kohë atëherë do të këputen bisedimet e do të vijojnë nji ditë tjetër.

Art. 251. – Vendimet e konferencës mirren ma tepër mbas njij shkëmbimi harmonik të mendimevet se sa mbas njij gjyqimi të dhanun me anë votash. Vetëm vendimet me randësi mbi masat disiplinore të rrebta duhet të bahen me shumicë zanesh. Në barasi zanesh randon zani i kryetarit.

Art. 252. – Antarët qi nuk pëlqejnë ndonji vendim të bamun kanë të drejtë me vumun në protokol mendimin e tyne të përkundërt e me kërkuëm qi protokoli t'i dërgohet autoritetit shkolluër të qarkut. Me këtë punë nuk pengohet të vuëmit në veprim të ndonji vendimi të bamun rregullisht, se anëtarët detyrohen me ndjekë vendimin edhe psë mund t'i kenë kundër-

shtuem. Në rast të njij mosmarrveshtjeje mirret gjykimi i inspektorit të qarkut, i cili, po t' a shohë të nevojshme, pyet dhe mendimin e autoritetit ma të naltë.

Art. 253. — Të rrahunit e çdo çashtjeje do të shtihet në protokol ku do të shënohet shkurtazi rrjedhja e saj, zanet edhe vendimet e dhanuna. Në protokol do shënohen edhe anëtarët qi mungojnë si edhe shkaku i mungesës së tyne.

Art. 254. — Protokoli do të mbahet me rend alfabetik prej të gjithë anëtarvet të konferencës edhe do të nënshkruhet prej të gjithë atyneve qi kanë marrë pjesë n' atë.

Art. 255. — Anëtarët qi kanë munguëm do t' a këndojnë protokolin ma vonë edhe do t' a vërtetojnë mbrendin e tij me nënshkrimin e vet.

Art. 256. — Në kërkoftë ndonji anëtar e në ndaloftë kryetari ndonji vendim të bamun, atëherë protokoli do t' i paraqitet autoritetit shkolluër të qarkut, i cili, mbasi t' a shqyrtojë çashtjen, ep urdhënin e nevojshëm.

Art. 257. — Pjesëmarrësit e konferencës detyrohen të ruejnë rrebtësisht fshehtësin e zyrës për sa u përket të gjijha çashtjevet të rrahuna edhe t' atyneve qi u difton kryetari tue u zanë besë.

Art. 258. — Në rast nevoje mund të mbahen edhe konferenca të jashtëzakonshme, në të cilat mund të bisedohen:

a) mbi ndonji çashtje të paraqitun prej komisjonit shkolluer;
b) mbi disiplinën e mbrendëshme;
c) mbi çdo tjetër çashtje simbas urdhënit ma të naltë.

VII. Rregullore mbi nxansit e shkollave fillore para mësimit

Art. 259. — Çdo nxanës para se të vijë në shkollë lypset të pastrojë mirë si petkat ashtu edhe këpucët. Po pat ndonji gjasend të grisun, duhet t' u thotë prindëvet apo kujdestarit të tij qi t' a arnojë. Përveç kësaj, duhet të lajë mirë fytyrën e veshët, të dliri thojt, të krehi flokët e të marri me vehte edhe nji mafër (shami).

Art. 260. — Para se të niset për në shkollë lypset të kqyri mirë a i ka në rregulì të gjitha sendet, qi i duhen për mësim. Sendet, qi s' kanë të bajnë me mësimet s' do të mirren me vehte në shkollë, e këto ka të drejtë me i u a marrë mësuesi.

Në kurt të shkollës

Art. 261. — Asht e ndaluëme t' ecin me rendë, të kërcejnë (të hofin) e të gërthasin nxansit në kurt të shkollës, as të qëndrojnë aty pa ndonji shkak, përveç se kur t' i urdhënojë mësuësi për me bamun lëvizje të shtatit.

Art. 262. — Në qoftë se nxanësi vjen në shkollë mbas fillimit të mësimit nuk mundet të shkojë në vend të vet, po do të presë te dera, deri sa t' i apë leje mësuësi qi të shkojë në vend.

Art. 263. — Si të shkojë në vend të vet, do të reshtojë librat e sendet e tjera të tij në fluer të bankës, ashtu që sendet që i duhen ma shpesh të gjinden ma sipër e përdorësh.

Po pati petka të sipërme, do t' i vari në vend te shenuem për këtë gja.

Art. 264. — Nuk asht leje me folë në shkollë me za të naltë; me za të ultë mund të flasin nxanësit vetëm para mësimit edhe kur të thotë mësuesi „pushim".

Art. 265. — Nxansit nuk kanë leje të sjellen nëpër klasë as para mësimit as në kohë të pushimit. Po pat nevojë ndonji nxanës që të luej prej vendit të vet, atëbere do t' eci nga dalë në majë të gishtavet, që të mos trazojë qetësin e të tjerëvet.

Art. 266. — Kur të hyj ndokush i huej në shkollë; nxanësit do të ngrihen në kambë edhe do të qendrojnë ashtu deri sa t' u thotë mësuesi që t' ulen. Kur të niset me shkuem i hueji, do të ngrihen përsëri pa zhurmë.

Art. 267. — Kur të thotë mësuesi „vini re" nxanësit do të shikojnë nga mësuesi e do të ndigjojnë ç' ju thotë.

Art. 268. — Ndalohet rreptësisht që t' u ndihmojnë nxanësit shokut të tyne që pyetet, tue i pishtëlluem fjalët.

Art. 269. — Librat, drasëzat edhe fletoret (tefterët) nxirren prej bankës edhe vehen aty pa zhurmë, ashtu si të urdhnojë mësuesi.

Art. 270. — Kur këndon ndonji nxanës në libër, të tjerët do të kalxojnë me dorë të djathtë çka këndohet.

Art. 271. — Si mbas urdhënit „gati" gjithë nxanësit gatohen ndejas dhe pa za. Nuk asht lejë të ngrihen, pa u dhanë urdhëni prej mësuesit.

Art. 272. — Kur të urdhënojë mësuesi, do të dalin ma sëpari mbiqyrësi, mbasandaj nxanësit me rradhë prej bankash, tue përshëndetun mësuesin dhe të huejnë, që mund të ndodhi aty,

Në kurt të shkollës nxanësit rrjeshtohen përsëri nga dy edhe presin aty, deri sa të thotë mësuesi „para", kështu me rrjeshtë do të shkojnë deri aty ku u bië rruga me u shpërndamë. Nuk asht leja me folë me za të naltë tue shkuem rrugës.

Art. 273. – Kur u duhet nxanësvet të shkojnë prej klasës së tyne në nji tjetër për të kënduem a po për ndonji mësim tjetër, do të shkoinë me qetësi në vend të caktuem e do të presin aty urtësisht mësuesin.

Art 274. – Ndalohet të hymunit në klasë të tjera pa lejen e mësuesit.

Art. 275. – Kur i bie rasa ndonjij nxanësi të shkojë në ndonji klasë tjetër, duhet të përshëndesë mësuesin njerzisht e t' i kalzojë shkakun e t' ardhunit në klasë tij.

Art. 276. – Mësuesit s' do t' i lajmohet gja as nuk do t' i paraqiten ankime në kohë të mësimit, por vetëm mbas mbarimit të këtij.

Siellje në rrugë

Art. 277. – Nxanësit do të shkojnë njerëzisht rrugës. Prandaj s' kanë leje që të ngarendin, të bërtasin e të luejnë.

Çdo nxanës duhet të diftojë, me sjelljen e tij, se mburret që asht nxanës shkolle.

Art. 278. – Nxanësit nuk të shoqnohen në çfarëdo rrugash e bjerrëditës. Ata nxanës që shoqënohen me çilimij rrugash, lëndojnë nderin e shkollës e fytyrën e nxanësvet edhe për këtë gja do të ndëshkohen rreptësisht.

Art. 279. – Nxanësit nuk do të shkojnë rrugës grumbull, po dy nga dy. Vetëm kur mbetet vetëm ndonji nxanës, mund të shoqnohet me dy të tjerët para mbrapa atëhere mund të shkojnë tre bashkë në radhë.

Nxanësi, tue kaluem pranë ndonji njeriut ma të motshëm do t'i lëshojë atij rrugën a anën ma të pëlqyeshme. Po qe rruga e gjanë dhe e mirë nxanësi duhet të shmanget n' anë të djathtë. Të parët e vendit, mësuesit, pleqt e zotnit e tjerë të njoftun duhen përshëndetë me njerëzi. Në qëlloftë kush ndejun duhet të ngrihet në kambë e të përshëndes zotnit e përmendun që kalojnë andej pari.

P a s t r i a

Art 280 – Nuk ast lejë me hjedhë nëpër shkollë copa karte, teprica pemësh e të tjera rrapulli.

Art. 281. – Ndalohet rreptësisht të shkarravitunit e murevet të shkollës, të nevojtorevet, të bankavet e të tjeravet rraqe shkollore si edhe të gdhenunit e të gërvishtunit e këtyneve me thikë, me brisk e me ndonji send tjetër. Gjithashtu ndalohet edhe të ecunit mbi banka si edhe të pshtymit në truëll të shkollës a të rruginavet të kësaj.

Art. 282. – Nxansit tue ecun rrugës, duhet të ruhen që mos të zhyhen.

Art. 283. – Sidomos duhet me u kujdesë shumë për pastrin e nevojtorvet (yzyrhaneve). Kush ndyn nevojtoret, do të shtërngohet aty për aty t' i pastrojë vetë.

Art. 284. – Asht e ndalueme rreptësisht e hymja në nevojtore dhe e dalmja soje nga dy për nji herë.

Nxansit do të shkojnë vetëm n' atë nevojtore, që asht shenuem, për klasën e tyne.

Art 285. – Për sa të ngjasë mësimi, nxansit nuk guxojnë të dalin jashtë, veç atyneve që janë të smundë e të cilvet u ep leje mësuesi.

Mbiqyra (roja)

Art. 286. – Për punën e mbiqyrës së nxansvet do të kujdeset kryemësusi i javës apo ai njeri, që asht shenuem prej konferencës së mësuesvet. Përveç kësaj në shkollat e njiklasëta mësusi mund të shenojë çdo javë nga nji mbikqyrës prej atyne nxansve që shquhen mbi të tjerët nga sjella e nga përparimi. Detyra e këtij asht të vejë rregullën e qetësin, kur nuk gjindet mësuesi në klasë. Mbikqyrsi do të vijë ma i pari në shkollë e së pakut nji 1/4 e orës para se të fillojë mësimi.

Në kohë të pushimit mbikqyrsi do të shenojë mbi drasë të shkollës të gjithë ata nxanës që prishin rregullën e qetësin në nji letër të veçantë.

Po u mirsuën përsëri nxansit e tillë, atëherë mund t' ja u shlyejë emnin e tyne.

Po qe se ndonji nxanës i shkruëm, për shkak se asht shkrryem, zihet me mbikqyrsin, ky s' do t' i përgjegjet gja por pa nji pa dy, do t' a padisi ke mësuësi, i cili ka për t' a ndeshkuëm nxanësin e tillë veçanërisht për atë punë. Mbikqyrsi në të tilla punë duhet të jetë i drejtë e i pa anshëm.

Mbikqyrsi do të ndajë bankë për bankë fletoret, pendëlat etj. etj. si t' urdhnojë mësuësi.

Art. 287. – Sjellja e nxanësvet në rrugë mbikqyret nga të gjithë mësuësit e shkollës.

Vendime të përgjithëshme

Art. 288. – Nxansit duhet të sjellen si vllazën shoq me shoq e të shkojnë me dashuni. Nuk do të guxojnë të lëndojnë njani tjetrin me shpoti e me qesti as me kurrfar mënyre tjetër. Të shamet si edhe fjalët e panjerzishme janë të ndaluëme rreptësisht.

Art. 289. – Nxansit nuk guxojnë t' i shesin njani tjetrit apo të ndrrojnë a të falin teshat shkollore të tyne. Çdo tregti e tillë asht e ndaluëme. Gjithashtu ndalohet edhe çdo lojë me fitim, si lojë kartash, zarësh etj. etj.

Nxansi do të shkruëj mbi secilin send të tij emnin e mbiemnin e vet.

Art. 390. – Nxansi asht i detyruëm t' i nxajë të gjitha detyrët e tij t' i punojë me zellë të gjitha punimet me shkrim edhe përgjithësisht t' i bindet mësuësit.

Ai që nuk e ka nxanë mësimin apo qi s' i ka ba detyrat e punët me shkrim do t' ja lajmojë këtë mësuësit t' ardhmen ky në shkollë.

Art. 291. – Po qe se ndonji nxanës ndrroj shtëpi, me nji herë do t' ja lajmojë këtë gja mësuësit tue i diftuem vendin, rrugën edhe numrin e shtëpis së re.

Art. 292. – Nuk asht leje të mungojë nga shkolla ndonji nxanës pa lejë të mësuësit. Në qoftë se nxansi nuk ka muëjt të vijë në shkollë prej sëmundjes ase për ndonji tjetër shkak, duhet t' ja diftojë këtë punë mësuësit përpara apo t' ja rrëfejë, kur të vijë përsëri në shkollë.

Art. 293. – Po s' vjefti gja e përmenduna, do të ndeshkohet. Ndeshkimi për të dytën herë do të jetë ma i rreptë.

Nxansit e këqij fare, të cilët asfarë ndeshkimi s' i përmirson, do të përzehen nga shkolla.

Art. 294. – Asht e ndalueme të bahen nxansit antarë shoqnijash të themelojnë ata vetë të tilla ase të marrin pjesë në mbledhje të këtyneve a në mbledhje të tjera botore a në sheti shokësh pa lejen e drejtorit.

Art. 295. – Nxansit nuk mund të shkojnë e nuk mund të marrin pjesë veprimtare në të çfaquna theatrosh, koncertesh, e kinematografesh veç se me lejen e drejtorit e në qoftë se programa e qëllimi i këtyneve nuk i kundërshtohet moralit e po qe se nuk damtohet zelli, përparimi i nxansit në mësimet e të ndjekunit e shkollës prej tij.

Prindët apo vendëzanët e tyne do të kërkojnë lejën e duhëshme prej drejtoris së shkollës.

Edhe të çfaqunat prej anës së nxanësvet ndër shkolla do të kenë ma parë lejën e auktoritetit shkolluër të qarkut. S'asht i ndaluëm të shkuëmit në të çfaquna botore, theatrore koncerti bashkë me prindët a po me vendzanësit e tyne, por me kushtet e sipërpërmenduna.

Art. 296. — Në çdo klasë të çdo shkolle do të jetë nga nji copë e kësajë „rregullore" e çdo nxanës asht i lirë t'a marrë e t'a këndojë e t'a shkruejë.

Shërbëtorët

Detyrët e shërbëtorëvet janë:

a) të gjinden në shkollë, në ditët punëtore, nji orë para fillimit të mësimevet e të rrijnë aty për gjithë kohën e mësimevet, e në e kërkoftë nevoja, edhe pas mbarimit të tyne; e vetëm me leje të drejtorit mund të dalin jashtë shkollës;

b) të pastrojnë e të fshijnë për ditë, pas mësimevet gjith shkollën d. m. th. dhomat e mësimit, koridoret, nevojtoret e kurtin e shkollës e t'a lajnë dyshemenë dy herë ase të paktën nji herë në muejt si mbas urdhënit të drejtorit të shkollës;

c) Nji orë para fillimit të mësimevet e mbas mbarimit të tyne të ajrisin dhomat e mësimit tue çelun e tue mbyllun mirë e me kujdes dyert e dritoret e për çdo mëngjes të dlirin me nji shparcë tryezat, shqembet, etj.;

ç) t'u ndihin shoqi shoqit në të mbaruemit e punëvet të tyne;

d) të kujdesen qi të mos i vijë kurrnji dam shkollës, nga të prishunit a të thyemit e nji orendije prej pa-kujdesis së tyne a të ndonji nxanësi. Për ndryshe do të jenë përgjegjës ata vetë.

dh) të sillen me nxanësit me butësi e me njerëzi tue u ruejtun qi mos të nxjerrin fjalë të liga e të shame nga goja ase tu apin shkak me u tallun e me qeshun me ta;

e) të mos marrin dhurata nga nxanësit në çfarëdo forme qi t'u epen këto;

ë) T'i presin me njerzi të huejt qi vizitojnë shkollën ase prindët a mprojtësit e nxanësvet, qi vijnë e kërkojnë lajme për ta.

f) t' u binden urdhënavet të drejtorit e të mësuesve pa ua u këthyem fjalën këtyneve aspak;

g) drejtori i shkollës në rast të moskryemi të ndonji nga këto parashkresa së parit e këshillon shërbëtorin, pastaj e qorton për të parën, për të dytën e për të tretën herë e mbasandaj, në mos u ndreqtë e përze tue lajmuem inspektorin e qarkut e tue propozuem nji tjetër në vend të tij.

Dispozita të përgjithëshme mbi rregullimin e mbrendshëm shkolluer

Art. 297. – Në shkollë fillore pranohen fëmij që kanë mbushun 6 vjet e qi nuk janë ma të mëdhaj se 14 vjetësh.

Art. 298. – N' ato vende ku nuk ka shkolla foshnjore, të veçanta, as klasë foshnjore të pshtetuna në shkolla femnore, mosha e pranimit të fëmijve zbritet deri në 5 vjet.

Art. 299. – Jashta kufive të caktueme në dy nyjet e sipërm, nuk mund të pranohen nzanës në shkollat fillore pa nji autorizim të veçantë t' inspektoris.

Art. 300. — Çdo fëmi qi do të nënshkruhet në shkollë, duhet t' i paraqesë drejtorit ase mësuesit akt-lindjen e nji vertetesë mjeksore, ku të diftohet se ka marrë linë dhe se ka kalue fruthin e se nuk ka ndonji gjymtim të trupit ase semundje gjitëse.

Art. 301 – Kur të bahet fëmija dhet vjetësh, duhet t' a shenojë prapë linë, qi të mundet të ndjekë shkollën pa pengim. Për këtë qëllim detyrohet mjeku i bashkis, ase ndonji mjek tjetër i dërguem nga autoriteti arsimuer. Mësuesi detyrohet me i ruejt si akt-lindjen ashtu edhe vertetesën mjeksore, deri sa ndjek fëmija shkollën.

Art. 302. — Për shkollën kujdeset edhe e ruen mësuesi, pa nji autorizim të veçantë t' autoritetit të naltë.

Art. 303. – Orët e mësimevet të përditëshme do të jenë 6, nga të cilat 4 orë do të bahen para mesdite e dy orë mbas mesdite. Koha e fillimit dhe e mbarimit të mësimeve do të caktohet prej inspektoris tue u marrë para sysh stina e nevojët e vendit.

Art. 304. – N' ato katunde ku nevojët bujqësore ndalojnë vijimin e rregullshëm të fëmijvet, ose n' atë shkollë ku përmblidhen fëmijt e disa katundeve, mësimet mund të bahen nji herë në ditë a para mesdite ase mbas mesdite. Kjo e drejtë i lehet inspektoris së qarkut në marreveshtje me komisjone shkollore e këshillet arsimore.

BKSh

Art. 305. – Mbas çdo orë mësimi do të bahet nji dëfrim prej 5 (pesë) minutash në orën e parë e të fundit të mëngjezit, dhe prej 10 minutash në orën e ndërmjetme. Mbas mesdite bahet nji pushim prej 9 minutash.

Art. 306. – N'ato orë që punon shkolla fëmijt gjinden nën vështrim të mësuësit, i cili asht përgjegjës për çdo ngjarje që mund të ndodhë. Në shkollat ku përmblidhen nxanës prej disa katundeve të largëta prap mësuësi detyrohet t'i ketë nën kujdes edhe në kohën e pushimevet të drekës.

Art. 307. – Në shkollat qi kanë shumë mësuës kujdesi i nxanësve në kohë të dëfrimevet bahet prej çdo mësuësi me rradhë. Mësuësi kujdestar detyrohet që të ketë nën vështrim edhe nxanësit që mbahen për dënim mbas mbarimit të mësimevet.

Art. 308. – Mësuësit e katundevet me auktorizim të inspektorit të qarkut mund t'u shesin nxanësvet të shkollës libra, radhoj e mjete shkrimi të tjera; por çmimet e këtyne do të jenë të shënueme në nji listë të posaçme, e cila, passi të vërtetohet nga inspektori, do të varet në nji vënd të dukshëm të shkollës.

Art. 309. – Kthinat e shkollës do të lyhen me gëlqere, të pakën nji herë në mot, kur çilen shkollat; çdo ditë, në fund të mësimeve, kthinat do të fshihen edhe nji herë në muej do të lahen. Ajrimi i klasëve do të bahet për çdo orë, edhe në dimën dritoret do të çilen, kur nxanësit dalin për dëfrim.

Art. 310. – Libra të përkohëshme që nuk kanë të bajnë me qëllimin e mësimevet s'mund të hyjnë në shkollë pa autorizimin me shkrim t'inspektorit të qarkut.

Art. 311. – Këto dispozita aplikohen edhe nëpër shkollat fillore femnore.

Art. 312. – Zbatimi i kësaj rregullorje i ngarkohet auktoriteteve kompetente t'arsimit.

Kremtore

Art. 313. – Të kremtet që mbahen në shkollat fillore.

a) Për Myslimanët :

1. – Kurban Bajrami: 5 ditë inkluzive me ditën e Arifes.
2. – Ramazan Bajrami: 4 ditë inkluzize me ditën e Arifes.
3. – Mevludi: 1 ditë.
4. – Nata e Regaipit: 1 ditë.
5. – Nata e Miraxhit: 1 ditë.
6. – Nata e Beratit: 1 ditë.
7. – Nata e Kadrit: 1 ditë.
8. – Dita e Nevruzit: 1 ditë.

b) Për Orthodhoksët:

1. — Lindja e Sh. Marisë: 8 Shtatuer.
2. — Shinakryqi: me 14 Shtatuer.
3. — Shëmitri: me 26 Tetuër.
4. — Hyrja e Sh. Marisë (Isodhija): me 21 Nanduër.
5. — Krishndellet: 4 ditë: me 24, 25, 26 e 27 Dhetuër.
6. — Dita e Motit të ri (Sh. Vasili): me 1 Kallnduër.
7. — Ujët e bekuem: me 6 Kallnduër.
8. — Dita e Shin Gjonit: me 7 Kallnduër.
9. — Dita e tre Jerarkëvet: me 30 Kallnduër:
10. — Dita e Ipapandisë: me 2 Fruër.
11. — Dita e Vangjelismës: me 25 Mars.
12. — Dita e Sh. Gjergjit: me 23 Prill.
13. — Dita e Eites së Madhe, e Premtes së zezë, e Shtundës së Madhe: 3 ditë.
14. — Pashkët: 3 ditë.
15. — Dita e të ngjitunit të Krishtit në qiell (Analipsis).
16. — Dita e Hanës së Rrshajevet.
17. — Dita e Sh. Pjetrit e Sh. Pavlit: me 29 Qershuër.
18. — Dita e Kishës së vendit (1 ditë).

c) Për Katholikët:

1. — Lindja e Sh. Marisë: me 8 Shtatuër.
2. — Dita e të gjithë shejtënve: me 1 Nanduër.
3. — Dita e Zojës së papërlyeme: me 8 Dhetuër.
4. — Krishndellet: 4 ditë: me 24, 25, 26 e 27 Dhetuër.
5. — Ujët e Bekuem: me 6 Kallnduer.
6. — Dita e Sh. Josefit: me 19 Mars.
7. — Dita e lajmimit të Zojës: me 25 Mars.
8. — Pashkët: 6 ditë (prej t'Ejtes së madhe deri të Mërkurën.
9. — Dita e Shëlbuemit.
10. — Dita e Hanës së Rrshajevet.
11. — Korpi i Krishtit.

ç) Të kremte kombtare të përbashkëta:

1. — Dita e shpalljes së vetqeverimit: me 28 Nanduër.
2. — Dita e motit të ri: me 1 Kallnduër.
3. — Dita e shpalljes së Republikës: me 21 Kallnduër.

Art. 314. — Në shkolla ku ka nxanës me besime të ndryshme, të kremtet do të mbahen me këtë mënyrë:

a) kur asht numri i nxanësve i njijshëm ase gati i njijshëm, atëhere të gjitha të kremtet e sipërtreguëme do të mbahen prej të gjithë shkollës;

b) nëpër ato shkolla ku nxansit e njenit ase të tjetrit besim janë me nji numër ma të vogël d. m. th. ndën nji të tretën të numrit të përgjithëshëm, atëhere të kremtet e atij besim që asht përfaqësuëm me numër ma të vogël, do të mbahen vetëm prej nxanësve t' atij besimi, por jo prej të gjithë shkollës;

c) në shkolla të ndjekuna vetëm prej nxanësish myslimanë, ditë pushimi do të jetë e Premtja e përveç kësaj edhe nji ditë (ase dy gjysma ditësh mbas dreke) tjetër e javës, e cila mund të caktohet mbas nevojës së vendit;

ç) në shkolla ku ka vetëm nxanës kristjanë, ditë pushimi do të jet e djela edhe dy gjymsa dite të tjera;

d) në shkolla të ndjekuna përpjesisht si prej nxansish myslimanë si prej të krishtenësh, si ditë pushimi do të mbahet e Premtja edhe e Djela, por jo ndonji tjetër ditë e javës;

dh) besimi i mësuesvet nuk mirret parasysh;

e) në shkolla ku shumica e nxanësvet janë myslimanë, në mojin e Ramazanit do të bahen 4 orë mësim në ditë, tuë u mësuëm vetëm landët kryesore. Caktimi i orarit relativ u lihet inspektorivet.

Art. 315. — *Të kremtet që mbahen në shkollat e mesme*:

1. — Dita e motit të ri.
2. — Dita e shpalljes së Republikës me 21 Kallnduër.
3. — Dita e shpalljes së vetqeverimit me 28 Nanduër.
4. — Të gjitha të kremtet e urdhnuëme prej kalendarit zyrtar.

Art. 316. — Përveç këtyne të kremtevet, do të jenë edhe 5 ditë të tjera, të cilat do të caktohen prej konferencës së profesorve, si pas nevojavet e rrethevet të vëndit.

Art. 317. — Pushimet e përjavëshme do të bahen dy ditë, të dielavet e të premteve.

Na, Kryetar i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë Rregullore të pranuëme prej Këshillit Ministruer dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Tiranë, më 28-8-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
e Zav. M. i P. të Mbrendëshme
P. POGA

Minis. P. Botore e Bulqësis
K. KOTTA

Nr. 66.

RREGULLORE, ...

Mbi përdorimin e mbajtjen e automobilave

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 31 Gusht 1925, Nr. 47)

Parime :

§ 1. Të gjitha qerret me fuqi motori, qi punojnë në rrugë ase në vende botnore duhet t' jenë në kontrol t' autoritetevet kompetentë të Qeveris.

Qerret me fuqi motori, si u përmend janë : Automobilat, motocykletet, traktorat e ç' do tjetër makine qi punon me motor mbi rruga botnore.

§ 2. Ç' do njeri qi dëshiron të mbajë ose të përdorë qerre me fuqi motori duhet të ketë leje nga Qeverija. Kjo leje ka vjeftë për të tanë viset e Shtetit Shqiptar. Leja mirret mbassi kërkuesi të paraqitet n' autoritet kompetent të Shtetit e të ketë dhanë nji provim zotsije mbi mbajtjen e përdorimin e qerrevet të përmenduna.

Ç' do qerre me fuqi motori qi vepron mbi rruga ase vende botnore duhet të ketë nji Leje veprimi, dhe ç' do përdoruës i këso-lloj qerresh duhet të ketë leje përdorimi, qi quhet **Leje Chauffeuri**.

§ 3. Mësuësi, tue dhanë mësime nji nxansi mbi përdorim e drejtim të nji qerrje me motor asht përgjegjës përpara Ligjës, për ç' do rrezik qi mund të ndodhi.

§ 4. Ç' do njeri me të meta fizike trupi nuk mund të nxierrin prej autoritetevet kompetente Leje Chauffeuri.

Kur autoritetet kompetente gjejnë përdoruës qerrje me fuqi motori, tue shpërdorue Lejen e tij, atë-herë leja i mirret përkohësisht e në rasë përsëritje për gjithmone.

Pjesë e parë

Nevojat Mekanike

§ 5. Ç' do qerre me fuqië motori duhet të ketë nji timon e mekanisma e sajë të jetë e ndërtueme aqë mirë sa me dhanë sigurim ma të plotë në përdorim.

Ç' do automobil me nji peshë ma tepër se 350 kg. duhet të ketë dhe nji mekanisëm me të cillin mund të tërhiqet edhe prapthi (marche reverse).

§ 6. Ç' do automobil do të ketë dy frêj përherë në gjendje të mirë: me njenin për të frenue sigurisht rrotat e pasme, e me tjetrin mekanismet e mbrendëshme; njeni me përdorim dore e tjetri kambe.

Për motocykletat mjafton nji fré.

§ 7. Të gjitha mekanismat qi sigurojnë përdorimin e drejtimin e qerres do të gjinden për herë nën dorë të chauffeurit qi t' i shtijë në veprim me shpejti e lehtesi.

§ 8. Enët (reservoirs) e landëë ndezëse (si benzinë, vojgurit, alkohol, gaz etj.) do t' jenë të ndërtuëme prej materjalit të padjegshëm mprojtuna prej rreziqevet të ndezjes e të plasjes (explosion).

Baterit elektrike duhet të jenë në vend të mirë dhe lidhur me sigurië në mënyrë qi acidet mos të derdhen.

§ 9. Ç' do qerre me fuqi motori do të ketë një aparat signali me zâ.

§ 10. Ç' do qerre me fuqi motori do të ketë përpara dy llampa e përmbrapa nji për ndritim.

Motocykletat me karoceri do të kenë nji dritë signali n'anë të karoceris dhe nji tjetër në motocykletë.

§ 11. Ç' do qerre me fuqi motori do të ketë nji vegël shfrimit (marmite) për të shue zhurmën e motorit e avullimet e randa të gazevet.

Mbrenda qyteteve as nji qerre me fuqi motori nuk mund udhëtojnë pa marmitë ose me marmite të hapun.

§ 12. Ç' do qerre me fuqi motori do të ketë tabellën e firmës e numrin e fabrikës.

Pjesë e dytë

Përdorim

§ 13. Përmbrenda qyteteve, Chauffeuri nuk do të kalojë 10 km. shpejtësi n' orë ; përjashta qyteteve jo ma tepër se 40 km. n' orë me gjith kaq kjo shpejtësi do të pakohet kur prej qarkullimit të shpeshtë mund të damtohen shtegtarët ase gjaja ase mund të parashifen të tjera rreziqe.

Shpejtësija nuk do të kapërcejë ma tepër se 6 klm. n' orë kur moti asht me mjegull ose në vende ku rruga nuk shifet, si në rruga kryq, në të kthyeme të forta, në rrpina të mdhaja, në të hym prej rruge në shtëpi ase në të dalun në rrugë, mbi ura, në rrugë të ngushtë në të cillat dy qerre bashkë nuk mund të kalojnë dot, në vende ku ka traffik të madh, dhe në vende ku janë mbledhur shumë njerës.

§ 14. Signali, do të jepet prej Chaufferit gjithmonë me kohë.

§ 15. Me të ngrysur, ose me mj^gull, duhet të ndizen llampat e qerres.

§ 16. Chauffeuri n' udhtim e sipër nuk duhet të largohet asndonji herë nga automobili, pa pushuar motorin, dhe pa siguruar frenat.

§ 17. Chauffeuri asht i detyruar kurdoherë të mbajë me vehte lisenzën e vet dhe lejen zotërimi të qerres me fuqië motori, dhe kurdoherë qi autoritetet e qeveriës t' i a kërkojnë për kontrollim, asht i detyruar t' i tregojë.

Kur chauffeuri urdhënohet prej organeve të qetsis botore për ndalim (qendrim) asht i detyruëm të qendrojë; gjith kështu chauffeuri duhet me një herë të qendrojë maqinën po të jetë që ban ndonji dam në udhtim e sipër ose të ndollë ç' farë do aksidenti qi shkakton dam.

§ 18. Ç' do qerre me ose pa fuqi motori n' udhtim do të mbajnë krahun e djathët të rrugës. Mund të dalin në krah të majt (të mëngjërt) vetëm kuer i duhet me kalue ndonji qerre tjatër qi ka përpara në direkcjonin e udhtimit të vet.

§ 19. Asnji qerre me ose pa fuqi motori nuk do të xajë rrugën tue penguë cirkulacjonin publik.

§ 20. Askush nuk mund të majnë ngamje shpejtësie me kushte, me qerre me fuqi motori ose motocyklete, pa patur leje të veçantë nga an' e Prefekturës në qarkun e së cillës do të bahet e ngamja.

Kur Chauffeuri damton ndonji njeri, me qerren me fuqi motori, atëherë ay është i detyruar t' i bëjë tërë lehtësinat të damtuëmit dhe t' a shpjerë me një herë në ndonjë vënd, shtëpi, ose spital ku mund t' i bëhen shërbimet mjeksore të nevojëshme.

§ 21. Zotnuësi i qerres me fuqi motori duhet kurdoherë të bëjë të gjitha pregatitjet që maqina e tij të jetë në kondisjon të mirë.

Zotnuesi asht përgjigjës qi maqinat e veta të përdoren vetëm prej atyre personave qi plotësojnë konditat e ksaj rregullorje.

Pjesa e tretë

Rregjistrim i qerrevè me fuqië motori

§ 22. Në rrugat publike mund të përdoren vetëm ato qerre me fuqië motori qi janë të aprovuara prej autoriteteve kompetente, dhe që përmbajnë lejen si mbas rregullores.

Forma e çertifikatës së zotnimit

ÇERTIFIKATË

Zt. ....

Ndenjes në ....

Rrugë .... *Nr.* ....

Ka regjistruar maqinën me 1 Nr.

që karakterizohet në anë tjatër të cilën do t' a përdorë në vende publike.

.................., *me* *19*

Pulle : ....

Nënshkrim i Autoritetit

Nr. i Registrimit ....

Marka e Fabrikës		
Tabella e Fabrikës		
Tip i maqinës		
Leje punimi i maqinës		
Kuaj fuqi motori HP		
Rëndësia e maqinës komplet		
Rëndësia e ngarkimit (kg.... ose Nr. i personave)		

§ 23. Ngarkimi i nji qerreje me fuqië motori duhet të mos jetë ma tepër se sa caktimi i bërë prej autoriteteve kompetentë dhe shenue në çertifikatë. Udhtarët duhet të jenë të venduem mirë mbrenda karoceriës ndër vende ndejet. As një udhëtar, ose ndihmës shoferi nuk do t' udhëtojë ose të qendrojë mbi shkallat ose baltëmprojtset e qerreve me fuqi motori as ndejun as në kambë. Plaçkat e vendosuna ndër qerre me fuqi motori nuk do të dalin për së gjani ma jasht se boshtat e rrotave.

§ 24. Certifikata zotërimi duhet të merret për çdo qerre me fuqi motori qi përdoret në rrugat dhe vendet publike dhe ç' do zotuës pa patur kët certifikat nuk ka të drejtë të përdorë maqinën në të këtilla vende.

Çmimi i Certifikatës Zotërimi asht 50 Fr. ari dhe paguhet me të marrë certifikatën.

BKSH

§ 25. Forma e Certifikatës Chaufeurit.

Lisenze chauffeuri *Jepet për* ...., *Lindur më* *në* .... *ndenjes në* .... *Rrugë* .... *Nr.*	*Z.* ...., ... *mbasi u aprovua prej autoriteteve kompetent. Ztn.* .... *në* .... *me* .... *19* .... *përmbushi tërë kërkimet dhe është i meritueshëm të përdorë qerre me fuqi motori* *bicyklet me fuqi motori* .... *me,* .... *19* .... (Nënshkrim i Autoritetit)
Vendi rezervohet për fytyrën e Chauffeurit **Vula** **Nëshkrimi i chaufeurit me dorën e vet**	(Vendi rezervohet për shenime zyrtare më von)

Pjesa e katërt

Kondìtat për Chauffeur

1. – § 26. Aj qi dishron të japë provimin për Chauffeur për të marrë lejen duhet të paraqesë nji kërkesë përpara autoriteteve kompetente dhe të përmbajë këto :

a) Dëftes me emnin e mbiemnin, dat' e vendin e lindjes. Për me pasë lejen për shofer duhet me pasë mbushë 21 vjet.

b) Dëftesa banimit të vërtetueme prej Bashkis.

c) Dëftesë penale jo ma të vonëshme se dy muejshe.

d) Dëftesë e një mjekut të Qeveris ose të Bashkis mas së

Bksh

cillës të vertetohet se leje kërkuesi nuk ka kurrfarë të mbetë fizike që të mund e pengojnë n' ushtrimin e zejës së tij. Në kët dëftesë do të përmendet posaçërisht se leje kërkuesi shef dhe ndien mirë.

f) N' asht se i ka, do të paraqesë dhe Dëftesat mbi mësimet shkollore ase praktike.

g) Fotografië të veten 6 X 8 në dy kopje.

Personi i interesuem do të prezantohet, në kohën e caktueme për të marrë provimin, dhe të ketë nji qerre me fuqi motorit me të cillën do t' japin provimin.

§ 27. Provimi do të bahet në pyetje të ndryshme verbale dhe praktike, mbi përdorimin e mekanizmave.

1. — Pyetjet verbale permbajnë :

a) Njoftime të përgjithëshme mbi mekanismat e ndryshme qi përmban qerreja me fuqi motori e mbi përdorimin të mekanismave n' udhtim me sigurië ; si timone, frena, marshet e ikjes, reverse, dhe rrotat.

b) Njoftime të jashtë-zakonëshme si, kur rrugët janë të lagëta dhe makina shket, kur është frikë zjarri e maqinës, kur mungon uji në radiator etj.

c) Njoftime mbi masat që lypsen marrë para çë do udhtimi, në rasë rrezikesh n' udhtim e sipër etj.

d) Chauffeuri duhet të ketë njoftim të plotë mbi përshkrimet e kësajë rregullorje.

2. — Provimi pratik përmban :

a) Përdorim me dijeni të plotë të freneve dhe të timonit, të vumit e motorit në zjarre, të kontrolluemit e indukjsonit (magneto ose Bateri) dhe t' ecunit të makinës në largsina të shkurta. Për shembëll, të mbajtunit e direksjonit t' ecunit ndër vende të ngushta, ndalunit me shpejtësië dyke përdorur frenat, t' ecurit prapthi me sigurie, të kthyemit në vende të ngushta duke përdorur ose mos përdorur marcien reverse.

b) Të përdorunit të qerrës me fuqi motori në vende ku ka popullsië të madhe si edhe qerre tjera, të nxjerrunit të qerres nga vende të mbylluna në rrugë, t' ecurit në të kthyerat kuptim të shenjeve nga qerre të tjera ndrrim i shpejtësis në përpjeta dhe në teposhtë, përdorunit të veglave të ndryshme për reparasjon, dhe të përdorunit të mekanismave të frenave etj.

c) Provimet e t' ecunit do të bahen kurdoherë n' ato vende ku ka ma tepër vështirësina.

§ 28. Ç' do Chauffeur veçanërisht duhet të japë provim praktik.

§ 29. Provimi praktik merret mbasi provimi verbalisht mbarohet dhe i interesuemi tregon qi asht i meritueshëm.

§ 30. Në provim praktik konsiderohet vetëm aj qi tregon dijeni të plotë dhe nuk ka gjaknxetësië.

§ 31. Chaufferi do të konsiderohet i meritueshëm vetëm atëhere kur plotëson provimin me dijeni të plotë.

§ 32. Mbi provimin të ç' do personi do të mbahet, prej autoriteteve kompetent, nji regjistrim i plotë, dhe numri qi do të ketë kjo Listë, do të shënohet në lejen që do t'i dorëzohet.

§ 33. Kushtimi i Certifikatës së Chauffeurit asht 20 Fr. ari dhe maqina qi do të përdoret për provimin pratik duhet t'jetë angaxhuar prej personës s' interesueme.

Pjesa e pestë

Regjistrim dhe numrim

§ 34. Forma e librës Regjistrimit.

1	2	3	4	5
Numër vazhdus	Emëri dhe mbiemëri dhe banim i zotuesit	Marka e Fabrikës dhe Numëri Fabrikuar	Tip i qeres me fuqi motori	Lloj motor Punimi

Numurim :

§ 35. Ç' do qerre me fuqië motori që përdoret në rrugat dhe vendet publike duhet të ketë nji numur të caktuar me dy tabellë, një përpara edhe një prapa, qi do të korrespondojnë me numrin të regjistrimit.

§ 36. Madhësia e tabelave do t' jetë 25 X 12 cm. dhe shkronjat nga 8 cm. Kur është koha në mjegull ose ngrysur tabellat

duhen të ndritohen me llampa të posaçme dhe numri i tyne duhet t'jetë kurdoherë i dukëshëm.

§ 37. Përdorim i nji numuri të pa rregjistruem ndalohet reptësisht.

Forma e numërit

§ 38. Forma tabellave të Numurimit

D. 126

Pjesë e gjashtë

Dënime:

§ 39. Ç' do persone qi nuk vazhdon si mbas kësajë rregullore dhe shpërdoron dispozitat e ndryshme në përdorim të qerres me fuqi motori, denohet si vazhdon:

a) Për herën e parë gjer me 50 Fr. ari gjobë.

b) Për herën e dytë 100 Fr. ari gjobë, dhe tërhekjen e lejes prej 3 e deri në 6 muej, herën e tretë me 100 Fr. ari gjobë dhe heqja e lejës përgjithmonë.

§ 40. Ç' do person do të dënohet me pagim prej 100 (njiqind) Fr. ari dhe dy muej burgim kur përdorë në rruga dhe vende publike nji qerre me fuqi motori qi nuk përmban regjistrimin t' autoriteteve kompetent, si mbas kësajë rregullorje.

Gjithkështu dënohet dhe zotuësi i nji qerre me fuqi motori i cilli nuk ka rregjistruar qerren dhe e le të përdoret.

§ 41. Çdo person do të dënohet me 100 (njiqind) Fr. ari dhe dy muej burg i cilli përdorë maqinën pa Lisenze.

Gjithkështu do të dënohet dhe Zotuësi i qerres me fuqi motori H që pajton Chauffeur pa Lisenze.

§ 42. Kur nji Chaffeur shkakton dem personi, kafshe, ose çdo farë lloj propretari, do të dënohet si mbas kodit penal.

Kjō rregullore hynë në fuqi për zbatim me datë 1 Shtator 1925.

BKSH

Nr. 67.

RREGULLORE, 29 Shtatuer 1925.

Mbi internatet e Shtetit

I. Administrimi i Internatevet

Neni 1. Internatet e Shtetit kanë për qëllim që t'u japin djelmëvet nji edukatë morale, intelektuale e fyzike e të formojnë, kështu, qytetarë të vërtytshëm, të diçëm e të shëndoshë.

Neni 2. Internatet e Shtetit janë dy farësh. Internate që kanë mbrenda nxanës shkollash fillore e Internate, ku gjinden mbrenda nxanës shkollash të mesme.

Neni 3. Për të gjitha të prishunat e Internatevet të mesmë, si për rrogat e personalit, për orendit, për qiran, etj. do të kujdeset Shteti; gjithashtu edhe për të prishunat e Internatevet fillore do të kujdeset prapë Shteti, veç atyneve të qiras e të orendivet, të cilat do të mbulohen nga t' ardhunat që mund të ketë Internati e nga kredit e veçanta që do të caktohen prej Bashkivet të vendit, si pas ligjës mbi ndërtesat e shkollavet fillore.

Neni 4. Personali edukativ e drejtues i Internatevet fillore përbahet prej njij Drejtori, prej njij mësuesi ekonom, prej njij mësuesi kujdestar e prej nji numri mësuesish, sipas nevojës së klasës. Personali i Internatevet të mesmë përbahet prej Drejtorit të Shkollës, prej njij Nëndrejtori, i cili do të jetë nji nga profesorët, prej njij ekonomi e magazinieri, i cili asht i veçantë as nji nga profesorët e prej nji kujdestari të karierës së mësuesis, i cili mund të jetë edhe sekretar i Drejtoris; këtij personali, pas nevojës, mund t' i shtohen edhe nji a ma shumë profesorë, të cillët do të jenë ndihmës kujdestarë. Përveç këtyneve, personali edukativ përbahet edhe prej gjithë profesorëve që japin mësim n' atë shkollë të mesme.

Neni 5. Për administrimin e Internatavet do të jetë nji Këshill administruer i kryesuem prej Drejtorit e i përbamë:

a) prej dy delegatësh, nji i Këshillit administruer të Prefekturës, Nënprefekturës a Krahinaris e tjetri prej Këshillit të Bashkis së vendit;

b) prej dy anëtarësh t' emmnuem drejt për së drejti nga Drejtorija e Përgjithëshme; nga këta njeni do të jetë nji nga

mësuesit a profesorët e Shkollës e tjetri nji nga Inspektorët e shkollavet të vendit;

c) prej njij nëpunësi të zyrës së Finrncavet të vendit që do të caktohet prej Drejtoris së Financavet të Prefekturës ku gjindet Internati.

Në qoftë se Internati gjindet në nji vend, ku nuk ka as krahinari as kurrfarë zyre financjare, atëhere në këshillin administruer t' Internatit do të mirren dy nga Bashkija e vendit, e për këta do të mirret pëlqimi i Drejtoris së Përgjithëshme t' Arsimit.

N' Internatet fillore kryesin e Këshillit administruer e merr Inspektori; n' Internatet e mesëm e merr Drejtori, e, në u-gjindtë edhe Prefekti, kryesin e merr ky i fundit.

Anëtarët e Këshillit administruer t' Internatit qëndrojnë në këtë zyrë për tri vjet e mund të zgjidhen përsëri. Për shërbimin e tyne nuk do të marrin asnji shpërblim.

Ai anëtar që pa ndonji shkak me themel nuk merr pjesë në tri mnledhje me radhë bie nga zyra e tij.

Neni 6. Këshilli administruer sqyrton e aprovon buxhetin e Internatit, auktorizon Drejtorin që të vejë në veprim, mbassi të ketë marrë aprovimin definitiv të Drejtoris së Përgjithëshme t' Arsimit; merr vendimet e duhuna për veprimin e rregullshëm t' Internatit, për transformimin e nevojshëm të tij, për shtimin e pasunis së tij, etj. Përveç këtyne, jep vendime për të vu në pakësim kontratën e ushqimit, a ndonji tjetër gja, mbassi të jetë marrë auktorizimi i Drejtoris së Përgjithëshme. Për gjana, çmimi i të cilave nuk kapërcen shumën e 300 frangave ari. Këshilli administruer mund të vendojë vetvetiu, pa pasë pëlqimin e Drejtoris së Përgjithëshme, për t' i blemë këto atje ku gjinden ma mirë e ma lirë.

Në mbarim të vitit financjar Këshilli administruer sqyrton e aprovon mbyllien e llogarivet.

Neni 7. Këshilli administruer i njij Internatit mund të shpërndahet me vendim të Drejtoris së Përgjithsshme t' Arsimit për shkaqe me randësi ase kur ndjek prapë po atë udhë veprimi, me gjithë që i asht ba verejtja që të veprojë simbas dispozitavet ligjore.

Në rasë të shpërndamjes së Këshillit, administrimi i Internatit i ngarkohet nji Komisari të jashtëzakonshëm i emnuem prej Drejtoris së Përgjithëshme t' Arsimit.

BKSH

Neni 8. *Detyrat e drejtorit.* – Drejtori i Internatevet fillore ase Nëndrejtori i Internatevet të mesëm asht përgjegjës për rregullimin e dishiplinën e mbrendëshme t' Internatit. Ky ka për detyrë:

a) të vëjë në veprim çdo ligjë, rregullore e urdhën ma të naltë;

b) t'ushtrojë auktoritetin e tij mbi zyrtarët, nxanësit e shërbëtorët e Internatit pas caktimit të dispozitavet të ligjëvet e të rregullorevet;

c) të mbi kqyrë që çdo nxanës të vështrohet e të udhëhiqet me kuides e me dashuni për sa i përket sjelljes morale e mësimevet të tij, të qërtohet për të metat e tij e të ndeshkohet për fajet e bame, por pas njij kriteri edukativ t' urtë e të matun;

ç) të gjyrmojë e të përpiqet për përparimin e çdo nxanësi në mësime e në sjellje;

d) t'i japë lajmet e duhuna auktoritetit ma të naltë (Inspektorit për Internatet fillore e Drejtorit të shkollës për Internatet e mesëm) për bursistët e Shtetit e familjevet të tyne për nxanësit qi mbahen me të hollat e veta.

Drejtori i Internatevet fillore ose Nëndrejtori i Internatevet të mesëm asht përgjegjës përpara Inspektorit e Drejtorit të Shkollës.

Neni 9. *Detyrat e kuidestarit.* – Ky përfaqëson Drejtorin apo Nëndrejtorin në çdo mungesë a pengesë të tij edhe asht përgjegjës kundrejt tij:

a) për të ruëjtunit e të vuëmit në veprim të ligjëvet, rregullorevet e urdhënavet epërore;

b) për të kryemit e detyrës si të shërbëtorëvet ashtu edhe të nxanësvet; këta të fundit duhet t' i vështrojë secilin veçanërisht, si janë nga sjellja e si venë në mësimet, e prandaj në kohë të ngranëjes, të fjetjes e të studimit të tyne duhet t' i mbikqyrë me kuides e me dashuni. Mbassi të lajmojë Drejtorin a Nëndrejtorin ka të drejtë t' i ndëshkojë nxanësit sipas rregullores e t' u japi lejë të kuvendojnë me vizitatorët e të shkojnë në shtëpi në kohë të pushimevet. Kujdsstari emnohet nga Drejtorija e Përgjithëshme e Arësimit.

Neni 10. *Detyrët e ekonomit.* – Ekonomi:

a) përkrah Drejtorin a Nëndrejtorin n'administrimin e Internatit për sa u përket shpenzimevet e t' ardhunavet të këtij e

asht drejt për së drejti përgjegjës kundrejt Drejtorit a Nëndrejtorit.

b) vështron që gjanat e dhanme prej kontratarit të jenë plotësisht pas cilësis e çmimit të caktuem prej Këshillit administruer të Internatit;

c) kujdeset për orendit e veglat e Internatit e mbikqyr punët e gjelltores;

ç) ban gati për ditë tabelat e ushqimit, të cilat do të vërtetohen prej Drejtorit a Nëndrejtorit e do të mblatohen me vulën Shkollës;

d) ep e merr, me vërtetim të Drejtorit a të Nëndrejtorit, me Financën e vendit e me çdo tjetër zyrë, me të cilën ka Internati veprime financiare; dëftesat e dhana për të holla që hyjnë n' arkë t' Internatit duhet të kenë nënshkrimin e Ekonomit e atë të Drejtorit a të Nëndrejtorit;

dh) i jep nji raportë të përmuejshëme Drejtorit ase Nëndrejtorit mbi gjendjen ekonomike të Internatit;

e) asht përgjegjës për të mbajtunit me rregullë të llogarivet e të çdo tjetër veprimi financjar të Internatit;

ë) detyrohet që të mbajë këto libra:

1) nji libër arke;

2) nji libër inventari;

3) nji fletë të përditëshme t' ushqimit;

4) një fletë përmbledhëse të përmuejshme;

f) detyrohet t' api nji kaucion, sipas rasëve, prej 1000 deri 10.000 fr. ari.

Neni 11. *Detyrët e kujdestarëvet.* — Kujdestarët:

a) janë drejt për së drejti përgjegjës për edukatën e sjelljen morals e dishiplinore të nxanësvet, të cilët do të jenë kurdoherë nën vështrimin e kujdesin e tyne;

b) mbikqyrin nxanësit në punët e tyne të përditëshme tue u kujdesë e tue u siguruem që secili nxanës të ketë kryem për ditë detyrët e tij shkollore;

c) i drejtojnë nxanësit, i këshillojnë e i qërtojnë me dashuni atnore sipas karakterit e gjëndjes morale të secilit;

ç) me shëmbëllën e me fjalët e tyne kujdesen që nxanësit të sillen njerëzisht shoq me shoq, të rrijnë pastër nga trupi e nga pëtkat, të mos prishin e të mos damtojnë kurrfarë sendi; përveç kësaj do të kujdesen që nxanësit të kenë gjithëmonë në shpirtin e tyne kult për familje, dashuni e mirënjohje për prind,

nderim për epërorë e ndjenja të nalta e fisnike për komb e për atdhe.

Neni 12. *Detyrët e shërbëtorëvet.* – Shërbëtorët zgjidhen prej Drejtorit a Nëndrejtorit me pëlqimin e Inspektorit a të Drejtorit.

Neni 13. Të ndamit e punëvet të shërbëtorëvet do të bahet prej Drejtorit a Nëndrejtorit e të kujdestarit tue i u-kallzue secilit puna që ka për të ba. Me gjithë këtë, secili shërbëtuër asht i detyruëm me krye edhe çfarëdo pune tjetër që i urdhënon Drejtori a Nëndrejtori a kujdëstari.

Neni 14. Asht detyrë e shërbëtorëvet :

a) që të sillen me nxanësit sa ma fort me butësi e me njerëzi, por pa pasë me ta kurr-farë intimiteti;

b) që të kujdesen fort për teshat e nxanësvet, t' u ndihmojnë në pastërti e t' i bajnë me dijtë kujdestarit për ndreqjet a arnimet që kanë nevojë teshat e tyne.

c) që të shkojnë fort mirë ndërmjet të tyne tue nderuem e ndihmuëm njeni tjetrin. Për grindjet a fjalët që mund të kenë ndërmjet vedit do të ndeshkohen e ma në fund do të nxirren nga puna;

ç) që të mos kryejnë ndonji punë a porosi të nxanësvet pa lejë e dijë të kujdestarit si edhe të mos flasin e të mos marrin nëpër gojë jashtë çdo gja që i përket Internatit, nxanësvet e personalit të tij;

d) që të mos sjellin jashtë Konviktit, pa lejën e Drejtorit a t' Ekonomit gjana të nxanësvet apo të Internatit.

dh) që t' i referojnë me njiherë eprorit për çdo prishje që mund t' u jenë ba mobilavet t' Internatit ; në qoftë se nuk e bajnë detyrë, do të jenë vetë përgjegjës tue iu ndaluëm prej rrogës shuma e damit ;

e) që t' i bajnë me dijtë kujdestarit apo Drejtorit, kur do t'a kenë radhën për me ruëjtë natën, për çdo farë ngjarje, sado e vogël me qenë, që mund të ngjasë n' Internat ;

ë) që të kenë kujdes të madh e të ruëjnë mirë portën e Internatit, e për të kryëmit e pa të metë të kësaj detyre do të jetë përgjegjës ai që ka marrë përsipër këtë barrë ;

f) që të mos pijnë duhan, në çfarëdo ore, nëpër lokalet e mbrendëshme t' Internatit ;

g) që të mos kërkojnë dhurata, në çfarëdo forme që të jenë këto, prej nxanësvet apo prej familjes së tyne.

II. Pranimi i nxanësvet nëpër Internate

Neni 15. Nëpër internatet fillore pranohen ata djelm që janë jo ma të vegjël se gjashtë vjeç për klasën e parë e jo ma të mëdhej se katërmbëdhetë vjeç për klasën e gjashtë të fillores. Për djelmt që vijnë prej Internatevet të tjera nuk merret para sysh mosha që kanë, por dëshmit e rregullshëme si për mësimet e kryëme si për sjelljen morale.

Neni 16. Për t'u pranuë nji nxanës, prindët apo përfaqësuësi ligjuër i tij duhet t' i drejtojë nji lutje të rregullshëme Drejtorit t' Internatit bashkë me këto dokumenta ;

a) me aktin e lindjes së zyrës së Shtetit Civil të vërtetuëme prej auktorit, prej të cilit varet zyra që jep aktin. Çertifikatat e lindjes që mund të jipen prej së jashtëmi duhet të vërtetohen nga përfaqësuësi i Shqipnis që gjindet n' atë Shtet ku jipet akti e nga Ministrija e jashtëme ;

b) me nji çertifikat të ligjshëm, ku të tregohet se nxanësi asht i shëndoshë nga trupi, e ka shartuë linë e nuk ka ndonji gjymtim fizik apo lëngatë ngjitëse, që s' mund të durohet në jetën kolegjale. Ky çertifikat duhet të vërtetohet prej kryetarit të Bashkis së vendit e të Prefektit a të Nënprefektit a të Krahinarit ;

c) me nji dishmi shkollore të mësimeve që ka krye.

Neni 17. Pranimi definitiv i nxanësit bahet, mbassi të vërtetohet gjëndja e mirë e shëndetit të tij prej mjekut t' Internatit a të Bashkis e pas informatavet që rezervohet të marrë Drejtori mbi sjelljen e kandidatit.

Neni 18. Pranimi i kandidatit në Internat e lidh familjen e tij, që t'iu shtrohet për gjithë vitin shkolluër dispozitavet të kësaj Rregulloreje si edhe çfarëdo tjetër dispozitë eventuale që mund t' ipet prej Drejtoris së Përgjithëshme a prej Këshillit administruër t' Internatit.

Neni 19. Nxanësi që nuk e kapërcen klasën për dy vjet rresht për Internatet fillore e për motmot për ato të mesme ase për dy vjet, për këto, për shkaqe të justifikuëme nuk pranohet ma n' Internat.

III. Pagesat e nxanësvet

Neni 20. Pagesa e përvjetshëme e njij nxanësi për Internatet fillore e të mesme asht minimum 400 e maximum 600 fr.ar tuë marrë para sysh gjëndjen e nxanësit e shtrejtësin e vëndit. Pagesa do të caktohet prej Këshillit Administruër t' Internatit.

Neni 21. Pagesa do të bahet me kiste të parapaguëme në krye të çdo tremuejshi : 1 Shtatuër, 1 Dhetuër, 1 Mars e 1 Qershuër. Nxanësit e Internateve fillore mund t' i bajnë pagesat e tyne edhe në natyrë, d. m. th. mund t' apin, në vend të të hollavet, edhe gjana ushqimi, si groshë a fasule, patate, djathë, tëlynë (gjalpë), etj. sipas çmimit të ditës që t' i caktohet prej Këshillit administruër të Internatit.

Neni 22. Për bursistët e Ministris do të bahen ato pagesa që kanë për t' u caktuem pas njij marrëveshje të Ministris e të Drejtoris bashkë me Këshillin administruer. Drejtori, mbas vendimit të Këshillit t' Administratës, ka të drejtë t' i largojë nga Internati, ata djelm, familjet e të cilëvet nuk kanë paguem në dy javët e para të kistit si edhe shumat e shpenzimet e shënueme në nyjën 24.

Neni 23. Nxanësit që pranohen n'Internat duhet të parapaguejnë kistin e plotë, në qoftë se hyjnë n' Internat në gjysmën e parë të tremuejshit e gjymsën e kistit, në hyfshin në gjymsën e dytë të tremuejshit.

Ata që dëbohen prej Internatit për shkak sëmundjeje paguejnë vetëm muejin, në të cilin dalin. Përveç këtyre dy rasëve, në çdo muej të vitit që të dalin nxanësit nga Internati, asht i detyruem të paguejë shumën e krejt vitit.

Neni 24. Për çfarëdo mungese të përkohëshme të nxanësit prej Internatit nuk mund të bahet kurrfarë zbritjeje prej pagesës së përvjetshëme.

Neni 25. Secili internatist duhet të paguaj fr. ari 20, sado kohë që të qëndrojë n' Internat, për qera të mobiljeve, si të shtratit, të shtrojës, të mbulesavet, etj. Ka për të pague edhe fr. ari 60 në vit për arnime të vogla petkash e këpucësh, për shërbim të berberit, për bojë këpucësh, për sapun, për të lamit e petkavet, etj. Këto dy pagesa të sipërpërmenduna do të paguhen bashkë me kistin e parë tremujuer të vitit shkolluer. Librat, katërshoret e gjanat e tjera të shkollës do të blihen prej internatistëvet.

IV. Gjymës internatistësh

Neni 26. Nëpër Internatet fillore e të mesme pranohen edhe djelm si gjymës internatistë. Këta do të paguajnë 150 deri 250 fr. ari të parapaguëme në tri kiste sipas N. 20. Përveç kësaj do të paguajnë edhe fr. ari 10 në vit si qera mobilash, për të arnuëmit e të lamit të petkavet, etj.

Neni 27. Gjymës internatistët kanë të drejtë të hanë vetëm drekën n' Internat, sipas listës së caktuëme të gjellëvet.

Neni 28. Për pranimin e gjymës internatistëvet do të bahen po ato veprime, si për internatistët e plotë, të diftuëme në nyjet 11 e 12.

V. Pajisja e nxanësvet

Neni 29. Secili internatist duhet të ketë nji pajisje të plotë, sipas listës së poshtëshënuëme. Por sa të hyjë n' Internat, petkat që siell me vehte do t' ja dorëzojë ekonomit a magazinierit, prej të cilit do të marri nji dëftesë. Internatisti ka për të mbajtë pranë ç' i lypset për përdorim të përditshëm, pse të gjitha të tjerat do të mbeten nën rojë të magazinierit.

Neni 30. Çdo nxanës i Internatit duhet të ketë:

1. Uniformë dimni (1 gjaketë, dy palë pantallonë, 1 kapotë, 1 ksulë, sipas modelit).
2. Petka shtëpije për dimën (2 gjaketa e 2 palë pantallonë, si pas modelit).
3. Uniformë vere (1 gjaketë, 2 palë pantallonë e 1 ksulë sipas modelit).
4. Petka shtëpije për verë (2 gjaketa e 2 palë pantallonë dokut, sipas modelit).
5. Dy palë këpucë me lidhca.
6. Nji palë pantoflla.
7. Gjashtë çarçafë dyshekësh nga mt. 2.70.
8. Katër peshqirë (rize)
9. Gjashtë mësalla (peceta).
10. Gjashtë këmisha dite të bardha.
11. Katër këmisha nate.
12. Gjashtë palë të linda (brekë).
13. Gjashtë palë çarapë.
14. Nji duzhinë faculeta të bardha.
15. Katër faculeta leshi a pambuku
16. Dy trajse (strajca pëlhure me lidhëza për tesha).
17. Nji brushë petkash.
18. Nji brushë këpucësh.
19. Nji brushë dhambësh.
20. Dy krahën, nji të shpeshë, nji të rrallë.

Secila copë e këtyne petkave do të ketë numrin e shënum prej Drejtoris.

VI. Ushqimi e mjekimet

Neni 31. Nxanësvet t' Internatevet do t' u jipet ushqimi në këtë mënyrë :

Sillë (mëngjes) : kafe, çaj, kafe me qumësht, sipas stinës, me nji copë bukë.

Drekë : supë, sallatë, a pilaf e nji pjatë me mish a me peshk ase me ve e nji copë bukë.

Darkë : sallatë a supë a pilaf e nji pjatë me mish e me peshk ase ve e nji copë bukë.

Dy herë në javë do të hahet groshë a zarzavate të ndryshme. Nga ndonji herë, kur të shifet e udhës prej drejtorit bahet edhe nji herë ambëlsinë, por jo ma tepër se dy herë në javë.

Neni 32. Sasija e ushqimit të përditshëm për çdo nxanës do të jetë :

Lloji i ushqimit	*Gram* Për të mesmet	— Për filloret	*Vrejtje*
1. Bukë	750	700	Nga ma e mira.
2. Mish	300	250	Këjo sasi asht për drekë e darkë, tuë u dhanë vetëm mishin për nga 125 gr.
3. Qepë	50	30	
4. Krypë	20	20	
5. Oriz	160	120	Për pilafin e drekës e të darkës ; për çorbë 15 gr. : për gjellë të mbushuna (si domate, patëllxhane, etj.) 40 gr. ; për sytljaç 25 gr.
6. Tlyen	50	40	Pilafevet e byrekëvet nga 25 gr. ; makaronavet 20 gr. për çdo gjellë me barishte nga 10 gr.
7. Barishte të thata.	150	120	Për drekë e për darkë nga 60 gram.
8. Barishte të njoma	350	300	Patate, spinak, pras e barishte të tjera që firojnë jipet nga nji sasi e gjymës ma tepër ; patëllxhanet po të jen të mdhaja jipen nga nji e po të jen të vogla nga dy, bamjet e njoma nga 80 gr.

BKSh

Lloji i ushqimit	*Gram* Për të mesmet	Për filloret	*Vrejtje*
9. Miell	70	50	Për byrek; për ambëlsina me brumë jipet nji sasi prej 30–40 gr.; për çorbë e për gjellë nga 15 gr.
10. Sheqer	80	70	Për kadaif; për ambëlsinat e tjera e për kompostot jipet që prej 40–60 gr.; çajë 20 gr.
11. Djathë	30	25	Për mëngjezin; për byrek, makarone, omelet e qofte patatesh nga 15 gr.
12. Ullîj (kokërr) . .	40	30	Për mëngjezin.
13. Reçel.	40	30	Për mëngjezin.
14. Çajë	1/2	1/2	
15. Rush të njomë .	200	150	Për nji herë të vetme.
16. Molla, dardha etj.	180	150	Për nji herë të vetme.
17. Voj.	20	20	Këjo sasi asht për barishtet; për fergesat e peshkut, të patllixhanit, të kungullit, etj. prej 20–25 gr.
18. Makarona . . .	80	60	Për nji herë të vetme. Për sherije e fide për çorbë nga 10 gram.
19. Qumësht. . . .	200	150	Për muhalebi e për sytljaç; për kafe e për kakao nga 100 gram.
20. Voe (kokrra) . .	2	2	Për nji herë të vetme; për spinak vetëm nji kokërr.

Shënim. – Sasija e shënuëme në gram asht për drekë e për darkë; në qoftë se sasija jipet vetëm për njenën nga këto (për nji vaft), atëherë mirret gjymsa e sasis së shënuëme.

Sasija për voj guri, për sapun për petka e për enë, për dru e për thëngjill do të caktohet pas nevojës.

Neni 33. Sasit e sipërshënuëme për çdo nxanës nuk do të kalohen; numri i nxanësvet do të llogaritet për ditë e do të vërtetohent prej kujdestarit t' Internatit.

Neni 34. Prej ushqimit të përgjithshëm të nxanësvet do të dali edhe ushqimi i shërbëtorëvet.

Neni 35. Për Drejtorin e Nëndrejtorin e kujdestarin do të shtohen 2 porsione pas sasis së caktuëme për çdo nxanës.

Neni 36. Drejtori a Nëndrejtori në vënd t' ushqimit mund të marrë pjesën e tij në të holla pas vendimit të Drejtoris së Përgjithëshme t' Arsimit.

Neni 37. Sasija e caktuëme do t' i dorëzohet gjelltarit me peshim, përpara kujdestarit edhe të njij nxanësi qi do të shënohet për ditë nga Drejtori a Nëndrejtori i Internatit.

Neni 38. Sasija e ushqimit që do të ndahet çdo ditë do të nënshkruhet prej Drejtorit, kujdestarit, gjelltarit e nxanësit të shënuëm; listat e çdo dite do të ruhen prej Ekonomit.

Neni 39. Mjekimi i sëmundjevet të zakonëshme, që nuk janë kronike ka për të qenë mbi administrimin e Internatit; vetëm barnat kanë për t' u paguë, në qoftë se kushtojnë ma tepër se 2 fr. ari.

Neni 40. Konsultimet e vizitat e bame prej njij mjeku tjetër të kërkuëm nga prindët e internatistit janë për njehsim të familjevet: gjithashtu mjekimet e sëmundjevet kronike a të gjata do të bahen për njehsim të familjevet.

VII. Vizitat

Neni 41. Vizitat e prindëvet e të përfaqësuësvet të nxanësvet apo të ndonjij farefisi t' auktorizuëm prej familjevet të tyne bahen për ditë të Premte e të Djelë pas dreke n' orën e caktuëme prej Drejtoris. Në ditë të tjera nuk mund t' u bahen vizita internatistëvet, përveç të ndonji rase që e shef t' arsyëshme Drejtori ase Nëndrejtori a kujdestari.

Neni 42. Po të jetë i sëmundë ndonji nxanës, mund të vizitohet çdo ditë deri n' orën që mbyllet porta e internatit, d. m. th. deri n' orën 8 pas dreke.

Neni 43. Internatistët para se të shkojnë n' orën ku do të vizitohen prej të vetvet duhet të paraqiten te kujdestari. Vizituësit do të ruhen që mos t' u japin nxanësvet gjana që i ndalon rregullorja.

VIII. Korrespondenca

Neni 44. Për të mbajtë të gjallë dashunin mbë familjet, internatistët kanë detyrë t' u shkruejnë prindëvet ma së paku nji herë në muëj, n' ato orë, kur s' kanë mësime. Nëpër Internatet fillore korrespondencë me të tjerë, përveç se me familjet, nuk u jipet lejë të bajnë internatistëvet përveç se kur t'u kenë dhanë lejë prindët e kujdestarët e tyne. Nëpër internatet e mesme nxanësit mund të korrespondojnë edhe me miqt e tyne.

Neni 45. Korrespondenca e nxanësvet, si kur arrin si edhe kur niset, duhet të shkojë nëpër duer të kujdestarit. Asht e ndaluëme rreptësisht që të dërgojnë e të marrin letra nxanësit me anë të bashkënxanësvet të jashtëm ase me anë të shërbëtorëvet: nxanësit duhet t' i drejtohen kujdestarit për çdo nevojë

Neni 46. Në rasë dyshimi korrespondenca do të çensurohet; porse fshehtësija epistolare do të mbahet e do të ruhet.

Neni 47. Drejtori a Nëndrejtori, në krye të çdo tremuejshi t' u dërgojë familjeve të nxanësvet dishmit me notat e marruna në sjellje e dë mësime. Këto dishmi do t' i kthehen Drejtoris të nënshkrueme. Dishmit e bursistëvet të Qeveris do t' i dërgohen Ministris.

Neni 48. Çfarëdo pyetjeje që i bahet Drejtoris së njij Internati, për sa i përket jetës së njij nxanësi, prej familjes a prej përfaqësuesit të saj Drejtori jep përnjiherë përgjigjen e nevojshëme.

IX. Detyrët e internatistëve

1) Dispozita të përgjithëshme

Neni 49. Internatistët detyrohen të ndjekin pikërisht orarin e Internatit e të shpejtojnë të kryejnë punët e shënueme nëpër orët e caktueme. Të vonuemit në punë bahet shkak shrregullimi për shkollën e ndeshkimi për ta.

Neni 50. Internatistët detyrohen t' i ndjekin rregellisht gjithë mësimet e punët e klasës së tyne tue mos i u shmangë asnjij mësimi e detyre, por tue dëftye kujdes e vemende për të gjitha mësimet.

Neni 51. Nxanësit internatistë e kanë me detyrë të sillen, si në Internat ashtu edhe jashtë, me të prume të njij edukate të naltë, ashtu që sjellja e tyne mos t' u randohet as familjevet as Institutit që i mban.

Neni 52. Ndërmjet të internatistvet duhet të mbretnojë harmonija ma e madhe tue u sjellë shoq me shoq me të mirë e më të butë, sikur me qenë vllazën. Duhet t' i ndihin njeni tjetrit në çdo punë, të duhen e të mos zihen. Prandaj ndalohen rebtësisht fjalët e liga e të randa, të shamet e çdo tjetër lëndi a e fyeme.

Neni 53. Internatistët duhet të dëftejnë ndëgjesë e nderim mbi të parët e tyne; të dëftehen për herë të njerëzishëm, të dashun e mirënjoftës kundrejt gjith' atyneve qi kanë marrë përsipër edukatën e tyne. Nuk do të shmangen kurr së kryemi ur-

dhënat që u jipen, e ankimet e tyne duhet t' ja paraqesin në mënyrën e duhun kujdestarit a Drejtorit të tyne.

Neni 54. Internatistët duhet të rrijnë kurdoherë të veshun pastër, të pagrisun petkash, të lamë, të rruem e të qethun flokësh e thojsh. Përdorimi i pudravet, konsmetikëvet e levandavet, etj. âsht i ndaluem. Gjithashtu detyrohen nxanësit të mbajnë pastri e rregullë të madhe, si për libra, defterë e të tjera gjâna shkollore të tyne, si edhe për çdo mjet e orendi tjetër mësimi të shkollës. Prandaj të gdhenunit me brisk e të shkarravitunit mbi banka, mure, harta, nevojëtore, etj, ndalohet rreptësisht.

Neni 55. U asht ndaluem nxanësvet të mbajnë të holla, sahata, thika brisqe e sende të tjera të çmueshme. Gërshanët, brisqet për t' u-rrue, të nevojshëme për pastrin e nxënësvet, do të mbahen prej kujdestarit, i cilli do t' ua japi nxanësvet, kur të kenë me të vërtetë nevojë, por që do t' ua marrë, porsa të kryet nevoja.

Gjithashtu janë të ndalueme fletoret e librat, këndimi i të cillavet mund t' i largojë nëxanësit nga mësimi e mund t'iu prishë zakonin e mirë të tyne.

Të hollat që mund të kenë nxanësit me vehte do t' i dorëzohen ekonomit të Internatit.

Neni 56. Asht i ndaluem rreptësisht të pimit e duhanit. Nxanësit duhet ta dijnë se kjo porosi a urdhën rrjeth prej se asht nji masë shëndetsije për moshën e re të tyne të mos pimit e duhanit, e, mbassi do të rrojnë së bashku me të tjerë nuk mund të durohet tymi i duhanit prej atyneve që nuk e pijën.

Neni 57. Internatistët nuk mund t' u japin kurrë urdhëra shërbëtorvet, as nuk duhet të kenë ndonji marrëdhanje me ta, por lypset t' i drejtohen kujdestarit për çdo nevojë të tyne, e ai do të kujdeset për të kryemit e saj.

Neni 58. N' Internat nuk mund të bahet asfarë sendi për t'u ngranë pa lejen e kujdestarit.

Neni 59. Janë të ndaluem rreptësisht nxanësit të bajnë ndërresa e të blejnë gjana si ndërmjet të tyne ashtu edhe me të huejt; as t' u japin porosi bashkënxanësvet të tyne të jashtëm a shërbëtorëve t' Internatit.

Neni 60. Nxanësit duhet të kujdesen fort për të gjitha gjanat, si për të vetat, si edhe për ato të tjerëvet e për ato t' Internatit. Ata që thyejnë a prishin ndonji gja të huej a të Inter-

natit detyrohen të paguejnë kushtimin e ndreqjes a të blemjes së gjasendit të prishun a të damtuem.

Neni 61. Janë të ndaluem të gjith bisedimet e komentet mbi urdhënat eprorë e mbi çfarëdo argumenti që mund të sjelli pakënaqësi e grindje.

Neni 62. Në kohë të dëfrimit, përveç lojavet, për të cilat asht dhanë leja prej kujdestarit a mësuesit, kurrnji lojë tjetër nuk mund të përdoret. Gjithashtu në këta u ndalohet nxanësvet të bërtasin, të bajnë potere, të fishkëllojnë, të flasin konvencionalisht ase të ndahen anësh prej shokëvet e të bisedojnë gjana që shtien në dyshim.

Neni 63. Shumë shërbime t' Internatit që do të caktohen prej Drejtorit a kujdestarit internatistët detyrohen t' i bajnë vetë pa ndihmën e shërbëtorëvet.

2) Rregulla në të ngranët e në të fjetunit

Neni 64. Kohët e të ngranit e të të fjetunit do të caktohen në nji orar të veçantë prej Drejtoris a Nëndrejtoris.

Neni 65. Të gjithë nxanësit e të gjitha klasëvet hanë bashkë në tryezë. Porsa t' epet shenja për të ngranë, të gjithë nxanësit mblidhen me radhë e me qetësi të plotë, dy nga dy, venë në sallët e të ngranit.

Nuk i jipet lëje ndonjij nxanësi të vonohet me ardhë në tryezët. Asnji nxanës nuk mund të largohet nga tryeza pa mbaruëm së ngrani të gjithë, gjithashtu nuk mund të ngrihet e të vejë në gjelltore.

Asnji nxanës nuk mund të marri me vehte në tryezë libra studimi për asndonji arsyë.

U ndalohet nxanësvet të vejnë në tryezë të veshun me rrobet e flejtores.

Në tryezë nxanësit do të vërehen prej kujdestarit e do të flasin nga dalë. Të folunit me zâ të naltë asht ndaluem; gjithaqë edhe të hudhunit bukë e e shkuëmja prej njij tryëze në tjetrën.

Për çdo nevojë nxanësit duhet t' i drejtohen kujdestarit që i vigjëllon.

Pas të ngranit nxanësit do të dalin prej tryezës me rregullë e qetësi të madhe.

Neni 66. Në fillim të çdo vjeti shkolluer Drejtori a Nëndrejtori i cakton çdo nxanësi flejtoren edhe vendin e tij për

gjithë vitin. Do të ketë për rregullë që në çdo flejtore të gjinden nxanës po t' asaj klase e ndryshimi i moshës së nxanësvet po t' asaj flejtorje të jetë sa mâ i vogël. Asnji nxanës nuk ka të drejtë të ndrrojë vendin që asht shënue prej Drejtoris.

Neni 67. Në çdo flejtore do të varet në mur nji tabellë, e cila do të ketë emnin e mbiemnin e nxanësvet të asaj flejtore.

Neni 68. E hymja e nji nxanësi në një flejtore të huejit âsht e ndalueme.

Të gjithë nxanësit, pa përveçrí, detyrohen të hyjnë në flejtore m' atças, pas urdhnit të dhanun. Dhetë minuta pas të rammes së parë bie edhe nji herë tjetër zilja, e atëhere të gjithë nxanësit duhet të bien në shtrat, e do të pushojë mâ çdo zhurmë e qetësi e madhe do të mbahet nëpër flejtore. Gjithë në këte rregullë edhe do të ngrihen prej shtratit.

Neni 69. Nuk u jipet leja nxanësvet të bien veshë ase t' ecin xveshë nëpër flejtore ase të ngrihen e të dalin jashtë pa pasë ndonji nevojë të madhe. Për çdo nevojë do të lajmërojë ruejtësin a kujdestarin.

Neni 70. U ndalohet nxanësvet të bien mâ vonë ase të ngrihen mâ heret se n' orë të caktueme prej rregullores. Gjithashtu u ndalohet që të këndojnë a të shkruejnë natën, kurse të tjerët flejnë.

Neni 71. Flejtoret do të rrijnë mbyllë gjithë ditën, e për asndonji shkak nuk mund të hyjnë ditën nxanësit nëpër flejtoret.

Neni 72. Internatistët kanë për të pasë për secilën sallë të flejtjes e të ngranit nga nji kujdestar prej shokëvet të tyne. Ky do të zgjidhet prej Drejtoris a Nëndrejtoris, e do t' i tregohet detyra që ka për të pasë si kujdestar.

3) Rregulla nëpër sallët e studimit

Neni 73. Për t'u u-bâmun gati mësimevet do të bahen studime në mëngjes e në mbramjet n' orë të caktueme.

Neni 74. Në kohë të studimevet do të mbahet nji rregullë e nji qetësi e plotë: nxanësit nuk do të largohen nga vëndi i tyne, nuk do të flasin me t' afërmin as nuk do t' i bajnë shënjë njêni tjetrit.

Nxanësit nuk mund të dalin jashtë në kohë të studimit veçse për ndonji nevojë të shquëme lejën e së cillës do t' a japi kujdestari i ngarkuëm me të ruejtunit e studimevet.

Neni 75. Asht e ndaluëme që të këndojnë nxanësit në kohë të studimit libra që nuk janë të shkollës, veçse kur i jipet leja nga ana e mësuësit për të këndue ndonji libër të caktuem. Prandaj nxanësit, në këtë kohë, duhet t' iu shtrohen inspektimit a pyetjevet që mund t' u bajë kujdestari për t' u-siguruë, në qoftë se këta merren me detyrët e tyne shkollore ajo me ndonji tjetër punë.

4) Rregulla në sheti e në të dalun jashtë

Neni 76. Kur dalin me shetitë nxanësit, do të shkojnë me radhë, nga dy e nëpër atê udhë që do t' u shënohet prej Drejtorit a Nëndrejtorit. Vetëm në rasë të veçanta e nën përgiegjësi të vet mund t' a ndrrojë udhën kujdestari që i përciell, porse për këtë ndrrim do të lajmojë mbasandaj Drejtorin a Nëndrejtorin.

Neni 77. Tue kalue nëpër qytet nxanësit do të ecin me rresht; vetëm jashtë qytetit mund t' a prishin radhën, kur t' u thotë eprori që i përciell, por edhe atëherë do të rrijnë pranë tij e nuk do të largohen nga vështrimi i tij.

Neni 78. Nëpër shëtitjet, kur ecet me radhë, asht e ndaluëme të folunit, të qeshunit e të bamunit shenjë me ndonji të huej ose të ndalunit udhës për të folë me ndokënd. Në kohë të shëtitjes nxanësit do të mbajnë qetësi e rregullë të madhe.

Neni 79. Internatistët nuk mund të dalin aspak jashtë Internatit vetëm ; të dalunat jashtë si edhe shëtitjet do të bahen bashkarisht e në ditë të caktuëme prej Drejtoris.

Neni 80. Mund të mirret lejë prej Drejtorit a Nëndrejtorit për të vojtë nxanësit nëpër familjet e tyne (në qoftë se këto nuk janë mâ shumë se dy orë larg) e me ndejë gjithë ditën në këto të kremte :

1. Ditën e motit të ri.
2. Ditët e të dy Bajramevet.
3. Ditët e Pashkëvet.
4. Ditët e Krishndellavet.
5. Ditën e 28 Nandorit, edhe për ndonji rasë të jashtëzakonëshme.

Neni 81. Kanë detyrë të randë familjet apo përfaqësuësit e tyne, që të mos i lanë kurrë vetëm internatistët e t' i dorëzojnë n' Internat në kohën e caktueme.

X. Ndeshkime

Neni 82. Internatistëvet që u shmangen detyravet të tyne edhe prej shkresavet të kësaj Rregullorje veç atyne ndeshkimeve që përmban Rregullorja e nxanësvet mund t' u jipen edhe këto ndëshkime :

1) Qortim i veçantë.

2) Ndalim nga të luetunit për nji herë apo gjith ditën.

3) Ndalim nga të dalunit jashtë e me shëtitë.

4) Dënim me të preme të sillës (mëngjezit) a të njij gjelle.

5) Qortim faqe shokëvet të bamun prej Drejtorit, Nëndrejtorit a kujdestarit.

6) Qortim i madh që do t' u njoftohet familjes e gjithë shokëvet në rend të ditës.

7) Largim i përkohëshëm nga internati.

8) Largim i gjithmonshëm nga Internati.

XI. Pushimet e verës

Neni 83. Internati asht i hapun gjithë vitin. Edhe në kohë të pushimevet të verës kanë të drejtë familjet të lanë fëmijt e tyne n' Internat.

Nëpër Internatet fillore, kur mbeten mbrenda nji farë numri nxanësish mund t' u jipen këtyneve disa mësime me urdhën t' auktoritetit ma të naltë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë Rregullore të pranueme prej Këshillit Ministruer dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Tiranë, më 29 IX-1925.

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
e Zav. M. i P. të Mbrendëshme
P. POGA

Minis. P. Botore e Bulqësis
K. KOTTA

BKSH

Nr. 68.

INTERPRETIM, 2 Tetuer 1925.

I paragrafit të dytë të nenit 47 të Statutit

(i botuem në Fletoren Zyrtare, 8 Tetuer 1925, Nr. 53)

Asamblea Legjislative i ka dërgue së Ndershmes Kryesis Këshillit Ministruer shkresën qi vijon:

Kam nderin me i bamë të njoftun asaj P. T. Kryesije, se të dy Dhomat, në bazë të vendimeve të marruna veçanërisht mbi nevojën e interpretimit të paragrafit të dytë t' art. 47 të Statutit, u mblodhën në formë t' Asamblesë, në mbështetjen e Nenit 141 të Statutit, dhe kështu tue vazhdue në bisedime, mbasi u pa se artikujt 24 e 47 të Statutit janë në lidhje me njani tjetrin dhe janë marrun nga zgjanimi i Statutit të Lushnjes, dhe mbassi u studjuen hollësisht qi procesverbalet qi përmbajnë mënyrën e arsytë e formullimit të dispozitavet t' artikujvet në fjalë, u shque se, paragrafi i dytë i Art. 47, asht plotsues i kuptimit t' Art. 24 në rasë qi parashef paragrafi i parë i art. 47, Asambleja me 42 vota kundra 13, do me thanë me dy të treta votash të gjith misevet që përbajshin mbledhjen e përbashkët, vendosi interpretimin qi mbledhjet e sotshme janë vijim i sesjonit të parë të Qershorit, i cili vijon deri në mbarim të sesjonit, d. m. th. deri me 15 Dhetuer të këtij viti.

2 X-1925 Nr. 3

Nr. 69.

LIGJË, 27 Tetor 1925

Mbi rihapjen e konsullatës së Stambollit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 27 Tetuer 1925, Nr. 61)

Art. 1. – Autorizohet Qeverija me riçel Konsullatën e Stambollit.

Art. 2. – Për të përballun rrogat e personalit të saj, dhe shpenzimet e ndryshme si shkresina, qira, post-telegraf e tjera që prej datës së zbatimit të kësajë ligje deri në mbarim të vitit financjar, i shtohet buxhetit t' ushtrimit financjar 1925-926 të Ministris së P. të Jashtme, nji shumë prej 7.100 (shtatmij e nji qint) Fr. ari.

Art. 3. – Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

Art. 4. – Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i P. të Jashtme — H. VRIONI

Ministri i Financës — S. STAROVA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë ligjën e nalt përmendun e pranueme prej të dy Dhomave legjislative dhe urdhërojmë zbatimin e saj.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë, 27-X-1925.

Kadro Specifikues

Konsullata në Stamboll

Konsulli rrogë	Fr. ari	350 në muej
Konsulli Indemnit	Fr. ari	150 në muej
Sekretari ,,	Fr. ari	300 në muej
Shërbëtori ,,	Fr. ari	100 në muej
Qira	Fr. ari	400 në muej
Shkresina	Fr. ari	50 në muej
Post-telegrame	Fr. ari	40 në muej
Zjarm-dritë	Fr. ari	30 në muej
	Fr. ari	1.420 në muej
për pesë muej	Fr. ari	7.100

Nr. 70.

LIGJË, 14 Nanduer 1925.

Mbi shpërnguljen e qendrës Nën-prefekturës Dukagjinit prej Prekalit në Kodrën e Shëngjergjit

(e botueme në Flet ren Zyrtare, 17 Nanduer 1925 Nr 74)

1. Shpërngulet qendra e Nënprefekturës së Dukagjinit prej Prekalit në Kodër të Shëngjergjit dhe suprimohen krahinat Shal Shosh e Theth t' asajë Nënprefekturë.

2. Rikrijohen krahinat Reç e Luzni të Prefekturës së Dibrës dhe ajo e Kelmendit të Prefekturës së Shkodrës.

Bksh

3. Shpenzimet e krahinavet të rikrijueme do të përballen prej atyne qi suprimohen.

4. Kjo ligjë hynë në fuqi që nga data shpalljes në Fletoren Zyrtare.

5. Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj llgjë.

Ministri i Drejtësis
M. TUTULANI

Ministri i P. të Mbrendshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë të pranuëme prej të dy trupave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e sajë.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë, me 14-XI-1925.

Nr. 71.

SHTOJCË-LIGJE, 20 Nanduer 1925

Për zgjedhjen e misave të Dhomës së Deputetve

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Nanduer 1925, Nr. 78)

Art. 1. — Në rasë qi për ç'do shkak mbetet vakant vendi i Deputetit bahen zgjedhje syplimentare me ata zgjedhës të dytë por tue u rujtun gjith formalitetet e zgjedhjeve të pergjithshme.

Art. 2. — Kjo ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes.

Art. 3. — Ministrija e Drejtësis dhe ajo e P. të Mbrendshme ngarkohen me zbatimin e kësaj shtojcë-ligje.

Zav. Ministri i Drejtësis
Ministri i P. të Jashtme
H. VRIJONI

Zav. Ministri i P. të Mbrendshme
Ministri P. Botore e Bujqësis
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej trupave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e sajë.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë, 20-XI-1925

Nr. 72.

LIGJË, 3 Nanduer 1925

Mbi pranimin e telegramave përbrenda qytetit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Nanduer, 1925 Nr. 80)

1. Munden me u pranuem telegrama private për mbrenda qytetit.

2. Taksa e telegramave private për mbrenda qytetit asht 50% ma poshtë se ajo e telegramave përjashta Qytetit.

3. Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes.

4. Ministrija e P. Botore e Bujqësis dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Drejtësis
M. TUTULANI

Ministri P. Botore e Bujqësis
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë të pranuem prej të dy Dhomave Legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e tij.

Tiranë, me 3-XI-925

Kryetari i Repupblikës
A. ZOGU

Nr. 73.

LIGJË, 3 Nanduer 1925.

Mbi pranimin e telegramave letër të natës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Nanduer 1925, Nr. 80)

Mundet m' u pranué forma e telegramave letre të natës mbrenda Shqipnijet.

I. Telegramat letre të natës duhet me pasë nji minimum prej 40 fjalësh.

II. Telegrama letrë të natës taksohen prej Fr. ari 1.50 deri në 40 fjalë dhe me qintim 1/2 për fjalë tej 50 fjalve,

III. Telegramat letre të natës pranohen prej orës 18 deri në 24 dhe këmbehen ndërmjet zyrave qi kanë shërbim të vazhdueshëm ose deri në mes natë.

IV. Telegrama letre të natës i dorzohen marrësve si telegramat ordinare.

V. Kjo ligjë hynë në fuqi që nga dita e shpalljes.

VI. Ministrija e P. Botore e Bujqësis dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Drejtësis — M. TUTULANI

Ministri i P. Botore e Bujqësis — MUSA JUKA

Ministri i Financavet — S. STAROVA

Na, Kryetari i Reppublikës Shqiptare, pëlqejmë ligjin e sipërmë mbi pranimin e telegramave letre të natës pranue prej të dy Dhomave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e tij.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Nr. 74.

LIGJË, 3 Nanduer 1925.

Mbi pranimin e telegramave të natës me drejtime të shumta

(e botueme në Fletoren Zyrtare 24 Nanduer 1925 N. 80)

I. Mundet m' u pranue forma e telegramave të natës me drejtime të shkurtna ose të marrëveshtuna dhe për mbrenda Shqipnis.

II. Taksa e drejtimeve të shkurtuna ose të marrëveshtuna si mbrenda dhe jashtë, asht fr. ari 40 për nji vjet, fr. ari 22,50 për gjashtë muej fr. ari 4 për nji muej.

III. Kjo ligjë hynë në fuqi që nga dita e shpalljes.

VI. Ministrija e P. Botore e Bujqësis dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Drejtësis — M. TUTULANI

Ministri i P. Botore e Bujqësis — MUSA JUKA

Ministri i Financave — S. STAROVA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej të dy Dhomave Legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e tij.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë me 3-XI-925

AQSh

Nr. 75.

LIGJË, 3 Nanduer 1925.

Mbi pranimin e telegramave diferueme drejtue regjimit ekstra Europen (vonüme)

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Nanduer 1925, Nr. 80)

I. — Munden m' u pranuë telegrama të diferuëme (vonuëme) drejtuë viseve të regjimit ekstra europen.

II. — Taksa e telegramave të diferuëme, asht gjymsa e taksës së telegramavet ordinare.

III. — Kjo Ligjë hynë në fuqië që nga dita e shpalljes.

IV. — Ministrija e P. Botore e Bulqësiës dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

Ministri i Drejtësiës
M. TUTULANI

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
M. JUKA

Ministri i Financavet
SUL. STAROVA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë pranuëm prej të dy Dhomave Legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e tij.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë, me 3-XI-1925

Nr. 76.

KONVENTË, 11 Nëndor 1925.

Marrëveshtje radio telegrafike ndërkombëtare bamun ndërmjet

L' Allemagne et les protectorats allemands, les Etats-Unis d' Amérique et les Possessions des Etats-Unis d' Amérique la République Argentine, l' Autriche, la Hongrie la Bosnie-Herzegovine, la Belgique, le Congo belge, le Bresil, la Bulgarie, le Chili, le Danemark, l' Egypte, l' Espagne et les Colonies espagnoles, la France et l' Algerie, l' Afrique occidentale française, l' Afrique équatoriale française, l'Indo-Chine, Madagascar, la Tunisie, la Grande-Bretagne et diverses Colonies et Protectorats britanniques, l'Union de l'Afrique du Sud, la Fédération australienne, le Canada, les Indes britanniques, la Nouvelle-Zelande, la Grèce, l' Italie et les Colonies italiennes, le Japon et Chosen, Formose le Sakhalin japonais et le territoire louê de Kwanroung

le Maroc, Monaco, la Norvège, les Pays-Bas, les Indes néerlandaises et la Colonie de Curaçao, la Perse, le Portugal et les Colonies portugaises, la Roumanie, la Russie et les Possessions et Protectorats russes, la République de Saint-Marin, le Siam, la Suéde, la Turquie et l' Uruguay.

Të nënshkruemit, delegatët plotfuqi të qeverive të vendeve nalt diftueme, tue u mbledhun në konferencë të Londrës, kanë me nji akord të përbashkët dhe me reservë të retifikimit, vendos marrëveshtjen qi vijon.

Art. 1. — Palët e nalta kontraktuëse lidhën për zbatim të dispozitave të kësaj marrëveshtje në gjithë Stacionet radio telegrafike (stacione toksore dhe stacione mbi vapor) qi janë vumë ose çfrytuëm prej palëve kontraktuëse dhe të hapun shërbimit të korrispondencës botore ndërmjet tokës e të vaporave në det.

Këto lidhen, prapë me detyruë zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshtje edhe e stacionevet e çfrytimeve private të autorizuëme qoftë për me ngref o me çfrytuë stacione toksore radio telegrafike hapun për korrispondencë botore nërmjet tokës e të vaporave në det, qoftë me ngref ose me çfrytue stacione radio telegrafike hapun ose jo shërbimit të korrispondencës botore sipër vaporave qi mbajnë flamurët e tyne.

Art. 2. — Quhet stacion anëdetse (cotiere) ç' do stacion radio telegrafik ngrefun mbi tokë të qëndruëshme ose mbi vapora qi qindrojnë për me i përdoruë për këmbim të korrispondencës me vaporat në det.

Ç' do stacion radio telegrafik i ngrefun mbi nji vapor në lëvizje quhet "Stacion de bord".

Art. 3. — Stacionet toksore (cotieres) dhe stacionet e vaporeve (de bord) janë të detyruëme me këmbyë me njena tjatrën radio telegramat pa daësi sistemi radio telegrafik përdorun prej këtyne stacioneve.

Ç' do stasion vapori (de bord) asht i detyruëm me këmbyë radio telegramat me ç' do tjatër stacion të vaporit pa daësi të sistemit radio telegrafik përdorun prej tyne.

Me gjith kët, për mos me ndaluë përparimet shentifike dispozitat e këtij artikulli nuk ndalojnë përdorimin e qëllueshëm të nji sistemi radio telegrafike qi s' mundet të komunikojë me stacionet e sistemave tjera mjaft qi kjo mos mundje të jetë e rjedhun prej natyrës ndryëshme të atij sistemi dhe ajo mos të

jetë efekti i maqinave të përdoruna për me ndaluë nërkomunikimin (komunikimet qi bajnë stacionet e tjera me njena tjatrën).

Art. 4. – Me gjith dispozitat e art. 3 nji stacion mundet me u-përdoruë për nji shërbim të korrispondencës botore të kufizuëme caktuë prej qëllimit të korrispondencës ose prej cirkonstancave të pa mvaruna nga sistemi i përdorun.

Art. 5. – Cila-do prej palëve kontraktuëse detyrohet me lidh stacionet e tokës me rjeta lelegrafike me anë të fillave të posaçme ose, me marrë masa të tjera për me siguruë nji këmbim të shpejtë ndërmjet stacioneve radio telegrafike të tokës dhe Zyrat telegrafike.

Art. 6. – Palët e nalta kontraktuëse napin njoftim njena tjatrës për emnat e stacioneve toksore dhe të stacioneve të vaporeve parapamun n' art. 1 si dhe për gjith shpiegimet për me lehtësuë dhe me shpejtuë këmbimin radio telegrafike qi asht çkoqitun në rregullore.

Art. 7. – Cila-do prej palëve kontraktuëse reservon të drejtën me përshkruë ose me pranuë qi në stacionet e përmenduna n' art. 1 pamvarësisht prej installacionit shenjat e të cilës janë çpallun si mbas art. 6 dispozita të tjera të jenë caktuë për çfrytim të radio telegrafës të posaçme pa qi hollësinat e tyne të çpallen.

Art. 8. – Çfrytimi i stacioneve radio telegrafik asht e organizuëme sa asht e mundun, në mëndyrë qi mos të trubullojë shërbimin e stacioneve të tjera radio telegrafike.

Art. 9. – Stacionet radio telegrafike janë të detyruëme me digjuë me preferencë të preme thirje e rezikut, cila-do të jetë burimi i tyne, me i përgjegjë atyne thirjeve dhe me i u dhanë vazhdimin qi kërkojnë.

Art. 10. – Taksa e nji radio telegrami përmban, si mbas rastit.

1. *a)* Taksën toksore q' i përket stacionit taksore (cotiere).

(b) Taksën e vaporit (taxe de bord) q'i përket stacionit të vaporit.

2. Taksën për transmetim mbi vijat telegrafike llogaritun si mbas rregullave ordinare.

3. Taksat transite të stacioneve toksore e të vaporave nërmjetse dhe taksat q' i përkasin shërbimeve të posaçme të kërkuëme prej dërguësve.

Sasia e taksës së tokës asht e nënëvuëme pëlqimit të Qeveris prej të cilës mvaret stacioni i tokës; ajo e taksës të vaporit, në pëlqim të Qeveris prej të cilës mvaret vapori.

Art. 11. – Dispozitat e kësaj marrëveshtjeje janë të plotësuëme me nji rregullore qi ka po atë vlerë dhe hyn në zbatim n' atë kohë qi hyn marrëveshtja.

Përshkrimet e kësaj marrëveshtjeje dhe të rregullores q'i përket munden në ç' do kohë me u ndryshuë me nji akord të përbashkët ndërmjet palëve të nalta kontraktuëse. Konferenca e delegatëve plotfuqi për me ndryshuë marrëveshtjen dhe rregulloren do të mbahen periodikisht; ç' do konferencë ka me caktuë ajo vetë vendin dhe kohën e mbledhjes së ardhshme.

Art. 12. – Këto konferenca përmbahen prej delegatësh të Qeverive të vëndeve kontraktuëse.

Në vendime ç' do vënd ose shtet ka të drejtë vetëm për një votë.

Në qoftë se nji Qeveri pranon (adhesion) marrëveshtjen për kolonit e saj, pasunit ose të mbrojtunat, konferencat e mapastajme munden me venduë qi, e gjitha ose nji pjesë e koloniës pasuniës ose të mbrojtunavet asht konsideruë si me kjen formuës të nji vëndi për zbatim të paragrafit të parë, në ç' do rast numëri i votave qi ka nji Qeveri tuë numëruë edhe kolonit pasunit dhe të mbrojtunat, nuk mundet me kaluë gjashtë. Konsiderohen si me kjen formuës të nji vëndi për zbatim të këtij artikulli.

„Le Caméroun; Le Togo; Les Protectorats allemands du Pacifique L'Alaska; Hawai et les autres possessions américaines de la Polynesie; Les Iles Philippines; Porto-Rico et les possessions americaines dans les Antilles; Le Zone de Canal de Panama; Le Congo belge, Le Colonie espagnole du Golfe de Guinée; L'Afrique occidentale française; L'Afrique équatoriale française; L'Indo-Chine; Madagascar; Le Tunisie; L' Union de l'Afrique du Sud, le Fédération australienne; Le Canada; Les Indes britanniques; Le Somalie Italienne, Chosen, Formose, le Sakhalin japonais et le territoire loué de Kwantoung; Les Indes néerlandaises; La Colonie de Curacco; L' Afrique occidentale portugaise; L' Afrique orientale portuegaise et les possessions portugaises asiatiques; L'Asie centrale russe (littoral de la Mer Caspienne); Boukhara; Khiva; La Sibérie occidentale (littoral de l' Océan Glacial); La Siberie orientale (littoral de l' Océan Pacifique).

Art. 13. – Zyra nërkombëtare e bashkimit telegrafik asht e ngarkuëme me mbledh, me radhuë e me çpall shpiegimet e

ç' do farë llojit q' i përkasin radio telegrafit, me studjue kërkimet e modifikimet të marrëveshtjes dhe rregullores, me çpall ndryshimet e përdoruna dhe, përgjithsisht me u përkujdesuë në gjithë punërat Administrative në interesë të radio telegrafis ndërkombëtare.

Shpenzimet e kësaj zyre janë në ngarkesa të gjithë vëndeve kontraktuëse.

Art. 14. — Çila do prej palëve kontraktuëse reservon të drejtën me caktuë konditat me të cillat pranon radio telegrama të duhun dhe t' ardhuna në nji stacion, qoftë stacion vapori qoftë toksore, qi nuk asht e nënvuëme dispozitave të kësai Marrëveshtjeje.

Në qoftë se nji radio telegramë pranohet taksat ordinare duhen me i u zbatuë.

Nepet vijim ç' do radio telegrami të dalun prej nji stacionit të vaporit dhe marrim prej nji stacioni toksor të nji vëndi kontraktuës ose me pranuë në tranzit për admintstratën e nji vendi kontraktuës.

Nepet vijim prapë ç' do radio telegrami drejtuë nji vapori, në qoftë se administrata e nji vëndi kontraktuës e ka pranuë në tranzit prej nji vëndi jo kontraktuës nën reservë të drejtës stacionit të tokës me e refuzuë transmetimin nji stacionit të vaporit e nji vëndit jo kontraktuës.

Art. 15. — Dispozitat e art. 8 e 9 të kësaj marrëveshtjeje zbatohen edhe installacioneve radio telegrafike të tjera, përveç atyne të përshkruëme n' art. 1.

Art. 16. — Qeverit qi nuk kanë marrë pjesë në këtë marrëveshtje pranohen me hyë pas kërkimit të tyne (adheter). Këjo hyrje njoftohet me vija diplomatike asaj qeveri kontraktuëse pranë të cilës asht mbledh konferenca e fundit dhe prej asaj gjithë të tjerave.

Ajo me gjith të drejtat e konditave të kësaj marrëveshtje dhe pranohet me gjithë avantazhet e përshkruëme aty.

Pranimi i marrëveshtjes i nji Qeveris ose nji vendi qi ka kolonira, pasunira ose të mbrojtunavet nuk përmban pranimin e kolonivet sa të pasunive dhe të mbrojtunavet të saj, veç nji deklaratës së Qeveris për këtë punë shumë e kolonive, pasunive e të mbrojtunave ose cila do prej tyne veçanërisht mundet me formuë objektin e nji pranimi të veçantë ose të nji denonciationit të daëm në konditat e parapame në këtë art. dhe në art. 22.

Art. 17. — Dispozitat e artikullave 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 11, 12, e 17 të marrëveshtjes telegrafike ndërkombëtare të St. Petersbourg me 10—22 Korrik 1875 i zbatohen edhe radio telegrafis ndërkombëtare.

Art. 18. — Në rast mos marrëveshtjes ndërmjet dy ose ma shumë qeverive kontraktuëse për interpretim ose për zbatim të kësaj marrëveshtjes ose të rregullores parapa n' art. 11 çështje me akord të përbashkëve mundet me i u nënëvuë gjykimet arbitrare. Në kët rast cila do prej Qeverive e mos marrëveshtje zgjedh nji tjatër të pa interesuëme në çështje. Vendimi i arbitrave merret në shumicë të votave absolute.

Në rast të damunit të votave arbitrat zgjedhin, për me çkoqit çështjen, nji tjetër Qeveri kontraktuëse të pa interesuëme n' atë mos marrëveshtje. Në rast mos dakordit për me ba kët zgjedhje ç' do arbitër propozon nji Qeveri kontraktuëse të pa interesuëme; hiqet shorti ndërmjet Qeverive të propozuëme. Të hequnit e shortit i përket Qeverisë pranë të cilës ndodhet zyra ndërkombëtare e parapame n' art. 13.

Art. 19. — Palët e nalta kontraktuëse detyrohen me marrë ose me propozuë legislaturave të tyne masat e nevojshme për me siguruë zbatimin e kësaj marrëveshtjeje.

Art. 20. — Palët e nalta kontraktuëse i komunikojnë shoqi shoqit ligjat qi kanë me u-vuë ose qi janë vuë në vëndin e tyne për sa përkasin këtë marrëveshtje.

Art. 21. — Palët e nalta kontraktuëse ruajnë të drejtën e tyne të plotë për instalimet radio telegrafike jo të parapame n' art. 1 dhe veçanërisht installimet navale ushtarake si edhe stacionet qi sigurojnë komunikacionet ndërmjet dy vëndeve të caktuëme. Gjith këto installime dhe stacione mbeten të nënëvuëme vetëm detyrime parapa n'art. 8, 9 të kësaj marrëveshtje.

Me gjith kët, kur këto instalime dhe stacione bajnë nji këmbim korrispondencash botore detare ato konformohen për zbatim të këtij shërbimi përshkrimeve të rregullores për sa përket mënyrën e transmetimit dhe kontabilitetin.

Në qoftë se nga ana tjatër stacione toksore sigurojnë veç korrispondencën botore me vapora edhe komunikacione nërmjet vendeve të caktuëme, ato nuk janë të nënvuëme, për këtë veprim të fundit dispozitave të kësaj marrëveshtje, nën reservë të observacioneve, të artikullave 8, 9.

Bashkë me këtë, stacionet e qindrnëshme qi bajnë korrispondenca nërmjet tokës dhe tokët nuk duhet të refuzojnë këmbimin e radio telegramave me nji tjatër stacion të qendruëshmë për shkak të sistemit të përdorun prej këtij të fundit. Me gjith kët liria e ç' do shteti ose vendi mbet e plotë për sa përket organisacionin e nji shërbimi të korrispondencës ndërmjet vendeve të qendruëshme dhe caktimin e korrispondencës për t' u ba me stacionet qi kanë këtë shërbim.

Art. 22. — Këjo marrëveshtje ka me u vuë në zbatim ç'prej 1 Korrik 1913 dhe ka me mbet në fuqi për nji kohë të pa caktuëme e deri në mbarim të nji vjeti ç' prej ditës kur ka m' u ba denonciacioni i saj.

Denonciacioni nuk bije asnji efektive ose për qeverin n' emën të së cilës asht ba. Për palët e tjera kontraktuëse marrëveshtjes mbet gjithmonë në fuqi.

Art. 23. — Këjo marrëveshtje ka m' u ratifikuë dhe ratifikimet kanë m' u depozituë në Londrë brenda kohës ma të shkurtën qi të jet e mundun.

Në rast qi nji ose ma prej palëve të nalta kontraktuëse nuk ka me e ratifikuë marrëveshtjen, këjo mbetet në fuqi për ato qi e ratifikuenë.

Në besim të ekahit, fuqiplotësit respektif kanë nënëshkruë marrëveshtjen në nji kopje qi ka me mbet e depozituëme n'arkivat e Qeveris Britanike dhe prej të cilës nji kopje ka me i u dhanë gjith palëve.

Bamun në Londër, me 5 Korrik 1925.

Vazhdojnë nënshkrimet

Ministri i P. Botore e Bulqësis e zav. Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Zav. Ministri i Drejtësis
H. VRIONI

Ministri i P. Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financavet
SUL STAROVA

Na, Kryetari i Republikës, pëlqejmë këtë konventë të pranueme prej dhomave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 11-XI-1925.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Nr. 77.

LIGJË, 20 Nëndor 1925.

Mbi përjashtimin e prodhimeve të tokave kufitare

1. Tue filluem qysh prej 1 të Kallnorit 1925 përjashtohen nga tagri doganuer prodhimet e tokavet të katundeve kufijtare qi u kanë ngelë tokat jashtë kufinit të Shqipnis e jo ma përtej se 5 km.

Pronsija e tokevet të këtyne prodhimeve do të vertetohet me titra zyrtare ose me dishmi të pleqsis së Katundevet.

2. Ministrija e Financavet ngarkohet për zbatimin e kësaj ligje.

Zav. Ministri i Drejtësis
H. VRIONI

Ministri i Financavet
SUL STAROVA

Na, Kryetari i Republikës, pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej Dhomave Legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë, 20-Nanduer 925

Nr. 78.

LIGJË, 20 Nëndor 1925.

Mbi shtimin e nji kredis për festimin e ditës të 28 Nandorit

1. Për të përballuem shpenzimet e ceremonisë së ditës të 28 Nanduer i akordohet budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme nji shumë prej 10.000 fr. ari dhe buxhetit të Ministris së P. të Jashtme 5000 fr. ari.

2. Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

3. Ministrija e P. të Mbrendëshme, Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financave ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financave
S. STAROVA

Zav. Ministri i P. Mbrendshme
Ministri i P. Botore e Bujqsis
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej trupave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë, 20-Nanduer-1925

AQSH

Nr. 79.

LIGJË, 22 Nëndor 1925.

Mbi transferim kreditash në budgetin e Ministris së P. Botore e Bujqësisë

1. Për mos me u ndalue punimet Botore të qarkeve, kap. 8 mbajtje udha e ura, të buxhetit të Ministris së P. Botore e Bujqësis qi asht në të sosun, i mvishet nji shume prej 200.000 fr. ari tue u transferuem nga kap. 17 Ndertesa udhash e urash, e lanun nën dispozicion në Gjinokastër.

2. Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

3. Ministrija e P. Botore e Bujqësis dhe ajo e Financave ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Ministri i Financave — S. STAROVA

Ministri i P. Botore e Bujqësis — MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës. pëlqejmë ligjën e nalt-përmendun pranue prej dhomave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë, 22-XI-1925.

Nr. 80.

LIGJË, 22 Nëndor 1925.

Mbi transferim fondesh

Art. I. Autorizohet Ministrija e Financavet me paksuem prej buxhetit të vet të këtij vjeti fr. ari 32.000 (tridhjet e dymijë) nga kap. 38 „Shpenzime për nxjerrje e bartje krype" në kapitullin si vijon :

Kap. 9. Art. Rrogë	Fr. ari 3.000
Kap. 12. Art. Udhtim e djete	Fr. ari 5.500
Kap. 16. Art. Të parapame.	Fr. ari 3.500
Kap. 21. Art. Qira.	Fr. ari 2.500
Kap. 22. Art. Udhtim e djete	Fr. ari 1.500
Kap. 37. Art. Aggio $5^0/_0$ mbi shitje pullash . . .	Fr. ari 7.000
Kap. 42. Art. Dam Arke.	Fr. ari 5.000
Kap. 44. Art. Këthim taksash	Fr. ari 4.000
Gjithësejt	Fr. ari 32.000

Art. 2. Kjo ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes.

Art. 3. Për zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministrija e Financavet.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pranojmë këtë ligjë t' aprovueme prej trupave legjislativ dhe dekretojmë zbatimin e saj.

A. ZOGU
Kretari i Republikës

Tiranë 22 XII 925

Ministri i Financave
S. STAROVA

Nr. 81.

RREGULLORE, 4 Nëndor 1925.

E degave të Kryqit të Kuq

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Nanduer, 1925 Nr. 80)

I. — Në ç' do vend që ndodhet nji Bashki, ka me u formue në godinën e Bashkis nji degë e Kryqit të Kuq Shqiptar.

II. — Për administrimin dhe drejtimin e degavet do të emnohet nga qendra e Kryqit të Kuq Shqiptar, krytari i Bashkis ose nji nga këshilltarët ose nji person tjetër qi ka kapacitet të veçantë për drejtimin e kësaj dege.

III. Kryetari i degës merr për antar mjekun e Bashkis bashkë me nji mjek tietër civil dhe nji nga antarët e Bashkis.

IV. Detyrat e personelit të degavet janë honorere (pa pagesë) dhe dekretohen nga Presidenti i Kryqit të Kuq për nji kohë tri vjetsh.

V. — Detyrat e degave janë:

a) Rregjistrimi i antarëve në libra që do të dërgojë Qendra e Kryqit të Kuq mbas klasifikimeve që parashef Statuti.

b) Të përhapunit e qëllimeve të Kryqit të Kuq tue shpërdamun rozeta, afishe e sende të tjera që do të dërgohen nga Qendra.

c) Raportim Qendrës për mbi aktivitetin e degës krye ç' do mueji për ç' do pikpamje financjare.

ç) Raportim mbi gjendjen hygjenike të vendit dhe mënyrat e përmirësimit të sajë.

d) Organizim konferencash mjeksore, sosiale etj.

VI. — Ç'do Drejtor asht i përgjegjëshëm moralisht dhe materialisht përpara Qendrës së Kryqit të Kuq. Energjija edhe zelli

i tij për mirëvajtjen e degës do të shpërblehet me medale të veçanta që do t' i dhurohen nga Qendra e Kryqit të Kuq të shoqënueme me nji akt zyrtar ku do të çfaqet mirënjohtsia e Qendrës për veprat e tija.

VII. — Fotografit e kryetarve të degavet së bashku me listën e antarëve do të stolisin sallën e posaçme të Qendrës të Kryqit të Kuq.

VIII. — Nji nga qëllimet ma të shejta të degavet do të jet dhe krijimi i degës „Gruaja Shqiptare" në vendet ku do të shifet e nevojëshme dhe arësyeshme po vetëm me qëllime njerzore, bamirëse e filantropike.

IX. — Zonjat mund të shkruhen drejt për drejt antare me veprimet qi mund të bajnë me anën e ndihmave të punë-dorës të qepunit e të premunit.

X. — Ç' do degë do të ket nji vulë të degës të Kryqit të Kuq me emnin e vendit të cilat do të dërgohen nga Qendra.

Ministri i Dreitësis
M. TUTULANI

Ministri i P. të Jashtëme
H. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. Botore e Buiqësis e Zav. Ministri P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 82.

RREGULLORE, 24 Nëndor 1925.

Mbi formimin e kompanievet puntorësh për të kryemit e punimeve botore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 25 Nanduer 1925, N. 81)

§ 1. — Ministria e P. Botore e Bujqësis si pas nevojës dhe gjendjes formon „Kompanira Puntorësh" me nji fuqi 170 vetash.

§ 2. Sejcila kompani puntorësh, përbahet prej :

1) Nji Kryetar Kompanijet, me gradën e nji Kryekond. (Aspirant)

1) Sekretar Kompanijet, me gradën e nji Konduktorit (Kapter)

8) Kryetar Grupesh me gradën e nji Konduktori (Kapter)

§ 3. Kryetari i Kompanis, me Kompanin e ti, për sa i përket teknikës dhe dishiplinës i nenvehet Kryetarit të Zyrës së P. Bo-

tore të Qarkut ku shërbejnë. Ky i fundit asht përgjegjës për të gjith punimet dhe ngjarjet e Kompanis.

§ 4. — Sejcila Kompani dahet në 8 grupe punimesh, me nga 20 vetë të cillët si pas nevojës kan për t' u nda;

a) 3 Grupe për punime dheut
b) 1 Grup për punime urash
c) 1 Grup për punime shosehit
ç) 1 Grup për punime në të ngrehunit e hekurudhës.
d) 1 Grup për punime në të shtërnguemit e shinave.
e) 1 Grup për shërbimin n' uzina dhe ndihmësa (reparim veglash, këpuctar, rroba qepës, gjellbas, kasap, roje, shërbëtor, shëndetsije etj.)

Grupet *a*, *c*, *d*, përbahen prej puntorësh ordiner, dhe kan për t' u stërvitur për herë dhe veçanërisht për shërbimin e degës së tyne.

Grupet *b*, *e*, përbahen prej profesionistash dhe prej puntorësh ordiner qi kan me shërbye si ndihmësa.

Çë do grupit i jepet nji çadër e madhe dhe nji çadër e vogël, si dhe nji armë.

Çdo kompani ka me patur nji arkë me mjete shëndetsijet të përkatëshmë.

§ 5. — Zyra e P. Botore e përkatëshme, disponon për herë mbi mënyrën e përdorimit të sejcillit grup punimit, d. m. th. kurdoherë, si pas nevojës qi të çfaqet mund të përdorni grupet edhe për nji tjetër punim për veç atë që janë shenjue. Për shëmbëll, të gjith grupet njiherit mund të përdoren për punime dheut, ose për punime forcimit etj. etj.

§ 6. — Ç' do person hyën vullndetisht në shërbim, por asht i detyruëm me ndejun në shërbim të pakëtën nji (1) vjetë, për çë ka do të vërtetojnë me nji shkresë me nënshkrimin e tij se i nënvehet në të gjitha mëndyrët e organizimit të shërbimit dhe do të kryejnë çë do shërbim e punim që ka për t' ju urdhënue nga superjorët e tij.

§ 7 Me të kryemit në shërbim, sejcillit i jepet nji mblojë (batanie) e 1 tas ngranjet, dhe sejcillit puntuer nga 1 par petka punet e 1 par opanga. Pas gjasht muejsh sejcillit puntuer i jepet nji par petka punet të tjera, dhe krye tre muejsh nga nji par opanga. Veç kësaj sejcillit puntuer i jepet nga nji sherit të kuqe krahit; dhe sejcilli, konduktor Sekretar, dhe Kryekonduktor nga nji sherit të bardhë krahit mbi të cillin ka për t'u she-

njue dhe numri i përkatëshëm i kompaniës. Gjith' ashtu dhe personali i Shëndetësiës ka me patur nji sherit të bardhë krahit me kryq të kuq, dhe me numër të kompaniës.

Sharzhistave s' ju epen petka as opanga por kan me patur çadra të veçanta, d. m. th. kan me bamë veçmas prej puntorëvet.

§ 8. — Sejcillit puntuer si dhe Sharzhist ka me ju pague nji rrogë mujore prej 70 Frang ari, rrogë e cilla ka për t' ju pague në fund të çë do muejit nga ana e Ministriës së P. Botore e Bujqësiës, prej kësaj rrogë, çë do puntori ose Sharzhistit kan për t' ju ndalue nga 30 franga ari në muej, për ushqim, banim, dritë, zjarm dhe për ndreqjen e veshjes e të mbathjes. Përkujdesimi i të tjerave sendeve të nevojshme dhe për lamje e qepje të petkave të levereve, asht çeshtje qi i përket sejcillit vetë.

Përmbi rrogë mujore, Sharzhistat marrin këto shtesa:

Kryepuntori, shtesë mujore Fr. ari 30.

Profesjonisti shtesë mujore Fr. ari 60.

Konduktori shtesë mujore Fr. ari 70.

Sekretari shtesë mujore Fr. ari 90.

Kryekonduktori shtesë mujore Fr. ari 150.

§ 9. — Ushqimi përbahet prej:

Kafes së zezë në mëngjes, supë me mish në drekë dhe supë ose djathë, ullij etj. në darkë, si dhe nga 1 bukë, 1 kg. në ditë.

§ 10. — Përgjithësisht banimi ka me kenë nër çadra.

Nga nji herë provizorisht kan për të banue dhe nër baraka ose shpija. Për fjetje kan për t' ju dhanë shtretën hekri ose kan me ju ba prej druni.

§ 11. — Për humbje në çë do mënyrë, të ndonji veglës ose plaçkash, si dhe për prishje ose humbjen e teshave dhe të këpucëvet para kohet dhe për faj të puntorit; shkaktari ka për t'u gjobitë tue i zbritë nga rroga mujore e tia thjesht vleftjen që ka kushtue vedit vegla ose plaçka e humbun jose e prishun para kohet.

§ 12. — Orari dituer i punimit të jetë, tue fillue punën 1 orë pas që të ken lé djelli, dhe ndalimi i punës 1 orë para prendimit të diellit, me nji pushim 1 oret në kohën e drekës. Si ditë pushimit caktohet e Ejtja, në të cillën ditë duhet që sejcilli të lajnë, të pastrojnë dhe të ndreqin leveret e teshat e tia.

§ 13. — Si leje pushimit vjetore, caktohen 14 ditë për pun-

torë dhe 21 ditë për Sharzhistat. Leja në fjalë do të merret minimum dy herësh, për çka në kurr nji mëndyrë si duhet qi prej nji Kompaniës të gjinden njiherit në leje ma tepër se 8 vetë.

§ 14. – Sekretari i sejcillës Kompani kryen punimet administrative të zakonshme.

§ 15. – Kryetarët e grupeve janë të detyruem me i paraqitë Kryetarit të Kompaniës, dita me ditë raporta eksakte mbi përdorimin e puntorëvet dhe mbi punimet e bame. Kryetar' i kompaniës mandej duhet t' i përmbledhin dita me ditë raportat e grupeve të gjitha në nji raportë dhe t' ja paraqesin Zyrës së P. Botore të përkatëshme, dhe kjo e fundit, do t' ja parashtrojë Ministriës së P. Botore javë më javë me raportë javore telegrafike, dhe për çë do muëj, me raportë mujore, për sejcillin kompanië veçmas.

§ 16. – Sejcilli puntuer dhe sharzhist, që në të kryemit e detyrës ka me rrëfye zellë, energjie dhe zotësie në drejtimin e punës, ka për t' u gradue.

§ 17. – Mbas 1 vjetet shërbim nga puntorët ata që kan me rrëfyë energjië të vërtetë në të kryëmit e punimeve, ka dy për grupet jashtëzakonisht mund të gradohen si Kryepuntorë, dhe kjo, si pas propozimit që Zyra e P. Botore e përkatëshme ka për t' i ba Ministris së P. Botore e Bujqësis Kryepuntorvet në fjalë ka me ju akordue nji shtesë rroget mujore prej 30 franga ari.

§ 18. – Atyne puntorëvet, të cillët pas që të ken krye detyrën e tyne mirë, d. m. th. pas që të ken krye nji vjetë shërbim si pas detyrës së marrun, dhe të ken rrëfye zellë në të kryemit e punimeve e dishrojnë me vazhdue edhe nji vjetë tjetër në shërbim, (për çka duhet të detyrohet rishtas me shkrim) ka për t' ju dhanë nji shpërblim vjetuer 20 franga ari.

§ 19. – Çë do mos-kujdesim plogësie kundravajtje ose çë do lloji tjetër pengimi që ka për të rrëfye personali në të kryemit e detyrës ka për t' u ndeshkue në kët mëndyrë:

Për të parën herë tue ju hjekë vrejtje me shkresë;

Për të dytën herë tue e gjobitun me 1–15 franga ari;

Për të tretën herë tue e gjobitun me 16–35 franga ari.

Kurse nji puntusr ose sharzhist t' jetë ndeshkue deri në 6 herë në mëndyrat e sipërtregueme, si pas propozimit për t'u ba në Ministriën e P. Botore e bujqësiës, duke i zbritun nji rrogë mujore, ka për t' u pushue me nji herë nga puna.

§ 20. – Nji puntuer ose sharzhist s' mund të dalin me kurr nji mëndyrë nga puna para afatit të nji vjetës, pa i paraqitun Ministriës së P. Botore e Bujqësiës nji dishmi të Doktorit me të cillën të vërtetohet mos muejtja e vazhdimit të ti në detyrë.

§ 21. – Në rasë qi nji puntuer ose sharzhist për arsye të tregue n' art. 20 të kësaj rregullore, largohet nga puna, asht i detyruem me dorëzue rregullisht të gjith veglat e plaçkat qi i janë kenë dhanë në fillimin ose në vijimin e shërbimit, në rasë të kundërt, për veglat ose plaçkat e mangëta ka për t' ju zbritë thjesht vleftja, nga rroga.

§ 22. – Kuerse ndonji largohet rregullisht nga puna, dhe ka krye detyrën si çë lypset ka për t' ju dhanë nji dishmi mirë-shërbimit mbi zotsin etj. të tia.

§ 23. – Për të gjith punimet, si dhe për marrjen në dorëzim dhe kthimin rregullisht të gjith veglave, almisave, janë përgjegjës sharzhistat dhe për fund edhe Zyra e P. Botore e përkatëshme.

§ 24. – Marrja në shërbim, dhe largimi nga puna e personalit te Kompanis, bahet nga Ministria e P. Botore e Bujqësis.

Nr. 83.

LIGJË, 3 Dhetuer 1925.

Mbi 8000 fr. ari kredi për Zyrën e Shtypit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Dhetuer, 1925 N. 85)

I. – Për të përballuar shpenzimet e propagandës nëpër fletore dhe për taksat telegrafike të jashtme, i shtohen Kap. 3. të budgetit t' ushtrimit financjar 2925 1926 të Ministris së P. të Mbrendshme nji kredi prej Fr. ari 8.000.

II. — Ministrija e P. të Mbrendshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin kësaj ligje.

III. – Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pelqejmë këtë ligjë të pranueme prej trupave legjislative dhe urdhnojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 3 XII 25 A. ZOGU

Zav. Ministri i P. të Mbrendëshme
Ministri i P. Botore e Bujqësis *Ministri i Financavet*
MUSA JUKA S. STAROVA

Nr. 84.

LIGJË, 3 Dhetuer 1925.

Mbi shtimin e një kredije prej 5000 fr. ari për bursa të jashtme në budgetin e Drejtoris P. t' Arsimit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Dhetuer 1925, Nr. 86)

1. – I akordohet Budgetit në veprim të Drejtoris P. Arësimit nji shumë prej Fr. ari 5.000 për bursa të jashtme.

2. – Kjo Ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

3. – Ministria e Drejtësis dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejm këtë ligjë t' aprovueme prej trupave Legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 3-12-1925 A. ZOGU

Zav. Ministri i Drejtësis
Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 85.

RREGULLORE, 3 Dhetuer 1925.

Për inspektimin e përgjithshëm t' ushtris

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Dhetuer 1925, Nr. 86)

1) Inspektor i përgjithshëm i Ushtris asht nji Oficer Madhorë ndër ma të naltët, i cili nëpër jetën e vet ushtarake asht i zoti me e zbatue inspekcjonin e trupavet n' atë mëndyrë qi të rrjedhin nji dobië për shërbim.

2) Inspektori i përgjithshëm emnohet prej Presidentit (në cilsiën e vet si komandantë ma i naltë ushtriës).

3) Inspektor i përgjithshëm i nënshtrohet pa ndërmjetësië Presidentit si organ i tij për inspektimin e Trupavet.

4) Pranë inspektorit të Përgjithshem asht për t' u shenjue si adjutant nji oficer i rijë, i cili do t' a përcjellin dhe ndër të gjitha inspektimet, e do të jenë gjithmonë në disposition të tij. Përveç kësaj inspektor i përgjithshëm ka të drejtë për shërbëtor kual si mbas dispozitavet qi janë në fuqië për gradën e tij.

Inspektori i përgjithshëm e adjutanti i tij pa u marrë pa-

rasysh gradat kan të drejtë i pari për 20 fr. ari i dyti për 10 fr. ari në ditë shpenzime udhtimi deri sa ngjat inspektimi.

5) Inspektor i përgjithshëm ka me inspektue dy herë në vjet në nji kohë qi t' a shofin t' arsyeshme të gjitha trupat e zyrat e ushtriës Militarisht e Administrativisht.

6) Nji inspektim tjetër i përsëritun mbi ndonji pjesë t' ushtriës mund të bahet mbas urdhnit të Presidentit ose mbas propozimit të arësyeshëm t' inspektorit të përgjithshëm.

7) Inspektimet mbas pikavet 5 e 6 do të jenë konsiderue si inspektimet të paranjoftueme.

Në vend-qëndrimin e përhershëm e në rastin e qindrimit të ndonji ç' farë do garnizonit tjetër, inspektor i përgjithshëm mundet në çë do kohë pa i njoftue dhe shpesh herë me inspektue.

8) Mbi rezultatin e inspektimevet ka për t' u qit si mbas rastit nji raport me shkrim Presidentit e cila të përfshinjë materjet e shenjueme në pikat 5, 10 e 11.

Nji kopje e kësaj raportë ka me ju dërgue Komandës P. të Fuqis Armate.

9) Inspektimet përfshijnë:

Stërvitjet e oficervet, të nën-oficervet t' ushtarvet, n' ushtrime të mbylluna e të hapuna, n' ushtrime luftimi e shërbime fushore, në një të shtime.

Gjendjen e armëve të veshjes e të pajimit.

Gjendja e banimevet e të rregullimit të Kazermës.

Ushqimin, të të rujtunit e hygjenës e të Shëndetsiës.

Përdorimin e të drejtës dënimit disiplinore.

Administrim ndër trupa e ndër zyre (ekspozituarat e rekrutim).

Në rastin e inspektimevet munden me u mbajt me oficerat (aspiranta) dhe shoshitje taktike.

10) Me rastin e inspektimevet inspektori i Përgjithshëm do të vizitonjë depot e zyrat e rekrutimit edhe krejt gjendjen ushtarake, e zyrat e do të lajmërojnë edhe mbi ta.

Përveç këtyne ka për të lajmërue observacionet (vrejtjet) e bame mbi marrëveshtjen ndërmjet t' ushtriës, gjindarmeriës, e t' autoritetevet civile.

11) Asht për t' u lajmërue mbi stërvitje, sjellje e dobsi t' oficerave të vendeve të ndryshme të komandave e të zyrave emën për emën.

Sidomos ësht për t' u lajmërue cillët oficera e tjerë janë krejt të ç' mueshëm, ose të cilët duken qi nuk i gjegjen në kur nji mëndyrë detyrës së vet.

12) Mejtimet mbi oficerët me pikën 11 janë për t'u shenjue krye-vjetit në Komandën e P. të Fuqiës Armate me jetëshkrimin (në listën e qualifikacionit).

13) Inspektori i Përgjithshëm do të thirret prej Komardës P. të Fuqiës Armate në të gjitha komisionet e ndryshme qi përkasin :

a) Organizimit ;

b) Blerjet e materialit të Luftes të ç'do llojit ;

c) Ligj rregullore ;

d) Dislokacion ;

e) Mbrojtje Atdheut ;

f) Operacion e tjera të ndryshme ;

g) Ndër këto këshille vepron si përfaqësuës i Kryesis ;

h) Në vështrim të pikave 11, 12, Inspektori i Përgjithshëm asht edhe antar i komisionit për gradimin e oficeravet.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë rregullore të pranueme prej Këshillit Ministruer dhe urdhnojmë zbatimin e sajë.

Tiranë, me 3-XII-1925. A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme
dhe zav. Ministër i Drejtësis
H. VRIONI

Ministër i Financavet
S. STAROVA

Ministër i P. Botore e Bulqësis
e zav. Ministër i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 86.

LIGJË, 3 Dhetuer 1925.

Mbi Statutin e Urdhnit Skanderbeut

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer, 1925 Nr. 88)

1. — Për kujtim të shpalljes së Republikës në Shqipëri me 31-1-925 themelohet urdhni e medalja e Skenderbeut si i vetmi urdhën Shqiptar.

2. — Urdhni i Skenderbeut, epet në ç'do degë në meritimet për Republikë. Shenjat e urdhnave qi kanë me u dhanë për meritime ushtarake, ndryshojnë prej të tjerve në mënyrë, qi ata kanë të venduemë dy shpata kryesore.

3. — Shkallet (gradet) e urdhnit janë: (tue fillue prej ma të ultit deri ke ma i nalti):

1) Kavalier: fig. 1. ka me u mbajt në anën e sipërme të krahënuerit majtë me sherit, kuq e zi.

2) Oficer: Fig. 2. ka me u mbajt në anën e poshtëme të krahënuerit pa sherit.

3) Komanduer: fig. 3. ka me u mbajt në qafë me nji shirit kuq e zi.

4) Kordoni i Math (grand-cordon) fig. 4. Ka me u mbajt me nji shirit të gjanë kuq e zi, i varun prej supit të djathtë deri në ije të majtë.

5) Ylli baras fig. 5. Ka me u dhanë gjithmonë për njiherit me grand cordon, ose edhe si dekorim i veçantë për komanduer. Prandej gjithsejt janë 5 grada urdhnash si vijojnë:

1) Posa: e vetëm.
2) Posa: e vetëm.
3) Posa: e vetëm.
4) 3 me 5.
5) 4 me 5.

Për sovranë e Kryetarët e Shtetit, edhe për njerzit të naltë të Shteteve të huaj (hommes d' etat) me nji randësi të posatshme, krijohet nji klasë e veçantë e Urdhnit të Skenderbeut.

Ky urdhën ka formën e nji njishme si komanduer.

Me gjith kët, ky nuk asht bamë me kuaske (email), por Shqipja në rubina të lidhuna me ar qi ndjek anat e publishtes, skjepi kthetrat n' ar, ndër sy Brilante (xhevahir, Brilanta të vegjël).

Stema e midisme asht ba si vijon:

Emni i Skender Beut n' ar me fund të kjartë me ngjyrë të lapis lazuri; në vend të fundit arit, me brilanta të vegjël. Kunorë lisit, me Semeralda të lidhuna n' ar në vend të fundit arit, me brilanta.

Ky urdhën mbahet në nji kollan (katele).

Kjo kollanë përbahet prej medaljeve me fytyrë në krenat ideale, Skenderbeu, Lek Dukagjini, Mois Golem Dibra, Muzhaka, Tonus Topia, e Ismail Qemali, e cila bashkohet nën nga tri shqipe në kuaske (Email) të kuq si katenë (vargu) (fig. 6).

Veç këtyre, ka me u nxjerrë edhe nji medalje e Skenderbeut e shtypun n' argjent e në tunxh (bronz) (fig. 7). e cila ka me u mbajt si të tjerat n' anën e majtë të krahënuerit me shirit kuq e zi.

4. — E drejta e dhurimit, i përket vetëm Presidentit të Republikëë qi asht në fuqi.

Të dhanunit e urdhnit e të medaljes, është një shenjë mirësije (gratis) e Kryetarit të Shtetit, prandaj nuk mundet të kërkohet prej kur kujt si nji e drejtë.

5. — Propozimet për të dhanunit, janë për t' u ba me rast të nji veprës së deje për urdhën, ose edhe mbas nji shërbimi të bam ma së mirit për shumë vjet rjesht. Këto propozime, janë për t' u ba prej Zyravet sypërore në për Ministrit, relativisht nëpër Komandat e Fuqis Armate e të Gjendarmeris, dhe janë për t' u drejtue Zyrës Sekretaris të Presidentit të Republikës.

6. — Të dhanunit rregullisht, bahet nji herë në vjet, ditën e të Kremtes Kombëtare të Republikës (21-1-1925); dhe sa të jetë e mundun, prej vetë Presidentit.

7. — Sasia e urdhnavet të shkallës së kordonit të math kufizohet me 5 cop. Sasia e Komandeurve do të ndahet në 30; edhe ajo e shkallës së Oficerve, në 100. Në qoftë se plotësohet kjo sasi, at' herë mundet t' epen urdhna të tilla vetëm mbas vdekjes së proprietarve të shkallës, kordoni i math, komanduer e oficer.

8. — Mbas vdekjes së proprietarit shenjat e urdhnavet e medaljet, janë për t' u dorëzue zyrës së urdhnave. Në qoftë se familja don me i mbajt për kujtim at' here do të paguej çmimin e blerjes së tyne. Titullarit t' urdhnave të Skenderbeut në rast të vdekjes i bahen nderime të posatçme ushtarake si mbas klasës s' urdhnit.

9. — Me kohë, edhe vetëm nji personi mund t' i epen të gjitha gradat e urdhnit, (me këtë rrallë; medalja e tunxhit e argjentit edhe e arit e garadit e urdhnit si mbas radhës q' u shenjue n' art. III.).

Në qoftë se ndo njani mer ndonji gradë t' urdhnit ma të naltë ase ate qi ka, at' herë grada e fundit duhet dorëzue; *kjo nuk ka fuqi për gradën e dytë e për medalje.*

10. — Dënimi gjyqësuer për nji faj të ç' nderueshmë edhe delikt, sjell me vete edhe humbjen e urdhnit, relativisht humbjen e medaljes.

Kjo humbje do të përmendet edhe në vendim të Gjyqit.

11. — Urdhnat e medaljet, mund t' u nepen edhe shtetasve të huej për meritime të veçanta, ose në shenjë nderi. Këto urdhëna nuk kanë me u njeh në sasi të kufizuëme në pikën VII.

12. – Urdhnat e medaljet, janë për t' u mbajtun të kremtet zyrtare për ditët e tjera, mjafton me mbajt vetëm shiritin e urdhnit (o të medaljes) për ata qi janë me uniforma, m' anën e majtë të krahënuësit, me civilat m' anën e majtë në birën e sipërme të qafës.

13. – Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

14. – Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej trupave legjislative dhe urdhnojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 3 XII-1925.

A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme
e zav. Ministri i Drejtësiës
H. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
e zav. Ministri i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 87.

LIGJË, 21 Nëndor 1925.

Mbi rregullimin e të mbrapambetunave

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1925, Nr. 88)

I. – Autorizohet rregullimi i pagesave të mbrapambetuna si mbas dispozitave të nenit 5 të ligjës së kontabilitetit (vjet 327a-t) sot në veprim.

II. Çelet në Budgetin për ç' do degë administrative nga nji shtyllë pa shifër e cila mer emertimin „borxhe të vjetve të kaluem“ ku llogariten të gjith borxhet e përmenduna të cilat ndodhnëse kanë pasun kreditin e vet n' ushtrimin e përkatshëm e kanë qenë të penguem, kanë mbetë pa u pague deri në ditën e shpalljes së kësajë ligje.

III. – Pagesa e borxhevet të mbetuna nuk mund të kalojnë shumën e sasiës të mbrapambetunavet qi mund të nxirren mbrenda ushtrimit 1925–1926 e të cilat do të parashifen në buxhetin e t' ardhunavet të këtij vjeti.

IV. – Autorizohet pagesa e depozitave të pa kthyme e të shpenzuëme, të cilat kanë me u nxjerrë mbrenda vjetës 1925–1926.

V. – Inserohen në buxhetin e ushtrimit 1925–1926 të hy-

met nga ndalje pensioni si edhe të dalunat për pagesë pensjoni për ushtar e civila, e cila nuk do të kalonjë shumën e t'ardhunavet të nxjerruna nga përqindja për fond pensioni si mbas ligjës në fuqië.

VI. — Ministria e Financavet asht e autorizuëme për zbatimin e kësaj ligje.

VII. — Kjo ligjë hynë në fuqi me ditën e shpalljes në fletorën zyrtare dhe ka vleftë deri në mbarim t' ushtrimit financjar 1925 — 1926.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, aprovojmë këtë ligjë të pranuëme prej trupave legjislative si mbas shkresës Nr. 167 me 19-XI-1925 të Kryesis së Senatit dhe dekretojmë zbatimin e sajë.

Tiranë, me 21-XI-1925. A. ZOGU

Zav. Ministri i Drejtësiës
Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 88.

LIGJË, 5 Dhetuer 1925

Mbi shpërblimin e Kryetarit të Republikës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Dhetur 1925, N. 89)

1. — Shpërblimi i përmujshëm i Kryetarit të Republikës i caktuem në Statut prej Fr. ar 10.000 shtohet në Fr. ar 20.000.

2. — Këjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

3. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pranojmë këtë ligjë t' aprovueme prej Dhomavet Legjislative dhe dekretojmë zbatimin e saj.

A. ZOGU
Kryetari i Republikës

Tiranë, me 5 XII-925

Ministri i Financavet
S. STAROVA

BKSH

Nr. 89.

LIGJË, 5 Dhetuer 1925.

Mbi ndryshimin e artikujve 1, 2 e 3 të ligjës mbi internimin e familjeve dhe konfiskimin e pasuris së t'aratisunve

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Dhetuer 1925, Nr. 89)

I. — Të pandehunve me krim e delikt qi arratisen e qi nuk dorëzohen mbrenda 15 ditve të dorzimit të letër-shtërngimit, ju konfiskohet pasunia e tyne e tundshme dhe e pa tundshme dhe në qoft se ajo pasuni ka dhe pjestar të tjerë ju ndahet pjesa e tyne me anë të pleqsis së lagjës a të katundit dhe ju shitet pjestarve të të pa fajshëm; në mos e blefshin ata shitet me adjudikat dhe të hollat i porëzohen Financës së vendit; në mos dalt kush blerës, pasunia e pa tundshme regjistrohet si pasuni e Shtetit.

Kriminelvet t' aratisun ju internohet gjith fëmija mashkuj e femna qi gjinden në nji zjarrmë e banojnë tokërisht të pa ndamun.

Përjashtohen nga internimi pjestarët e gjinis qi janë uloga e studenta aktivë dhe nga gratë, vajzat e fejueme ma tepër se 15 vjeçe qi nuk kan dalë ke burri.

Vendi i internimit caktohet nga Ministria e P. të Mbrendëshme dhe vazhdon deri sa i aratisuni t' i dorzohet Qeveris ose të falet nga ana e Kryetarit të Republikës.

II. — Për ata që mbajnë e mshehin të aratisunit ose lehtësojnë aratisjen e tyne me dashje e pa shtrengim nga ndo nji anë, veprohet si mbas nenit 1. me përjashtimin e internimit të gravet dhe konfiskimin e pasunis së këtyneve.

III. — Në qoft se t' aratisunit, të cilve do t' u konfiskohet pasunija e do t' u shitet ose të regjistrohet si pasuni e Shtetit, kur t' aratisunit i dorëzohen Qeveris ose të falen nga ana e Kryesis së Republikës ose të vdesin, do t' u kthehen të hollat e vleftës së pasunis nga ana e arkës ose pasunija qi do të jetë e rregjistrueme si pasuni e Shtetit.

IV. Kjo ligjë hynë në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

V. — Ministria e P. të Mbrendshme dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej Dhomave legjislative dhe urdhnojmë zbatimin e saj.

Tiranë, 5 XII-925 — A. ZOGU

Zav. Ministri i Drejtësis
Ministër i P. të Jashtme
H. VRIONI

Zav. Ministër i P. të Mbrendshme
Ministri i P. Botore e Bujqësis
MUSA JUKA

Nr. 90.

LIGJË, 3 Dhetuer 1925.

Mbi shenjë kujtimin për ringrehjen e Qeveris Legale në Dhetor

(e botueme në letoren Zyrtare, 12 Dhetuer 1925, Nr. 89)

1. — Për kujtim të ri-ngrehjes së Qeverjës Legale të Shqipniës në Dhetuer 1924, themelohet nji Shenj kujtimit për gjith ata qi muarën pjesë në pregatitje e luftime të bame për këtë qëllim.

Dhënija e këtyne shënjave të kujtimit si mbas shkakut të sipërtreguëme bahet vetëm nji herë.

Mbas vdekjes së proprietarit, Shenji mbetet në proprietet të familjes si kujtim.

E drejta e mbajtjes së Shënjës së kujtimit, mund të rëxohet vetëm me rasë gjykimit për trathti atdheu.

2. — Kjo ligjë hynë në fuqië që ditën e shpalljes.

3. — Trupi Ministruer ngarkohet për zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej trupave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e sajë.

Tiranë, me 3-XII-1925. A. ZOGU

Zav. Ministri i Drejtësiës
Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financës
S. STAROVA

Nr. 91.

LIGJË, 3 Dhetuer 1925.

Mbi krijimin e një konsullate nderi në Pragë

1. Krijohet në Pragë të Çekosllavakisë nji Konsullatë Nderi pa kurrë farë shpenzimi.

2. Kjo ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes.

Ministrija e P. të Jashtme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej trupave legjislative dhe urdhënojmë zbatimin e saj.

Tiranë, 3-XII-1925

Kryetari i Republikës
A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

BKSH

Nr. 92.

KONVENCION, 3 Dhetuer 1925.

Mbi konçesionin e vaj-gurit shoqëris franceze

Nlërmjet t' Exelencës së Tij Ministrit të Punve Botore e Bulqësiës, veprues n' emën e për njehsie të Shtetit Shqiptar, që ka për t' u quejt tesh e mrapa „Shteti", në njenën anë;

e të Sindikatit Franko-Shqiptar i përfaqësuem prej Zotni Pierre Beaudouin, mandatar ligjuer, që ka për t' u quejt tash e mbrapa „Konçesjonari" (terme qi përfshien Sindikatin Franko-Shqiptar edhe Shoqënien ose Shoqëniët t' organizueme prej tij si mbas përshkrimit t' artikullit 9 të këtij Konvencioni, në tjetrën anë;

Asht konvenue e vendue ç' ka vazhdon:

Art. 1. – Shteti i akordon Konçesjonarit të drejtën ekslusive për kërkim dhe shfrytzim të voj-gurit, (hidrokarbure të langta, solide ase gasose, bitume dhe shkame asfaltike të cilat prodhojnë vojguri tue i distilue) mbi sypërfaqet dhe konditat e caktueme në këtë Konvencion.

Art. 2. – Konçesjonari detyrohet me tregue në nji afat gjasht (6) muejsh tue nisë që nga data e nenshkrimit të këtij Konvencioni kufijt e tokave të mbajtuna prej tij për me ba kërkime me konditat qi vijojnë:

a) Sasia e përgjithëshme të sypërfaqeve të mbajtuna nuk ka me mujt me qenë ma e madhe se njiqind e njizet mij (120.000) hektarësh.

b) Nga caktimi i tokave të zgjedhuna kan me u përjashtue ato vise mbi të cilat partië të treta kan fitue të drejtën për kërkimin e shfrytzimin e landëve të tregueme n' art. 1 përpara datës së nënshkrimit të këtij Konvencioni.

Me gjith këte po sa që Shteti të ket pranue kufijt e tokavet, Konçesjonari i ka të fitueme të drejtat mbi tokat e caktueme.

c) Numri i pjesëvet të tokavet nuk ka me mujt me qenë qenë ma tepër se katër (4).

Art. 3. – Konçesjonari ka me pasë të drejtën eksklusive, për tri vjet rresht tue nisë që nga data e njoftimit formal mbi zgjedhjen e njiqind e njizet mij (120.000) hektarve të caktuem n' art. 2, me ba mbi viset e tregueme të gjitha punimet e kërkimít, si në sypërfaqe ashtu në thellësië me qëllim qi me zbulue landën e tregueme n' art. 1.

CONVENTION

Entre S. E. le Ministre des Travaux Publics et de l' Agriculture, agissant au nom et pour le compte de l' Etat Albanais, à désigner dans la suite comme «l' Etat», d' une part ;

Et le Syndicat Franco-Albanais représenté par Monsieur Pierre Beaudouin, mandataire légal, et à désigner dans la suite comme „le Concessionnaire" (terme désignant le syndicat Franco-Albanais et la ou les Société par lui organisées conformement à l' article 9 de la présente convention, d' autre part ;

Il a été convenu et arrêté ce qui suit :

Art. 1. — L' Etat accorde au Concessionnaire le droit exclusif de recherche et d' exploitation du pétrole, (hydrocarbures liquides, solides ou gazeux, bitumes et reches asphaltiques aptes à produire de l' huile par destillation) sur les superficies et aux conditions fixées dans la présente convention.

Art. 2. — Le Concessionnaire s' engage à indiquer dans le terme de six (6) mois à partir de la date de la signature de la présente convention la délimitation des territoires par lui retenus pour a faire des recherches sous les conditions suivantes :

a) L' ensemble des superficies retenus ne pourra pas être supérieur à cent vingt mille (120.000) hectares.

b) De l' indication des terrains choisis seront exclus les territoires sur lesquels des tierces parties auraient dé à acquis avant la signature de cette convention des droits pour la recherche et l' exploitation des susbstances indiquées dans l'art. 1. Toutefois dès que la délimitation des terrains aura été acceptée par l' Etat les droits du Concessionnaire sur les terrains ainsi désignés seront acquis.

